



REPUBLICA E SHqipërisë
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

AKPT

AGJENCIA KOMBETARE E
PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT



BASHKIA PUKË

**HARTIMI I
PLANIT TË
PËRGJITHSHËM VENDOR
për Bashkinë PUKË**

FAZA I-rë

RELACIONI TEKNIK

Shtator 2017



AUTORITETI KONTRAKTOR:

MIRATOHET:

KONTRAKTUESI:

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN



OPERATORIT EKONOMIK
GAIA S.A.



ISO 9001:2008 Certificate No 2194 IAF Code 34 & 35 ASR

MONASTIRIOU 95, 54627 THESSALONIKI TEL.2310516732 / 2310540107 Fax 2310555659 Email: info@gaiasa.gr Web site: www.gaiasa.gr

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	6
1. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE	8
1.1. Pozicioni strategjik	8
1.2. Evolucion i historik	10
1.3. Analiza dhe vlerësimi i mjedisit natyror	11
1.3.1. Klima	11
1.3.2. Gjeologjia	20
1.3.3. Kushtet hidrogeologjike	26
1.3.4. Makrozonimi – mikrozonimi sizmik	27
1.3.5. Peisazhi dhe elemente të rëndësishme që ndikojnë në të	34
1.3.6. Boniteti i tokës	43
1.3.7. Topografi- Modeli Dixhital i Lartesisë (D.E.M.) – Hidrologji	55
1.3.8. Analiza e elementeve kimike	61
1.3.9. Informacion për geo-mjedisin	62
1.3.10. Të dhëna për burimet gjeologjike	64
2. ANALIZA, RISHIKIMI I PLANEVE EKZISTUESE, STRATEGJITË, POLITIKAT, NORMAT DHE STANDARTET	75
2.1. Analiza e legjislacionit kombëtar e lokal të planifikimit të territorit dhe kuadri ligjor	75
2.1.1. Plani territorial në Shqipëri - Hyrje	75
2.1.2. Strategji dhe direktiva të planifikimit sektorial	82
2.1.3. Kuadri European për planifikimin territorial	101
2.2. Shqyrtimi i direktivave të planifikimit urban dhe sektorial, standardet dhe normat ekzistuese kombëtare	103
2.2.1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar	105
2.2.2. Plani i Integruar Bregdetar Ndërsektorial	126
2.2.3. Plani i Integruar Ndër-sektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës	130
2.2.4. Plane rajonale dhe vendore	132
2.2.5. Zonat dhe objektet me rëndësi kombëtare	136
2.2.6. Shqyrtimi i standardeve ekzistuese kombëtare dhe normativat përkatëse	138

3. ANALIZA E DOKUMENTEVE TE NJESISE SE PLANIFIKIMIT TE QEVERISE VENDORE TE MEPARSHME.....	145
3.1. Analiza e inventari të territorit të bashkisë	145
3.2. Rishikimi i Planeve ekzistuese të Përgjithshme Vendore	147
4. ANALIZA E ELEMENTEVE TË MJEDISIT – NIVELET E NDOTJES – ZONAT E MBROJTURA.....	152
4.1. Elementet e Mjedisit	152
4.1.1. Burimet ujore.....	152
4.1.2. Resurset natyrore	154
4.1.3. Biodiversiteti	155
4.2. Zonat e mbrojtura natyrore.....	158
4.3. Problem mjedisore – ndotja	166
4.3.1. Ndotja industriale.....	166
4.3.2. Cilësia e ajrit – ndotja akustike – ndotje të tjera.....	167
4.3.2.1. Ndotja akustike.....	167
4.3.2.2. Cilësia e ajrit – ndotje të tjera.....	170
4.3.3. Rreziqet- impakti.....	171
4.3.3.1. Presionet mbi akuiferët.....	171
4.3.3.2. Formacionet litologjike, inkuadrimi gjeologjik i tyre.....	171
4.3.3.3. Fenomenet e rrezikut gjeologjik, përhapja dhe përshkrimi i tyre	180
5. ANALIZA E VLERËSIMEVE DEMOGRAFIKE, ASPEKTE SOCIOEKONOMIKE DHE MJEDISIT KULTUROR.....	184
5.1. Analizë e vlerësimit demografik	184
5.2. Analiza dhe probleme për gjendjen e strehimit	191
5.3. Analiza e aspekteve ekonomike.....	200
5.4. Analiza dhe problematikat e situatës së punësimit	219
5.5. Analiza e tokës dhe çështja e pronës	225
5.6. Analiza e shërbimeve publike	229
5.7. Analiza e aspekteve sociale.....	233
5.8. Analiza Periferike	242
5.9. Monumente dhe zona të trashëgimisë kulturore dhe historike.....	250

5.10.	Të dhëna për Personat me Përgjegjësi të Kufizuar	255
5.11.	Të dhëna mbi arsimin profesional	256
6.	ANALIZA DHE VLERËSIMI I PËRDORIMEVE TË TOKËS DHE MJEDISIT TË NDËRTUAR	258
6.1.	Sistemi natyror i përdorimit të tokës	258
6.2.	Sistemi i përdorimit të vijave të tokës	259
6.3.	Sistemi i përdorimit të tokës buqësore	259
6.4.	Sistemi i përdorimit të tokës urbane	260
6.5.	Sistemi i përdorimit të tokës së infrastrukturës	261
6.6.	Kategoritë bazë të përdorimit të tokës	262
7.	ANALIZA DHE VLERËSIMI I INFRASTRUKTURËS	265
7.1.	Transporti.....	265
7.2.	Sistemi furnizimit me uje.....	269
7.3.	Sistemet e kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza	269
7.4.	Sistemi i ujitjes	270
7.5.	Menaxhimi i mbetjeve të ngurta	270
7.6.	Rrjetet teknologjike	270
8.	ANALIZA E INVESTIMEVE	272
9.	STRUKTURA E QENDRAVE URBANE, FUNKSIONET EKZISTUESE, LLOJET KRYESORE	280
9.1.	Struktura kryesore e qendrave urbane.....	280
9.2.	Hapësirat e lira publike	289
10.	METABOLIZMI URBAN	293
10.1.	Të përgjithshme.....	293
10.2.	Energjia.....	294
10.3.	Uji	300
10.4.	Materialet.....	306
10.5.	Mbetjet dhe emetimet	306
10.6.	Konkluzione.....	311
11.	DATAVAZA TERRITORIALE	313
11.1.	Analiza e situatës aktuale	313
11.1.1.	Inventarizimi i të dhënave	313

11.1.2. Hardware dhe software	313
11.1.3. Pajisje të tjera teknike	313
11.1.4. Burimet njerëzore	314
11.1.5. Telekomunikacioni	314
11.1.6. Cështjet e lëvizshmërisë	314
11.2. Krijimi dhe Përditësim i strukturës së bazës së të dhënave i strukturës bazë e të dhënave ...	314
12. VLERËSIMI TE DHËNAVE, PROBLEMEVE DHE PERSPEKTIVAVE	326
13. REFERENCAT	328
ANEKS	331

HYRJE

Ky material është një pjesë e Fazës A' të studimit «Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Pukë». Planet e Përgjithshme Vendore janë plane territoriale që kryhen në nivel bashkie dhe duhet të hartohen në vijim të Reformës Territoriale Administrative, Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Plave Ndër-sektoriale e Sektoriale. Si projekte të planifikimit, është e nevojshme një analizë e situatës aktuale në disa nivele, Strategjia dhe Plani Territorial duhet të përcaktohen, me të gjitha veprimet strategjike, investimet kapitale dhe projekteve pilote të zhvillimit. Plani i Zhvillimit Territorial dhe Rregullorja Vendore do të formësohen si rezultat i procesit të planifikimit dhe konsultimeve publike dhe organizimit të seancave dëgjimore. Së fundmi, Plani i Përgjithshëm Vendor do të shoqërohet nga Vlerësimi Strategjik Mjedisor.

Për studimin "Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkitë: MIRDITË, PUKË", u nënshkrua një kontratë më 04-07-2017 ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe GAIA S.A., ndërsa, në të njëjtën kohë, u nënshkrua marrëveshja trepalëshe ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, Bashkisë Pukë dhe kompanisë GAIA S.A. Studime, më 06-07-2017.

Pas nënshkrimit të kontratës, u realizua takimi për shpalljen e procesit të hartimit të Planit të Përgjithshëm, ditën e Enjte, më 06.07.2017, ku edhe u prezantuan pikat kyçe dhe hapat për përgatitjen dhe përfundimin e studimit dhe u analizuan rolet e të gjitha palëve të përfshira. Në kuadër të takimit të parë u realizua edhe prezantimi i njohjes midis kryetarit të Bashkisë z. Gjon Gjonaj dhe nëpunësit z. Petrit Dodaj, GIS Ekspert si dhe përfaqësuesve të studiuesve të shoqërisë GAIA S.A. STUDIME, në vazhdim, filluan punimet për grumbullimin dhe analizën e të dhënave.

Duhet të theksohet se në lidhje me kufijtë administrativë të Bashkisë, në hartat e studimit paraqiten dy kufij. Njëri kufi u miratua në bazë të të dhënave të Ministrisë së Zhvillimit Urban, ndërsa kufiri tjetër reflekton sygjerimet e Bashkisë.

Në këtë pikë dëshirojmë të falënderojmë kryetarin e Bashkisë së Pukës z. Gjon Gjonaj për bashkëpunimin dhe sigurimin e informacionit të vlefshëm për vizionin e qytetit.

Dëshirojmë gjithashtu të falënderojmë të gjithë stafin e Bashkisë dhe posaçërisht Eduard Sokoli, Arkitekt, Drejtor Urbanistike, Endrit Kraja, Jurist, Gjin Filipi, Pergjësës Sektori i Pyjores, Denisa Islami, Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore, Mirjana Pashkaj, Specialiste IT dhe Turizëm, Agron Hadroj, Përgjegjës PMNZSH dhe Behar Ademi, Specialist në Sektorin e Shërbimeve dhe z. Petrit Dedaj, Specialist Hartograf, me të cilët kemi pasur komunikim të vazhdueshëm, bashkëpunim dhe shkëmbim të dhënash dhe mendimesh gjatë gjithë Fazës A.

Në këtë kontekst, u morën të dhënat e ruajtura nga bashkia (dokumentat në CAD, harta analoge dhe tekste - tabela digjitale), si dhe arkivat e marra në një fazë më të hershme nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor (ASIG). Ky bashkëpunim vazhdoi gjatë gjithë Fazës së parë, ku në kombinim edhe me interesin e bashkisë për zbatimin e duhur të kësaj faze, çoi në marrjen nga ana jonë e të dhënave që bashkia zotëronte. Sigurimi i fakteve nga të dhënat e ruajtura dhe të mbledhura nga bashkia, si edhe nga departamentet e ndryshme të përfshira, filloi me nënshkrimin e kontratës.

Gjatë gjithë zhvillimit të përgatitjes së Fazës A të studimit, kishte një bashkëpunim të plotë dhe komunikim të dyanshëm me AKPT dhe z. Taulant Dano dhe z. Ermal Pashollari, të cilët janë mbikëqyrësit e përgjithshëm dhe koordinatorët e planit «Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për bashkitë: MIRDITË, PUKË», të cilin do të dëshironim ta falënderonim për kontributin e tij të rëndësishëm në hartimin e Fazës A të studimit.

Së fundi, do të donim të falënderonim të gjithë anëtarët e Grupit të Studimit GAIA SH.A. STUDIME dhe veçanërisht partnerët vendorë:

znj. Diana Bardhi, Inxhinierë Civile, Udhëheqëse e Ekipit, Zyra Vendore e Tiranës

znj. Boriانا Golgota, Arkitekthe & Urbaniste, Zyra Vendore e Tiranës

z. Elton Toska, Arkitekt, Koordinator i të gjitha Ekipeve Vendore në bashkitë Pukë dhe Mirditë

znj. Etmira Kanani, Eksperte Ligjore

1. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE

1.1. Pozicioni strategjik

Bashkia Pukë është ndodhet në pjesën veriore të Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe prej 1,033.39 km² dhe një popullsi prej 11.069 banorë (Census 2011). Nga pikëpamja administrative, Qarku Shkodër (në veri të Shqipërisë) i cili përfshin Bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Vau-Dejës dhe Fushë-Arrëz, kufizohet me Malin e Zi dhe Kosovën. Qendra e Bashkisë Pukë është qyteti me të njëjtin emër.

Bashkia Pukë kufizohet në veri - veriperëndim me Bashkinë e Vaut të Dejës; në lindje - verilindje me Bashkinë Fushë-Arrëz, të cilat ndodhen brenda Qarkut Shkodër, dhe në jug me Bashkitë Mirditë dhe Lezhë, të Qarkut Lezhë, duke pasur si kufij natyral kreshtat malore Maja e Runës, Thirrës, Maja e Roshit dhe Bjeshkët e Tërbunit.

Kufinj të Bashkisë Pukë u ri-përcaktuan në kuadër të projektit të fundit të qeverisjes qendrore, në përputhje me Ligjin Nr.115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” i cili ripërcaktoi kufijtë e njësive vendore dhe rajonale. Si rrjedhojë me konfigurimin e ri, Bashkia përbëhet 5 prej njësish administrative:

- Ish Bashkinë Pukë, e cila përfshin qytetin dhe fshatin me të njëjtin emër dhe fshatin Lajthizë.
- Ish Komunën Gjegjan, që përfshin fshatrat: Dom, Gjegjan, Gojan i Vogël, Rras, Kuzhnën, Gojan i Madh, Shkozë, Kimëz, Kalivare dhe Mesul.
- Ish Komunën Rrapë, që përfshin fshatrat: Breg, Rrapë, Kabash, Buhot, Bicaj, Bilnisht, Lumzi dhe Meçe.
- Ish Komunën Qelëz, që përfshin fshatrat: Qelëz, Bushat, Dushnezë, Midhë, Buzhalë, Dedaj, Levrushk, Ukth dhe Qerret i Vogël.
- Ish Komunën Qerret, që përfshin fshatrat: Qerret, Luf, Dush, Karmë, Kcirë, Luf-Plan, Korthpulë, Kaftall, Tejkodër, Gomsiqe, Vrith dhe Plet.

Në bazë të propozimit të Bashkisë për kufirin administrativ, fshati Koman përfshihet në zonën e studimit për Planin e Përgjithshëm Vendor, i cili sipas Ligjit Nr.115/2014 i përket Bashkisë Vau i Dejës.

Terreni është malor (me një lartësi mesatare mbi nivelin e detit prej 787m mbi nivelin e detit) dhe i larmishëm, me maja të larta, shpate të mprehta, lugina, kanione, shpella dhe rrjet të pasur hidrografik me lumenj, përrenj, burime dhe ujëvara. Sipërfaqjet e gjerë të tokës janë të mbuluara me pyje dhe livadhe. Nga veriu rrjedh lumi Drin dhe formohen liqenet Koman–Fierzë.

Bashkia ka një histori të gjatë dhe gjurmë të ruajtura e të shpërndara në pjesë të ndryshme të territorit të saj. Legjendat, traditat dhe zakonet mbijetojnë dhe janë ringjallur nëpër ngjarje të ndryshme kulturore.

Banorët janë të punësuar në bujqësi, blegtori dhe në qytet në biznese të vogla dhe të mesme. Gjithashtu, vlen të përmendet se në zonën e studimit janë zhvilluar aktivitete industriale dhe minerare për shkak të depozitave të pasura dhe rezervave me lëndë të para, veçanërisht minerale, por në vitet e fundit këto aktivitete janë ndërprerë.




Figura 1.1.1: pozicioni i Bashkisë Pukë në nivel kombëtar, dallohen kufijtë e rinj administrativë (burimi: Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit në Shqipëri - Manual Teknik)

Infrastruktura kryesore rrugore, e cila ofron qasje bazë në bashki, është rruga SH5 që i përket rrjetit primar rrugor kombëtar, i cili e lidh së pari me Kukësin dhe Morinën portën kryesore për në Kosovë dhe së dyti me Shkodrën, qendër kryesore urbane dhe një Kombëtare multimodale, bregun perëndimor të vendit dhe Hanin e Hotit si portë për Malin e Zi.

Avantazhet krahasuese të Bashkisë janë trashëgimia kulturore (e prekshme dhe e paprekshme), peizazhi veçanërisht i bukur, mjedis i qetë dhe i pastër, flora dhe fauna e shquar, burimet e pasura natyrore (rezervat minerale, pyje, ujra), dhe produktet bujqësore dhe blegtorale (duke përfshirë bimët medicinale dhe manaferrat) dhe kualifikimi i banorëve në grumbullimin dhe përpunimin e tyre. Këto të dhëna ofrohen për diversifikimin / forcimin e ekonomisë lokale dhe zhvillimin e aktiviteteve të reja të tilla si turizmi alternativ dhe malor.

1.2. Evolucioni historik

Shqipëria gjendet në gadishullin ballkanik, në pjesën perëndimore të tij dhe kufizohet me shtete si Greqia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Kosova; ndërsa në perëndim laget nga deti Adriatik dhe Jon. Malet mbulojnë rreth 75% të territorit, i cili vlerësohet si shumë i pasur me burime ujore mbitokësore e nëntokësore; ndërsa pjesa perëndimore e vendit është kryesisht fushore. Vargmalet shqipëtare janë Alpet e Shqipërisë në veri, Vargu Lindor në zonën e Kukësit e deri në Liqenin e Ohrit, Vargu i Maleve Qëndrore që nisin në Dukagjin e përfundojnë në Korçë, Vargmalet Detare që nisin në Lezhë e përfundojnë në Tiranë dhe Malet Jugore që nisin nga jugu i Korçës e deri në Gjirokastër. Shqipëria dallohet për numër të mash pasurish ujore, ku dallojmë lumenjtë: Buna, Drini, Fani, Ishmi, Erzeni, Shkumbini, Semani, Devolli, Osumi, Vjosa, Shushica dhe Drino; si dhe liqenet e Shkodrës, Ohrit dhe Prespës.

Emri i Bashkisë së Pukës erdhi nga fjala "Via Publika", siç quhej rruga e ndjekur nga udhëtarët dhe karvanët në periudhën Antikitetit dhe Mesjetës. Kjo rrugë përfshinte disa vendbanime të rëndësishme si Lissus-Scodra-Kukës-Dardania. Në këtë rrugë një ndalesë ishte dhe vendbanimi Ad Picaria, i cili daton të ketë qenë i banueshëm rreth 2000 vjet më parë. Ky vendbanim është përshkruar në hartat e Perandorisë Romake të shekullit të 2-të. Emri në shqip do të thotë Pezhve. Herë pas here populli i Pukës u thirr me emra të ndryshëm. Në vitet 1637-1638, Frang Bardhi e quan Pukën si Dukagjin. Burimet arkeologjike raportojnë se zona është emëruar kohë pas kohe si lisi i Lekës, sofa e Lekës, kalaja e Lekës etj.

Terreni malor intensiv çoi në ndarjen e territorit në kategori gjeografike, etnike dhe gjeografike. Ky kategorizim rezultoi në ndarje më të vogël në 7 njësi, të quajtura bajrak. Puka është e banuar që nga lashtësia nga fiset e Ilirëve dhe Piruseve, ndërsa veprimtaria mbizotëruese e banorëve të saj ishte nxjerrja dhe shfrytëzimi i metaleve të zones.

Bashkia Pukë ka një numër vendesh arkeologjike dhe monumentesh nga të cilat dallohen Kalaja e Shqelit, kështjellë e ndërtuar nën Perandorinë Romake në shekullin II-V, Këçirë Pukë, Fortesa e Gralishtit, kështjellë e ndërtuar nën Perandorinë Romake-Sllave gjatë shekujve II-VII, Grad – Gralisht Bugjon Pukë. Një tjetër monument i rëndësishëm është Forteza e Dalmacies që u ndërtua në shekujt e IV – VIII në Koman Pukë dhe Kalaja e Zhubit e epokës romake - sllave, e cila u ndërtua gjatë shekullit VI - VII në Zhub Pukë.

Gjatë periudhës 1878-1881 dhe 1885 Puka ishte mbështetja e sigurt e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me pjesëmarrjen e figurave të rëndësishme historike si Ismail Age Kryeziu, Hoxha Puka, Musa

Dizdari et. Ndërmjet viteve 1911 dhe 1912, Puka mori pjesë në lëvizjen kombëtare të lirisë (lëvizjen mbarë kombëtare për liri dhe pavarësi) dhe u çlirua më 12 Shtator 1912.

1.3. Analiza dhe vlerësimi i mjedisit natyror

1.3.1. Klima

Shqipëria është një vend mesdhetar. Klima e saj karakterizohet nga dimër i lagësht, i butë dhe verë të nxehtë dhe të thatë. Regjimi i klimës ndikohet herë pas here nga sistemet atmosferike, si përplasjet nga Oqeani Atlantik i Veriut dhe Deti Mesdhe, dhe anticiklone që vijnë nga Siberia dhe Azoret. Një faktor tjetër kyç që ndikon në klimën është afërsia me detin.

Territori i Shqipërisë është i ndarë në katër zona të ndryshme klimatike:

- Mesdhetare Fushore
- Mesdhetare kodrinore
- Mesdhetare kontinentale
- Mesdhetare Malore





Figura 1.3.1.1: Ndarja klimaterike ne Shqiperi (IHM 1978) (Burimi: <http://aea-al.org/climate-characteristics-of-albania/>)

Në Pukë, klima është e ngrohtë dhe e butë. Ka reshje të mjaftueshme gjatë gjithë vitit. Edhe në muajin më të thatë të vitit ka akoma shumë reshje shiu. Reshjet mesatare vjetore janë 1270 mm. Muaji më i thatë është korriku, ku reshjet janë 54 mm. Pjesa më e madhe e reshjeve bie në nëntor, me një mesatare prej 161 mm. Reshjet ndryshojnë 107 mm midis muajit më të thatë dhe muajit më të lagesht.


Temperatura mesatare vjetore është 10.2°C në Pukë. Muaji më i ngrohtë është korriku me një mesatare prej 19.5°C. Në janar, temperatura mesatare është 0.5°C. Kjo është temperatura mesatare më e ulët e tërë vitit.

	January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November	December
Avg. Temperature (°C)	0.5	2	5.1	9	13.5	17.2	19.5	19.5	15.9	11.1	6.2	2.3
Min. Temperature (°C)	-2.8	-1.5	1	4.5	8.6	12.1	14	13.9	10.7	6.7	2.8	-0.8
Max. Temperature (°C)	3.8	5.5	9.3	13.5	18.5	22.3	25.1	25.1	21.2	15.5	9.7	5.5
Avg. Temperature (°F)	32.9	35.6	41.2	48.2	56.3	63.0	67.1	67.1	60.6	52.0	43.2	36.1
Min. Temperature (°F)	27.0	29.3	33.8	40.1	47.5	53.8	57.2	57.0	51.3	44.1	37.0	30.6
Max. Temperature (°F)	38.8	41.9	48.7	56.3	65.3	72.1	77.2	77.2	70.2	59.9	49.5	41.9
Precipitation / Rainfall (mm)	132	118	111	106	97	68	54	60	91	121	161	151

Tabela 1.3.1.1: Të dhënat historike të motit, Pukë (burimi: <https://en.climate-data.org>)



Grafiku 1.3.1.1: Temperaturë, Pukë (burimi: <https://en.climate-data.org>)



Grafiku 1.3.1.2: Klima, Pukë (burimi: <https://en.climate-data.org>)


Gjegjan

Në Gjegjan klima është e ngrohtë dhe e butë. Gjegjani është një qytet me reshje të rëndësishme. Edhe në muajin më të thatë ka shumë shi. Reshjet mesatarisht 1268 mm. Muaji më i thatë është korriku, me 47 mm reshje shiu. Pjesa më e madhe e reshjeve këtu bie në nëntor, mesatarisht 164 mm. Dallimi në reshjet midis muajit më të thatë dhe muajit më të keq është 117 mm.


Temperatura mesatare vjetore është 12.5°C. Muaji më i ngrohtë i vitit është korrik, me një temperaturë mesatare prej 22.3°C. Janari është muaji më i ftohtë, me temperatura mesatare prej 2.4°C.

	January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November	December
Avg. Temperature (°C)	2.4	4.2	7.3	11.5	16.1	19.9	22.3	22.2	18.3	13.2	8.4	4.3
Min. Temperature (°C)	-0.8	0.6	3	6.8	11	14.6	16.6	16.4	12.8	8.6	4.9	1.1
Max. Temperature (°C)	5.7	7.8	11.7	16.3	21.3	25.3	28	28	23.8	17.8	12	7.5
Avg. Temperature (°F)	36.3	39.6	45.1	52.7	61.0	67.8	72.1	72.0	64.9	55.8	47.1	39.7
Min. Temperature (°F)	30.6	33.1	37.4	44.2	51.8	58.3	61.9	61.5	55.0	47.5	40.8	34.0
Max. Temperature (°F)	42.3	46.0	53.1	61.3	70.3	77.5	82.4	82.4	74.8	64.0	53.6	45.5
Precipitation / Rainfall (mm)	138	125	112	107	92	61	47	53	90	120	164	159

Tabela 1.3.1.2: Të dhënat historike të motit, Gjegjan (burimi: <https://en.climate-data.org>)



Grafiku 1.3.1.3: Temperaturë, Gjegjan (burimi: <https://en.climate-data.org>)



Grafiku 1.3.1.4: Klima, Gjegjan (burimi: <https://en.climate-data.org>)


Rrapë

Klima këtu është e butë, përgjithësisht e ngrohtë dhe e butë. Në Rrapë bie shumë shi, edhe në muajin më të thatë. Rreth 1245 mm reshje bie çdo vit. Reshjet janë më të ulëta në korrik, me një mesatare prej 54 mm. Sasia më e madhe e reshjeve ndodh në nëntor, me një mesatare prej 158 mm. mes muajve më të thatë dhe më të lagë, dallimi në reshje është 104 mm.


Temperatura mesatare vjetore në Rrapë është 10.2°C. Me një temperaturë mesatare prej 19.7°C, në gusht dhe 19.6°C në korrik, janë muajt më të nxehtë të vitit. Temperaturat mesatare më të ulëta të vitin ndodhin në janar, kur janë rreth 0.4°C.

	January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November	December
Avg. Temperature (°C)	0.4	2	5.2	9.1	13.8	17.3	19.6	19.7	16.1	11.2	6.2	2.3
Min. Temperature (°C)	-2.8	-1.5	1	4.6	8.8	12.2	14.1	14	10.8	6.8	2.8	-0.8
Max. Temperature (°C)	3.7	5.5	9.4	13.7	18.8	22.5	25.2	25.4	21.4	15.6	9.7	5.5
Avg. Temperature (°F)	32.7	35.6	41.4	48.4	56.8	63.1	67.3	67.5	61.0	52.2	43.2	36.1
Min. Temperature (°F)	27.0	29.3	33.8	40.3	47.8	54.0	57.4	57.2	51.4	44.2	37.0	30.6
Max. Temperature (°F)	38.7	41.9	48.9	56.7	65.8	72.5	77.4	77.7	70.5	60.1	49.5	41.9
Precipitation / Rainfall (mm)	129	115	108	104	96	67	54	59	90	118	158	147

Tabela 1.3.1.3: Të dhënat historike të motit, Rrapë (burimi: <https://en.climate-data.org>)



Grafiku 1.3.1.5: Temperaturë, Rrapë (burimi: <https://en.climate-data.org>)



Grafiku 1.3.1.6: Klima, Rrapë (burimi: <https://en.climate-data.org>)


Qerret i Madh

Në Qerret i Madh klima është e butë dhe përgjithësisht e ngrohtë dhe e qëndrueshme. Ka një sasi të madhe të reshjesh edhe në muajin më të thatë. çdo vit ka rreth 1330mm reshje. Reshjet janë më të pakta në korrik me një mesatare prej 52mm, ndërsa sasia më e madhe bie në nëntor me një mesatare prej 170mm. Midis muajve më të thatë dhe më të lagësht, diferenca në reshje është 118 mm.


Temperatura mesatare vjetore është 11°C. Korriku është muaji më i nxehtë i vitit me 20.6°C dhe gusht me 20.4 me 1.3°C më i ftohti është Janari me 1.3°C.

	January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November	December
Avg. Temperature (°C)	1.3	2.8	5.9	9.8	14.5	18.1	20.6	20.4	16.8	11.9	7.1	3.1
Min. Temperature (°C)	-1.9	-0.7	1.8	5.3	9.5	13	15.1	14.8	11.6	7.5	3.6	-0.1
Max. Temperature (°C)	4.6	6.4	10.1	14.4	19.5	23.3	26.1	26.1	22.1	16.3	10.6	6.3
Avg. Temperature (°F)	34.3	37.0	42.6	49.6	58.1	64.6	69.1	68.7	62.2	53.4	44.8	37.6
Min. Temperature (°F)	28.6	30.7	35.2	41.5	49.1	55.4	59.2	58.6	52.9	45.5	38.5	31.8
Max. Temperature (°F)	40.3	43.5	50.2	57.9	67.1	73.9	79.0	79.0	71.8	61.3	51.1	43.3
Precipitation / Rainfall (mm)	142	127	117	112	97	68	52	60	96	127	170	162

Tabela 1.3.1.4: Të dhënat historike të motit, Qerret i Madh (burimi: <https://en.climate-data.org>)



Grafiku 1.3.1.7: Temperaturë, Qerret i Madh (burimi: <https://en.climate-data.org>)



Grafiku 1.3.1.8: Klima, Qerret I Madh (burimi: <https://en.climate-data.org>)


Qerret i Vogël

Në Qerret i Vogël klima është e butë dhe përgjithësisht e ngrohtë. Bie një sasi e madhe reshjesh edhe në muajin më të thatë. Në çdo vit bien rreth 1384mm reshje. Reshjet janë më të pakta në korrik me një mesatare prej 50mm, ndërsa sasia më e madhe bie në nëntor me një mesatare prej 178mm. Midis muajve më të thatë dhe më të legësht, diferenca në reshjet është 128 mm.


Temperatura mesatare vjetore është 11,9°C. Korriku është muaji më i nxehtë i vitit me 21.5°C dhe janari është më i ftohti me 2.0°C.

	January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November	December
Avg. Temperature (°C)	2	3.6	6.8	10.8	15.3	19.1	21.5	21.4	17.8	12.7	7.9	3.8
Min. Temperature (°C)	-1.2	0	2.6	6.2	10.3	14	16	15.8	12.5	8.2	4.4	0.6
Max. Temperature (°C)	5.3	7.2	11.1	15.4	20.4	24.3	27.1	27.1	23.1	17.2	11.4	7.1
Avg. Temperature (°F)	35.6	38.5	44.2	51.4	59.5	66.4	70.7	70.5	64.0	54.9	46.2	38.8
Min. Temperature (°F)	29.8	32.0	36.7	43.2	50.5	57.2	60.8	60.4	54.5	46.8	39.9	33.1
Max. Temperature (°F)	41.5	45.0	52.0	59.7	68.7	75.7	80.8	80.8	73.6	63.0	52.5	44.8
Precipitation / Rainfall (mm)	151	136	123	117	97	67	50	60	99	132	178	174

Tabela 1.3.1.5: Të dhënat historike të motit, Qerret i Vogël (burimi: <https://en.climate-data.org>)



Grafiku 1.3.1.9: Temperaturë, Qerret i Vogël (burimi: <https://en.climate-data.org>)



Grafiku 1.3.1.10: Klima, Qerret i Vogël (Burimi: <https://en.climate-data.org>)

1.3.2. Gjeologjia

1.3.2.1. Hyrje

Shqipëria ndodhet në kufirin e jashtëm të Detit Adriatik, midis Dinarideve në veri (Mali i Zi, etj.) dhe Helenideve në jug (Greqi) (Fig. 1.3.2.1.2).

Gjeotektonikisht, Shqipëria është pjesë e zinxhirit Peri-Adriatik të sistemit orogjenik Alpin. Ky sistem përfshin Albanidet-Dinaridet-Helenidet dhe Apeninet, që janë produkt i subduksionit të tyre dhe historisë së kolizionit dhe aktualisht janë të ndara nga kepi Puglia- Adriatik (Fig. 1.3.2.1.1).

Sipas Velaj, T. (2015) gjeologjikisht, mund të dallohen tre njësi të mëdha gjeologjike në Albanide: (i) në kepin autokton Puglia-Adriatik, (ii) orogjeni i Albanideve që ndahet në Albanidet e jashtme, të zhvilluara në Shqipërinë perëndimore nga njëra anë dhe Albanidet e brendshme të Shqipërisë lindore nga ana tjetër dhe (iii) depresioni Periadriatik.

Ndarja në zonat gjeotektonike tregon gjeo-mjediset e krijimit të formacioneve gjeologjike dhe marrëdhëniet midis tyre. Zona në fjalë i përket zonave gjeografike Mirdita dhe Crasta-Cukalli. (Fig. 1.3.2.1.3)

Zona e Mirditës

Zona e Mirditës, bën pjesë në Albanidet e brendshme dhe përfaqësohet nga kompleksi ofiolitik me të njëjtin emër, seria vullkano-sedimentare dhe korniza karbonatike triasiko-jurasike e saj. Në këtë zonë gjithashtu përfshihen seria karbonatiko-silicore pelagjike (T2), depozitimet terrigjeno-karbonatike e karbonatike të Kretakut dhe depozitimet mollasike Pliocenike e Plio-Kuaternare të gropave kontinentale.




Figura 1.3.2.1.1: Profili rajonal në zonën e Adriatikut (Shqipëria dhe Italia) (Burimi: Velaj T., 2015)




Figura 1.3.2.1.2: Pozicion rajonal Shqipërisë (Burimi: <http://aea-al.org/wp-content/uploads/2014/07/Geological-Overview-Albania.pdf>)




Figura 1.3.2.1.3: Harta skematike e njësive tektonike në Shqipëri. Shënohet pozicioni i Bashkisë Puke. (Burimi: Harta Gjeologjike Qarku Shkoder, Shkalla 1:100.000, e modifikuar nga autori).

1.3.2.2. Gjeologjia lokale

Sipas studimit ‘Gjeologjia - Gjeoresurset - Gjeorrezimet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë’ për Bashkia Pukë dhe me hartën Gjeologjike të Bashkisë Pukë, shkalla 1:50.000 të Shërbimi Gjeologjik të Shqipërisë, në ndërtimin gjeologjik të rajonit në bashkinë e Pukës marrin pjesë shkëmbinjët magmatikë e sedimentar të përbërjeve e moshave të ndryshme të inkuadruar në zonat strukturalo - faciale të Mirditës, dhe nënzonës së Cukalit. Thyerja e Drinit, në veriperëndim është elementi

tektonik kryesor, ku vërehet mbivendosja e zonës Mirdita ndaj Cukalit. Veprimtaria magmatike në rajonin e studimit është zhvilluar gjatë Paleozoit dhe Mesozoit. Prodhimet magmatike i përkasin facieve vullkanike, intruzive dhe subvullkanike. Ndërmjet tyre veçohen shkëmbinjtë magmatikë të moshës së Triasikut të poshtëm dhe të mesëm dhe ofolitët Jurasike Në rajonin e studiuar ofolitët përfaqësohen në pjesën më të madhe nga shkëmbinjtë ultrabazike të tre masiveve perëndimore (Krrabi, Puka, Gomsiqe) nga ato bazike gabrore (gabro troktolitët e Qelzes, GojanRrasit, Kçirë - Korthpule) dhe më tej shkëmbinjtë vullkanogjene bazike – mesataro – acid në marrëdhënie tektonike me ultrabazikët. Mbulesa më e hershme e ofoliteve të rajonit përfaqësohet nga depozitimet sedimentare të Titonian – Valanzhinianit (J3) të cilët në Kaftalle, Gomsiqe, Kçirë e deri në Qerret, Levrushk zenë një sipërfaqe të konsiderueshme. Mbulesa më re e ofoliteve të rajonit përfaqësohet nga depozitimet e neogjen – kuaternarit, që mbushin gropat, ultësirat ndërmallore si në Qerret të madh, Kçirë -Korthpule etj.

Në përgjithësi kompleksi ofolitik paraqitet i rrudhosur lehtë por dëshifrimi i kësaj strukture komplikohet nga prishjet tektonike shkëputëse me orientim kryesisht meridional por edhe gjerësore. Në këtë kompleks vërehen edhe tektonika të karakterit shkëputës, tektonika regjionale deri në millonite që zgjaten VP – JL. Në kornizën karbonatike të zonës së Mirditës vërehen tektonika gjatësore që zgjaten 5 – 6 km me rënie gati vertikale. Nga prishjet shkëputëse – mbihypëse gati gjatësore me drejtim VL – JP më e madhja në rajon rreth 30 km është ajo që nis nga V në Berishë – Bushat Levrushk – Buzhalë – Ukth – Qerret vogël – Qerret madh – Kçirë – Gomsiqe duke patur mjaft degëzime dhe prishje tjera paralele.

Më konkretisht, formacionet gjeologjike të gjetura në kufijtë e Bashkisë janë si më poshtë:

Nën / zona e Cukalit

Triasi i mesëm (T2)

Këto depozitime janë të përhapura në pjesën veriperëndimore të rajonit. Ndërtohen nga rreshpe argjilite –sericitike dhe mergelore shpesh me pamje flitike me ngjyrë hiri të errët që përmbajnë konglomerate, zaje dhe bloqe të shkëmbinjve koglomeratë.

Depozitimet e Triasikut sipërm (T3)

Përhapen në pjesën veriperëndimore të rajonit në shpatet e malit Mulqithit dhe përfaqësohen nga gëlqerorë shtresë hollë biomikritike, shpesh herë me bivalvorë pelagjik shkëmbformues gëlqerorë të dolomitizuar me thjerrëza silicorësh. Në prerjet e Triasit të sipërm janë të shpeshtë dhe gëlqerorët shtresë trashë, konglo-brekçore, turbiditike të rrjedhjes së copave për gravitet. Në të gjithë prerjen takohen thjerrza e konkrecione silicorësh.

Jurasiku i sipërm – Kretaku i poshtëm (J3m – Cr1)

Përfaqësohen nga radiolarite, gëlqerorë radiolaritike, gëlqerorë me kalpionelide, rreshpe mergelore – silicore dhe përhapen në malin e Çikokut, rreth depozitimeve kretake të malit Vilës etj. Ato vendosen me pushim mbi gëlqerorët me silicorë të triasit të sipërm. Radiolaritet në pjesën e poshtme janë me ngjyrë hiri kurse në pjesën e sipërme dora dorës kalojnë në llojet e kuqe me një përmbajtje të madhe të materialit rreshpore – silicore.

Kretakut sipërm (Cr2)

Përfaqësohet nga gëlqerorë biomikritik me globotruncana, shtresë hollë – shtresë mesëm gëlqerorë turbiditike e silicore dhe përhapen në pjesën VP të planshetit, kryesisht në kurorat e majave të larta si në majen e Vilës, majen e Qerretit, majen Shkezës etj, deri në bregun e lumit Drin si në Palaj – Gushte etj. Ndërmjet gëlqerorëve takohen dhe shtresa të rralla të kalkareniteve si dhe konkrecione dhe shtresa të holla silicorësh.

Mastriktian – Eoceni (Cr2m -Pg2)

Formacioni i rreshpeve Xhani, që rrethon bërthamën e strukturës kupolare karbonatike të Cukalit, shtrihet në veriperëndim duke filluar nga Milla, Bushat, Buzhale, Koman (Shenkolle). Më në perëndim të rajonit shfaqet përsëri në Karne (Pecaj) – Karne (Markolaj). Ky formacion në perëndim e veriperëndim mbihet nga zona e Alpeve Shqiptare, kurse në juglindje nga zona e Mirditës. Në përgjithësi rreshpet Xhani vendosen mbi gëlqerorët me Globotruncana të Cukalit nëpërmjet pakos kalimtare, me trashësi 13 – 20m. Ky formacion përfaqësohet nga rreshpe argjilo mergelore me shtresa ranorësh, shtresa gëlqerorësh kryesisht turbidik si dhe me copa blloqe (olistolite) brenda rreshpeve.

Zona Mirdita: Në territorin e bashkisë Pukë kjo zonë është e përfaqësuar nga njësitë litostratigrafike si më poshtë:

Depozitimet e Triasikut të mesëm – poshtëm (T1– 2)

Këto depozitime takohen nga Karne, Qerret i vogël, Ukth deri në lagjen Skurak të Bushatit kanë kryesisht kontakte tektonike me shkëmbinjtë anësorë. Prerja e përgjithësuar e këtyre depozitimeve nga poshtë – lart përfaqësohet nga gëlqerorë të kuq nyjor, gëlqerorë dolomitik rozë verdhacake, vullkanite, shiste argjilore e silicorë radiolaritik me trashësi nga 120 – 250m.

Depozitimet e Triasikut i mesëm – Jurasik i mesëm (T2 – J2).

Këto depozitime takohen në formë blloqesh, fragmente të vegjël e të mëdhenj tektonik brenda depozitimeve të Jurasikut të sipërm në Kaftalle, Korthpulë, Kçirë, Qerret dhe gjithashtu në dalje të veçanta drejt Veriut në Rrasen e Qerretit, në majën e Kaçilingut, Qerret i Vogël, Ukth Buzhalë dhe përfaqësohen nga gëlqerorë radiolaritikë me ndërshtresa silicorësh.

Jurasiku i mesëm - i sipërm (J2 - 3)

Depozitimet e Jurasikut të mesëm – të sipërm përfaqësohen kryesisht nga silicorët radiolaritike. Litofacia e silicoreve radiolaritike të Jurasikut të mesëm – të sipërm shtrihet mbi formacione të ndryshme gjeologjike:

- a. Mbulesë sedimentare e vullkaniteve të masiveve ofolitike jurasike.
- b. Mbulesë sedimentare e gëlqerorëve pllakorë me silicorë të nënzoneve pelagjike të Qerret – Miliskase.
- c. Mbulesë sedimentare e formacionit vullkano-sedimentar (bT2-J1) në rajone periferike

Melanzhi Mirdita (Pakoja argjilite me copa) J3

Në këtë rajon ky formacion ka një përhapje në pjesën lindore nga Koshaj deri në Kimëz, ndërsa në pjesën perëndimore nga Kaftalla – Gomsiqe – Dush – Karmë – Qerret – Buzhalë – Bushat. Kjo litofacie karakteristike është quatur më parë “pako argjilite me copa” apo “suited Kimza” (Qirinxhi etj. 1973). Ai shtrihet mbi vullkanitet e pjesës së sipërme të ofoliteve lindore dhe perëndimore, rrallë mbi gabrodiabazet. Këto formime vendosen direkt mbi silicorët, përgjithësisht në pajtim me

to dhe me pajtushmëri ose jo me vullkanitet. Mendimet për moshën e kësaj sekuence janë të ndryshme.

Ky formacion përbëhet nga një matriks argjilor i ngjyrosur në gri, gri të gjelbërt, me zotërim të blloqeve të ranorve arkozë, vende vende me pjesmartje të konglomeratëve. Copat dhe blloqet janë vendosur pa ndonjë rregull. Ata përfaqësohen nga gëlqërore triasikë e jurasikë dhe më të vjetër, vullkanite tipike të formacionit vullkano – sedimentar triasiko – liasik (bazalte, trahite alkaline, albitofre).

Këto depozitime në sektorët e këtij rajoni kanë trashësi vertikale të dukeshme deri 350 – 400 m, të matura me shpime në Kimez, Mushtë. Për sektorët më perëndimorë, si në Kacinar – Simon – Kalur ato vlerësohen deri 600 m

Depozitimet e Kretakut të Poshtëm Cr1 (Barem – Apt)

Këto formime përfaqësohen nga depozitimet terrigjeno – karbonatike të Barremian – Aptianit (Marku 2000). Kanë përhapje të gjerë në malin e Munellës (që shënojnë kreun e prerjes) deri mbi Domgjon, Mushtë dhe Livadhet e Buta e Bisakë të Fanit, ndërsa në lindje jashtë rajonit ato fillojnë në Barremian e shkojnë deri në Santonian në Zepe, Guri Nuses e Malin e Shejtë. Këto depozitime ndahen në shtatë litofacje të grupuara në tre pjesë: në pjesën e poshtëme të Barremianit grupohen tre litofacje: të brekçieve, e ndërthurjeve të brekçieve. e konglomerateve me shkëmbinj pllakorë karbonatikë. Në pjesën e mesme grupohen dy litofacje të Barremianit: ajo e ndërthurjeve flishore – floishoidale dhe litofacja e konglomerateve të pangopur me copra dhe thjerrza qymyresh të koksifikueshme. Ndërsa në pjesën e sipërme grupohen litofacjet e ndërthurjeve të konglomerateve me gëlqerorët konglomeratikë dhe prerja mbyllet me gëlqerorët masive e shtresë trashë koralo – algore dhe biomikritike.

Në Munellë pjesa më e sipërme e Kretakut është Aptiani dhe më në jug në Malin e Shejtë dhe Gurin e Nuses, është deri në Senomanian (Cr2) me gëlqerorë masivë organogjenë me rudiste e nerinea. Në përgjithësi këto depozitime kanë rënie të butë lindore 15-25°, pak të ondular dhe në lindje rënie më të butë perëndimore 5 – 15°, duke dhënë formën e një sinklinali me zhytje jugore, si dhe blloqe të rrëshqitur e të varur nga shplarje të bazamentit magmatik si në Mollë Kuqe në veri, Munellë, Mushtë, pjesa lindore e Munellës.

Pliocen – Pleistocen (N2 – Qp).

Depozitime konglomerate, ranore, argjila dhe suargjila. Këto depozitime përhapen kryesisht në gropën e Qerretit, Kçirës, Korthpulë (fg. I. 1.). Përfaqësohen nga depozitime trashamane terigjene, kontinentale, konglomerato – ranore, të grumbulluara në liqene ndërmallore e deltat e lumenjve që derdreshin në to, duke formuar në ditët tona gropa ndërmallore. Këto depozitime vendosen transgresivisht e me mospajtim këndor me kënd 5-15° mbi shkëmbinjtë ofolitike, duke i mbuluar ato me trashësi nga disa m.

Holoceni i vonshëm (Qh2)

Depozitime aluviale: Këto janë depozitimet që takohen në shtratin e lumit Gomsiqe, Gomine, Fan i madh ku përfaqësohen nga zhavorre, alevrite, argjila, llum argjilor. Këto depozitime kanë qënë dhe janë objekt i shfrytëzimit të inerteve në disa vende të lumit Fan i madh si në Shkozë, Gojan, Gjegjan pasi kryesisht përfaqësohen nga zhavore, zhure dhe rëra.

Pleistocen – Holocenit – Qp – h

Depozitime të përziera aluviale – deluviale – proluviale, brekçie shpatesh, zhavore, rëra. Në rajonin e studimit këto depozitime zënë një sipërfaqe të konsiderueshme të rajonit. Takohen nga veriu në drejtim të jugut duke fluar nga fshati Mille (Tmug), Bushat, Dushnez, Levrushk, Buzhale, Qelez, Dush, Pukë, Kabash, Blinisht, Bicaj, Rrape, Kaulina, Shkozë, Gojan, Gjegjan, Rras, Kalivare, Mushtë. Përfaqësohen nga material të padiferencuar me zaje jo fort të rrumbullakosura, të cilët kanë përbërje të shkëmbinjëve gëlqerorë, ultrabazik, bazik, vullkanite, alevrolito – argjilore me ngjyrë të kuqe, që janë çarë shkatërruar grryer dhe transportuar. Gjithashtu dallohen depozitimet e fundit të shpatit me argjila ngjyrë kafe. Sot ato përbëjnë dhe tokat bujqësore të fshatrave të mësipërm.

Magmatizmi

Ofolitet Jurasike

Në rajonin e bashkisë Pukë shkëmbinjtë ofolitik kanë një përhapje të madhe duke zënë pothuajse rreth 90% të rajonit. Ato përfaqësohen nga:

Ofolitet e tipit perëndimor (MORB) që përbëhen nga sekuenca ultramafke harzburgit – lercolitike, sekuenca plutonike kryesisht gabrore e tipit troktolit dhe sekuenca vullkanike bazaltike e tipit MORB që mbulohen nga silicorët radiolaritike (fg. I. 3.).

Ofolitet e tipit lindor (SSZ) përbëhen nga, sekuenca plutonike gabro (të tipit gabronorit) – plagiogranitike, kompleksi i dajkave paralele dhe sekuenca vullkanike bazalto – dacitike që mbulohet nga silicorët radiolaritike (fg. I. 3.)

1.3.3. Kushtet hidrogjeologjike

Në Bashkinë Pukë resurset ujore nëntokësore janë të lidhur me akuiferë të disa llojeve, por që në një shkallë shumë të madhe janë përhapur akuiferët me porozitet çarjesh. Të gjithë llojet e tjera të akuiferëve kanë përhapje shumë më të vogël. Në mënyrë të veçantë ujëmbajtësit veçanërisht porozë me përshkueshmëri dhe kapacitet të lartë kanë pamje minimale dhe nuk kanë vlerë të përmenden në detaje. Ato janë të lidhura me shtretërit e lumenjve dhe ujëvarat. Sipas studimit Gjeologjia - Gjeoresurset - Gjeorrezizet për Bashkia Pukë nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar, formacionet hidrogjeologjike janë përshkruar në vijim.

Akuiferët me porozitet ndërkokrrizore me përhapje të kufzuar dhe ujëpërcjellshmëri të ulët deri shumë të ulët.

Akuiferët e shkrifët me përhapje të kufzuar dhe ujëpërcjellshmëri të ulët deri shumë të ulët lidhen me depozitimet aluviale të Holocenit (zhavore, rëra, alevrite e argjila), me depozitimet e përziera deluvialealuviale e depozitime të shpatit të Pleistocen – Holocenit (argjila, alevrite rëra, zhavore e copëra shkëmbinjsh). Në territorin e Bashkisë Pukë ato zënë një sipërfaqe relativisht të vogël prej 37 km². Përhapjen më të madhe ky akuifer e ka në luginën e Fanit duke fluar nga fshati Shkozë, në Gojan e deri në Gjegjan më në jug. Ai përhapet gjithashtu në trajtën e shumë daljeve me forma në trajtë njollash, të vendosur kryesisht mbi akuiferët më porozitet çarjesh. Për shkak të paraqitjes së shpërndarë të këtij formacioni nuk është përcaktuar në shkallën 1:50,000 të hartës hidrogjeologjike.

Akuiferë me porozitet poro - çarje me përhapje të kufzuar dhe ujëmbajtje të ulët deri në shumë të ulët.

Akuiferët me porozitet poro/çarje dhe ujëmbajtje të ulët deri në shumë të ulët kanë përhapje të kufzuar dhe ndërtohen kryesisht nga konglomeate, ranor dhe argjila të pliocen-Pleistocenit dhe seria vullkanogjenosedimentare e Triasikut Mesëm-Jurasik i Poshtëm. Ato përhapen kryesisht në jugperëndim e juglindje të Qerretit të Madh, në Karmë, Korthpulë (Verrishta), etj. Në këtë tip akuiferi burimet janë shumë të rralla e me prurje shumë të ulta, nën 0.1 l/s. Burimi i ushqimit të tyre janë rreshjet dhe akuiferët fqinjë. Ujërat janë pa shije, pa erë, pa ngjyrë dhe cilësisht të mirë për tu pirë; përbërja kimike kushtëzohet nga litologjia akuifere. Ato shrytëzohen nga përdorues të veçantë familjar.

Akuifer me porozitet çarjesh me uje përshkueshmëri mesatare - të ulët.

Akuifer me porozitet çarjesh me ujëpërshkueshmëri mesatare- të ulët kanë përhapje shumë të gjërë në Bashkinë e Pukës dhe zënë rreth 384 km² ose 76 % të sipërfaqes së saj. Këto akuiferë ndërtohen nga shkëmbinj magmatikë intruzivë (kryesisht shkëmbinj ultrabazikë e bazikë). Akuifer shtrihen në Krrab, në Tërbun, në Gomsiqe, Korthpulë, Fushë Arrëz, Gjegjan, Lumzi, etj.

Akuifer me porozitet çarjes - karst me përhapje të kufzuar me ujëpërshkueshmëri tepër të ndryshueshme, vende-vende shumë të lartë.

Akuiferët me porozitet çarjes-karst ndërtohen nga gëlqerorë shtresor të Kretakut të Sipërm; gëlqerorë e gëlqerorë konglomeratike të Kretakut të Poshtëm, gëlqerorë shtresorë -pllakore me silicorë të Triasikut të Mesëm – Jurasik i Mesëm. Këto akuiferë kanë përhapje relativisht të kufzuar, rreth 22.8 km². Ato përhapen në pjesën qendrore veriore të bashkisë nga ana perëndimore Dush – Qerret i Madh, në Qerretin e Vogël e deri në perëndim të Lëvrushkut. Ato përhapen gjithashtu në anën më veriprëndimore të bashkisë në Karmë (Vni) e në anën juglindore. Në trajtë njollash ky akuifer takohet midis fshatrave Kçira e Epërme deri në Perëndim të Qerretit të Vogël. Ujërat nëntokësorë që drenojnë nga ky akuifer janë rreth 163 l/s.

Praktikisht jo akuiferë.

Në Bashkinë e Pukës mjedisi praktikisht jo akuiferët zen një sipërfaqen të vogël prej 29 km². Ky mjedis ndërtohet kryesisht nga flishi i Maastrikian-Eoceni (alevrito-ranor-mergelor). Nga këto formacione drenojnë edhe burime me prurje të ulta nën 1.5 l/s.

1.3.4. Makrozonimi – mikrozonimi sizmik

Shqipëria është një vend i aktivitetit të moderuar sizmik, megjithatë shumë qytete dhe zona rurale janë shkatërruar nga tërmete të ndryshme me intensitet të madh dhe të moderuar.

Vlerësimi i rrezikut sizmik në një rajon mund të bazohet në shpërndarjen e tërmeteve intensive historike (të regjistruara dhe jo) dhe në strukturën e tërmeteve dhe në aktivitetin neotektonik të zonës.

Në Shqipëri janë identifikuar zona të aktivitetit sizmik (zona ku janë regjistruar vatra sizmike), përgjatë të çarave aktive dhe zonave të parjeve. Në veçanti ato njihen si:

I. Brezi sizmik bregdetar **Jonian-Adriatik**, në buzën lindore të mikro-pllakës së Adrias me shtrirje veriperëndim-juglindje.

II. Brezi sizmik **Peshkopi-Korçë** me shtrirje veri-jug, dhe

III. Brezi sizmik **Elbasan-Dibër** me shtrirje veri-lindje

Në Skemën 1.3.4.1 tregohen pikat fokale të tërmeteve me përmasa $M \geq 5$ për shekullin e 20-të nga ku dallohen zonat e mësipërme. Në bazë të kësaj skeme, bashkia e Pukës gjendet jashtë zonave sizmike, por kjo nuk përjashton mundësinë e ndikimit nga një tërmet në shkallë të gjerë në rajonin më të gjerë.

Sipas një ndarjeje të veçantë të Shqipërisë në 10 zona sizmike (Figura 1.3.4.2), bashkia i takon pjesërisht zonës ODA dhe pjesërisht zonës ST. Historia e Shqipërisë Lindore (EAB) është një zonë sfondi që përfshin pjesën e brendshme të Shqipërisë dhe rajonet fqinje që shtrihen në lindje të zonave bregdetare dhe nuk përfshihen në asnjë nga zonat e përmendura në tabelën e mëposhtme (Figura 1.3.4.3). Shkodra-Tropoja (ST) është një zonë e brendshme e tërthortë që përfshin defekte normale të goditjes NE, kryesisht përgjatë kufirit të zonës ophiolite Mirdita. Përgjatë tërmeteve që vijuan janë regjistruar: 7 korrik 1855 $M_s = 5.5$; 27 gusht 1948 $M_s = 5.5$. Mekanizmat e përbërë fokale të tërmeteve të gjeneruara nga kjo zonë tregojnë regjimin e tensionit që zgjeron NWN (Muço, 1994). Zona e Shkodrës-Tropojë ka një mjedis të ngjashëm me zonën Elbasan-Dibër-Tetovë, kështu që mund të ndodhin edhe tërmete të ardhshme këtu $M_{max} = 6.9$.




Figura 1.3.4.1.: Epiqendrat e tërmeteve në Shqipëri me $M \geq 5.0$ për shekullin e 20^{-të}. Shënohen tre zonat e dallueshme sizmike dhe pozicioni i Bashkisë Mirdite. (Burimi: Aliaj S. et al., 2010)




Figura 1.3.4.2. Sizmiciteti i Shqipërisë. Pikat e kuqe tregojnë tërmetet e përdorura për vlerësimin e riskut, pikat gri përfaqësojnë tërmete të tjera. Shënohet pozicioni i Bashkisë Pukë.

Istituto Nazionale di Geofisica e Vulcanologia
Database of Individual Seismogenic Sources DISS version 3

Seismicity parameters of Albania

Table 1. Parameters for the ten seismic source zones

Zone Name / Code	Zone Area (km ²)	Earthquakes used	Beta	Alpha (No)	M _x	Rate of M>6 p.a.	Rate density
Ohrid-Korca, KO	2760	44	1.44	242	6.9	0.0315	11.4
Kukesi-Peshkopia, KP	1480	21	1.75	481	6.9	0.0104	7.0
Ionian Coast, IC	16600	151	1.40	692	7.0	0.115	6.9
Elbasani-Dibra-Tetova, EDT	2660	46	1.99	3142	6.9	0.0167	6.3
Periadriatic Lowland PL	7460	75	1.61	914	7.0	0.0458	6.1
Lezha-Ulqini, LU	5140	39	1.52	293	7.2	0.0272	5.3
Skopje, SK	3300	5	2.08	2541	7.2	0.00913	2.8
Shkodra-Tropoja, ST	1570	11	1.99	778	6.9	0.00418	2.7
Peja-Prizreni, PP	1740	5	2.03F	418	6.8	0.00173	1.0
Eastern Albanian Backgr. EAB	57200	75	2.03F	6075	6.5	0.0199	0.35

Notes: Skopje values adopted from [22]. "Rate density" is 10⁶ times annual rate for M≥6 per km². F=slope fixed as discussed in text.

Figura 1.3.4.3: Tabela e listave të parametrave të dhjetë zonave të burimeve sizmike të Shqipërisë. Zona e burimit në det të hapur e Shqipërisë Jugore bie në rajonin e quajtur BJ (Bregdeti Jonian) (nga Aliaj et al., 2004) (Burimi: <http://diss.rm.ingv.it>)

Përveç kësaj, Shqipëria karakterizohet nga një aktivitet intensiv mikrosizmik (Figura 1.3.4.4), siç është shfaqur pas instalimit dhe funksionimit të ASN, i cili ka 13 stacione të pajisura me sizmografë me regjistrim analog me periudhë të shkurtër, me tre-komponentë (ASN, i cili përfshin 13 stacione të pajisura me sizmografë të një periudhë të shkurtër të regjistrimit analog të tre variablave) (skema 1.3.4.5). Në bashkinë Pukë, aktiviteti mikro-sizmik është i rritur në kufijtë e saj veri perëndimor, duke treguar aktivitet të butë neotektonik (skema 1.3.4.4).





Figura 1.3.4.4. Tërmetet në Shqipëri $ML \geq 3.0$ për periudhën 1976-1995 dhe stacionet e Rrjetit Sizmologjik Shqiptar. Shënohen e pozicioni i Bashkisë Puke (Burimi: Muço B. et al., 2000)



Skema 1.3.4.5: Rrjeti Sizmologjik Shqiptar (ASN) deri në fund të vitit 1999 (majtas), stacionet ASN me instrumenta digitale GBV-316 (në qendër) dhe stacioni i ASN me transmetorë satelitor (djathtas)

Bazuar në tërmetet historike dhe të regjistruara nga stacione sizmologjike, brenda dhe jashtë Shqipërisë, Sulstarova et al. (1980) hartuan një hartë që përcakton zonat e intensitetit sizmik (Figura 1.3.4.6). Në bazë të kësaj harta Bashkia e Pukës i takon zonave VIII dhe VII.




Figura 1.3.4.6. Zonimi sizmik në Shqipëri në shkallën 1:500.000 (nga Sulstarova et al., 1980). Shënohen e pozicioni i Bashkisë Puke (Burimi: Muço B. et al., 2000)

Sipas studimit “Zonimi sizmik në Shqipëri duke përdorur një qasje deterministike”, (B. Muço et al., 2000) vlerat DGA për Shqipërinë (figura. 1.3.4.7 a) janë në gamës e 68-311 cm/s^2 . Zona me vlera më të mëdha është një vend i vogël në jug të Shqipërisë, në kufi me Greqinë (DGA mbi 300 cm/s^2). Zona e dytë mbulon 80% të territorit shqiptar (DGA ndërmjet 150 dhe 300 cm/s^2). Zona e tretë (DGA ndërmjet 80 dhe 150 cm/s^2) është e shpërndarë në të gjithë territorin e Shqipërisë, nga veriu në jug. Zona e fundit vazhdon në pjesën veriore të Shqipërisë (DGA ndërmjet 40 dhe 80 cm/s^2).




Figura 1.3.4.7.: Vlerat e parametrave të lëvizje së tokës: (a) Projekti i Përshpejtimit të Tokës (b) Shpejtësia (c) Zhvendosja. Shënohen e pozicioni i Bashkisë Pukë (Burimi: Seismicity, seismotectonics and seismic hazard assessment in Albania, Aliaj S., et al, 2010)

Vlerat e shpejtësisë (figura. 1.3.4.7 b) mund të ndahet kryesisht në dy zona, e para (V midis 15 dhe 27.1 cm/s^2) mbulon shumicën e pjesëve jugore dhe juglindore të Shqipërisë dhe e dyta (V ndërmjet 8 dhe 15 cm/s^2) mbulon shumicën e pjesës qendrore dhe veriore të vendit. Gjithashtu janë gjetur disa pika të vogla me V ndërmjet 4 dhe 8 cm/s , në pjesën veriore të Shqipërisë. Për sa i përket zhvendosjes (fig 1.3.4.7 c), mund të ndahet në dy zona: një shumë në jug të Shqipërisë, në pjesën

lindore dhe në pjesën veriperëndimore (D në mes të 7 dhe 9.7 cm) dhe një tjetër në më shumë se 80% të territori shqiptar (D në mes të 3,5 dhe 7 cm).

PUKË	koordinat		Probab	PGA	SA				
	N	E			0.01 s	0.2 s	0.5 s	1.0 s	2.0 s
Gjegjan	41.93	19.99	10%/10 10%/50	0.091 0.139	0.232 0.387	0.126 0.226	0.065 0.117	0.03 0.057	
Pukë	42.04	19.89	10%/10 10%/50	0.12 0.214	0.295 0.545	0.162 0.319	0.081 0.16	0.036 0.075	
Qelëz	42.09	19.90	10%/10 10%/50	0.134 0.245	0.319 0.617	0.178 0.36	0.087 0.18	0.038 0.082	
Qerret	42.05	19.82	10%/10 10%/50	0.149 0.27	0.352 0.668	0.197 0.399	0.097 0.204	0.042 0.09	
Rrapë	42.03	19.96	10%/10 10%/50	0.12 0.214	0.295 0.545	0.162 0.319	0.081 0.16	0.036 0.075	

Tabela 1.3.4.1 Vlerat e riskut sizmik (PGA dhe SA (g)) për 4 bashki dhe komuna në Shqipëri me propabilitet 10%/10 vjet (95 vjet periudhë kthimi) dhe 10%/50 vjet (475 vjet periudhë kthim) në kushte terreni shkëmbor (Burimi: Seismicity, seismotectonics and seismic hazard assessment in Albania, Aliaj S. et al., Academy of Science of Albania, 2010)

1.3.5. Peisazhi dhe elemente të rëndësishme që ndikojnë në të

Sipas Konventës Evropiane të Peisazhit (Konventa e Firences), peisazhi është përcaktuar si një zonë, siç perceptohet nga njerëzit, karakteri i të cilit është rezultat i veprimit dhe ndërveprimit të faktorëve natyrorë dhe / ose njerëzorë. Përfshin si të dhëna natyrore- ekologjike edhe kulturore-ekonomike. Gjithashtu, në ndryshim të vazhdueshëm, evoluon dhe nuk mbetet statik dhe inert, dhe pranon stimuj të ndryshëm me origjinë ose nga natyra ose nga aktiviteti njerëzor. Nëpërmjet këtij perceptimi të zgjeruar, peisazhi:

- Është i njohur si një komponent i rëndësishëm i trashëgimisë natyrore dhe kulturore evropiane dhe luan një rol përcaktues në stabilitetin e identitetit evropian.
- Është i domosdoshëm për prosperitetin dhe cilësinë e jetës së banorëve kudo, në zonat urbane dhe rurale, në zonat e klasifikuara si të degraduara dhe të atyre klasifikuar si të cilësisë të lartë,
- Përbën burim të favorshëm për veprimtarinë ekonomike dhe faktor për të tërhequr kapitalet.

Duke hetuar Bashkinë në një shkallë të vogël, mund të shohim se mbizotërohet nga peizazhe malore dhe kodrinore. Bashkia është e rrethuar nga malet e Krabit në veriperëndim, Munellës në jug perëndim, Mirditës në jug dhe Tërbunit në qendër. Midis tyre janë luginat e lumenjve Drin, Fani i Madh, Gomsiqes dhe Gjadërit. Në mënyrë të veçantë, lumenjtë e Drinit dhe Gjadërit formojnë kufijtë veriorë dhe jugorë të bashkisë. Disa maja shtrihen në luginat e lumenjve duke krijuar një rrjet hidrografik shumë-ngjyrëshe.

Në një shkallë më të madhe, sa i përket vëllimeve malore, mund të shohim peizazhin karstik të malit Munellës. Ajo përfaqëson një sipërfaqe erozive të formuar mbi formacionin karbonatik.

Rrafshinat e vogla me kullota dhe tokë të punueshme, të shpërndara ose në vende të grumbulluara dhe me gardhe të pasura natyrore mund të strehojnë aktivitete të buta njerëzore (blegtori, bujqësi). Rezervuaret artificiale dhe liqenet e vegjël rrisin elementët ujorë dhe pasqyrojnë qiellin duke krijuar peizazhe idilike.

Luginat dhe kanionet e ngushtë në formë V parandalojnë zhvillimin e aktiviteteve njerëzore duke rritur biodiversitetin në këto vende.

Rrjedhat e lumenjve të mëdhenj në zonat e rrjedhës së poshtme janë baltore duke krijuar fusha të vogla aluvionale rreth të cilave janë të përqëndruara aktivitetet kryesore antropogjene dhe janë zhvilluar vendbanimet më të mëdha.

Mjedisi audio dhe vizual janë të shkëlqyera dhe ndryshojnë në varësi të sezonit. Regjistrohet bollëk geotopes (p.sh. shpella, burime) si dhe monumente kulturore të shpërndara por me një histori të theksuar.

Aspektet negative të peizazhit përfshijnë zonat e minierave të cilat e kanë ndryshuar dhe vazhdojnë të ndikojnë fuqishëm. Shpyllëzimi i pemëve, zbulimi i nëntokës dhe akumulimi i mbeturinave në zonat e afërta krijojnë probleme estetike dhe mjedisore.

Gjithashtu, digat në lumenj për prodhimin e energjisë elektrike janë elementë të rëndësishëm që transformojnë zonën, si në rrjedhën e sipërme edhe në drejtim të rrymës. Në zonën e studimit, në lumenjtë e mëdhenj që e përshkojnë atë, po ndërtohen ose janë ndërtuar mjaftueshëm. Shkalla dhe shtrirja e ndikimit të tyre varet nga madhësia e digës dhe nga karakteristikat e lumit dhe pellgut së mbulimit. Ndikimet janë të larmishme dhe lidhen kryesisht me ndryshime në mikroklimë dhe në ekosistemin ujor, mbajtjen nën kontroll të sedimenteve dhe përbërësve ushqimorë, pengimin e migrimin e peshqve, ndryshime në fenomenet e erozionit dhe përmbytjeve, ndryshimin në sasinë dhe cilësinë e ujërave nëntokësore. Përveç kësaj, ndërtimi i tyre ka sjellë ndërhyrje në relievin e tokës dhe mbulimin e zonës përreth: gërmime, kantiere ndërtimi, përmbytje të brigjeve të lumenjve, sipërfaqe të reja artificiale (ndërtesa, infrastruktura) etj.

Së fundi, shpërndarja e mbeturinave shtëpiake dhe mbeturinave të ngurta pranë zonave të banimit, lumenjëve dhe liqenëve, mungesa e mirëmbajtjes dhe braktisja e ndërtesave, shpyllëzimi i zonave pyjore me rezultat erozionin e tokës krijojnë një degradim estetik në peisazh.

Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i peisazhit në planifikimin territorial kontribuon:

- që së bashku të mbrojnë mjedisin natyror dhe kulturor, gjë që nuk është e mundur me identifikimin individual të zonave të mbrojtura dhe vendeve arkeologjike, monumenteve, etj,
- në përmirësimin e cilësisë së jetës,
- në zhvillimin e balancuar dhe
- në kohezionin ekonomik dhe social me paraqitjen e mundësive të reja për zhvillim dhe vende pune, madje edhe në zonat pa peisazhe me vlerë të lartë.



Foto 1.3.5.1: Lugina e V në peisazhin malor (burimi: grupi i studimit)



Foto 1.3.5.2: Reliev i ulët me toka bujqësore (burimi: grupi i studimit)



Foto 1.3.5.3: Hedhje e pakontrolluar e mbetjeve (burimi: grupi i studimit)



Foto 1.3.5.4: Peizazh malor me tokë të punueshme (burimi: grupi i studimit)



Foto 1.3.5.5: Fusha me të korra (burimi: grupi i studimit)



Foto 1.3.5.6: Peisazh malor (burimi: grupi i studimit)



Foto 1.3.5.7: Lugina e lumit (burimi: grupi i studimit)



Foto 1.3.5.8: Peizazhi malor dhe toka bujqësore (burimi: grupi i studimit)



Foto 1.3.5.9: Lugina e V në peizazhin malor (burimi: grupi i studimit)



Foto 1.3.5.10: Elementi i ujit në peizazhin malor (burimi: grupi i studimit)



Foto 1.3.5.11: Pllajë e vogël (burimi: grupi i studimit)



Foto 1.3.5.12: Liqeni Kukaj (burimi: grupi i studimit)



Foto 1.3.5.13: Elemente ujore në një peizazh kodrinor (burimi: grupi i studimit)



Foto 1.3.5.14: Hedhje e pakontrolluar e mbeturinave (burimi: grupi i studimit)

1.3.6. Boniteti i tokës

Gjatë tridhjetë viteve të fundit, në Shqipëri është grumbulluar një përvojë e çmuar sa i përket kontrollit të tokave dhe aplikimeve të tij. Fillimisht, ishte Departamenti i Shkencave të Tokës i Universitetit Bujqësor të Tiranës ai që ndërmoi disa aktivitete në lidhje me tokat dhe më pas Instituti i Studimit të Tokës (IST) i Tiranës, i krijuar në vitin 1971, i cili drejtoi të gjitha veprimtaritë që lidheshin me të. Ky i fundit është nën varësinë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe është i vetmi institucion në vend i specializuar në shkencën e tokës (Zdruli P., Lushaj S., 2001).

Klasifikimi i tokës në Shqipëri nga viti 1950 deri më 1990-ën bazohej tek lartësia, kushtet klimatike dhe bimësia natyrore, përshtatur nga Klasifikimi rus i Tokave. Harta e parë e tokave me shkallën 1:200000 doli në vitin 1958 (figura 1.3.6.1). Nga viti 1970 deri më 1990-ën, për çdo kooperativë bujqësore, fermë shtetërore apo rreth, përgatiteshin harta të detajuara të tokave në shkallën 1:10000 dhe 1:50000. Këto sondazhe toke përdoreshin për planifikimin e praktikave dhe teknologjive bujqësore. Sipas Sistemit Kombëtar të Klasifikimit të Tokave (SKKT), tokat ndahen në katër breza bazuar tek ndryshimet klimatike, bimësia natyrore, lartësia, pjerrësia, faktorët e formimit të dheut dhe tek karakteristikat e tyre fizike dhe kimike (Zdruli P., Lushaj S., “Overview of soil information and soil protection in Albania” (ppt)).




Figura 1.3.6.1: Harta e parë e tokave të Shqipërisë e vitit 1958 (burimi: Burimet e Tokës dhe Dherave të Shqipërisë: problemet aktuale dhe tendencat në të ardhmen (Burimi: Zdruli P. Lushaj S., "Overview of soil information and soil protection in Albania" (ppt))

	Brezat	Lloji	Shpjegimi	%	Sipërfaqja ³ në 1000 Ha
Tokat zonale					
I	Kullota subalpine	LM	Lëndina malore	0.5	3.2
II	Pyje ahu dhe pishë	MP	Pyje malore të errëta	3.0	20.2
		LMP	Pyje lëndina të errëta	0.6	3.4
III	Brezi i pyjeve të lisit	KM	Kanellë mashkull	17.7	121.3
		KL	Lëndinë kanellë	5.4	37.0
		LK	Lëndinë kanellë	7.5	51.3
IV	Shkurre mesdhetare	HK	Kanellë gri	25.7	176.2
		HKL	Lëndina kanelle gri	6.4	50.7
		LHK	Lëndina kanelle gri	18.5	127.1
Toka azonale					
	Aluviale	AL	Toka me origjinë fluviatile	11.8	80.9
	Kripore shtufore	LT	Toka moçalore	1.4	10.0
		LKr	Toka me origjinë solonchak, solonetz	1.4	9.7
	Toka malore natyrale	PM	Toka të pazhvilluara	0.1	0.4
	Plazhe ranore	PL	Toka të pazhvilluara		0.2
TOTALI				100.0	691.6

Tabela 1.3.6.1 Tabelë e përgjithësuar e tokave shqiptare dhe sipërfaqeve të tyre në raport me totalin e tokës bujqësore në vend (Burimi: Zdruli P., Lushaj S., 2001)

Shpërndarja e tokave (Zdruli P., Lushaj S., 2001).

- Brezi i kullotave subalpine në lartësinë 1600-2700 m
- Brezi i pyjeve të ahut dhe pishës në lartësinë 1000-1600 m
- Brezi i pyjeve të lisit në lartësinë 600-1000 m
- Shkurre mesdhetare në lartësinë 0-600 m

Brezat e mësipërme tregojnë shpërndarjen tokave, e cila ndjek një rregull vijues mbizotëruar nga lartësia dhe bimësia. Këto toka quhen toka zonale. Karakteristikat e tyre lidhen me faktin që formimi i tyre ka ndodhur në kushte biologjike, gjeologjike, topografike dhe klimatike specifike dhe vendndodhja e tyre përcaktohet mirë sipas lartësisë. Tokat e njërit brez nuk gjenden në asnjë brez tjetër (Zdruli P., Lushaj S., 2001).

Në zonat ku formimi i tokës nuk lidhet thjesht me bimësinë natyrore dhe lartësinë, tokat konsiderohen azonale dhe përfshijnë tokat me origjinë aluviale, shtufore, kripore dhe tokat e

pazhvilluara ose natyrale. Ato mund të gjenden në të gjithë brezat e tokave të përmendur më sipër. (Zdruli P., Lushaj S., 2001)

Deri në vitin 1990, pjelloria e tokës monitorohej në të gjitha tokat bujqësore çdo 4 deri në 5 vjet. Të dhënat tregojnë se 44.6% e tokave klasifikohen si toka me nivel të ulët humusi që gjenden kryesisht në zonat kodrinore dhe malore dhe pjesërisht në zonat fushore perëndimore. 78% e tokave klasifikohen si toka me nivel të ulët dhe mesatar të N. 75% e tokave klasifikohen si toka me nivel të ulët dhe mesatar të P. Më shumë se 90% e tokave klasifikohen si toka me nivel të lartë dhe mesatar të K (figura 1.3.6.2) (Zdruli P., Lushaj S., “Overview of soil information and soil protection in Albania” (ppt)).

Pas vitit 1990, me qëllim unifikimin e Klasifikimit Shqiptar të Tokave me Sistemin Ndërkombëtar, Instituti i Studimit të Tokave (IST) i Shqipërisë në bashkëpunim me Byronë Evropiane të Tokave zhvilloi hartën pedologjike në shkallën 1:1 milion (Zdruli P., Lushaj S., “Overview of soil information and soil protection in Albania” (ppt)).

Bashkëpunimi i IST-së me Institutin Mesdhetar të Agronomisë (IMA) në Bari realizoi një studim dhe përgatiti hartën pedologjike në shkallën 1:250000 për të gjithë sipërfaqen (figura 1.3.6.3) dhe një hartë në shkallën 1:50000 për zonën bregdetare (Zdruli P., Lushaj S., “Overview of soil information and soil protection in Albania” (ppt)).

Shumica e tokave shqiptare klasifikohen si toka *cambisols*, *luvisols*, *regosols*, *leptosols*, *phaeozems* në zonat bregdetare perëndimore si *fluvisols* (figura 1.3.6.4). (Zdruli P., Lushaj S., “Overview of soil information and soil protection in Albania” (ppt)).

Cambisols karakterizohen nga mungesa e një shtrese prej balte, humusi, kripërash të tretshme ose okside hekuri dhe alumini. Ato ndryshojnë nga materiali i bazë i papërpunuar në strukturën e tyre agregate, ngjyra, përmbajtja e argjilës, përmbajtja e karbonatit ose vetitë e tjera që japin disa prova të proceseve të formimit të tokës. Për shkak të strukturës së tyre të favorshme agregate dhe përmbajtjes së lartë të mineraleve të lëvizshme, ato zakonisht mund të shfrytëzohen për bujqësi, duke iu nënshtuar kufizimeve të terrenit dhe klimës. Cambisols janë grupi i dytë më i gjerë i tokës në Tokë, duke zënë 12 për qind të sipërfaqes totale të tokës kontinentale - kryesisht në rajonet boreale polare, në peizazhet me shkallë të lartë të erozionit dhe në rajonet e materialit bazë që i rezistojnë lëvizjes së dheut. Ato nuk janë të zakonshme në klimat e lagështa tropikale.

Regosolët karakterizohen nga materiale bazë të cekët, të mesëm të pa konsoliduara, të cilat mund të jenë me origjinë aluviale dhe nga mungesa e formimit të një horizonti të konsiderueshëm të tokës (shtresës) për shkak të kushteve klimatike të thata ose të ftohta.

Leptosolët janë toka me thellësi shumë të cekët profili (duke treguar pak ndikim në proceset e formimit të tokës) dhe shpesh përmbajnë sasi të mëdha të zhavorrit. Ato zakonisht mbeten nën vegjetacion natyror, duke qenë veçanërisht të ndjeshme ndaj erozionit, tharjes ose lagështisë, në varësi të klimës dhe topografisë. Leptosolët janë përafërsisht të shpërndara në mënyrë të barabartë midis zonave të larta malore, shkretëtirave dhe rajoneve boreale ose polare, ku formimi i tokës është i kufizuar nga kushtet e rënda klimatike.

Phaeozems karakterizohen nga një shtresë sipërfaqësore me humus të mbuluar në gjendjen natyrore me bar të bollshëm ose vegjetacion bimor gjethesh. Ato janë toka shumë të lërueshme dhe përdoren

për rritjen e drithërave, sojës dhe kullotave për bagëtinë, si dhe për prodhimin e drurit dhe prodhimin të naftës. Zënë rreth 1.5 përqind të sipërfaqes së tokës kontinentale në Tokë.




Figura 1.3.6.2: Niveli i humusit dhe fosforit në tokën bujqësore (Burimi: “Burimet e tokave dhe dherave të Shqipërisë: problemet aktuale dhe tendencat në të ardhmen”, Lushaj S., Zdruli P.,2007)




Figura 1.3.6.3 Pedologia e tokave të Shqipërisë (Burimi: "Përmbledhje e Informacionit të Tokave dhe Mbrojtjes së Tokave në Shqipëri", Lushaj S., Zdruli P., (ppt)).

Main soil pedons of Albania




Figura 1.3.6.4 Pedologjia e tokave të Shqipërisë (Burimi: “Përmbledhje e Informacionit të Tokave dhe Mbrojtjes së Tokave në Shqipëri”, Lushaj S., Zdruli P.,(ppt)).

Një klasifikim territorial tjetër i tokës Shqiptare u krye në bazë të cilësisë së saj. Tokat e shkrifta përfshijnë një përqindje prej 50% të gjithë tokës, tokat clayely soils një përqindje prej 30% dhe tokat Sandy soils 20% (Figura 1.3.6.5)




Figura 1.3.6.5: Shpërndarja e strukturës së tokave të Shqipërisë (Burimi: “Përmbledhje e Informacionit mbi Tokat dhe mbi Mbrojtjen e Tokave në Shqipëri”, Lushaj S., Zdruli P., (ppt))

Cilësia e tokës në Bashkinë e Pukës, siç shihet nga lart, është:

- Nessuna territura (rocce affioranti o torbe)
- Grossolana (18% argilla e >65% sabbia)
- Media (18% <argilla <35% e >15% sabbia, o 18% <argilla e 15% <sabbia <65%)
- Medio fine (<35% argilla e 15% <sabbia <65%)
- Fine (35% <argilla <60%)

Për sa ka të bëjë me thellësitë e tyre, tokat në territorin shqiptar dallohen në (figura 1.3.6.6):

- Toka të thella që dominojnë në zonat fushore bregdetare dhe

- Toka sipërfaqësore që dominojnë në zonat kodrinore dhe malore.




Figura 1.3.6.6 Harta e thellësisë së tokave e Shqipërisë (Burimi: “Përmbledhje e Informacionit mbi Tokat dhe Mbrotjtjes së Tokave në Shqipëri”, Lushaj S., Zdruli P.,(ppt)).

Ka disa faktorë që kontribuojnë në përshpejtimin e erozionit të tokës, të cilët përfshijnë faktorët natyrorë (d.m.th. periodiciteti jo i rregullt i reshjeve, tokat e cekëta, pjerrësia e madhe, brishtësia e materialit të tokës) dhe faktorët njerëzorë si braktisja e tokave të pjerrëta, shpyllëzimi, kullotja pa

kriter dhe keqpërdorimi apo keqmenaxhimi. Një formë tjetër degradimi janë edhe rrëshqitjet e tokave, të cilat gjenden në shumë zona në vend, duke ulur ndjeshëm jo vetëm qëndrueshmërinë e bujqësisë, por edhe sigurinë afatgjatë të strehimit rural (Zdruli P., Lushaj S., 2001).

Në figurën 1.3.6.7 duken llojet e presionit që ekzistojnë në tokat e Shqipërisë.




Figura 1.3.6.7 Burimet e streseve të tokave në Shqipëri (Burimi: “Përmbledhje e Informacionit mbi Tokat dhe Mbrojtjes së Tokave në Shqipëri”, Lushaj S., Zdruli P.,(ppt)).

Siç shihet nga harta e mësipërme, duket se dëmi kryesor i shkaktuar nga njerëzit është kryesisht shpyllëzimi i pyjeve.

Një problem tjetër i Bashkisë është mbiprodhimi. Mbivlerësimi në veçanti, është vërejtur në pjesën më të madhe të vendit.

Në figurën 1.3.6.8 paraqiten metalet e rënda në tokën bujqësore sipas prefekturës – bashkisë. Tokat në Pukë kanë sasi të mëdha të mineralve nikel (Ni) bakri (Cu), krom (Cr) dhe plumb (Pb).




Figura 1.3.6.8 Përmbajtja totale e metaleve të rënda në nivel toksik në tokën bujqësore të Shqipërisë (burimi: “Përmbledhje e Informacionit mbi Tokat dhe Mbrojtjes së Tokave në Shqipëri”, Lushaj S., Zdruli P.,(ppt)).

Sipas një studimi të vlerësimit të tokës fizike, i cili përfundoi në fund të viteve 1990, toka bujqësore ndahet në dhjetë kategori sipas nivelit të përshtatshmërisë së tyre. Kategoria e parë ishte më e mira, kurse e dhjeta më e keqja. Si rregull, nga perëndimi në lindje, cilësia e tokës ulet për shkak të klimës më të ashpër dhe rritjes së pjerrësisë dhe lartësisë (Kaleshi et al., 1992, nga “Burimet e

tokave dhe dherave të Shqipërisë: probleme aktuale dhe tendenca në të ardhmen”, Lushaj S., Zdruli P., 2007)

Klasifikimi Ekonomik Tokave (BONITETI) Bashkia PUKË					
Sipas dokumentacionit ZAMT, MT-PUKË				Sip. 2854 ha.	
N.R.	Zona Kadastr.	QYTET/FSHATI	Kategorit Tokes Sipas Dokument.	Kategor. Mesatar.	Fondi Tokes
1	3069	Q. PUKE		=	366
2	3070	F. PUKE	V,VI,VII,VIII	VII.	53
3	2370	F. LEJTHIZE	VI,VII,VIII	VII.	34
4	1576	DUSHI	VII,VIII	VIII.	25
5	1798	GOMSIQE	V,VI.	VI.	30
6	2024	KAFTALLE	IV,V,VI,VII.	VI.	148
7	2098	KARME	IV,V,VI,VII.	VI.	4
8	2130	KQIRE	VII,VIII.	VIII.	123
9	2229	KORTHPULE	VI,VII.	VII.	202
10	2505	Q. LUFI		=	
11	2992	PLETI	VI,VII,VIII.	VII.	
12	3104	QERRET MADH	IV,V,VI,VII.	VI.	113
13	3836	VRRITHI	IV,V,VI,VII.	VI.	43
14	2509	LUF-PLANI	VI,VII,VIII.	VII.	
15	2012	KABASH	V,VI.	VI.	82
16	2638	MECE	VII,VIII.	VIII.	21
17	1219	BLINISHTI	VI,VII.	VII.	40
18	3207	RRAPE	VI,VII,VIII,IX.	VIII.	121
19	1179	BICAJ	IV,V,VI,VII.	VI.	46
20	1268	BREG	V,VI.	VI.	73
21	1239	BUHOTI	VI,VII.	VII.	34
22	2528	LUMZI	VI,VII,VIII.	VII.	37
23	1330	BUSHAT	VI,VII.	VII	96
24	1340	BUZHALE	V,VI,VII,VIII.	VII	6
25	1455	DEDAJ	VI,VII,VIII.	VI	59
26	1586	DUSHNEZ	VI,VII,VIII.	VI	28
27	2439	LEVRUSHK	V,VI,VII,VIII.	VII	11
28	2687	MIDHE	VI,VII,VIII.	VII	51
29	3092	QELEZ	IV,V,VI,VII,VIII.	VII	210
30	3107	QERRET VOGEL	VI,VII,VIII.	VII	38
31	3673	UKTHI	VI,VII,VIII.	VII	29
32	1506	DOMI	V,VI.	VI.	73
33	1725	GJEGJAN	V,VI.	VI.	95
34	1786	GOJAN MADH	IV,V.	V.	157
35	1787	GOJAN VOGEL	V,VI,VII.	VI.	75
36	2044	KALIVARE	VI,VII,VIII.	VII	29
37	2150	KIMEZ	VI,VII,VIII.	VII	44
38	2354	KUZHNNEN	V,VI,VII,VIII.	VII	56
39	2672	MESUL	VI,VII,VIII.	VII	75
40	3210	RRASI	VI,VII,VIII.	VII	53
41	3394	SHKOZA	V,VI.	VI.	74
Fondi Tokes sip. Ha.					2854

Figura 1.3.6.9 Kategorizim në vendbanime të ndryshme të Bashkisë Pukë (burimi: Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës Shkodër)

1.3.7. Topografi- Modeli Dixhital i Lartesisë (D.E.M.) – Hidrologji

1.3.7.1. Njësitë gjeomorfologjike

Në strukturën gjeomorfologjike të Bashkisë mbizotërojnë vëllimet malore dhe më pak ato kodrinore dhe ultësirat.

Vëllimet malore karakterizohen nga kreshta të larta, shpate të pjerrëta dhe lugina të thella. Vëllimet kryesore malore janë në veri të malit të Krrabit (1680m), në jug lindje të malit Munellës (Maja e Kryqit 1991m) dhe në jug të malit Tërbun (Maja e Suçelit 1476m). Mali i Munellës përbëhet kryesisht nga shkëmbinjë vullkanikë të zhdukur (deri në 1300-1400m) të cilat mbartin pllakë gëlqerore. Munella formon pikën më të lartë të një zinxhiri me drejtim nga Verilindja për në Jug perëndim. Pjesa më e lartë gëlqerore e malit ka një karakter alpin dhe me shpate shumë të pjerrëta; megjithatë, maja e malit është një rrafshnaltë me shumë gropa dhe lugina.¹

Në Tërbun ka forma e peisazhe nga me të ndryshmet duke filluar që në rrëzë të tij me luginat e përrenjve, shpatet e mbushura me lloje të ndryshme bimësie. Atje gjenden gryka e qafa, kodra e maja të larta.

Në zonën malore të qarkut Shkodër mund të përmendim edhe kreshtat, kurrizoret, kryesisht me shtrirje afro meridionale dhe më rrallë paralele.

Në varësi të strukturave gjeologjike, njësitë morfologjike kodrinore, ku gjenden, kanë forma tipike të relievit, si relievet kodrinore të strukturave monoklinike dhe relievet kodrinore të strukturave të rrudhura.

Zona kodrinore e Gomsiqe - Korthpule ka një pjerrësi mesatare deri në 25°. Nga pikëpamja gjeologjike, ato janë ndërtuar nga shkëmbinjë ofiolitike të zonës së Mirditës, nga masivët ultrabazikë të Gomsiqes dhe nga vazhdimësia gabroperidotite e masivit verilindor të Kashnjetit.

Terreni kodrinor dhe vëllimet malore me kreshtat e tyre përcaktojnë pellgjet ujore të lumenjve Drin dhe Fani i Madh. Në zonën e Bashkisë, lumi Drin është i vendosur në rrugën e vet. Pellgu i kullimit është në formë V dhe rajonet aluviale janë shumë të vogla. Në mënyrë të ngjashme, Lumi Fani i Madh është shtrirja e sipërme e lumit të Fanit dhe baseni i tij paraqet të njëjtën gjeomorfologjinë me lumin Drin.

¹ Trajçe et al., 2014, “Munella Mountain: Summary of findings from the Balkan Lynx Recovery Programme”, PPNEA




Figura 1.3.7.1.1: Njësitë gjeomorfologjike në zonën më të gjerë të Bashkisë Pukë

1.3.7.2. Karakteristika gjeomorfologjike – analiza sasiore

Për kuptimin më të mirë të morfologjisë së zonës së studimit dhe nxjerrjen e përfundimeve për sa i përket proceseve gjeomorfologjike, u krye analiza e relievit me ndihmën e modelit dixhital të relievit (Digital Elevation Model/D.E.M.). Nga analiza rezultuan të dhëna gjeomorfometrike të derivateve, dmth harta e lartësive dhe harta e pjerrësive të zonës së studimit që ndihmon në njohjen e formave të ndryshme gjeologjike dhe në kuptimin e zhvillimit të zonës.


Sipas Dikau (1989), klasifikimi i një relievi të një zone mund të karakterizohet sipas lartësisë që paraqet mbi nivelin e detit (tabela 1.3.7.2.1).

Lartësia (m)	Lloji i relievit	Shtirirja (km ²)	% Sipërfaqja
0-150	Fushor	3,40	0,64
150 – 600	Kodrinor	212,96	40,04
600 – 900.	Gjysmëmalor	192,63	36,22
>900	Malor	122,84	23,10

Tabela 1.3.7.2.1: Klasifikimi i relievit (sipas Dikau, 1989) i zonës së studimit

Siç duket në histogram (Grafiku 1.3.7.2.1) dhe në hartën e lartësive (fig 1.3.7.2.1.b) në përputhje me klasifikimin sipas Dikau rreth 40,04% të relievit të zonës karakterizohet si kodrinor, rreth 23,10% karakterizohet si malor, rreth 36,22% si gjysmë malor dhe rreth 0,64% karakterizohet si fushor.

Një parametër i rëndësishëm për analizën e mëtejshme të relievit të një zone, është pjerrësia e tij. Në bazë të saj mund të nxirren përfundime në lidhje me shkallën e erozionit që kryhet në një zonë.



Grafiku 1.3.7.2.1: Histograma e lartësive të Bashkisë Pukë (sipas DIKAU, 1989)




Figura 1.3.7.2.1 a : Modeli dixhital i tokës së Bashkisë Pukë




Figura 1.3.7.2.1 b: Klasifikimi i lartësisë Pukë, sipas DIKAU, 1989

Një parametër i cili mund të llogaritet dhe të kuantifikohet nga analiza e mëtejshme e modelit dixhital të relievit (DEM) është pjerrësia e relievit. Pjerrësia e relievit është madhësia më e përhapur topografike dhe me rëndësi të madhe për çdo kërkim gjeomorfologjik. Si pjerrësi përcaktohet ndryshimi maksimal i lartësisë në çdo pikë të një sipërfaqeje. Sa më e vogël vlera e pjerrësisë, aq më i sheshtë është relievi, ndërsa sa më e madhe vlera e pjerrësisë, aq më i pjerrët është relievi. Pjerrësitë llogariten ose në gradë ose në përqindje (%). Duke marrë parasysh klasifikimin e pjerrësive të relievit që propozoi Demek (1972), i cili më pas u adaptua nga Komisioni i Kërkimeve Gjeomorfologjike dhe i Hartografisë (Commission on Geomorphological Survey and Mapping) të Bashkimit Gjeografik Ndërkombëtar (IGU – International Geographical Union), u bë klasifikimi i pjerrësive në 6 kategori kryesore (Demek, 1972).

Pjerrësia 0 – 2°: Reliev i sheshtë deri në pak i pjerrët (Sipërfaqe nivelimi, Tarraca). Fillimi i erozionit tip mbulesë. Mungesë problemesh në veprimtaritë njerëzore (transporte, ndërtim, bujqësi, prerje e drurëve).

Pjerrësia 2° – 5°: Reliev pak i pjerrët (nivelet e ulëta të luginave, zonat e shpateve të dunave). Erozioni i mbulesës dhe fillimi i erozionit me brazda. Në zona me mbulesë bimore, vërehet fillimi i shkarjes së dherave. Masat e mbrojtjes së tokës në zonat e kultivuara. Vështirësi të lehtë në lëvizjen e mjeteve, mundësi vendbanimi dhe funksionimit të industrive. Kultivimi është i mundur me përdorimin e makinerive. Rekomandohet kultivimi sipas izohipseve.


Pjerrësia 5° – 15°: Reliev shumë i pjerrët (shpatet e luginave, shkallëzime tektonike). Lëvizjet e masive, erozion i fortë i tipit të mbulesës dhe me brazda, procese të theksuara erozive, në zona me mbulim të ulët bimor por fillimi i tyre dhe në zona me mbulim bimor të dendur. Rrëshqitje të mundshme të dherave dhe shkarje. Vështirësi të mëdha në ndërtimin e rrugëve dhe në lëvizjen e mjeteve. Kultivimi është i pamundur pa përdorimin e tarracave. Vështirësi në përdorimin e mekanizmave bujqësore.

Pjerrësia 15° – 35°: Reliev i thyer (15° - 25°) deri shumë i thyer (25° – 35°) (shpatet e luginave të maleve të mesme). Procese të forta zhveshjeje të çfarëdo lloji, shkarje dherash, rrjedhje balte, erozion shumë i theksuar linear dhe me brazda, si në zona të zhveshura ashtu dhe të mbuluara (pyje). Lëvizja është e mundur vetëm mekanizma me zinxhir. Kultivimi i pamundur, prerja e drurëve jo e favorshme. Zonë pyjesh dhe kullotash.

Pjerrësia 35° - 55°: Reliev rëpire (shpate shumë të pjerrëta të luginave të maleve të larta, shpatet e kanioneve prej gurësh gëlqerorë). Shtresë toke shumë e hollë, e pavazhduar, zhveshje e theksuar e materialit mëmë, ekspozim i fortë ndaj faktorëve të erozionit dhe të gravitetit. Kalimi i pamundur. Zonë pyjesh, kufiri i shfrytëzimit të prerjes së druve.

Pjerrësi > 55°: Reliev vertikal. Mungesë dheu. Zhveshje e shkëmbinjve dhe rënie e shkëmbinjve. Pamundësi e shfrytëzimit ekonomik.

Prirjet territorial në zonën e studimit variojnë nga 0-68°. Sipas histogramës (skema 1.3.7.2.2) dhe hartës së prirjeve (fig.1.3.7.2.2) dalim në përfundimin se zona në studim karakterizohet kryesisht nga një reliev i pjerrët me vlerë 57,28% të shtrirjes së përgjithshme të zonës në studim ndërkohë pasohet nga sipërfaqe me pjerrësi të fortë me vlerë 28,79%. Sipërfaqet e sheshta dhe lehtësisht të pjerrëta (0-5°) okupojnë 4,96%, ndërsa sipërfaqet e pjerrëta deri vertikale okupojnë 8,98%.



Grafiku 1.3.7.2.2: Histograma e pjerrësive të tokës në Bashkinë Pukë (Sipas Demek, 1972)




Figura 1.3.7.2.2: Pjerrësitë e tokës (në gradë) në Bashkinë Pukë (sipas Demek, 1972)

1.3.8. Analiza e elementeve kimike

Kontrollet mbi parametrat fiziko-kimike të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore tregojnë se ato janë të mira për të përmbushur nevojat e ujit të pijshëm dhe ujitjes. Megjithatë, ndikimi i mëvonshëm mbi to për shkak, së pari, të aktiviteteve minerare dhe së dyti, metodave të kultivimit, shpërndarjes së pakontrolluar të mbetjeve urbane dhe industriale, kanë bërë të pamjaftueshëm këtë burim të rëndësishëm, ndërsa banorët që e konsumojnë atë - të cënueshëm ndaj sëmundjeve.

Nga Studimi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për Bashkinë,² i cili i referohet cilësisë së ujërave nëntokësore të kontrolluara në burime të ndryshme natyrore të përhapura gjithandej në bashki, kanë dalë konkluzionet e mëposhtme lidhur me parametrat fiziko-kimike.

Ujërat nëntokësore të akuiferëve me porozitet ndërkokrrizore me përhapje të kufizuar dhe ujëpërcjellshmëri të ulët deri shumë të ulët kanë veti fizike e kimike të mira. Janë pa shije, pa ngjyrë, pa erë, transparente, me temperaturë më të lartë se ujrat e ultrabazikëve 12-14⁰ C. Edhe mineralizimi i tyre është më i lartë se sa tek burimet e akuiferëve me porozitet çarjesh. Ai shkon nga 0.25 - 0.3 gr/l. Kjo ndodh për shkak të shtimit të kohës së kontaktit ujë - shkëmb i ujërave dhe që lëvizin më ngadalë nëpër këto akuiferë porozë, duke rritur mineralizimin e tyre.

Përbërja cilësore e ujërave të burimeve të akuiferëve me porozitet çarjes - karst me përhapje të kufizuar dhe me ujëpërshkueshmëri tepër të ndryshueshme, vende-vende shumë të lartë është e mirë. Temperatura e tyre luhet nga 6.2 deri në 13.5⁰C dhe mineralizimi i përgjithshëm rreth 240 mg/l, fortësia e përgjithshme rreth 6.7 dH, dhe vlerat e Ph rreth 8. Ato i përkasin kryesisht tipit hidrokimik HCO₃-Ca.

Ujërat nëntokësore të akuiferëve me porozitet/çarje me përhapje të kufizuar dhe ujëmbajtje të ulët deri në shumë të ulët janë pa shije, pa erë, pa ngjyrë dhe cilësisht të mirë për tu pirë; përbërja kimike kushtëzohet nga litologjia akuifere. Ato shrytëzohen nga përdorues të veçantë familjar.

Në akuiferët me porozitet çarjesh me ujëpërshkueshmëri mesatare - të ulët dallohen cilësi të ndryshme të ujërave sipas origjinës së tyre. Për shembull, ujërat nëntokësore të Akuiferit të masivit të Krrabit kanë veti fiziko-kimike shumë të mira. Mineralizimi i përgjithshëm i tyre është në 600 mg/l, ujërat e këtij tipi janë shumë të buta, dhe në varësi të shkëmbinjve ku qarkullojnë janë të tipit me bikarbonat magneziale (HCO₃ – Mg) ose hidrokarbonat – kalçiumi (HCO₃ – Ca) por edhe tipe të përziera HCO₃-Ca-Mg e Mg-Na-Ca. Mbetja e thatë në këto burime luhet nga 18-300 mg/l. Temperatura e ujit të burimeve në këtë akuifer varion nga 3-18.2⁰ C, zakonisht ato janë 9 – 12.5⁰ C.

Përkatesisht, ujërat nëntokësore të Akuiferit të masivit të Pukës, kanë veti fiziko-kimike të mira. Mineralizimi i përgjithshëm i ujërave në burime luhet nga 84 mg/l deri në 264 mg/l, fortësia e përgjithshme nga 1.7 deri në 9.65⁰ gj dhe temperatura nga 9 deri në 13⁰ C. Tipet hidrokimike të ujërave nëntokësore të akuiferit janë kryesisht HCO₃-Mg; HCO₃-Mg-Na; HCO₃-Mg-Ca-Na.

Në akuiferët jo akuiferë, burimet kanë cilësi të mirë për përdorim për tu pirë dhe shfrytëzohen nga familja të veçanta. Ato kanë mineralizim të përgjithshëm rreth 220 mg/l, Fp rreth 7.70 dH dhe Ph në vlerat rreth 7.8. Janë kryesisht të tipit HCO₃-Ca-SO₄.

² SHGJSH 2017, "Gjeologjia - Gjeoresurset - Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë"

1.3.9. Informacion për geo-mjedisin

Evolucioni gjeo-historik i planetit identifikohet me pasoja komplekse, shtrembërime, ndryshime dhe rindërtim të kores së tokës, të cilat krijuan gjeomjedisin në të cilin në jetojmë sot. Nga të gjitha gjeomjediset, një pjesë e tyre kanë vlerë të vecantë shkencore dhe estetike dhe janë me rëndësi më të madhe. Ruajtja e disa prej tyre i bën ato zona të mbrojtura dhe i integron në një rrjet gjeoparqesh – gjeomonumentesh. Kriteret e integritimit janë si më poshtë:

- Integriteti
- Përfaqësimi
- Të qëniti i rrallë (rrallshmëria)
- Paleogjeografia
- Vlerat shkencore
- Vlerat ekologjike
- Vlera estetike
- Vlerat kulturore
- Vlerat e arritshmërisë

Gjeomonumentet kategorizohen duke u bazuar në fenomenet gjeologjike të cilat i kanë krijuar dhe estetikën e tyre. Gjejmë gjeomonumente në Tektono-strukture, Paleontologjike, paleobotanike e paleoambientale, Stratigrafike, sedimentare, Petrologjike/petrografike, Gjeomorfologjike komplekse, spelologjike dhe peisazhet, Hidrogjeologjike, Mineralogjike ekonomike, burimet e naftës dhe gazit.

Në kufijtë e Bashkisë ekzistojnë gjeomonumente me rëndësi lokale, kombëtare por edhe ndërkombëtare.

a) Gjeomonumente me vlera ndërkombëtare:

Amonitet e Kçirrës (VII-3) ose Fosilet e Kçirrës Gjeomonument paleontologjik-paleoambientalhistorik

Ky gjeomonument gjëndet në fshatin Kçirrë, 600 m mbi nivelin e detit Kçirra është bërë e njohur në literaturën ndërkombëtare gjeologjike qysh në vitin 1911, kur paleontologu austriak Arthaber G. A. me kampionet e mbledhura nga gjeologu i shquar F. Nopscha zbuloi 5 familje, 5 nënfamilje 9 gjini dhe 49 specie të reja amonitesh, gjithsej 62 specie, të cilat i botoi në artikullin “Dietrias von Albanien”. Këto specie të veçuara nga Arthaber u paraqitën edhe në veprën madhore të paleontologut anglez L. Spath “The ammonoidea of the Trias” në vitin 1934. Më vonë, këto amonite u gjetën edhe në Greqi e vende të tjera të Europës, Kinë, Himalaja, Timorr etj. Punime të detajuara për këtë objekt ka realizuar paleontologu Ded Marku. Ai ka gjetur të gjitha amonitet e përshkruara nga Arthaber, por ka gjetur edhe shumë specie të tjera të reja. Gjithashtu, ai ka gjetur edhe specie të grupeve të tjera si Belerunitide (Attracites) etj. Amonitet dalin në një sektor me formë ovale të përzgatur dhe sipërfaqe 4500 m² (gjatësi mesatare 150 m dhe gjërësi rreth 30m). Kjo prerje stratigrafike ndërtohet nga gëlqerorë të T1-2 (Verfenian-Anizian-Ladinian). Ajo është pjesë e kornizës karbonatike të ofoliteve të Zonës Mirdita. Koleksioni i amoniteve është gjetur në pjesën e sipërme të Verfenianit të poshtëm-Anizianit që përfaqëson në vetvete të ashtu-quajturin kat Kolumbitian. Disa nga speciet e studiuara janë Sagaceras albanikum, Pronorites osmani-cus, Procarmites

scanderbegis, etj. Ky gjeomonument ka vlera shkencore, gjeologjike, didaktike dhe historike. Kjo prerje është shpallur shesh në mbrojtje sipas VKM nr. 676, datë 20.12.2002 dhe vizitohet me rrugën Pukë-Kçirrë.

Rrudhosjet në pjesën qendrore të masivit ultrabazik të Krrabit (IV-6), Gjeomonument tektonikoo-strukture

Në pjesën qendrore të Krrabit, në veri të qytetit të Pukës, pak metra larg majës ku ndodhen antenat e përforcuesve televizive, vërehen zhveshje shumë të bukura që dëshmojnë për fenomenin e deformimeve dhe rrudhosjeve të shkëmbinjve ultrabazikë mantelorë. Format e deformimeve janë shprehur qartë dhe me bukuri të rrallë. Ky fenomen është takuar në ofolitet e Shqipërisë, por është i rrallë për ofolitet e tipit alpin. Masivi ndërtohet nga tektonitet ultrabazike, lercolite-harcburgitet, me ndërthurje dunitesh të rrudhosura dhe të millonitizuara (amfbolitizuara). Shkëmbinjtë formojnë mikrorrudha me pamje të vogla dhe të mesme, 2-3x0.5-1 m, me breznime plagioklazike e. më sipër në prerje, takohen troktolite, dunitë plagioklazike, deri në gabrot e Qelzës në perëndim. Vlera e këtij gjeomonumenti qendron në rrudhat dhe në ndërthurjet millonitike (në tektonite) dunit-peridotit. Ai vizitohet nëpërmjet rrugës automobilistike Pukë- Antenat e Krrabit.

b) Gjeomonumente me vlera kombëtare

Dajkat paralele në Kalivar-Munellë (II-10), Gjeomonument petrologjik/petrografk

Në vullkanitet e zonës Kalivar-Munellë, takohen daljet sipërfaqësore të dajkave paralele. Ky është një fenomen i rrallë në tërë brezin ofolitik mesdhetar, në kuadrin e vullkaniteve bazike. Dajkat janë shumë të spikatura në këtë territor dhe kanë përmasa të ndryshme, me trashësi 0.3-1 m dhe shtrirje dhjetra e qindra m. Ky gjeomonument ka vlera shkencore, gjeologjike dhe didaktike. Ai vizitohet nëpërmjet rrugës automobilistike Pukë-Munellë.

Gjeomonumente të tjera me vlerë kombëtare janë si më poshtë:

- Guri i Shenjtë, Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik
- Sofra e Lekës, Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik
- Mineralizimet e dausonitit-realgar-auropigmentit Koman, Gjeomonument mineralogjik e ekonomik
- Shpella e Kaurrit (V-d-44), Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, karstik
- Llavat jastëkore Rras i Egër, Gjeomonument petrologjik/petrografk
Llavat jastëkore mbi Përroin e Bicajt, Masivi i Krrabit, Gjeomonument petrologjik/petrografk

c) Gjeomonumente me vlera locale

Peneplena e Gomsiqes, Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik

Peneplena e Gomsiqes dodhet afër fshatit Gomsiqe, 800 m mbi nivelin e detit. Ajo përbën mbetje të peneplenës tortoniane: sheshimi i relievit nga veprimi i faktorëve të jashtëm (erozionet etj.), para 17 milionë viteve, në kushtet e qetësisë relative të lëvizjeve tektonike diferencuese. Peneplena ka formën e një pllaje të sheshtë: 1,5 km e gjatë, 700-750m e gjërë. Ky gjeomonument ka vlera

shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike dhe gjeoturistike. Ai është shpallur shesh në mbrojtje sipas VKM nr. 676, date 20.12.2002 dhe vizitohet nëpërmjet rrugës Pukë-Gomsiqe.

Ujvara e Gjegjanit, Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks

Ujvara e Gjegjanit ndodhet në Luginën e Fanit të Madh, sapo kalon Gojanin e Vogël dhe ekzaktësisht sa kalon Tunelin e Gojanit drejt Gojanit të Sipërm, pjesë e ish Komunës Gjegjan. Ajo ndodhet mbi shkëmbinjtë efuzivë të Mirditës Qëndrore që bien thik mbi Lumin e Fanit të Madh. Ajo ka një lartësi rreth 60m. Duhet theksuar fakti se në periudha thatësire kjo ujvarë nuk ka ujë. Jo shumë larg kësaj ujvare ndodhet edhe gjeomonumenti i Dajkave paralele në Kalivar-Munellë. Ky gjeomonument ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, didaktike dhe gjeoturistike.

1.3.10. Të dhëna për burimet gjeologjike

Struktura gjeologjike e Bashkisë disponon pasuri minerare, megjithatë, sasia nuk mund të llogaritet gjithmonë.

Sipas studimit "Gjeoresurset dhe Gjeorreziket në Qarqet e Shqipërisë" për rajonin e Shkodrës dhe hartës Gjeologjike të Prefekturës Shkodër e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (shkalla 1: 100,000) në bashkinë e Pukës gjenden tre grupe burimesh minerare.

- Minerale metalike dhe gurë (Krom, bakër, zhiva, hekur, titan)
- Minerale industriale, jo metalike (asbest, gurë dekorativë, gelqerorë, granit, kaolinë, xham vulkanik, argjilë, bazalte, dausonite, magnezite)
- Burime minerare energjetike (qymyr)

Në hartën e burimeve minerale ka edhe kategorizim në lidhje me përlllogaritjen apo jo të depozitave. Në zonat ku shfaqja e një burimi mineral nuk shoqërohet edhe nga një vlerësim i depozitës së tij, duhet të studiohet më tej mundësia e ekzistencës së sasive të shfrytëzueshme me qëllim që të studiohet potenciali i shfrytëzimit të tokës në këto rajone.

Zonat në të cilat janë përlllogaritur depozitat e mineraleve janë ndarë më tej në tri nënkategori:

Grupi I – Vendburime deri ne 100 000 ton, rezerva gjeologjike (në total)

Grupi II – Vendburime me 100 000 – 1 000 000 ton, rezerva gjeologjike (në total)

Grupi III – Vendburime mbi 1 000 000 ton, rezerva gjeologjike (në total)




Figura 1.3.10.1: Harta skematike e pasurive minerale të Bashkisë Pukë.

Mineralet Metalorë

Bakri

Sipas studimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me temë “Gjeologjia - Gjeoresurset – Gjeorreziqet dhe Mjedisit në Bashkitë e Shqipërisë”, për Bashkinë e Pukës, burimet kryesore të bakrit janë si më poshtë:

Vendburimi i bakrit Kçirë.

Është një vendburim i vogël, por më i madhi në gabrot e ofoliteve perëndimore dhe lokalizohet të masivit të vogël gabror të Kçirës. Vendburimi është shfrytëzuar nga miniera rreth 40 %, nga e cila janë nxjerrë 110114 ton xeherorë me Cu 0.95 %, ku ka gjendje në minierë edhe 203 000 ton me 1.63 %.Miniera është konservuar.

Shfaqja e mineralizuar Meçe.

Në Meç është llogaritur të ketë patur 42350 ton rezerva të kategorisë C1+C2. Trupi kryesor është shfrytëzuar që nga viti 1969, nuk janë shfrytëzuar disa trupa të vegjël në veri dhe jug të trupit kryesor me rezerva të kufzuara. (Gjoni S. T.D.K.Pukë, Plansheti K-34-64-D-b Viti 2003).

Vendburimi i bakrit Shmi

Për këtë vendburim janë raportuar 36196 ton rezerva të kategorisë C1 dhe 22726 ton C2. Gjithsej 58922 ton. Rezerva jashtë bilanci 5706 ton. Objekti është shfrytëzuar gjatë viteve 1975-1980, janë pa shfrytëzuar panelet mbrojtëse. (Gjoni S. T.D.K. Pukë, Plansheti K-34-65-C-c Viti 2003).

Objekti i bakrit Rras

Për këtë vendburim përmbajtja e bakrit lëviz nga 0.2-1.5-2 % dhe janë raportuar 52000 ton rezerva të kategorisë C1 dhe 20360 ton C2. (Gjoni S. T.D.K. Pukë, Plansheti K-34-64-B-b Viti 2003, Formular i pronave të paluajtshme. Viti 2003).

Burime të tjera të bakrit paraqiten në tabelën më poshtë.

Nr	Emri i vendburimit	Rezervat gjeologjike 000/ton	Përmbajtjet e komponentëve përbërës						Perspektiva
			Cu	Zn	Co	S	Au/g/t	Ag/g/t	
1.	Meçe Kabash	42.3	0.3-2.5	0.045	0.02			0.1	Hapur
2.	Shmi	58.9	0.5-2.5		0.005				Hapur
3.	Keçire	203	1.63						Hapur
4.	Qafe Bari	914	1.9	1.34	0.029	28.4	0.5-1		Hapur
5.	Rrasat e Kuqe	89.5	0.5-2		0.001	9-16			Hapur
6.	Qafe Bari (J)	252.4	0.9	1.25		9			Hapur
7.	Munelle	9600	1.19	0.7	0.008	21	0.74		Hapur
8.	Rras	218	0.3-2		0.012		0.45		Hapur
9.	Kimez	50	0.4	0.15		10			Hapur
10.	Tuçi Lindor	1100	2.31		0.011		0.1-1		Hapur
11.	Qerret Vogel	6	1.5						Hapur
12.	Dedaj	3	1.19				2.5		Hapur
13	Braka e Thive	37.2	1.27	0.08	0.01	5			Hapur
14.	Bicaj	10.5	0.2-1.2						Hapur
15.	Lum Zi	18	0.6-2.6	0.01	0.005				Hapur
16.	Gojan	6	1.1						Hapur
17.	Kalivare	42	0.64	0.24					Hapur
18.	Gjegjan	16	0.9						Hapur
19.	Qafe Lisi	40	0.3	0.7					Hapur

Tabela 1.3.10.1: Tabela e vendburimeve dhe gjetjeve të bakrit

Bazuar në të njëjtin studim:

* Mineralizimet e bakrit në Qarkun e Shkodrës janë nga më të rëndësishmet në vendin tonë, si për nga sasia dhe cilësia e tyre.

* Në kuadrin e vlerësimeve, studimeve dhe punimeve të kërkim- zbulimit në këto rajone janë realizuar volume të konsiderueshme, duke u pasqyruar në raporte, relacione dhe projekte të ndryshme.

* Edhe momentalisht në këtë rajon po vazhdohet me punime shfrytëzimi dhe linja përpunimi, me përjashtim të gjithë sektorëve tjerë të vendit që nuk punohet.

* Në rajonin e qarkut të Shkodrës janë në aktivitet dhe disa Leje Minerare Kërkim – Zbulimi.

* Pavarësisht nga punimet e realizuara në këtë rajon, përsëri ka hapësira të mëdha për të punuar, si në aspektin e shfrytëzimit, kërkim – zbulimit dhe në atë të përpunimit e deri në atë metalurgjike.

Hekuri.

Sipas studimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me temë “Gjeologjia - Gjeoresurset – Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë”, nga të dhënat e fituara në fazën e kërkimeve me marshuta të dendura e punime gjeologjike, rezulton se në territorin e Bashkisë Pukë kemi të bëjmë me një brez të mineralizuar magnetit-mbajtës që shtrihet rreth 6 km gjatësi dhe 0.5-2 km gjerësi. Ky brez lokalizohet në zonën e kontaktit midis shkëmbinjve ultrabazik dhe atyre bazik duke fluar nga lagja Rukaj në jug e duke mbaruar në skajin verior afër Qerretit të Vogël. Në këtë brez lokalizohen venburimet e Planit, Luft, Rukajve, Bokës së Katundit, Dedajve. Në të gjitha rastet mineralizimi i magnetitit gjatë këtij brezi përqëndrohet në shkëmbinjte ultrabazik me shkallë të ndryshme injektimi me plagioklaz, ose me llojet metasomatike të tyre.

Nr.	Nr. në hartë	V.b, objekti ose shf. e mineralizuar	Rezervat gjeologjike 000/ton	Përmbajtja e komponentëve të dobishëm në %	
				Fe ₂ O ₃	SiO ₂
1	57	Planit Zona V	1606	14-27	40-60
2	60	Planit Zona J	433	14-27	40-60
3	62	Rukajve			
4	59	Lufit		14-25	
5	40	Boka e Katundit		19-25	
6	38	Dedaj 1			
7	35	Dedaj 2			
8	23	Perrejzit		16-70	20
9	27	Perroi i Shkallave			
Sasia e rezervave			2039	20	

Tabela 1.3.10.1: Vendburimet dhe gjetjet e mineralit hekur pa nikel³

Kromi

Sipas studimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me temë “Gjeologjia - Gjeoresurset - Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë”. Në territorin e Bashkisë së Pukës shtrihet masivi ofolitik i Pukës. Masivi ofolitik i Pukës bën pjesë në brezin e ofoliteve perëndimore. Në ndërtimin gjeologjik të këtij masivi marrin pjesë: sequenca e shkëmbinjëve mantelorë, zona kalimtare e (tranzicionit) dhe sequenca kumulate. Sequenca e shkëmbinjve mantelorë përfaqëson pjesën kryesore të rajonit dhe përbëhet nga lart poshtë: nga rreth 60 % dunitë, me ndërthurje harcburgitesh (Vrith-Lajthizë), nga facia harcburgite tektonite me linza të rralla dunitesh dhe facia e lercoliteve tektonite me ose pa

³ SH.GJ.SH 2017, “Gjeologjia - Gjeoresurset - Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë”

praninë e linzave dunitike. Janë të zhvilluara harcбургitet me linza të rralla dunitesh dhe takohen kryesisht nëpër përrenjtë e thellë (Gjader, Gomsiqe) e në zona të vogla (në jug të Livadhit të Kabashit). Në përbërjen minerale të tyre marrin pjesë olivina (60-70 %) ortopirokseni 15-30 %, klinopirokseni deri 5 %, kromshpinelidi 1-3 % dhe nga mineralet dytësore takohen serpentina e më rrallë talku. Më sipër vazhdojnë dunitet me ndërthurje harcбургitesh me zhvillim më të madh në zonën e Vrithit (Vrith-ajthizë), ndërsa si ndërthurje brezash, veçimesh të çrregullta linzash takohen në J, V të rajonit (Lugina e Kumbullës Gjadër), etj.

Nr.	Nr. në hartë	Emërtimi i V.b, objektit, shfaqjes.	Rezervat gjeologji 000/ton	Përmbajtja e komponentëve të dobishëm në %	
				Cr ₂ O ₃	Ni
1	87	Verrishte (Vrith)	3	20-46	99-
2	68	Fushë e Madhe	4	36	144-
3	67	Livadhi i Kabashit	-	10-29	-
4	71	Lugu i Kumbullës	-	20	-
5	91	Boka e Magjarit	-	6-25	-
6	93	Përroi i Magjarit	-	15-27	-
7	94	Vrith Zona 3	-	21-23	1.5
8	90	Likonja	-	20	-
9	92	Shkalla e Gjadrit	-	-	-
10	108	Kuzhnen	-	12	-
Sasia e rezervave			7	34.7	

Tabela 1.3.10.2: V.b, vendburimet dhe gjetjet e mineralit të kromit

Polimetalet (Pb-Zn)

Sipas studimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me temë “Gjeologjia - Gjeoresurset - Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë” Përqendrimet industriale të këtyre metaleve lidhen me shkëmbinj të intruzivë acidë, e më pak me të tjerët. Ato ndeshen edhe në depozitimet sedimentare. Plumbi është i butë dhe i petëzueshëm, shkrin në temperaturën 327°C dhe vlon në temperaturën 1700°C, ndërsa Zinku shkrin në temperaturën 419°C dhe vlon në temperaturën 907°C. Përhapja e Zn në vendburimet të lidhura me vullkanitet e Mirditës: Gjatë vlerësimit të mineralizimeve të bakrit, në vendburimet e lidhura me vullkanitet e Mirditës Qëndrore të konkretizuara me raporte gjeologjike, janë vlerësuar edhe mineralizimet e Zn dhe të shoqëruesve të tij, konkretisht: Në vendburimin Lak Roshi, në vendburimin Palucë Qëndrore, në vendburimin Guri i Kuq-Lak Ahu, vendburimin Rruga e Rinisë. Në vendburimin e bakrit Tuç. Në vendburimin Qafë Bari si dhe objektet rreth tij, Qafë Bari Lindor - Qafë Bari Qëndror, Qafë Bari Jugor - Guri i Korbit, etj.

Nr.	Nr. në hartë	V b. ose sh. e mineralizuar.	Rezervat gjeologjike 000/ton	Përmbajtja e komponentëve të dobishëm në %		
				Zn	Pb	Cu
1	79	Kimez	-	-	-	-
2	85	Qafe Lisi	3	1.5	0.3	0.1
Sasia e rezervave			3			

Tabela 1.3.10.3: V.b, objektet dhe vendburimet dhe gjetjet e mineralizuara për polimetalet.

Titani

Sipas studimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me temë “Gjeologjia - Gjeoresurset - Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë” Mineralizimet e titanomagnetitit lidhen në pjesën më të madhe me kompleksin shkëmbor gabro-peridotit, kryesisht më pjesën e mesme e të sipërme të tij, të përfaqësuar nga masivë të vegjël gabrorë të zgjatur, me shtrirje afro meridionale me raport gjatësi-gjerësi nga 3:1 deri 8:1 (Masivi i ferrogabrove të Kashnjetit). Këto masivë shquhen për ndërtim të stratifikuar, shpesh me kalime graduale për në shkëmbinj të ultrabazikë me plagjioklaz, troktolite, etj, ndonjëherë me pamje apofzash. Masivët e vegjël të Sukaxhi-Thanzës, Ungrejt, Fregenit, ndërtohen prej shkëmbinjsh gabrorë të llojeve magneziale, hekurore, amfbolike e gabrodiabazike, ku dallohet qartë natyra e brezave trashamane melanokrate, mezokrate e leokokrate në dallim me gabrot izotropike të brezit lindor, ku dhe Ti ka përmbajtje më të lartë. Në rajonin e Bashkisë Pukë këto mineralizime kanë zhvillim të kufizuar dhe përfaqëohen me disa dalje me përmasa të vogla, ndër të cilat me rëndësi është ajo e Dedajt.

Nr.	Nr. në hartë.	V b. ose sh. e mineralizuar.	Rezervat gjeologjike 000/ton.	Përmbajtja e komponentëve të dobishëm në %.	
				TiO ₂	Fe ₂ O ₃
1	22	Dedaj	-	5.35	27.34

Tabela 1.3.10.4: V.b, vendburimet dhe gjetjet e mineralit të titanit.

Zinku

Sipas studimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me temë “Gjeologjia - Gjeoresurset - Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë” Takohet pothuajse në të gjitha tipet gjenetike të vendburimeve të bakrit, në trajtën e mineralit të sfaleritit. Sasia dhe përmbajtja e tij ndryshon në varësi të tipeve të vendburimeve. Në pikëpamje metalogjenike për zonën Mirdita, mineralizimet e zinkut, ndonjëherë të shoqëruar edhe me të arsenikut (falerçët, arsenopiriti, etj), plumbit (galeniti) lokalizohen kryesisht në pjesët dhe nivelet e sipërme të trupave dhe të objekteve e vendburimeve sulfure të bakër-zinkut dhe të bakrit, duke ruajtur në përgjithësi zonalitet të drejtë në prerjen vertikale të këtyre mineralizimeve

Nr.	Nr. në hartë.	Vendburimi.	Rezervat gjeologjike 000/ton	Përmbajtja e komponentëve të dobishëm në %.		
				Zn	Pb	Cu
1	104	Gurth 2 (Koshaj)	294.6	2.3	-	-

Tabela 1.3.10.5: V.b, vendburimet dhe gjetjet e mineralit të zinkut.

Mineralet jometalorë (Mineralet dhe shkëmbinj të industrialë)

Argjilat

Sipas studimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me temë “Gjeologjia - Gjeoresurset - Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë” Argjilat në rajonin e Bashkisë Pukë shtrihen në pjesën perëndimore dhe përfshijnë zonën Qerret-Luf-Korthpulë. Argjilat janë shkëmbinj të mbetur në

vend, ose të transportuara nga ujërat rrjedhëse dhe të depozituara në lumenjtë, liqenet, lagunat, cekëtinat bregdetare. Shndërrimi kimik i silikateve dhe alumosilikateve gjatë procesit të gjatë të tjetërsimit shpie, në fund të fundit, në formimin e mineraleve argjilore. Sipas kushteve të formimit, argjilat ndahen në disa tipe: Argjila eluviale, argjila sedimentare dhe argjilat kontinentale.

Nr.	Nr. në hartë.	V.b. ose shf. minerali	Rez. gjeolo. m ³	Përmbajtja e komponentëve të dobishëm në %.			
				MgO	Al ₂ O ₃	Fe ₂ O ₃	SiO ₂
1	54	Pla	85000	0.354.58	13.65-17.66	10.62-16.56	58-62
2	63	Lepërthit	35000	2.62	14.22	8.56	59.1
Sasia e rezervave			120000				

Tabela 1.3.10.6: V.b, vendburimet dhe gjetjet e mineralit të argjilave.

Azbesti

Sipas studimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me temë “Gjeologjia - Gjeoresurset - Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë” Mineralizimet e azbestit përqendrohen në shkëmbinj të ultrabazikë në afërsi të kontakteve me shkëmbinj të gabrorë e plagjiogranitikë, vullkanogjenë e vullkanogjeno-sedimentarë dhe në zonat e dobësuar tektonikisht. Vërehet lidhje e ngushtë e mineralizimit të azbestit me tektonikën shkëputëse. Mineralizimi lidhet më tepër me serpentinitet, harcburgitet e serpentinizuara, rrallë herë me lercolitet dhe dunitet e serpentinizuara. Formon zona ose breza të zgjatur. Në masivin ofolitik të Pukës, janë fksuar disa shfaqje të asbestit ndër të cilat dallohen objektet e azbestit të Pukës dhe Kaftallës.

Nr.	Nr. në hartë.	V b. ose sh. mineralizuar	Rez. gjeolo. 000/ton	Përmbajtja e komponentëve të dobishëm në %.			
				MgO	CaO	Al ₂ O ₃	Fe ₂ O ₃
1	43	Pukë	8657	38.1	2.04	1.03	6.04
2	82	Korthpulë	16562				
3	95	Kodra e Gjatë	-				
Sasia e rezervave			25219				

Tabela 1.3.10.7: V.b, vendburimet dhe gjetjet e mineralit të asbestit.

Bariti

Sipas studimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me temë “Gjeologjia - Gjeoresurset – Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë” Daljet rrënjësore të baritit janë evidentuar në masivin granitik të Lëvrushkut. Vendburimi i Lëvrushkut bën pjesë në zonën tektonike Mirdita dhe ndodhet në ballin veriperëndimor të mbihijes së saj mbi zonën tektonike të Cukalit, gjë që e ka kushtëzuar gjendjen shumë të trazuar të shkëmbinjve dhe mineralizimeve që ndërtojnë këtë rajon. Të gjitha vendburimet e njohura të baritit (dhe të viteritit), në bazë të kushteve të formimit ndahen në tipet

endogjene dhe ekzogjene. Ndërmjet këtyre vendburimeve veçohen këto tipe gjenetike: karbonatike, hidrotermale, sedimentare, vullkanogjeno-sedimentare, të mbetjes, shkrifërimet dhe ato teknogjene.

Nr.	Nr. në hartë.	Objekti.	Rez. gjeologj 000/ton	Përmbajtja e komponentëve të dobishëm në %.			
				BaSO ₄	CaO	Fe ₂ O ₃	SiO ₂
1	5	Lëvrushk	60	37.78	3.66	-	50.20

Tabela 1.3.10.8: V.b, vendburimet dhe gjetjet e mineralit të baritit.

Bazaltet

Sipas studimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me temë “Gjeologjia - Gjeoresurset – Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë” Bazaltet janë shkëmbinj, që mbështetur në treguesit fiziko-mekanikë e kimikë. Janë nga më cilësorët, që plotësojnë kërkesat teknike për t’u përdorur si lëndë inerte ofolitike, për bazamente aeroportesh, portesh, linjash hekurudhore, autostradash, etj, duke zëvendësuar të gjitha lëndët e mëparshme të marra nga depozitimet e lumenjve dhe ato karbonatike. Vullkanitet bazaltike në rajonin tonë zhvillohen në dy breza: brezi lindor (rajoni Gurth-Qafë Mali) dhe brezi perëndimor (i përfaqësuar nga vullkanitet bazaltike të rajonit Rras, Dom, Kalivare, Fushë Arrëz, Rrapë, Kabash etj). Këto vullkanite të Mirditës Qëndrore janë të ndara në dy sekuenca: sekuenca bazaltike dhe sekuenca bazalto-andezite-andezito-dacit-riolite.

Nr.	Nr. në hartë.	Objekti	Rez. gjeolo. 000/ton
1	53	Kroi Zojes	9000

Tabela 1.3.10.9: Vendburimi i bazalteve.

Gëlqerorët

Sipas studimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me temë “Gjeologjia - Gjeoresurset – Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë” Në rajonin e Pukës janë të evidentuara disa shfaqje dhe vendburime të gëlqerorëve si ata në Kaftall, Rrasa e Korthpulës, Kçirë, Qerret i Madh, etj.

Nr.	Nr. në hartë.	V b. ose sh.e mineralizuar	R. gjeol nëm ²	Përmbajtja e komponentëve të dobishëm në %.	
				CaO	MgO
1	86	Kaftall	4421200	55.4	0.31
2	80	Rrasa e Korthpulës	1506000	54.9	0.41
3	70	Kçirë	2511600	53.8	1.67
4	18	Kaçilung	1473200	53.1	0.39
5	33	Rrasa e Qerretit	574400	53.5	0.40

6	100	Gazoll	832000	50.4	2.6
Sasia e rezervave			11318400		

Tabela 1.3.10.10: Vendburimet dhe gjetjet e mineraleve gëlqerorë.

Granitet

Bazuar në studimin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me temë “Gjeologjia - Gjeoresurset - Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë” Shkëmbinjtë granitikë në rajonin tonë përfaqësohen me masivin granitik të Levrushkut. Nga mineralet më të rëndësishëm janë ortoklazet, plagjioklazet acide, ato alkalinoe: leucidet të kaliumit, natriumit dhe pjesërisht ato të kalciumit. Plagjioklazet me përbërje albiti quhen acide, ndërsa plagjioklazet me përmbajtje të lartë të komponentit anortit quhen bazike. Në sasi të vogël në to janë të pranishëm Rb, Ce, Sr, B, Ga, Ta. Vetitë më të rëndësishme të feldshpateve janë: temperatura e shkrirjes jo e lartë (nga temperatura 1170° C, deri 1450°C) dhe mundësia që gjatë ftohjes të ngrijnë (si qelqe transparente), vetitë dielektrike, treguesi i thyerjes i vogël, fortësia e madhe, pesha specifike e vogël, etj.

Nr.	Nr. në hartë.	Objekti.	Rez. gjeolo 000/ton.	Përmbajtja e komponentëve të dobishëm në %.				
				MgO	CaO	Al ₂ O ₃	Fe ₂ O ₃	SiO ₂
1	3	Levrushk	932	0.80	0.91	13.15	1.39	73.1

Tabela 1.3.10.11: Vendburimet dhe gjetjet e mineraleve granite.

Gurët dekorativë

Bazuar në studimin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me temë “Gjeologjia - Gjeoresurset - Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë” Gurët dekorativë përfshijnë një gamë të gjerë të shkëmbinjve sedimentarë të metamorfzuar, pjesërisht të metamorfzuar dhe shkëmbinj magmatikë, ndër të cilët veçohen sidomos mermeret kalcitike, mermeret dolomitike, gëlqerorët e mermerizuar, gëlqerorët dolomitikë të mermerizuar, gëlqerorët konglomeratikë dhe brekçiozë të mermerizuar, granite, diorite kuarcore, gabro e troktolite, olivinite, dunitë, harchurgitet e serpenitinizuara, piroksenitet, etj. Në tërësi gurët dekorativë janë të grupuara në tre tipe kryesore gjenetike: gurë dekorativë të origjinës endogjenë (magmatike), gurë dekorativë ekzogjenë sedimentarë dhe gurë dekorativë të origjinës metamorfke.

Nr.	Nr. në hartë.	Objektet	Rez. gjeologjike m ²	Përmbajtja e komponentëve të dobishëm.			
				MgO %	Fe ₂ O ₃ %	SiO ₂ %	Rez. shtypje kg/cm ²
1	9	Mardhanaq	57500				1504
2	96	Fushe Lajit	145800				1545
3	69	Vorbthinë		9 -17	1.6-3.3	82.2	
4	65	Mali i Skajes					
Sasia e rezervave			203300				

Tabela 1.3.10.12: Vendburimet dhe gjetjet e mineralet e gurëve dekorativë

Inertet lumore

Bazuar në studimin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me temë “Gjeologjia - Gjeoresurset – Gjeorreziket dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë” Në territorin e Pukës janë realizuar studime për vlerësimin e inerteve lumore në luginën e lumit Fani i Madh, duke filluar nga Fushë Arrezi-Shkozë-Gojan-Gjegjan, e deri në afërsi të Rrëshenit. Nga studimet paraprake të kryera janë përcaktuar katër sheshe perspektivë për shfrytëzimin e inerteve lumore: Sektori tek Ura e Gjejanit, Tuneli tek Ura e Kalivarës; në fshatin Breg ku takohet Përroi i Lumit të Zi me Fanin e Madh, si dhe sektori tek Ura e Bardhetit. Inertet e lumit Fani i Madh në 80-90% përbëhen nga shkëmbinj magmatikë, vetëm 5-10% ndërtohen nga shkëmbinj të karbonatikë e terrigjenë. Përbërja granulometrike është e tillë: Poplat me diametër 8cm zënë 20-25 %, zhavorri me diametër 4-8 cm zë 30-35 %, zhavor me diametër 2-4 cm zë 20-25 %, rëra e trashë me diametër 0.5-2 cm zë 10-15 %, rëra 0.5 cm zënë 10-15 %.

Nr.	Nr. në hartë	V b, objekti ose shf. mineralizuar	Rezervat gjeologjike m ³	Granulometria në % sipas fraksioneve			
				80 mm	40-80 mm	20-40 mm	5 mm
1	103	Dom	16942	25	35	25	15
2	106	Ura Gjegjanit	-	25	35	25	15
3	88	Kimza Thate	-				
Sasia e rezervave			16942				

Tabela 1.3.10.1: Vendburimet dhe gjetjet e inerteve.

Kaolinat

Burimet Kaolina në Bashki paraqiten në tabelën më poshtë:

Nr	Nr. në hartë	V b. ose sh. mineralizuar	R e z . gjeologj 000/ton.	Përmbajtja e komponentëve të dobishëm në %				
				MgO	CaO	Al ₂ O ₃	Fe ₂ O ₃	SiO ₂
1	20	Dedaj	873	3	1.3	32.-33	4.5-5	43
2	81	Korthpulë	344	2.5-6		24-32	1.5-2	45
3	12	Kodër Fruthi	131	1.5-9	4	28-32	2-8	45
4	42	Talle	100	3-8	4.1	21-28	3-4	45
5	14	Kodra Dervisht	-	1-9	-	25-29	2-9	-
6	50	Fushë Qarri	20	-	2.7	27	4.2	41
7	56	Arat e Lijta	2	-	-	26-29	3.8	-
8	58	Luf	-	-	-	-	-	-
Sasia e rezervave			1470					

Tabela 1.3.10.14: Vendburimet dhe gjetjet e mineralit kaolina.

Xhami Vullkanik

Bazuar në studimin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me temë “Gjeologjia – Gjeoresurset – Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë” Xhamet vullkanike janë shkëmbinj me përdorim të gjerë në ekonomi, në veçanti në fushën e ndërtimit dhe si termoizolues. Xhamet vullkanike janë të lidhura me serinë bazalto-dacitike vullkanike të ofoliteve të zonës Mirdita, ndodhen në territorin e rretheve Pukë-Mirditë. Në rajonin e Pukës janë të njohura vendburimet dhe objektet e Qafë Mali, Lum Zi, Lumbardhë, Lak Roshi, Qafë Bari, Munellë, etj.

Nr	Nr. në hartë.	objekti	R e z . gjeolo 000/t	Përmbajtja e komponentëve të dobishëm në %.					
				MgO	CaO	Al ₂ O ₃	Fe ₂ O ₃	SiO ₂	Na ₂ O
1	61	Lum Zi	500	04-0.7	4-5	9.9-10.	1.5-1.9	64-66	1.5-1.8
Sasia e rezervave			500						

Tabela 1.3.10.15: Vendburimet dhe gjetjet e mineralit të xhamit vullkanik.

Lëndët e para energjetike

Qymyret

Bazuar në studimin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me temë “Gjeologjia – Gjeoresurset – Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë” Formacionet qymyrbajtëse janë formuar gjatë fazave të vonshme të zhvillimit të Albanideve dhe migrimi i tyre në kohë e hapësirë ka ecur nga territori i zonave të brendshme në ato të jashtme, duke krijuar pellgje me moshë e veçori dalluese. Në bashkinë Pukë qymyret takohen në malin e Munellës dhe lokalizohen në depozitimet e Kretakut.

2. ANALIZA, RISHIKIMI I PLANEVE EKZISTUESE, STRATEGJITË, POLITIKAT, NORMAT DHE STANDARTET

2.1. Analiza e legjislacionit kombëtar e lokal të planifikimit të territorit dhe kuadri ligjor

2.1.1. Plani territorial në Shqipëri - Hyrje

Zhvillimi historik i planifikimit të territorit në Shqipëri lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me zhvillimet e mëdha politike dhe social-ekonomike që ka kaluar vendi gjatë dekadave të fundit. Këto zhvillime kanë ndikuar në perceptimin mbi kuptimin dhe rolin e planifikimit, si dhe mbi përmbajtjen dhe kuadrin ligjor që e rregullon atë.

Planifikimi i mirëfilltë urban i disa prej qyteteve shqiptare mori hov gjatë viteve 1922–1944, si rezultat i bashkëpunimit të arkitektëve Shqiptarë, Italinë e Austriakë (si Brasini në 1925, Kohler në 1928, Bossio dhe Poggi në 1940⁴). Në kuadër të mbështetjes ekonomike të vendit nga Italia⁵, kompani italiane dhe profesionistë u përfshinë në planifikimin urban dhe arkitektonik të qyteteve më të mëdha të Shqipërisë, dhe morrën përsipër ri-konceptimin e infrastrukturës publike në të gjithë vendin (p.sh lidhje me rrugë të qendrave të mëdha urbane). Këto plane hodhën idetë e qyteteve me zona të ndara funksionale, duke parashikuar edhe zhvillimet apo zgjerimet e mëtejshme (zonat rezidenciale, zonat industriale, parqet etj). Përcaktimi i së ashtu quajturës “vijë e verdhë” ndante zonat urbane, brenda së cilave do të lejohej ndërtimi, me ato rurale duke krijuar disa unaza lëvizëse. Megjithatë, zhvillimi i planifikimit nga periudha e monarkisë (1922-1944) deri në periudhën e regjimit totalitar komunist (1945-1990), ishte i vogël dhe lidhej me konsolidimin e karakterit urban (Planifikimit Urban).⁶

Pas Luftës së dytë Botërore dhe me themelimin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, shteti pati kontroll të plotë mbi zhvillimi territorial dhe çdo lloj aktiviteti. Zbatimi i reformës agrare dhe shtetëzimi i të gjitha pronave private, shtroi nevojën e një planifikimi të gjerë e të kujdesshëm. Duke u bazuar në folozofinë ruse, zhvillimi i qyteteve shqiptare u organizua fillimisht në plane 2-vjeçare, e më pas në planet 5-vjeçare⁷, të cilat përmbanin një sërë fushash me prioritete zhvillimi. Investimet ruse e kineze, ndihmuan në vënien në lëvizje të ekonomisë vendase si dhe rindërtimin e qyteteve, apo ndërtimit të qyteteve të reja (si Kukësi). Organizimi i qyteteve u ndikua edhe nga zhvendosjet e popullësisë brenda vendit, bazuar në filozofinë e ri-shpërndarjes së popullësisë dhe kuadrove në të gjithë vendin, si dhe praktikën e shtetëzimit. Planet gjithashtu përcaktonin ndarjen territoriale, të përdorimeve të lejuara të tokës në zonat urbane, zonat rekreative, zonat sportive etj.

Me rënien e sistemit komunist dhe demokratizimin e vendit, filloi një periudhë tranzicioni (1990-2009), e cila çliroi të gjithë shtypjen sociale të akumuluar ndër vite dhe inkurajoi zhvillimin e flukseve të mëdha të migrimit të brendshëm. Nga njëra anë dëshira për të jetuar në qendrat urbane çoi drejt urbanizimit intensiv dhe në zgjerimin e ndërtimeve pa leje, pa marrë parasysh në të njëjtën

⁴ Besnik Aliaj, Keida Lulo, Genc Myftiu, *Tirana - Sfida e Zhvillimit Urban*, Dhjetor 2003.

⁵ Në këtë drejtim u themelua Shoqëria për Zhvillim Ekonomik të Shqipërisë.

⁶ Ledio Allkja, *Changing Planning Cultures - The Case of Albania*, Korrik 2012.

⁷ Ilir Parangoni, *Arkeologjia Industriale*, 2012.

kohë dhe kujdesin për të siguruar infrastrukturën e nevojshme teknike dhe sociale. Nga ana tjetër rezultoi në një rënie dramatike të popullsisë së zonave malore dhe përkeqësimin e vendbanimeve të tyre apo edhe braktisjen e disa prej tyre.

Gjatë viteve të para (1990 – 1993) planifikimi territorial mbështetej në kuadrin ligjor ekzistues të kohës dhe nuk mundi të përshtatej më ndryshimet e shpejta që ndodhën. Nuk kishte parashikime për zonim të zonave urbane ose planifikim të zonës jashtë saj (unaza), Gjithashtu, tek qytetarët mbizotëronte perceptimi se planifikimi institucional ndërhynte në liritë e tyre për të menaxhuar si ata duan pronën e tyre private. Përhapja e gjërë e ndërtimeve pa leje në kombinim me pamundësinë e institucioneve shtetërore për ta kontrolluar, çoi drejt konsolidimit të kësaj praktike në territorin shqiptar. Pasojat e para negative të tranzicionit lidheshin me fenomenin e ndërtimeve informale, pamjaftueshmërisë së infrastrukturës, mjediseve dhe shërbimeve publike, përdorimi i paqëndrueshëm të burimeve natyrore, degradimi i cilësisë së hapësirave të ndërtuara etj.

Nga viti 1991 e tutje, qeveria miratoi ligje dhe masa, me qëllim që të kishte kontroll mbi blerjet dhe përdorimin e tokës. Një sërë ligjesh kishin të bënin me të drejtat e pronësisë (të drejtat e tokës dhe pronës) dhe disa të tjerë trajtonin çështje të planifikimit territorial, zhvillimit rajonal dhe strehimit (shiko tabelat 2.1.1.1 dhe 2.1.1.2).

Pas vitit 1993, dallohen tre periudha, që korrespondojnë me një numër të barabartë ligjesh për planifikimin (Ligji Nr. 7693 i vitit 1993, Ligji Nr.8405 i vitit 1998, Ligji Nr. 9482 i vitit 2006). Ligjet Nr. 7693, datë 06.04.1993 dhe Nr. 8405, datë 17.09.1998, që njihen si Ligjet e Urbanistikës, përcaktuan udhëzimet për zhvillimin dhe vendosjen e perdorimeve të tokës. Megjithatë, nuk “preknin” çështjet e fundit dhe ndryshimet në vend, të tilla si privatizimi i prodhimit dhe ekonomisë.

TE DREJTAT MBI TOKËS DHE PASURITË E PALUATËSHME	
KUADRI LIGJOR BAZË	
viti	Ligji/ VKM
1991	Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" Ligjin Nr. 7715, datë 2.6.1993 (i ndryshuar me Ligjin Nr. 7763, datë 25.10.1993); Ligjin Nr. 7855, datë 29.7.1994; Ligjin Nr. 7971, datë 26.07.1995; Ligjin Nr. 8752, datë 26.3.2001; Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004
1992	Ligji nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore"
1994	Ligji nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluatëshme "
1995	Ligji nr. 7980, datë 27.07.1995 "Për shitblerjen e trojeve", ndryshuar me Ligjin Nr. 8260, datë 26.11.1997
1995	Ligji nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", ndryshuar me Ligjin nr. 20, datë 10.3.2016.
1995	Ligji nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me: Ligjin nr.8099, datë 28.3.1996, Dekretin nr.1631, datë 1.11.1996, Ligjin r.8237, datë 1.9.1997, Ligjin nr.8333, datë 23.4.1998, Ligjin nr.8482, datë 10.5.1999, Ligjin nr.8885, datë 22.4.2002, Ligjin nr.9775, datë 12.7.2007, Ligjin nr.10264, datë 8.4.2010, Ligjin nr. 8, datë 11.2.2016
2001	Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësite e qeverisjes vendore" Ligji nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për Pronat e paluajtshme të shtetit", ndryshuar me: Ligjin Nr. 9558, datë 08.06.2006

	Ligji nr.8752, datë 26.03.2001 i perdirtësuar me Ligjin 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, ndryshuar me: Ligjin nr.10257, datë 25.03.2010, Ligji nr.16, datë 16.02.2012
2004	Ligji nr. 9232, datë 13.05.2004 "Për programet sociale të strehimit" VKM nr. 8143, datë 03.12.2004 "Për standartet e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit" Ligji nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për Kthimin dhe kompensimin e pronës”, nryshuar me: Ligjin Nr. 9388, datë 04.05.2005, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 26, datë 02.11.2005, Ligjin Nr. 9583, datë 17.7.2006, Ligjin Nr. 9684, datë 06.02.2007, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 04.04.2007, Ligjin Nr. 9898, datë 10.04.2008, Ligjin Nr. 10 095, datë 12.3.2009, Ligjin Nr. 10 207, datë 23.12.2009, Ligjin nr. 10 308, datë 22.7.2010, Vendim i GJK nr. 27/2010, Vendim i GJK nr.43/2010, Ligj nr. 55/2012, Ligjin nr.49, datë 8.5.2014, Ligjin nr.47, datë 7.5.2015, Vendim i GJK nr.5, datë 5.2.2015 Ligji nr. 9404, datë 29.10.2004 "Për legalizimin dhe planifikimin urban të zonave informale"
2006	Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje"
2007	Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" Ligji nr. 9786, datë 19.07.2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9482 të vitit 2006"
2008	Ligji nr. 9895, datë 09.06.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9482/2006 Vendim nr.1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor” Ligji nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, ndryshuar me: Ligjin nr.10136, datë 11.5.2009; Aktin normative nr.5, datë 30.9.2009; Ligjin nr.58, datë 17.5.2012; Ligjin nr.176, datë 16.12.2013; Ligjin nr.172, datë 18.12.2014; Ligjin nr. 62, datë 2.6.2016
2009	Ligj Nr.10 186, datë 5.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin” (i përditësuar)
2011	Ligjin Nr.10395, datë 10.3.2011
2012	Ligji nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ndryshuar me: Ligjin nr. 9, datë 11.2.2016 Ligji nr. 55, datë 10.05.2012 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9235/2004" VKM Nr. 410, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”
2013	Ligji nr. 141, datë 02.05.2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482/2006"
2014	Ligji nr. 50, datë 15.05.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482/2006"
2014	Ligjin Nr. 67, datë 14.5.2014 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, i ndryshuar.
2015	Ligji Nr. 133, datë 5.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”
2016	VKM 221, datë 23.03.2016 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të agjencisë së trajtimit të pronës” VKM 222, datë 23.03.2016 “Për trajtimin e kërkesave për njohjen e pronës e të kompensimit të saj” VKM 223, datë 23.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronës” VKM 321, datë 27.04.2016 “Për miratimin e dokumentit” standartet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri- Tema: parcelat kadastrale”

Tabela 2.1.1.1: Të drejtat mbi tokën dhe pasuritë e paluajtshme: kuadri ligjor bazë.

Ligji nr. 7693, datë 06.04.1993 “Për urbanistikën”, përbën dokumentin e parë ligjor për planifikimin e territorit pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri. Kryesisht, ky ligj përfshiu përvojën e tre

viteve të para (periudhën 1990–1993). Nga njëra anë vendosi rregullat themelore për përcaktimin e tipologjive të përdorimit të tokës dhe zonave të zhvillimit të trojeve, në të gjithë territorin e vendit, nga ana tjetër ndarjen e përgjegjësisë në nivelet administrative përkatëse të planifikimit. Përcaktoi detyrimin e bashkive me popullsi me më shumë se 10,000 banorë në qendrat urbane për të prodhuar një plan strategjik, plan rregullues dhe studime urbanistike të pjesshme. Gjithashtu, përcaktoi detyrimin e rretheve për hatimin e planeve rajonale në zonën e jashtme të tyre (unaza) dhe themeloi Këshillin e Rregullimit të Territorit - KRRT duke i dhënë kompetenca për miratimin e planeve të përgjithshme rregulluese dhe studimeve të pjesshme urbane. Sipas burimeve të literaurës, ky ligji nuk sqaron përmbajtjen e saktë të planeve rregulluese, ndërsa disa prej projekteve të pakta në numër që u hartuan ishin teknike, dokumenta rregullatore që ilustroheshin në mënyrë grafike dhe shpesh herë nuk miratoheshin.

PLANIFIKIMI URBAN DHE TERRITORIAL		
KUADRI LIGJOR BAZË		
viti	ligji	Akti rregullator
1993	Ligji nr. 7693, datë 06.04.1993 "Për urbanistikën"	
1998	Ligji nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën"	
2006	Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin,urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje"	
2007	Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" Ligji nr. 9743, datë 28.05.2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën" Ligji nr. 9843 datë 17.12.2007 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën"	
2009	Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit" Ligji nr. 10078 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën dhe ndryshimet e mëvonshme" Ligji nr. 10097 datë 19.03.2009 "Për disa shtesa në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën"	VKM nr. 1190, datë 13.11.2009 "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit"
2010	Ligji nr. 10258, datë 25.03.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit" Ligji nr. 10360, datë 16.2.2010 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit"	VKM nr. 459, datë 16.6.2010 "Për miratimin e standarteve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS" <i>*VKM nr. 460, datë 16.6.2010 "Për organizimin dhe funksionimin e regjistrit të planifikimit të territorit"</i> VKM nr. 480, datë 22.06.2011 "Për miratimin e rregullores model të planifikimit" <i>*VKM nr. 481, datë 22.06.2011 "Për miratimin e rregullores uniforme të instrumenteve të planifikimit"</i> <i>*VKM nr. 502, datë 13.07.2011 "Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit"</i>
2013	Ligji nr. 22, datë 14.02.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10119,	

	datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit" Ligji nr. 110, datë 01.04.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit"	
2014	Ligji nr. 107, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit". Ligj nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë. Ligji nr.183, datë 24.12.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007"	
2015	Ligji nr.73, datë 02.07.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"	VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" VKM nr. 671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" VKM nr. 672, datë 29.07.2015 "Për një ndryshimin në VKM nr. 408, datë 13.5.2015" Vendim nr. 1096 datë 28.12.2015 "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike" VKM nr.894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësive Vendore" VKM nr.,280, datë 01.04.2015 i ndryshuar me VKM nr.756 datë 26.10.2016) "Për përcaktimin e kriterëve,procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje,shtesat anësore dhe/ose në lartësi,në ndërtime me leje"
2016		Vendim nr. 271, datë 06.04.2016 Për ndryshime dhe shtesa në VKM nr.408, datë 13.05.2013 "Per miratimin e rregullores se zhvillimit te territorit te ndryshuar" VKM nr. 342, datë 4.5.2016 "Për miratimin e kufijve territoriale dhe hidrografike të baseneve ujore" VKM nr. 881, datë 14.12.2016 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit" VKM nr. 348, datë 11.05.2016 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020" VKM nr.634 datë 07.09.2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.589, datë 10.09.2014 "Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktit në terren të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje,të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale"
2017	Ligj nr. 28, datë 23.3.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",të ndryshuar"	VKM nr. 231, datë 21.3.2017 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar VKM nr. 355, datë 19.4.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar

* është shfuqizuar.

Tabela 2.1.1.2: Planifikimi urban dhe territorial: Kuadri ligjor bazë.

Duke përfituar nga përvoja e akumuluar, Ligji nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, paraqiti disa përkufizime shtesë lidhur me planet territoriale, të tilla janë planet rajonale. Gjithashtu, sqaroi disa paqartësi të ligjit të mëparshëm në lidhje me kompetencat e planifikimit. Në vijim të ligjeve të mëparshme, planifikimi i territorit lidhet me hartimin e të përgjithshme për përdorimin e tokës dhe mënyrën e vendosjes së strukturave në të, duke ruajtur konceptin e vijës së verdhë.

Si një përpjekje për të kontrolluar urbanizimin e vrullshëm dhe ndërtimet pa leje dhe pa kriter, u miratua Ligji nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Ky ligj përcakton kuadrin ligjor për përfshirjen e zonave informale në planifikimin kombëtar me qëllim zhvillimin rajonal dhe zhvillimin e infrastrukturës. Gjithashtu, përcakton mënyrën për legalizimin e ndërtimeve pa leje që ishin ndërtuan deri në muajin Maj të vitit 2006. Pavarësisht ndryshimeve ligjore dhe shtimeve e mëvonëshme (Ligji nr. 9786, datë 19.7.2007, Ligji nr. 9895, datë 9.6.2008, Ligji nr. 141, datë 02.05.2013 dhe Ligji nr. 50, datë 15.05.2014), ai nuk arriti të kufizonte flukset e reja të ndërtimeve pa leje.⁸

Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit ” përkufizoi për herë të parë konceptin e planifikimit territorial, duke i dhënë përmbajtjes së tij dimension zhvillimi dhe karakter shumëdimensional. Qëllimi kryesor i ligjit ishte përcaktimi i parimeve bazë, rregullave dhe procedurave të planifikimit të territorit, për të promovuar një zhvillim të qëndrueshëm. Zbatimi i ligjit ishte i dobët, për shkak të kompleksitetit të tij, të dallimeve me kuadrin ligjor të mëparshëm dhe të vështirësisë së përshtatjes së institucioneve dhe shërbimeve me ndryshimet. Ky ligj parashikonte planifikime të përgjithshme, sektoriale dhe ndërsektoriale, në dy nivele, kombëtare dhe rajonale, si dhe në bashkëpunim midis tyre. Në mënyrë specifike parashikonte, zbatimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, në të gjithë territorin e vendit dhe planifikimeve kombëtare të llojeve të tjera në përputhje me Planin e Përgjithshëm Kombëtar. Gjithashtu, parashikonte zbatimin e planeve vendore dhe planeve ndërrajonale (në dy ose më shumë njësi vetëqeverisëse). Një risi e këtij ligji ishte ofrimi i gjashtë instrumentave të kontrollit të zhvillimit.⁹ Këto janë: pezullimi e zhvillimit, servituti publik, rezervimi i tokës publike, e drejta e transferimit, transferimi i drejtës për zhvillim, e drejta e preferencës. Një tjetër risi e tij ishte parashikimi i krijimit të regjistrit kombëtar të planifikimit të territorit. Regjistri do përmbajë në format analog dhe dixhital të dhëna për përdorimin e tokës, rregulloret, leje zhvillimore dhe aplikimet, lejet e ndërtimit etj. Në zbatim të këtij parashikimi u miratua edhe VKM nr. 460, datë 16.6.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e regjistrit të planifikimit territorial”.

Gjithashtu, në zbatim të këtij ligji u miratua VKM nr. 1190, datë 13.11.2009 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit – AKPT”. AKPT është kompetente për zhvillimin e politikave territoriale, zbatimin e legjislacionit në këtë fushë, bashkëpunimin mes institucioneve qendrore dhe lokale, etj.

Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit" ka zhvendosur parashikimet bazë të legjislacionit evropian lidhur me zhvillimin rajonal dhe kohezionin territorial në kuadër të harmonizimit me standartet evropiane. Tenton të decentralizojë procesin e vendimarrjes, pasi transferon planifikimin nga administrata qendrore tek ajo lokale. Disavantazhe të këtij ligji janë

⁸ Paul Rabe, Rudina Toto, Sibora Dhima, *Analyzing the Likely Impact of European Union Policies on Territorial Planning in Albania - Policy Brief*, Mars 2013

⁹ Lidhet me “mjettet të cilat janë miratuar dhe zbatuar nga autoritetet e planifikimit për të siguruar një interes publik” (Këshilli i Ministrave, 2009, neni 3, paragrafi 39)

detajimi i terpuar në disa fusha por edhe varësia e madhe që ka ndaj ligjeve të paplotësuara dhe rregulloreve.

Më 31 Korrik 2014 u miratua ligji nr. 115 "Për ndarjen administrativo - territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i cili hyri në fuqi më 15 Shtator 2014. Territori i Republikës së Shqipërisë u organizua në 12 Qarqe (u la në fuqi ndarja e mëparshme), dhe në 61 Bashki, të cilat u formuan nga bashkimi i 373 ish komunave dhe bashkive. Qëllimet kryesore të reformës territoriale janë:

- Forcimi i qeverisjeve vendore për të ofruar shërbime moderne dhe cilësore,
- Decentralizimi i kompetencave administrative,
- Tërheqja e më shumë fondeve evropiane dhe ndërkombëtare.

Në përfitimet afatgjata të riorganizimit të ri administrativ përfshihet edhe modernizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës publike dhe shërbimeve në nivel vendor si dhe promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm rajonal. Zbatimi i reformave administrative është akoma në proces.

Pas katër rishikimeve—ndryshimeve ligji nr. 10119 i vitit 2009 u zevëndësua më 1 Tetor 2014 nga ligji nr. 107, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit". Ligji i ri përcakton parimet, rregullat dhe procedurat e planifikimit territorial në territorin e Shqipërisë dhe parashikon:

- Një sistem planifikimi në nivel hierarkik, me instrumentet përkatëse,
- Një sistem kontrolli të ndërtimeve me leje, standartet dhe rregullat teknike.

Ligji i ri i planifikimit nr. 107, datë 31.07.2014 më konkretisht:

- Përcakton autoritetet përgjegjëse për planifikimin e territorit dhe funksionet e tyre përkatëse. Në nivel qëndror përgjegjës është Këshilli i Ministrave, Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) dhe Ministria përgjegjëse për planifikimin territorial (sot Ministria e Zhvillimit Urban). Këshilli i Qarkut dhe Këshilli Bashkiak janë përgjegjëse përkatësisht në nivel rajonal dhe vendor. Përcaktohen, gjithashtu, kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe të Ministrive të tjera.
- Ripërcakton strukturën e planifikimit territorial në dy nivele. Në nivel qëndror do ushtrohet nëpërmjet Planeve të Përgjithshme Kombëtare (PPK), Planeve Kombëtare Sektoriale (PKS) dhe Planeve të Detajuara për Zona të Rëndësisë Kombëtare (PDZRK). Në nivelin vendor të planifikimit përfshihen Planet Sektoriale në Nivel Qarku (PSNQ), Planet e Përgjithshme Vendore (PPV) dhe Planet e Detajuara Vendore (PDV). Koordinimi i këtyre planeve synon krijimin e një sistemi të plotë të planifikimit të territorit në Shqipëri.
- Përcakton qëllimet e planeve territoriale të cituara më lartë.
- Përcakton kuadrin për procedurat e koordinimit, konsultimit publik dhe inspektimit/ mbikëqyrjen e planeve territoriale.
- Krijon një seri instrumentesh për drejtimin e zhvillimit, të tilla si servituti publik, transferimin e të drejtës për zhvillim (TDZH), zhvillimin e detyrueshëm të tokës, të drejtën e preferimit, të drejtën e transferimit, intensiteti i ndërtimit me kushte, pezullimin e zhvillimit.
- Evidenton mjetet e kontrollit të zhvillimit, lejen e zhvillimit, lejen e ndërtimit, deklarin paraprak për kryerjen e punimeve, çertifikata e përdorimit si dhe procedurat përkatëse për kontrollin e zhvillimit (aplikimi për leje ndërtimi, shqyrtimi i kësaj kërkesë, taksat në infrastrukturë, dorëzimi i lejes së ndërtimit, vëzhgimi, inspektimi, miratimi etj).

- Së fundi, përcakton funksionin e Regjistrit të Integruar të Territorit (RIT) si dhe një sërë dispozitash të përgjithshme dhe kalimtare.

Më 9.7.2015 u miratua ligji nr. 73, i cili parashikonte disa ndryshime në ligjin 107 të vitit 2014. Më 29.7.2015 u miratua Rregullorja e Planifikimit të Territorit (VKM nr. 671, datë 29.7.2015 “Për miratim e rregullores së planifikimit dhe territorit”), me qëllim institucionalizimin dhe zbatimin e rregullave të njëjta në përmbajtje si dhe me procedurat e planifikimit, implementimit dhe monitorimit të planeve territoriale që parashikohen në ligjin nr. 107, datë 31.07.2014. Sot, edhe pas përfundimit dhe miratimit të PPK-së, PINS Tiranë-Durrës, PINS Bregdetit si edhe një sërë Planeve të Përgjithshme Vendore, VKM nr. 671, datë 29.7.2015 “Për miratim e rregullores së planifikimit dhe territorit” është përsëri në proces rishikimi.

2.1.2. Strategji dhe direktiva të planifikimit sektorial

Kuadri ligjor, i cili ndikon indirekt në planifikimin territorial kombëtar është:

- Strategjia për zhvillimin dhe integrimin.
- Strategjia i bujqësisë dhe zhvillimit rural.
- Strategjia për turizmin.
- Strategjia për mbrojtjen e mjedisit, biodiversitetit dhe zhvillimit të zonave të mbrojtura.
- Strategjia për trashëgiminë kulturore.
- Strategjia për energjinë.
- Strategjia për transportin.
- Strategjia për furnizimin me ujë, kanalizime dhe menaxhimit të mbetjeve.

Strategjia e dytë Kombëtare për Zhvillimin¹⁰ (Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin 2014-2020) paraqet vizionin kombëtar për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit për periudhën 2014-2020 dhe përbën një nga komponentët kyç të Sistemit të Integruar të Planifikimit në Shqipëri (SIP)¹¹. Bazuar në vizionin e përmirësimit të nivelit të jetesës në një shoqëri ligjore dhe kohezioni, dhe në integrimin në Bashkimin Evropian, përcaktohen synimet për secilën fushë politike. Programet sektoriale paraqiten në mënyrë të detajuar për arritjen e objektivave. Në përputhje me vizionin evropian përcaktohen përparësitë kryesore kombëtare në fushën e energjisë, të infrastrukturës së transportit, infrastruktura të tjera teknike (ujë, kanalizime etj), të zhvillimit rajonal, të fushës së bujqësisë, të turizmit, të mjedisit dhe të planifikimit territorial.

Në nivel zhvillimi rajonal, problemet ekzistuese janë rezultat kryesisht i migrimit të brendshëm në masë. Lidhen me fenomene si mbipopullimi, përdorimi i paqëndrueshëm i burimeve dhe pabarazi rajonale (midis komunave, zonave rurale-urbane, zonave bregdetare dhe malore). Me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe të ballancuar dallohen:

- Forcimi i aftësive konkurruese të rajoneve,
- Forcimi i kohezionit rajonal (reduktimi i pabarazive),
- Menaxhimi efikas dhe real i zhvillimit rajonal.

¹⁰ Strategjia e parë Kombëtare mbulonte periudhën 2007- 2013

¹¹ Me miratimin e VKM-së nr. 692, datë 11.10.2011 u krijua Sistemi i integruar i Planifikimit Shqiptar, një sistem kombëtar vendimmarrës për përcaktimin e orientimeve strategjike të zhvillimit dhe zhvendosjen e burimeve.

Në kuadër të adoptimit të standarteve evropiane, territori i vendit u nda në tre rajone statistikore bazuar në klasifikimin evropian NUTS II: (a) në rajonin e Durrësit dhe zonat veriore, (b) Tiranë dhe Elbasan dhe (c) zonat jugore.

Prioritetet strategjike në fushën e zhvillimit rural dhe prodhimit bujqësor lidhen me modernizimin e sektorit agro-ushqimor dhe me zbatimin e metodave ekologjike, miqësore në prodhim. Gjithashtu, lidhen më menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve dhe me zhvillimin e balancuar territorial të zonave rurale. Objektivat specifikohen dhe politikat përkatëse propozohen në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020.

Sektori i turizmit, vitet e fundit ka rritur kontributin e tij në ekonominë e vendit, kjo është rezultat i përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve. Objektivat strategjike, lidhen me reklamimin e vendit në nivel ndërkombëtar, si një destinacion turistik dhe në shumëllojshmërinë e produktit turistik. Gjithashtu, lidhen me zgjatjen e sezonit turistik, shfrytëzimin turistik të pasurive natyrore dhe kulturore në zonat rurale dhe në gjithë territorin e vendit, si dhe në përmirësimin e shërbimeve turistike.

Mbrojtja e mjedisit shtrihet në disa fusha, të tilla si, cilësia e ajrit, ndryshimet klimatike, ndotja industriale, menaxhimi i burimeve ujore, regjistrimi i zonave të mbrojtura etj. Objektiva strategjike kombëtare janë zhbllokimi i zonave urbane nga ndotja atmosferike dhe akustike, reduktimi i gazrave dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike. Gjithashtu, objektiva të tjera janë rritja e numrit të zonave të mbrojtura dhe menaxhimi i qëndrueshëm dhe i integruar i pyjeve, kullotave, burimeve ujore dhe ujrave ndërkombëtare.

Në vazhdim të orientimeve sektoriale, u hartuan strategji të ndryshme të cilat specifikojnë objektivat e tyre, parashikojnë një sërë masash dhe politikash dhe krijojnë bazën për pajtueshmërinë e kuadrit ligjor kombëtar me legjislacionin evropian.

Nevoja për një politikë të integruar, koherente rajonale bazuar në shqetësimin në rritje për boshllëqet që po thellohen në performancën social-ekonomike dhe pasuritë ndërmjet pjesëve të ndryshme të vendit ka sanksionuar formulimin e **Strategjisë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rajonal (SNZHR)** (VKM 773, datë 14.11.2007). SNZHR është një element kyç i Strategjisë së re Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin (SKZHI). Një rritje e qëndrueshme dhe e ekuilibruar social-ekonomike ndërmjet rajoneve të Shqipërisë, në përgjithësi, dhe zonave malore dhe periferike, në veçanti, me qëllim që të mbështetet një zhvillim i shpejtë i të gjithë vendit dhe të përshpejtohen proceset e integrimit në BE dhe NATO". Ky vizion do të arrihet nëpërmjet dy objektivave strategjike:

- Të gjitha qarqet të jenë në gjendje të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe konkurrencën – dhe në këtë mënyrë të reduktojnë pabarazitë sociale dhe ekonomike në të gjithë vendin, kjo do të arrihet nëpërmjet realizimit të Programit Kombëtar për Zhvillimin e Qarqeve dhe Programit të Zhvillimit të Zonave të Pa Favorizuara
- Krijimin e një kuadri efikas menaxhimi për zhvillimin rajonal nëpërmjet nxjerrjes së Ligjit për Zhvillimin Rajonal, akteve nënligjore përkatëse dhe nëpërmjet zhvillimit të strukturave të nevojshme institucionale për të menaxhuar politikat rajonale.

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014 - 2020, është vazhdimi i strategjisë paraardhëse (Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural, 2007- 2013), miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 709, datë 29.10.2014. Përbën kuadrin strategjik kombëtar për zhvillimin rural, në përputhje me udhëzimet evropiane.

Kjo strategji përcakton politikat, me qëllim që të bëjë sa më konkurrues sektorin agro-ushqimor përballë sfidave të tregut evropian. Ndërhyt në tre fusha: në politikat e zhvillimit bujqësor, skemat mbështetëse për mbështetjen e fermerëve dhe infrastrukturës dhe në zbatimin e normave evropiane.

Prioritetet kryesore të politikave të ndërmara për zhvillimin rural për periudhën 2014- 2020 janë:

- Përmirësimi i prodhimeve bujqësore, me qëllim përshtatjen me standartet evropiane duke ju përgjigjur kërkesave të tregut ndërkombëtar.
- Adoptimin e një modeli për prodhimet bujqësore i cili do të sigurojë mbrojtjen dhe menaxhimin racional të burimeve natyrore.
- Zhvillim territorial dhe ekonomik i balancuar i zonave rurale, duke synuar kryesisht diversifikimin e aktivitetit ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e nivelit të jetesës.
- Ndarja e njohurive, informacionit dhe inovacionit në fushën e bujqësisë dhe pyjore midis zonave rurale.
- Strategjia kombëtare është baza për harmonizimin e kuadrit ligjor kombëtar në sektorin bujqësor me ata legjislacionin evropian.

Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural” përcakton objektivat e politikave kombëtare bujqësore dhe përcakton kuadrin ligjor, institucionet publike përgjegjëse dhe format e organizimit të aktiviteteve bujqësore dhe blegtorale.

Në kuadër të programit të asistencës së para-anëtarësimit (IPA II)¹², u hartua Programi për Zhvillimin Rural bazuar në instrumentat e asistencës së para-anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë 2014- 2020. Ky program promovon investimit në sektorin argo-ushqimor dhe në shërbimet/strukturat mbështetëse për të forcuar konkurrencën. Objektivat e programit, nga njëra anë janë në përputhje me drejtimit përkatës të Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014 - 2020, nga ana tjetër përputhen me objektivin kryesor të përcaktuar në Dokumentin Strategjik për Shqipërinë 2014- 2020¹³ për zhvillimin rural. Synimi është zhvillimi i qëndrueshëm, inovativ dhe konkurrues i sektorit argo-ushqimor. Ky program ndihmon në përmbushjen e objektivave nëpërmjet:

- Nxitjen e investimeve në sektorin agro-ushqimor me synim përmirësimin e aftësive konkurruese dhe mbrojtjen e mjedisit,
- Mbështetjen e investimeve në zonat rurale me synim shumëllojshmërinë e ekonomisë bujqësore, përmirësimin e mundësive për punësim dhe kohezionin social.

Me identifikimin e rëndësisë së sektorit të turizmit në ekonomi dhe punësim, **Strategjia Kombëtare për Turizmin 2014-2020**, përcakton udhëzimet, politikat dhe mjetet për një zhvillim

¹² U krijua me Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe Këshillit nr. 231/2014.

¹³ Dokumenti Strategjik për Shqipërinë 2014- 2020 (Indicative Strategy Paper for Albania) përcakton prioritetet e mbështetjes financiare të vendit nga BE, për periudhën 2014- 2020 në rrugën drejt anëtarësimit. U përgatit në kuadër të Programit IPA II, i cili është mjeti i përkrahjes financiare dhe teknike për reformat në vendet aspiruese.

turistik të qëndrueshëm dhe konkurrues. Bazuar në vlerësimin e thellë të situatës aktuale (produktet dhe shërbimet e turizmit, kuadrin ligjor etj), por edhe në strategjitë e mëparshme¹⁴, u përcaktuan objektivat kryesore dhe parimet, objektivat financiare dhe strukturore (tregje, produkte, destinacione industriale). Për realizimin e objektivave është propozuar një platformë me 14 drejtime strategjike, të grupuara në pesë sektorë, dhe në më shumë se 100 masa. Në kuadër të masave zbatuese, janë përcaktuar treguesit si kriter minimal që duhet të realizohet brenda 2020, ndërsa përcaktohet dhe sistemi i monitorimit/menaxhimit. Të gjitha propozimet janë hartuar me bazë vizionin e vitit 2020, i cili është për ta bërë vendin destinacion terheqës, konkurrues në nivel evropian dhe destinacion lehtësisht të aksesueshëm. Shtyllat kryesore janë:

- Rritja e kontributit të turizmit në të ardhurat kombëtare (krijimi i vendeve të punës, rritja e të ardhurave, forcimin e sipërmarrjes), me një shpërndarje të balancuar të dobive ekonomike në të gjith vendin,
- Qëndrueshmëria e zhvillimit të turizmit, me mbrojtjen dhe menaxhimin racional të burimeve dhe respekti ndaj mjedisit dhe komuniteteve vendase.

Ligji nr. 9734, datë 14.05.2007 “Për Turizmin” (i ndryshuar me ligjin nr. 9930 të vitit 2008 dhe ligjin nr. 73 të vitit 2013) rregullon marrëdhëniet, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve publike dhe private, personave fizik apo juridik që përfshihen në aktivitete turistike. Përcakton parimet, standartet dhe rregullat që mbulojnë të gjithë spektrin e turizmit.

Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore janë ndër prioritetet kyç të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin 2014 – 2020, në kuadër të harmonizimit me objektivat evropiane. Në politikën kombëtare mjedisore është përfshirë edhe legjislacioni përkatës.

Pas nënshkrimit të Konventës për Diversitetin Biologjik, në Janar të vitit 1994 dhe në përmbushje të detyrimeve përkatëse, u hartua në vitin 1999 Strategjia e parë e Biodiversitetit dhe Plani i saj i Veprimit.¹⁵ Që atëherë, vendi ka shënuar progres të madh në zhvillimin e kuadrit institucional dhe ligjor për mbrojtjen e biodiversitetit. Në vitin 2007 u miratua **Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2007-2013**, e cila ishte pjesë e pandashme e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimi dhe Integrim.

Në Janar të vitit 2016 u miratua **Strategjia Kombëtare e Biodiversitetit** dhe Plani i saj i Veprimit, e cila përbën mekanizmin kryesor të zbatimit të Konventës së Diversitetit Biologjik (CBD). Përcakton hapat dhe veprimet që duhet të ndërmerret vendi për të realizuar objektivat e KDB për mbajtur dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshme biodiversitetin. Në kuadër të kësaj Strategjië, përcaktohen objektiva/prioritete të përgjithshme dhe qëllimet përkatëse:

- Futja e konceptit dhe e nevojës për mbrojtje të biodiversitetit në politikat sektoriale përkatëse.
- Reduktimin/ ujlën e faktorëve që çënojnë biodiversitetin.
- Monitorimin e veprimeve që degradojnë biodiversitetin dhe ndikimet përkatëse.
- Promovimin e ruajtjes së biodiversitetit dhe përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve.
- Sensibilizimin e opinionit publik, arsimim dhe informim.

¹⁴ Strategjia Sektoriale e Turizmit 2007- 2013, u miratua me VKM nr. 884, datë 11.6.2008 “ Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Turizmit”

¹⁵ U bazua në programet ekzistuese, të tilla si Plani i Veprimit Kombëtar për Mjedisin (Komisioni për Mbrojtjen e Mjedisit, 1993) apo Strategjia Mjedisore e Shqipërisë (Banka Botërore, 1993) etj.

- Sigurimi i një qasje për ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që vijnë nga përdorimi i burimeve gjeneruese.
- Rritje dhe përhapje e njohurive shkencore lidhur me biodiversitetin.

Për arritjen e objektivave, propozohen masa/veprime konkrete për një periudhe pesë vjeçare si dhe përcaktohen burimet e financimit. Së fundi, parashikohet një plan veprimi për zbatimin e kësaj strategjie, në formë tabele, që përmban objektivat, masat, kohën dhe koston e realizimit.

Kuadri ligjor kombëtar i cili rregullon mbrojtjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore përmban një numër të madh ligjesh dhe vendimesh, të cilat u hartuan dhe u miratuan kryesisht pas vitit 2001. Pas miratimit të ligjit nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për Mbrojtjen e Biodiversitetit” u përcaktua kuadri bazë për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, bazuar në Konventën e Diversitetit Biologjik (CBD).¹⁶ Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” përcakton parimet, rregullat dhe procedurat për të siguruar mbrojtjen e mjedisit. Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” synon parandalimin dhe trajtimin e degradimit mjedisor si dhe përcakton direktiva, organet dhe procedurat për vlerësimin e ndikimeve në mjedis. Në vitin 2013 u miratua ligji nr. 91, datë 28.2.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, e cila ka të bëjë me PPV.

Gjithashtu, është hartuar **Programi strategjik afatshkurtër dhe afatmesëm 2015-2020 nga AKZM**. Qeveria e Shqipërisë ka miratuar një sistem përfaqësues të zonave të mbrojtura (ZM). Baza e sistemit të zonave të mbrojtura konsiston kryesisht në 15 parqe kombëtare, disa rezervate natyrore të menaxhuara e pejzazhe të mbrojtura, në të cilat strehohen vlerat më të mëdha natyrore dhe biodiversitetit në vend. Përveç kategorive kryesore, ka filluar të jetë prezent edhe kategoria e Parqeve Natyrorë Rajonal (PNR) që lidhet me iniciativat dhe vendimet e organeve vendore.

Gjatë gjithë viteve të ekonomisë së tregut, zonat e mbrojtura nuk arritën asnjëherë të integrohen si duhet në politikat kombëtare dhe lokale, për tu bërë pjesë e zhvillimit ekonomik të rajoneve dhe të vendit.

Zonat e Mbrojtura në Shqipëri kthehen në territore për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës e biodiversitetit, duke promovuar vlerat e tyre të shumëllojshme (turistike/rekreative, kulturore, gastronomike, estetike, pejsazhistike, shëndetësore, shpirtërore, etj.), në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm me ndikim pozitiv të komuniteteve vendase dhe rritjes së mirëqënies së tyre.

Objektivat kryesorë të programit janë:

- përmirësimi i menaxhimit të zonave të mbrojtura sipas kërkesave dhe standarteve ndërkomëtare dhe eksperiencës së vendeve Europiane, duke ruajtur dhe përdoruar në mënyrë të qëndrueshme burimet natyrore në to.
- të ngrihet dhe zbatohet një sistem menaxhimi i qëndrueshëm financiar për zonat e mbrojtura, përfshirë edhe aprovimin e një fondi të veçantë për to, me kontributin e të ardhurave nga zonat, donatorët dhe buxhetit të institucionit;

¹⁶ Konveta u paraqit për nënshkrim në 5 Qershor të vitit 1992 në kuadër të Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin (Samiti për Tokën në Rio) hyri në fuqi në 29 Dhjetor 1993. Shqipëria ka ratifikuar këtë Konventë në 5 Janar 1994.

- futja e elementëve të rinj që lidhen me komunikimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin për të ndryshuar perceptimin dhe rolin e këtyre zonave për ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Në termat afatgjatë kërkohet zhvillimi i politikave dhe strategjive për ruajtjen e mbrojtjen e natyrës në përgjithësi. Fillimi i procesit për rrjetin Natura 2000 do të kërkojë një përjasje të ndryshme për ruajtjen e habitateve dhe specieve.

Në procesin e mbrojtjes së natyrës në vend, do të ishte me rëndësi të madhe, që zonat e mbrojtura që janë të njohura dhe të vlerësuara nga publiku i gjërë dhe nga grupet e interesuara në promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimin për Sistemin e Zonave të Mbrojtura në Shqipëri, duke e bërë më të qartë dhe prezent konceptin e zonës së mbrojtur dhe çfarë ato përfaqësojnë.

Do të shfrytëzohen festivalet, organizimet e ndryshme dhe mundësitë e vendit për të promovuar vlerat e zonës dhe pjesmarrjen e publikut, por edhe bashkëpunimin me sistemin e shkollave nëpër rrethe, problemet madhore që lidhen me mirëfunksionimin e çdo zone dhe raportet me aktoret e tjerë në zonë (peshkatarë, restorante, shërbime, organe vendore, etj.)

Ligji nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për **Trashëgiminë kulturore**” i ndryshuar me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006, ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008, ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009 dhe ligjin nr. 77, datë 14.2.2013 përbën kuadrin ligjor bazë që rregullon menaxhimin e trashëgimisë kulturore kombëtare. Identifikon elementët mbrojtës të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale, të luajtshme dhe të paluajtshme. Gjithashtu, përcakton detyrat e institucioneve përgjegjëse dhe organeve qëverisëse, si dhe ndëshkimet në rast të shkatërrimit të pasurisë kulturore.

Strategjia kombëtare sektoriale e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe Kanalizimeve 2011—2017 është përgatitur me qëllim prezantimin e Vizionit, Objektivave të Misionit dhe Planeve të Veprimit të Shqipërisë në mënyrë të qartë, specifike, sasiore dhe kohore së bashku me përgjegjësitë që i takojnë çdo institucioni për ta bërë “Aksesin në Ujë të Pijshëm të Sigurt dhe Kanalizime të drejta të njeriut” pasi Shqipëria, është bashkësponsorizuese e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara. Hartimi i politikave të përshtatshme dhe angazhimi i fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar dhënien e shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimeve, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit Evropian dhe me Objektivin e Zhvillimit të Mijëvjeçarit për qëndrueshmërinë e mjedisit

Strategjia konsideron popullsinë e përgjithshme për të hartuar Strategjinë e Sektorit. Qeveria ka marrë parasysh çështjet e mëposhtme që kanë lidhje me popullsinë, migrimin dhe varfërinë, të cilat duhet të adresohen në periudhën e planifikimit:

- Vendosjen e gjithë kërkesës për ujë dhe nevojave të mbulimit me shërbim me një rritje vjetore prej 0.4%.
- Migrimi i brendshëm që do të vazhdojë gjatë periudhës së planifikimit dhe popullsia migratore do të vendoset kryesisht në zonat rurale përreth zonave aktuale urbane. Për momentin, këto zona rurale në përgjithësi nuk kanë shërbim publik me ujë të pijshëm dhe kanalizime. Do të duhen investime të konsiderueshme për ofrimin e këtyre shërbimeve bazë.

- Nevojitet një program me synime të qarta për t'iu ofruar subvencione sociale individëve dhe familjeve që jetojnë nën kufirin e varfërisë, të përcaktuar skemen e subvencioneve të shumta në favor të kategorive të ndryshme për të hartuar Strategjinë e Sektorit,

Ligji Nr. 8093, datë 21.03.2006 “Për rezervat ujore” është ligji bazë që rregullon çështjet e menaxhimit të burimeve ujore në Shqipëri. Autoritetet kryesore të krijuara në bazë të këtij ligj janë Këshilli Kombëtar i Ujërave (KKU), Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujërave (STKKU) dhe Këshillat e Baseneve të Lumenjve. Në bazë të ligjit "Për rezervat ujore" dhe me qëllim për të përafuar Direktivën Evropiane të Ujit, në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave është ngritur Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Ujërave që është organi kryesor për menaxhimin e burimeve ujore.

Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujërave është struktura qendrore përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave kombëtare për menaxhimin e ujit dhe bashkërendimin sektorial, kombëtar dhe ndërkufitar.

Monitorimi i cilësisë së ujit në burimet sipërfaqësore është përgjegjësi e Institutit të Ujit, Energjisë dhe Mjedisit, ndërkohë që për ujërat nëntokësore përgjegjësinë e ka Shërbimi Gjeologjik Kombëtar.

Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve monitoron ndikimin e shkarkimeve të ujërave të zeza në ujërat sipërfaqësore (lumenjtë dhe zonat bregdetare), ndërkohë që Instituti i Shëndetit Publik nëpërmjet strukturave të veta rajonale monitoron higjienën dhe kushtet e tjera që lidhen me cilësinë e ujit.

Sipas kësaj strategjie çështjet Prioritare që duhen Adresuar në Periudhën e Planifikimit janë:

- Hartimi dhe miratimi i një ligj të ri për rezervat ujore që të zëvendësojë Ligjin Nr.8093, datë 21.03.2006 “Për rezervat ujore”, dhe përafrimin me Direktivat e BE-së për Ujërat për sa i përket planifikimit dhe menaxhimit të baseneve të lumenjve.
- Përgatitja e Planeve të Menaxhimit të Baseneve të Lumenjve për të gjashtë basenet e lumenjve në përputhje me Direktivat e BE-së.
- Zbatimi i udhëzimit të Këshillit të Ministrave lidhur me zonat e mbrojtjes sanitare rreth grykave të puseve në fushat e puseve të nxjerrjes së ujit nëntokësor.

Në bazë të Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9352, datë 3.03.2005 dhe Ligjin Nr. 9915, datë 12.05.2008, Enti Rregullator i Ujit (ERrU) është organ i pavarur që ka të drejta ekzekutive për të vendosur tarifa dhe për të licencuar operatorë në sektorin e ujësjellësit.

Ligji Nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” përcakton se NjQV-të janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve në zonat e tyre përkatëse të shërbimit.

Aksionet dhe asetet e ndërmarrjeve të ujësjellësit iu transferuan NjQV-ve. Pronësia e aseteve të ndërmarrjeve të ujësjellësit duhet regjistruar kundrejt aksioneve të shoqërisë, të cila zotërohen nga NjQV-të.

Enti Rregullator i Ujit i raporton Parlamentit dhe ka si funksione të pavarura përcaktimin e metodologjive tarifore për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve, lëshimin e licencave, politikat e subvencionimit dhe standardet e shërbimit konform burimeve financiare dhe kostos së shërbimit, cilësisë së ujit dhe ndikimit në mjedis të shërbimeve.

Enti Rregullator i Ujit (ERrU), nën vartësinë e Komisionit Kombëtar të Rregullimit, funksionon brenda kuadrit ligjor dhe në përputhje me Ligjin Nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9352, datë 3.03.2005 dhe Ligjin Nr. 9915, datë 12.05.2008. Enti Rregullator i Ujit (ERrU) është i vetmi autoritet në Republikën e Shqipërisë që lëshon liçenca për çdo person fizik dhe juridik që operon brenda sektorit të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, edhe pse është e detyrueshme me ligj, jo të gjitha ndërmarrjet e ujësjellësit janë të licencuara, ndërkohë që nuk është licencuar asnjë sistem ujësjellësi i komunave.

Strategjia Kombëtare e Energjisë shpreh në thelb përcaktimin e drejtimeve kryesore të zhvillimit të sektorit energjetik, si një sektor mbështetës për zhvillimin ekonomik të vendit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë, duke garantuar sigurinë, mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e mirëqenies me një kosto minimale sociale. Shqipëria ka potenciale të konsiderueshme të burime të rinovueshme:

- Energjia nga burimet hidrike
- Energjia Diellore
- Energjia e Erës
- Energjia e biomasës
- Energjia gjeotermale.

Përmirësimi i performancës së sektorit energjetik është thelbësor, për të mbështetur zhvillimin ekonomik të vendit tonë, por ajo duhet parë dhe në kontekst të situatës energjetike në vendet e Europës Juglindore.

Traktati i Komunitetit të Energjisë, i cili ka hyrë në fuqi në Korrik 2006, në të cilin vendi ynë është palë (ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9501, datë 03.04.2006), inkurajon krijimin dhe integrimin e tregjeve të energjisë elektrike dhe të gazit në rajon, në kuadër të Tregut të Brëndshëm Energjetik të Komunitetit Europian. Për realizimin e objektivave të strategjisë janë përcaktuar këto prioritete:

- Përfundimi i ristrukturimit të sektorit energjetik shqiptar;
- Përsosja e mëtejshme e kuadri efektiv institucional e ligjor;
- Rritja sigurisë së furnizimit me energji të vendit,
- Rritja e kontributit të sektorit energjetik në zhvillimin ekonomik të vendit, në Buxhetin e Shtetit dhe bilancin financiar të vendit,
- Rritja e kapaciteteve gjeneruese dhe diversifikimi i tyre,
- Intensifikimi i operacioneve të kërkim-prodhimit të hidrokarbureve dhe tërheqja e investitorëve strategjikë në këtë sektor, si dhe në zhvillimin e vendburimeve ekzistuese, për të mundësuar shfrytëzimin me efektivitet dhe efikasitet të naftës bruto.
- Ndërtimi i linjave të reja të interkonjeksionit në sektorin elektroenergjetik,
- Angazhimi në realizimin e projekteve rajonale të interkoneksionit me linjat e gazit dhe diversifikimi i burimeve të furnizimit,
- Optimizimi i sistemit të furnizimit me burime energjetike, me konceptin e planifikimit me kosto më të ulët dhe ndikim minimal në mjedis,

- Nxitja e përdorimit eficient dhe ekonomik të burimeve të energjisë, si dhe nxitja e aplikimit të mënyrave të ndryshme të menaxhimit të energjisë, në sektorët e ndryshëm të ekonomisë,
- Nxitja e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë,
- Krijimi i tregut të brendshëm dhe integrimi i tij në tregun rajonal,
- Përmirësimi i kapaciteteve menaxheriale në sektorin energjetik,
- Përmirësimi i organizimit institucional i sektorit energjetik dhe nënsektorëve të tij (elektroenergjetik, hidrokarbur, energjive të rinovueshme dhe efijencës).

Për realizimin e qëllimi strategjik në përafrimin me Direktivat e Bashkimit Europian duhet të realizohen:

- Përfundimi i plotësimit dhe përafrimit të kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator të sektorit energjetik, në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian;
- Përfundimi i strukturimit të shoqërive tregtare, që operojnë në sektorin energjetik;
- Do të përfundojë privatizimi i shoqërive të prodhimit të energjisë elektrike, pronë publike, me përjashtim të hidrocentraleve Vau i Dejes, Koman dhe Fierzë mbi lumin Drin.

Shqipëria si një prej Palëve Kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë është e detyruar të transpozojë dhe të jetë në përputhje me direktivën e BE-së 2009/28/EC, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”. Një nga kërkesat e ligjit 138/2013 “Për burimet e rinovueshme të energjisë” është përgatitja dhe miratimi i **Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Energjitë e Rinovueshme 2015-2020 (PKVER)**, i cili vendos objektiva kombëtare të energjive të rinovueshme në konsumin final total të energjisë të vendit, si dhe masat mbështetëse për t’i arritur ato.

Sipas vendim nr. 27, datë 20.1.2016 është miratuar Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme për vitet 2015–2020.

Është kërkesë e ligjit nr. 138/2013, “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të amendojë, e më pas të shfuqizojë direktivat 2001/77/EC dhe 2003/30/EC”. Një nga kërkesat e ligjit dhe e kësaj Direktive është përgatitja dhe miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Energjitë e Rinovueshme (PKVER), i cili përcakton objektivat kombëtarë të energjive të rinovueshme në konsumin final total të energjisë të vendit.

Me vendimin e Këshillit të Ministrave 2012/04/MC-EnC direktiva e BRE-së u miratua për Komunitetin e Energjisë për adoptimin e objektivit 38% nga këto BRE (burime të rinovueshme energjie).

Furnizimi me energji primare në Shqipëri është i dominuar nga nafta, hidrocentralet dhe biomasa. Sektori i energjisë në vend mbështetet kryesisht nga importet e energjisë, veçanërisht nga nënproduktet e naftës dhe importet e energjisë elektrike. Historikisht, nevojat e energjisë elektrike janë plotësuar pothuajse ekskluzivisht nga hidrocentralet. Kapaciteti total i instaluar i energjisë në Shqipërisë është i dominuar nga hidrocentralet. Burimet ujore janë burimet më të rëndësishme natyrore të Shqipërisë.

Edhe pse në fakt Shqipëria siguron mbi 95% të energjisë elektrike nga hidrocentralet, një pjesë të konsiderueshme të energjisë e importon, pjesë e cila varion – në varësi të kushteve vjetore – midis 30% dhe 60% të totalit të furnizimit me energji primare. Energjitë e Rinovueshme mund të jenë një

zgjidhje për reduktimin e kësaj varësie nga importet dhe për të përmirësuar jo vetëm sigurinë e furnizimit me energji, por edhe sigurinë makroekonomike dhe politike të vendit duke zvogëluar deficitin e buxhetit të vendit.

Vitet e fundit, Qeveria Shqiptare është përpjekur të përmirësojë kuadrin ligjor dhe rregullator për energjinë. Në këtë drejtim, ajo ka bërë përpjekje të shumta për të ndryshuar ligjet ekzistuese dhe për të nxitur një klimë më konkurruese për produktet e energjisë në përgjithësi dhe BRE-të në veçanti. Së bashku me një sërë përmirësimesh ligjore, janë miratuar katër ligje kyç: ligji për koncesionet, për sektorin e energjisë (miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në Maj 2015), për energjitë e rinovueshme, për eficiencën e energjisë në ndërtesa, projekt ligji u miratua dhe është përgatitur në një linjë me direktivën e BE-së.

Gjithashtu, është miratuar **Strategjia Kombëtare e menaxhimit të mbetjeve** me VKM 175, datë 19.01.2011. Administrimi i mbetjeve në Shqipëri është në një nivel shumë të ulët. Me sisteme për grumbullimin e mbetjeve të ngurta janë pajisur vetëm qytetet, por jo zonat rurale. Praktikohet shumë pak riciklim. Kryesisht mbetjet asgjësohen në vendgrumbullimet e mbetjeve. Nuk ka një sistem të sigurt për administrimin e mbetjeve të rrezikshme. Sipas kësaj strategjie raportohen disa problem mjedisore të cilat lidhen me këto çështje si:

- Sistemet për grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve janë të pamjaftueshme dhe joefektive;
- Vendimet për mbledhjen dhe heqjen e tyre nuk mund të bëhen në mungesë të një informacioni të besueshëm;
- Nuk ka një traditë të mirëfilltë për trajtimin dhe heqjen e mbetjeve;
- Burimet financiare dhe teknike janë të pamjaftueshme;
- Publiku ka mungesë informacioni për sa i përket rrezikut që shkaktohet nga administrimi i dobët i mbetjeve.

Strategjia mbulon periudhën 2010-2025, e cila është periudhë e rëndësishme para dhe menjëherë pas aderimit në BE, kohë gjatë së cilës administrimi i mbetjeve konsiderohet një çështje prioritare, ka përpjekje të rëndësishme dhe duhet të bëhen përmirësime radikale të situatën aktuale. Strategjia bazohet në katër shtyllat themelore të politikës kombëtare mbi mbetjet, si:

- planifikimi,
- edukimi,
- burimet dhe
- legjislacioni.

Strategjia kombëtare e mbetjeve e pranon nevojën për të marrë plotësisht në konsideratë nevojat dhe rrethanat lokale, në mënyrë që të identifikojë zgjedhjet praktikisht më të mira për menaxhimin e mbetjeve në të gjithë vendin.

Për këtë arsye, strategjia e ndan vendin në 12 zona mbetjesh bazuar në kufijtë gjeografikë të qarqeve ekzistuese, ku secili nga planet do të zhvillohet në bashkëpunim me aktorët lokalë.

Strategjia, gjithashtu, njeh nevojën për të identifikuar burimet parësore të mbetjeve, në mënyrë që ata të mund të jenë subjekt i veçantë në konsideratë për Qeverinë dhe komunitetin ndërkombëtar të donatorëve.

Shqipërisë i mungon një sistem grumbullimi, depozitimi dhe riciklimi dhe nuk ka ende një strategji të qartë mbi depozitimin e sigurt të mbetjeve të rrezikshme. Rigjenerimi i mbetjeve dhe monitorimi i tyre mungon, ashtu siç mungon dhe një *database* moderne në nivel kombëtar dhe rajonal.

Strategjia e Sektorit të Transportit në Shqipëri, është përcaktuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (ish Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Komunikacionit). Deri në vitin 2016, korniza bazë për sektorin e transportit ishte rishikimi i Planit Kombëtar të Transportit të Shqipërisë, i vitit 2010, i cili përditësohet çdo vit që nga viti 2010, me objektivin e përgjithshëm për të siguruar një sistem transporti dhe infrastrukturë të sigurtë, të besueshme, efikase dhe plotësisht të integruar, me plotësimin e nevojave të transportit të mallrave dhe pasagjerëve, duke qenë i qëndrueshëm në aspektin mjedisor dhe ekonomik.

Në nëntor 2016 u miratua "Strategjia Sektoriale e Transportit dhe Planit të Veprimit", e cila u përpunua përmes një projekti të financuar nga BE dhe me Asistencën Teknike të IPA-s. Strategjia dhe Plani i Veprimit mbulojnë periudhën 2016-2020, duke pasur si qëllim zhvillimin e mëtejshëm të sistemit kombëtar të transportit dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë, ndërlidhshmërisë, ndërveprimit dhe integritit të tij me sistemin ndërkombëtar të transportit, në përputhje me Politikën e Transportit të BE dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 që synon përmbushjen e dispozitave të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe detyrimet që rrjellin nga statusi i saj, si vend kandidat për në BE (*përsa i përket Politikës mbi Transportet Kapitulli 14 dhe Rrjeteve Transeuropiane Kapitulli 21*) dhe pjesëmarrjen e saj në *Iniciativën e Ballkanit Perëndimor që përcaktoi zgjerimin indikativ të Rrjeteve Trans-Europiane të Transportit dhe Korridoreve Kryesore Rrjetore në rajon (shih figurat 2.1.2.1 dhe 2.1.2.2)*

Zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës së transportit në Shqipëri është një nga prioritetet kryesore, për krijimin e parakushteve për zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë, rritjen e aksesit dhe kontributit të konsiderueshëm në rritjen e përgjithshme ekonomike dhe zhvillimin e ekonomisë. Shqipëria ka investuar shumë në transport dhe, duke pasur parasysh mangësitë ose cilësinë e ulët të infrastrukturës bazë, kryesisht në rrugë (97,2% të totalit të investimeve të periudhës 2010-2014) edhe në rrjetin kombëtar, me gjithë tendencën e përgjithshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor për huadhënie, vëllime të konsiderueshme të investimeve janë disponuar përmes buxhetit të shtetit.

Nga Strategjia Kombëtare e Transportit për zhvillimin e infrastrukturës së transportit, parashikohen si më poshtë:

- Prioritet strategjik për infrastrukturën rrugore, është përfundimi dhe modernizimi i rrjetit rrugor primar dhe dytësor të vendit, duke siguruar ndërlidhjen dhe lidhjen ndërkombëtare dhe sigurinë rrugore. Me gjithë investimet e fundit në rrjetin rrugor lokal dhe rajonal, cilësia e infrastrukturës së transportit rrugor mbetet e ulët dhe ekziston një ndryshim i konsiderueshëm rajonal në drejtim të aksesit të tregjeve dhe shërbimeve bazë. Rrjeti rrugor në vend është ende i kufizuar në mbulim dhe në cilësi dhe vuan nga mungesa e mirëmbajtjes, pavarësisht nga investimet e bëra përmes Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH). Mirëmbajtja dhe performanca sipas standardeve të BE-së, si dhe dendësia e rrjetit, duhet të përmirësohet përmes një sistemi menaxhimi të aseteve rrugore dhe zgjerimit të rrjetit rrugor kombëtar me pjesët e rrjetit rural.

Në këtë drejtim, kontribuon në zbatimin e projektit të Bankës Botërore për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore (EBRD) deri në vitin 2020 si dhe zbatimin e një programi shtesë, bashkëfinancuar nga IPA për mirëmbajtjen e rrugëve kombëtare që nuk mbulohej nga projekti RRMSP, por të konsideruara si prioritet i lartë sipas Deklaratës të Samitit të Vjenës për Ballkanin Perëndimor (Iniciativa 6 - Axhenda e Lidhjes).

- Përveç kësaj, rishikimi i klasifikimit funksional të rrjetit rrugor, rritja e alokimit të buxhetit vjetor për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar rrugor, promovimi i outputeve dhe konçesioneve të bazuara në performancë (Partneritetet Publike-Private) për operatorët rrugorë dhe mirëmbajtjen, jo vetëm për rrjetin kombëtar, por edhe për rrjetin rajonal dhe lokal dhe ekzaminimi i mundësisë së përcaktimit të një përqindje të caktuar të tarifave të përdoruesit të rrugës për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor.
- Për më tepër, për të siguruar lidhjen midis Evropës Juglindore dhe BE, strategjia parashikon përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimin e lidhjeve të munguara në rrjetin gjithëpërfshirës të Evropës Juglindore, duke siguruar në të njëjtën kohë lidhjen e këtij rrjeti bazë me pjesën tjetër të rrjetit primar dhe sekondar të vendit. Rrjeti i projektit përfshin seksionin Rrëshen - Milot të korridorit SEETO 7 (siç tregohet në figurën 2.1.2.3) që lidh Nishin (Serbi) - Prishtinën (Kosovë) dhe Durrësin, Korridorin Adriatik - Jon (seksionet Thumanë - Kashar / Vorë, Fushë Krujë - Shkodër, dhe bypaset e Tiranës, Lezhës dhe Tepelenës), rikonstruksionin e rrugës së lumit të Vlorës dhe fillimin e ndërtimit të rrugës së Arbërit. Përveç këtyre projekteve që janë në fazë të avancuar zbatimi, përta i përket përgatitjes dhe financimit, ndërtimi i Korridorit VIII (Elbasan, Korçë - Kapeshticë, Elbasan - Qafë-Thanë) mbetet prioritet dhe për këtë periudhë është planifikuar përfundimi i një ure dhe një tuneli në segmentin Kukës-Morinë në rrugën 7 drejt Prishtinës.
- Lidhur me infrastrukturën hekurudhore, prioritet është futja e vendit në tregun hekurudhor evropian si një aktor në korridoret e transportit në Evropën Juglindore. Kjo kërkon përpjekje për rritjen e performancës së hekurudhave, përkatësisht për të reduktuar kohën e tranzitit dhe shpenzimet e transportit dhe logjistikës, për të lehtësuar kalimet kufitare duke krijuar kalime të përbashkëta kufitare dhe tërheqjen e investimeve të nevojshme për të harmonizuar aspektet teknike dhe rregullatore sipas standardeve të BE. Është planifikuar një korridor hekurudhor atraktiv dhe konkurrues nga porti i Durrësit në Tiranë (ndërtimi dhe modernizimi i linjës në Terminalin e Transportit Publik Tiranë dhe lidhja e munguar me aeroportin e Tiranës), së bashku me rehabilitimin e linjës nga Durrësi në Rrogozhinë - Elbasan - Pogradec dhe Lin, ndërtimi i linjës Qafë Thanë drejt kufirit me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, përgatitja e rinovimit të linjës Vore - Hani i Hotit drejt kufirit me Malin e Zi.
- Përta i përket Porteve, vazhdimi i zhvillimit dhe modernizimit të infrastrukturës dhe shërbimeve të porteve, është parashikuar deri në vitin 2020, nëpërmjet zbatimit të planeve të investimeve portuale të modernizimit dhe rehabilitimit në Portet e Vlorës, Shëngjinit dhe Sarandës, të cilat do të përpunohen deri në vitin 2018. Qëllimi i përgjithshëm është që të rrisë ndjeshëm vëllimet e ngarkesave dhe pasagjerëve.
- Së fundmi, për Aeroportet, duhet të përpunohet një Master Plan për të gjithë vendin për 20 vitet e ardhshme, me theks në zhvillimin dhe ndërtimin e një aeroporti të ri në jug të vendit (punime

që do të fillojnë në vitin 2019), në mënyrë që të shërbejë si një qendër për fluturimet ndër-evropiane e dhe mesdhetare, për zgjerimin e aeroportit të Tiranës pas vitit 2025 dhe përmirësimin e aeroportit të Kukësit në periudhën 2018-2019.

- Perspektiva e zhvillimit Intermodal dhe Transportit të Kombinuar, qëllimi është të integrojë planifikimin dhe zhvillimin e terminaleve në planifikimin më të gjerë të transportit dhe përdorimit të tokës, përmirësimin e aksesit në terminale dhe pajisjet e terminaleve me kapacitete operacionale si dhe për të drejtuar investimet në trajtimin e pengesave, në mënyrë që të sigurohet një transport efikas i integruar me zinxhirë logjistike pa ndërprerje, kosto të ulët dhe zvogëlim të trafikut të automjeteve të rënda nga portet kryesore shqiptare në vendet fqinje (duke përfshirë vendet që kanë dalje në det, Kosovë dhe FYROM) dhe më gjerë dhe duke kontribuar në këtë mënyrë në zbatimin e Flagship Axes në rajon (shih Figurën 2.1.2.4). Ekzaminimi i zhvillimit të qendrave logjistike në Milot dhe Elbasan, duke siguruar akses hekurudhor në Portin e Durrësit do të shqyrtohet në 2017-2018 dhe ndërtimi i tyre është parashikuar për vitin 2020. Investimi në qendrat logjistike biometrike të brendshme përgjatë korridoreve është gjithashtu i parashikuar, në përputhje me projektin rajonal "Durana".




Figura 2.1.2.1: Shtirja treqese e Rrjeteve Trans-Europiane të Transportit në Ballkanin Perëndimor: Hekurudhat, përfshirë Detin dhe Portet IWW (burim: Komisioni Evropian, DG Mobiliteti dhe Transporti)




Figura 2.1.2.2: Shtirirja treguese e Rrjeteve Trans-Europiane të Transportit në Ballkanin Perëndimor: Rrugët, duke përfshirë portet e Detit dhe IWW (burim: Komisioni Europian, DG Mobiliteti dhe Transporti)




Figura 2.1.2.3: Infrastruktura e transportit në Shqipëri (burim: Instituti i Transportit)



Figura 2.1.2.4: Korridoret e Evropës Juglindore, Rrugët dhe Akset Flagship (burimi: SEETO)

PLANIFIKIMI SEKTORIAL: KUADRI LIGJOR BAZË

BUJQËSIA - ZHVILLIMI RURAL - BLEGTORIA

viti	Ligji / VKM
2001	Ligji nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës "
2004	Ligji nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore" i përditësuar me Ligjin nr. 69, datë 14.02.2013
2005	Ligji nr. 9426, datë 6.10.2005 "Për mbarështimin e blegtorisë"
2007	Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 "Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural"
2010	Ligji nr. 10257, datë 25.3.2010 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8752 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës"
2012	VKM nr. 410, datë 27.6.2012 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës"
2013	Ligji nr. 69, datë 14.2.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9244 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore"
2014	Ligji nr. 130, datë 2.10.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8752/2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës "

	Ligji nr. 131, datë 2.10.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9244, datë 2004 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore"
2015	VKM nr. 282, datë 1.4.2015 “Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve në njësitë e qeverisjes qendrore”, për vitin 2015.
2016	VKM nr. 342, datë 04.05.2016 “Për miratimin e kufijve territoriale e hidrologjike të baseneve ujore në RSH dhe qendrën e përbërjen e Këshillit të secilit prej tyre”

MJEDISI NATYROR	
viti	Ligji/VKM
2002	* Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për Zonat e Mbrojtura" Ligji nr. 8897, datë 16.5.2002 "Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja", i ndryshuar me ligjin nr. 10266, datë 15.4.2010
2003	Ligji nr. 9010, datë 13.2.2003 "Për Administrimin Mjedisor të Mbetjeve të Ngurta", i ndryshuar me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009. Vendim nr.795, datë 26.11.2003 “Për ngritjen, përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të përhershëm të vlerësimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, në pronësi private, të luajtshme dhe për kriteret shkencore e procedurat e vlerësimit të këtyre objekteve”
2005	VKM nr. 676, datë 20.12.2005 "Për deklarimin e Monumenteve Kulturore Shqiptare si Zona të Mbrojtura" Ligji Nr. 9385, datë 4.5.2005 për pyjet dhe shërbimin pyjor
2006	Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit"
2007	Ligji nr. 9700, datë 26.3.2007 "Për Mbrojtjen e Mjedisit nga Ndikimi Ndërkufikar" Ligj nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”
2008	Ligji nr. 9868, datë 4.2.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8906 "Për Zonat e Mbrojtura" VKM nr.1353, datë 10.10. 2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor” Vendimi Nr.1354,datë 10.10.2008 “Per rregullat dhe procedurat që ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor”
2011	Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” Ligji nr. 10448, datë 17.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” Ligji nr. 10436, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”
2012	Ligji nr. 111, datë 31.7.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”
2013	Ligji nr. 91, datë 28.2.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”
2016	VKM 372, datë 18.05.2016 “Për miratimin e rregullave te komunikimit, konsultimit dypalesh, dhe vendimmarres per lejen e mjedisit te tipit A, për funksionimin e instalimit të vendosur në territorin e RSH”
2017	Ligj nr. 81, datë 4.5.2017 “Për zonat e mbrojtura”

TRASHËGIMIA KULTURORE	
viti	Ligji/vkm
2003	Ligji nr. 9048, datë 7-4-2003 “Për Trashëgiminë Kulturore” i ndryshuar me Ligjin nr. 9592/2006, Ligjin nr. 9882/2008, Ligjin nr. 77/2003 VKM nr.795, datë 26.11.2003 “Për ngritjen, përbërjen dhe mënyrën e

	funksionimit të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të Objekteve të Trashëgimisë Kulturore, në pronësi private, të luajtshme dhe për kriteret shkencore e procedurat e vlerësimit të këtyre objekteve”
2015	Vendim i KKT nr. 1, datë 09.09.2015 “Për përcaktimin dhe shpalljen si zona të rëndësishme kombëtare në planifikim, të 64 zonave të mbrojtura të monumenteve të kulturës, të shpallura me urdhër të ministrit të kulturës, pas miratimit në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve për periudhën 2014-2015”

TURIZMI	
viti	Ligji/vkm
2007	Ligji nr. 9734, datë 14.5.2007 “Për Turizmin”, i ndryshuar me ligjin nr. 9930/2008, ligjin nr.76/2013
2015	Ligji nr.93, datë 27.7.2015 “Për Turizmin” VKM Nr. 961, datë 02.12.2015 “Për krijimin,organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, të Agjencive të Zhvillimit Rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal”

Ndertimi	
Viti	Ligji/vkm
1998	Ligji nr.8402, date 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimitper kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar me: Ligjin nr. 9200, datë 26.02.2004; Ligjin nr.9794, datë 23.07.2007; Ligjin nr.9826, datë 11.11.2007; Ligjin nr.10324, datë 23.09.2010; Ligjin nr.11/2012, datë 09.02.2012; Ligjin nr.20/2013, datë 14.02.2013.
2006	Li g j nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i azhurnuar me: Ligjin Nr.9786, datë 19.07.2007; Ligjin nr. 9895, datë 09.06.2008; Vendimi I Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 02.02.2009; Ligjin Nr. 10099, datë 19.03.2009, Ligjin nr. 10169, datë 22.10.2009; Ligjin nr. 10 219, datë 4.2.2010; Ligjin nr. 50/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr.9482, date 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”
2007	Ligj Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”
2015	VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016
2016	VKM 428, datë 08.06.2016 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale të venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta” VKM nr. 634, datë 07.09.2016 “Për miratimin e rregullave të komunikimit, konsultimit dypalësh dhe vendimarrës për lejet e mjedisit të tipit A,për funksionimin e instalimit të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që ka mundësi reale të krijojë efekte negative të konsiderueshme në mjedisin e një shteti tjetër ose menjëherë pasi kërkohet nga ky shtet”

Pushteti Vendor	
viti	Ligji/VKM
2015	Ligj nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” VKM nr.283, datë 01.04.2015 “Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve në njësitë e qeverisjes qendrore për vitin 2015” VKM nr. 961, datë 2.12.2015 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare për zhvillimin rajonal, të agjencive të zhvillimit rajonal dhe

	agjencisë së zhvillimit ekonomik rajonal”
--	---

Transporti	
viti	Ligji/VKM
2000	VKM nr. 153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor të Shqipërisë”
2004	Ligj Nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”
2012	Ligj nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.9808, datë 24.9.2007 dhe ligjin nr.10488, datë 5.12.2011
2016	Ligj nr. 142, datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”

Energjia	
viti	Ligji/VKM
2016	VKM Nr. 27, datë 20.1.2016 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme, 2015–2020”

* është shfuqizuar.

Tabela 2.1.2.1: Planifikimi Sektorial: Kuadri Ligjor Bazë.

2.1.3. Kuadri European për planifikimin territorial

Shqipëria është pjesë e procesit të Stabilizimit dhe Asociimit me Bashkimin Evropian, pasi e ka nënshkruar Marrëveshjen në vitin 2006 dhe hyri në fuqi në Prill të vitit 2009 (Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit - MSA). Në Tetor të vitit 2012 Komisioni Evropian rekomandoi dhënien e statusit të vendit kandidat, me kusht që të zbatohen plotësisht reformat e nevojshme. Vendi u thirr të transpozojë në legjislacionin e vet direktivat kryesore të Bashkimit Evropian dhe të ndërmarrë reforma të rëndësishme, një proces ky që ndikon edhe në kuadër të politikave kombëtare të planifikimit territorial.

Planifikimi territorial është përgjegjësi ekskluzive e shteteve anëtare, me Bashkimin Evropian që ka një rol ndihmës dhe indirekt. Politikat sektoriale evropiane (politika rajonale, zhvillimi bujqësor, mjedisi, transporti, kohezioni territorial etj.) dhe drejtimet për kohezionin territorial kanë ndikuar në kuadrin ligjor të planifikimit territorial në vend.

Me nënshkrimin e Traktatit të Lisbonës (2009), “kohezioni territorial” u përcaktua si objektiv kryesor i Bashkimit Evropian, së bashku me kohezionin ekonomik dhe social. Përmbajtja e saj lidhet me integrimin e dimensionit territorial në çdo faze të programit të zhvillimit, në formimin e politikave të plota territoriale dhe në bashkëpunimin midis rajoneve evropiane. Në Maj të vitit 2007 u miratua “Axe të Territoriale të B.E.-së” (2007) e cila u bazua në dokumeta politike të mëparshme të Bashkimit Evropian. Më i rëndësishmi është Plani i Zhvillimit të Territorit të Rajonit i vitit 1999 (perspektiva evropiane e zhvillimit territorial të vitit 1999).¹⁷

Perspektiva e Zhvillimit Hapësinor të Europës (ESDP, 1999), përcakton një kuadër të përbashkët të parimeve, me qëllim koordinimin sa më të mirë të politikave sektoriale evropiane që ndikojnë në

¹⁷ Paul Rabe, Rudina Toto, Sibora Dhima, *Policy Brief - Analyzing the Likely Impact of European Union Policies on Territorial Planning in Albania*, Mars 2013.

territor. Synon koordinimin horizontal ndërmjet fushave të ndryshme të politikës, në atë vertikal ndërmjet nivele të ndryshme të qeverisjes dhe në atë gjeografik ndërmjet rajoneve të ndryshme administrative. Theksoi katër çështje me rëndësi Evropiane: (a) tendencat në ndryshimin e sistemit urban, (b) ndryshimi i rolit dhe funksioneve të zonave rurale, (c) transportin dhe rrjetet, dhe (ç) trashëgimia natyrore dhe kulturore. U projektua për të nxitur vizionin evropian për konkurrencë të balancuar, për kohezion ekonomik dhe social dhe mbrojtjen e mjedisit. Me objektiv zbatimin e vizionit evropian të konkurrencës së balancuar, kohezionit ekonomik dhe social dhe mbrojtjes së mjedisit, percaktoi tre drejtime kryesore:

- Zhvillimin e rrjeti urban të ekuilibruar, policentrik dhe bashkëpunimin ndërmjet qytetit-fshatit.
- Promovimin e një rrjeti transporti dhe komunikimi të plotësuar për të mbështetur zhvillimin policentrik dhe lehtësimin e integrimin evropian.
- Mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe kulturore.

Axhenda Territoriale e B.E.-së (2007) i ka zgjeruar këto tre drejtime në gjashtë linja:

- Zhvillimin e formave të ndryshme bashkëpunimi midis zonave urbane dhe rurale.
- Krijimin e rrjeteve rajonale dhe urbane.
- Krijimin e nyjeve rajonale të konkurrencës dhe inovacionit.
- Fuqizimin e rrjeteve trans-evropiane.
- Promovimin e menaxhimit të rrezikut trans-evropian.
- Përmirësimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe kulturore, si një vlerë e shtuar për zhvillimin.

Agjenda territoriale 2020 është e lidhur me strategjinë e Evropës 2020 (rritje inteligjente, e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse). Me qëllim adresimin e sfidave që paraqesin: ndryshimet globale strukturore të krizës ekonomike, rritja e ndërvarësisë të rajoneve evropiane, ndryshimet demografike dhe sociale, efektet e ndryshimeve klimatike, çështja kritike e energjisë dhe humbja e biodiversitetit dhe ndjeshmëria e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, ka vendosur gjashtë prioritetet:

1. Promovimin e zhvillimit territorial policentrik dhe të ekuilibruar.
2. Inkurajimi i zhvillimit të integruar në qytete, zona rurale dhe zona të kategorive të veçanta.
3. Integrimi territorial në zona ndërkufitare dhe transnacionale funksionale.
4. Sigurimi i konkurrencës globale e rajoneve bazuar në ekonomitë e forta lokale.
5. Përmirësimi i ndërlidhjes hapësinore për individët, komunitetet dhe bizneset.
6. Menaxhimi dhe ndërlidhja e vlerave ekologjike dhe kulturore të zonave.

Bashkëpunimi Territorial Evropian (ETC) përbënte një nga tre shtyllat kryesore të politikave evropiane për periudhën 2007-2013 dhe për periudhën aktuale 2014-2020, me mjet kryesor Iniciativën e Komunitetit INTERREG. Iniciativa u paraqit për herë të parë në vitin 1990 dhe që atëherë përbën një mjet të rëndësishëm financiar për të mbështetur bashkëpunimin në tre nivele, ndërkufitar, ndërshtetëror dhe ndërrajonal. Në këtë mënyrë kontribuoi në zhvillimin e balancuar dhe të qëndrueshëm territorial. Programet aktuale të promovojnë bashkëpunimin territorial për që përfshijnë Shqipërinë janë: Programi i bashkëpunimit transnacional INTERREG V-B Mesdheu Ballkanik 2014-2020, Programi i bashkëpunimit transnacional MED 2014-2020 dhe “Grupi Evropian i Bashkëpunimit Territorial”.

Objektivat Europiane për kohezionin territorial dhe direktivat evropiane për planifikimin territorial ndikuan politikat përkatëse, në përgjithësi në vendet e Evropës jugore. Nxitën ndryshime dhe në disa raste justifikuan përpjekjet kombëtare për reforma. Po kështu ndihmuan transformimin e sistemit shqiptar të planifikimit territorial nga një qasje urbane në një planifikim më të gjërë, me karakter strategjik.

Legjislacioni shqiptar, si në planifikimin territorial edhe në fusha të tjera me ndikim në territor, të tilla si zhvillimi rural, mjedisi dhe transporti, përfshin rregullore që nxisin zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm territorial që janë në përputhje me prioritetet e Axsendës Territoriale 2020.

Reforma e politikave kombëtare të planifikimit nga një qasje urbane në atë rajonale/hapësinore është në përputhje më zhvillimin policentrik dhe marrëdhëniet e ngushta qytet-fshat. Legjislacioni kombëtar përshtati një model të plotë të planifikimit që mbulon zonat urbane dhe ato rurale/natyrore. Aplikohet në nivele të ndryshme (vertikal, horizontal dhe gjeografik) nga shumë organe dhe caktohet për konsultim publik. Zhvillimi policentrik zhvillohet gjithashtu, nga politikat kombëtare në bujqësi. Veçanërisht, është në përputhje me objektivat për forcimin e zonave rurale dhe reduktimin e pabarazive rajonale, të miratuara në kuadër të përshtatjes me standartet evropiane. Politika kombëtare në sektorin e transportin promovon, zhvillimin e qëndrueshëm policentrik dhe integrimin evropian, pasi ka si qëllim:

- Një rrjet rrugor kombëtar që do të ketë aksesueshmëri dhe do të anashkalojë zonat e populluara,
- Një sistem shumëdimensional të transportit që nxit integrimin rajonal.

Qëllimi i mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të kapitalit natyror dhe kulturor është promovuar përmes strategjive përkatëse kombëtare, biodiversitetit, zonave të mbrojtura, ujit dhe zhvillimit rural. Kjo përkthehet në një kuadër të gjerë ligjor, i cili ndër të tjera paraqet detyrimin (sipas nenit 108 të MSA-së) për të vlerësuar ndikimin mjedisor të projekteve dhe studimeve, që tashmë është zbatuar përmes Ligjit nr. 91, datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”.

Në përfundim, procesi i zhvendosjes legislative dhe politike me standartet evropiane shtrihet në fushën e planifikimit territorial. Sjell ndryshime të mëdha pasi planifikimi territorial në vend është në fillimet e tij dhe imponimi i autoriteteve evropiane sa vjen dhe intensifikohet dhe zgjerohet (direkt ose indirekt përmes politikave sektoriale). Transformimi i kuadrit ligjor mbi planifikimin nga një qasje urbane në një model hapësinor me shumë nivele, me qëllim përshtatjen me praktikën evropiane, u realizua me ndihmën e përvojës ndërkombëtare. Në praktikë, ka ende një rrugë e gjatë për të arritur mirëkuptimin, pranimin dhe zbatimin e legjislacionit të ri nga ana e autoriteteve lokale, por edhe për të përshtatur konceptin social të planifikimit.

2.2. Shqyrtimi i direktivave të planifikimit urban dhe sektorial, standartet dhe normat ekzistuese kombëtare

Legjislacioni kombëtar urban, konkretisht Ligji nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” parashikon materializimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar (PPK), Planeve Kombëtare Sektoriale (PKS) për të gjithë territorin kombëtar ose pjesëve të tij dhe të

Planeve të Detajuara për Zona me Rëndësi Kombëtare (PDZRK), si mjetet bazë të planifikimit hapësinor kombëtar. Në zbatim të legjislacionit, por dhe në përputhje me standardet evropiane, Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU), përgjegjëse për planifikimin territorial në Shqipëri, në bashkëpunim me AKPT, filloi në vitin 2013 procedurën e planifikimit të Planit të Përgjithshëm Kombëtar (PPK), të Planit të Integruar Ndërsektorial për Bregdetin dhe Planin e Integruar Ndër-Sektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës.




Figura 2.2.1.1: Planet ekzistuese kombëtare urbane (Burimi: Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin, DRAFT Narrativ i plotë i Planit).

Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) është i pari në hierarkinë e planit urban kombëtar, përcakton kuadrin për zhvillimin e të gjithë territorit dhe jep udhëzimet bazë për planet sektoriale dhe politikave analoge. U miratua me Vendimin Nr. 01 të KKT, datë 14.06.2016 dhe VKM Nr. 881, datë 14.12.2016. Plani i Integruar Ndër-Sektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës (PINS-DURANA) planifikon zhvillimin e rajonit Tiranë-Durrës sipas strategjive kombëtare të zhvillimit të përcaktuara nga PPK, me synim zhvillimin ekonomik, social dhe të territorit dhe përbën shembull përfaqësues për planet e ngjashme. U miratua me Vendimin të KKT Nr. 03, datë 14.06.2016. Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin (PINS Bregdeti) përcakton udhëzimet bazë për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe urbanistik të zonës bregdetare me rëndësi kombëtare. Hartimi paralel i planeve të mësipërme lehtëson koordinimin dhe zbatimin e politikave të propozuara. U miratua me Vendimin të KKT Nr. 02, datë 14.06.2016.

Gjithashtu, është miratuar Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP) me Vendimin të KKT Nr. 1, datë 04.07.2013.

Së fundi, shënohet se në vitin 2017 ka filluar hartimi i Planit Kombëtar Sektorial Turistik për Alpet dhe Plani i Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare të Valbonës.

2.2.1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar

Plani i Përgjithshëm Kombëtar (i miratuar me VKM Nr.881, datë 14.12.2016) parashikon zhvillimin për një periudhë afatgjatë, deri në vitin 2030.. PPK siguron kuadrin referues strategjik për zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të territorit kombëtar. Specifikon nevojat dhe ndërhyrjet e nevojshme në këtë fushë, duke adoptuar një qasje të integruar të kombinuar. Përbën bazën për harmonizimin dhe koordinimin e politikave sektoriale dhe ndërsektoriale kombëtare dhe mbështet organizimin e ri administrativ të territorit kombëtar (Ligji 115/2014). PPK shoqërohet me Vlerësimin Strategjik Mjedisor, i cili vlerëson ndikimin mjedisor.

Rëndësia e PPK vlerësohet si në nivel politik, ashtu edhe në atë institucional; duke parashikuar përfitime të drejtpërdrejta në ekonomi, mjedis dhe jetën shoqërore të qytetarëve. Synimet e shprehura në PPK janë:

- Promovimi i kohezionit territorial përmes zhvillimit të balancuar ekonomik dhe social të rajoneve dhe përmirësim të konkurrencës.
- Nxitje e zhvillimit të gjeneruar nga funksionet e përziera urbane dhe përmirësimi i marrëdhënieve midis zonave urbane dhe rurale
- Promovim të aksesit.
- Përmirësimi i aksesit në njohuri dhe informacion.
- Reduktimi i dëmtimit të mjedisit.
- Mbrojtja e burimeve natyrore dhe kulturore.
- Forcimi i trashëgimisë kulturore si faktor i zhvillimit.
- Zhvillimi i burimeve të energjisë duke ruajtur, paralelisht, sigurinë e energjisë.
- Promovimi i cilësisë dhe turizmit të qëndrueshëm.
- Ulja e ndikimit të fatkeqësive natyrore.

Vizioni i PPK për Shqipërinë në 2030 është **krijimi i një qendre të integruar** në sistemin evropian të ekonomisë dhe infrastrukturës, zhvillimi i **një ekonomie shumë -nivelëshe dhe konkurruese** në rajonin e Ballkanit, dhe krijimi i një shteti që ofron **qasje të barabartë në infrastrukturë, ekonomi dhe në njohuri** dhe siguron **mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore**, me synim për të krijuar një destinacion autentik.

Në mënyrë të veçantë janë vendosur gjashtë objektiva strategjike:

- Integrimi shumëdimensional në kontekstin evropian.
- Krijimi dhe forcimi i një pozite ekonomike të fortë dhe konkurruese të Shqipërisë në rajonin e Ballkanit dhe të Mesdheut.
- Sigurimi i integritetit fizik dhe territorial të peizazhit historik, kulturor, natyror dhe urban në të gjithë territorin shqiptar.
- Rritja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës për njerëzit, duke promovuar zhvillimin ekonomik, eliminuar pabarazitë hapësinore, hequr barrierat e aksesit në ekonomi, infrastrukturë dhe dije.
- Promovimi i "së drejtës për qytetin";
- Krijimi i bazave për zhvillim rajonal

PPK identifikon pesë sistemet territoriale me objektiva specifike dhe politika, të cilat janë të organizuara veçmas me ndihmën e qendrave, akseve dhe zonave. Bëhet fjalë për një sistem urban, sistemi bujqësor, sistemi natyror, sistem ujor dhe sistemi infrastrukturor.

SISTEMI URBAN

Me synim "zhvillimin e zgjuar urban", propozohet dendësimi dhe zhvillimi policentrik i sistemit urban i cili do të heqë pengesat dhe do të lehtësojë pabarazitë. Promovon rajonet e forta të cilat komunikojnë mes tyre dhe kanë marrëdhënie plotësuese.

PPK paraqet një rrjet të integruar dhe hierarkik të qendrave urbane të cilat përbëhen nga:


- Metropoli
- Qendrat primare urbane- janë konsideruar qendrat e qarqeve
- Qendrat Sekondare Urbane, të cilat shërbejnë si qendra urbane që ofrojnë funksione të specializuara dhe ofrojnë kujdes parësor me rëndësi rajonale (si vendbanime, funksione ekonomike, tregtare, kulturore, arsimore bazë, administrative, rekreative, shëndetësore, përkujdesje sociale dhe nyje transporti).
- Qendrat Terciare Urbane, të cilat janë qendra të Bashkive të reja (pas reformës administrative) dhe mbulojnë nevojat në shërbimet e arsimit dhe shëndetësisë së nivelit të tretë.
- Qendrat Lokale, të cilat janë konsideruar pole banimi të karakterit suburban dhe rural dhe janë qendra të komunave të vjetra. Shënohet se edhe pse këto përcaktohen nga plane të hierarkive më të ulëta se PPK (p.sh. Plani i Integruar Ndërsektorial), njihen disa qendra lokale, të cilat karakterizohen nga rritja ekonomike, burime natyrore, minerale, peisazhe, vlera kulturore dhe historike.
- Lokalitetet, të cilat janë qendra të banuara, me karakter rural. Përcaktohen nga nga plane të hierarkive më të ulëta se PPK (p.sh. Plani i Integruar Ndërsektorial), dhe në vija të përgjithshme janë njësia më e vogël e organizimit territorial.

Me qëllim zhvillimin hapësinor në përputhje me vizionin e PPK "Shqipëria 2030", propozohen një seri ndërhyrjesh strategjike në qendra urbane, në varësi të llojit të tyre:

- Konsolidim dhe përforcim: metropoli dhe qendrat primare urbane..
- Përforcim dhe rigjenerim: qendra terciare urbane qëndrore.
- Fuqizim dhe Rigjenerim - qytete-porta dhe qendra urbane lindore.
- Bashkëpunim - në nivel kombëtar.

Hierarkia e qendrave			Funksionet		
Metropol	Tiranë		Qytet Portë		
Qendër primare	Shkodër		Qytet Portë		
	Lezhë		Qytet Portë		
	Kukës		Qytet Portë		
	Peshkopi		-		
	Durrës		Qytet Portë		
	Elbasan		Hub Kombëtar		
	Fier		Qytet Portë		
	Berat		Hub Kombëtar		
	Korçë		Qytet Portë		
	Vlorë		Qytet Portë		
	Gjirokastrë		Qytet Portë		
Sarandë		Qytet Portë			
Qendër sekondare	Tropojë	Kavajë	Lushnje		
	Bulqizë	Librazhd	Kuçovë		
	Krujë	Pogradec	Përmet		
Qendër terciare	Tepelenë	Libohovë	Patos		
	Maliq	Kolonië	Prrenjas		
	Divjakë	Pukë	Shijak		
	Gramsh	Delvinë	Malësi e Madhe		
	Peqin	Skrapar	Vau i Dejës		
	Belsh	Has	Vorë		
	Mat	Pustec	Urë Vajgurore		
	Polliçan	Këlcyrë	Selenicë		
	Roskovec	Cërrik	Klos		
	Konispol	Kurbin	Mallakastër		
	Mirditë	Rrogozhinë	Devoll		
	Himarë	Finiq	Kamëz		
	Fushë - Arrëz	Memaliaj	Dropull		
Qendër lokale e specializuar	Xarrë	Çakran	Golem	Sukth	Velipojë
	Lukovë	Qendër	Pezë	Ishëm	Gjegjan
	Antigonë	Dermenas	Baldushk	Fushë-Kuqe	Qafë Mal
	Zagorie	Topojë	Krrabë	Laç	Katund i Ri
	Petran	Kuman	Bërzhitë	Ulëz	Bujan
	Leskovic	Kodovjat	Petrelë	Burrel	Shishtavec
	Kurvelesh	Udenisht	Dajt	Melan	Synej
	Orikum	Gjinar	Shëngjergj	Kala e Dodës	Vermosh
	Frashër	Tregan	Martanesh	Lurë	Koplik
	Sevastër	Klos	Zerqan	Rubik	Ballsh
	Selenicë	Kryevish	Kolsh	Fushë-Bulqizë	Voskopojë
	Bogovë	Gjocaj	Steblevë	Shëngjin	Fierzë
	Lokalitete	Për t'u detajuar në planet e hierarkisë më të ulët			

Tabela 2.2.1.1: Hierarkia e qendrave urbane sipas PPK-së (burimi: PPK).



Grafiku 2.2.1.2: Ndërlidhjet midis qyteteve-porta dhe hub-eve sipas PPK (burimi: PPK)

Konkretisht për rajonin që po studiohet, Bashkia Pukë konsiderohet si qendër urbane terciare, ndërsa vendbanimi Gjegjan në qendra lokale të specializuara. Në drejtimet specifike për *qendra të nivelit të tretë*, ku përfshihen Mat, Klos, Pukë, Rrëshen dhe Vau i Dejës, zgjedhje strategjike është nga njëra anë forcimi i lidhjes së tyre me portat – qendra të hyrjes së vendit, portet dhe aeroportet dhe nyjet multimodale të transportit kombëtar dhe nga ana tjetër përmirësimi i aksesit të qendrave lokale nga qendra e Bashkisë. Paralelisht, janë të nevojshme ndërhyrjet rehabilituese në qendrat e nivelit të tretë, të cilat disponojnë ndërtesa me vlerë dhe revitalizim të industrive me përdorime të reja ekonomike në fushën e industrisë jo, dëmtuese të përpunimit dhe industrisë së ushqimit (p.sh. prodhimi i produkteve standarde dhe të njohura të tilla si mjalti, vera, rakia). Gjithashtu, rivitalizimi rekomandohet në lidhje edhe me konsolidimin e elementëve historikë, arkitektonikë dhe kulturorë me qëllim për t'i shërbyer ekonomisë së turizmit. Veçanërisht e rëndësishme për këto qendra është nxitja e bashkëpunimit mes tyre si edhe bashkëpunimi me qendrat urbane të afërta të nivelit të parë (për zonën e studimit poli Shkodër-Lezhë). Gjithashtu theksohet rëndësia strategjike e integritimit të Rubikut në rrjetin primar hekurudhor dhe të lidhjes hekurudhore të tij me portin e Durrësit. Së fundi, ia vlen të përmendet afërsia e Bashkisë me dy zona ndërkufitare të bashkëpunimit, e cila promovohet më tej në kuadër të programeve IPACB: (a) Kukës-Prishtinë ku përfshihet aeroporti i Kukësit dhe (b) Shkodër-Podgoricë, ku përfshihet porti i Shengjinit.

Në lidhje me zonat rurale që ndodhen aty pranë dhe përreth poleve ekonomike të propozuara nga PPK, propozohet ruajtja e karakterit rural nëpër vendbanime, ndërsa në zonat përreth tyre u jepet prioritet aktiviteteve bujqësore dhe atyre blegtorale si edhe infrastrukturës që ka lidhje me këto aktivitete. Zhvillimi urban dhe ai turistik duhet të bazohet në rivitalizimin e qendrave rezidenciale që ruajnë karakter të vlefshëm arkitekturor, në mënyrë që të tërheqin vizitorë, investime dhe vende pune. Zhvillim i ri urban duhet të fokusohet në zonat tashmë të ndërtuara, ndërsa zgjerimet e tij duhet të jenë veçanërisht të kufizuara. Propozohet, gjithashtu, përdorimi i mjeteve të tilla si transferimi i së drejtës së zhvillimit, intensiteti me kushte etj. dhe projektet lokale, të tilla si PPV, luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin dhe në ekspertizën e tyre.

Nga ana tjetër, fshatrat në zonat e thella malore dhe ato rurale kanë potencial të madh në lidhje me diversifikimin dhe specializimin e sektorit të bujqësisë, për shkak të karakteristikave të tyre specifike dhe përdorimeve dhe aktiviteteve të ndryshme që ndeshen shpesh në zonën e tyre. Identifikimi dhe njohja e këtyre mundësive dhe rasteve, si edhe funksionimi i tyre duhet të jetë drejtimi kryesor dhe të mbështetet nga komuniteti lokal, grupet e biznesit, bordet rajonale, agjencitë e zhvillimit rajonal, bordet e ndërmarrjeve të qarkut dhe departamentet e agjencive të ndryshme lokale, por edhe nga institucionet qendrore në varësi të MBZHRAU.

Së fundi, shikohen me rëndësi të veçantë zonat e ndjeshme mjedisore (p.sh. fshatra pranë liqeneve dhe grykëderdhjet e lumenjve, brenda zonave të mbrojtura). Përveç zbatimit të rreptë të legjislacionit sektorial (p.sh. për zonat e mbrojtura, për burimet ujore), zhvillimi duhet të kufizohet brenda kufijve të zonave rurale. Për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm propozohet: diversifikimi i produktit të turizmit, duke zhvilluar forma të reja (p.sh. ekoturizmi, turizmi rural), prodhimi i produkteve autentike lokale, zhvillimi i rrugëve për çiklizëm dhe mjeteve të transportit publik, lidhja me fshatrat tradicionale rurale të rajonit, lidhja e përshtatshme rrugore me qendrat kryesore urbane.


SISTEMI BUJQËSOR

Objekti i sistemit të bujqësisë është rritja e efikasitetit dhe produktivitetit i një sektori të prodhimit bujqësor.

Politikat e PPK janë: ruajtja, konsolidimi, modernizimi. Në mënyrë të veçantë, në këtë kontekst propozohet:

- Ruajtja maksimale e mundshme dhe mbrojtja e tokës bujqësore përmes: zbatimit të politikave të dendësimit të zhvillimit urban (Ruajtje maksimale e fondit të tokës bujqësore me anë të politikave të densifikimit të zhvillimit urban) (pas miratimit të PPK nuk do të lejohet ndërtimi që nuk ka lidhje me sistemin e bujqësisë).
- Pyllëzimi i tokës së degraduar pyjore duke respektuar natyrën dhe identitetin natyror të çdo zone.
- Funksionimi i mirë i ekosistemeve natyrore përmes mbrojtjes së tyre dhe krijimit të korridoreve të gjelbra përgjatë rrugëve ujore.
- Krijimi i një zinxhiri efikas të furnizimit: Prodhim-grumbullim-përpunim-disponim (zinxhiri ekonomik bujqësor: prodhim - grumbullim - përpunim - tregtim), me synim rritjen e vlerës së shtuar të një produkti (rritjen e vlerës së zinxhirit ekonomik).
- Reduktimi i kostos së prodhimit dhe përmirësimi i cilësisë së produktit nëpërmjet modernizimit teknologjik dhe investimeve në mirëmbajtjen e rrjeteve të ujitjes dhe kullimit.

- Bashkëpunimi me sektorët e tjerë ekonomikë: (a) Turizëm (kontributi i shijes dhe cilësisë së produkteve bujqësore në njohjen e produktit turistik shqiptar), (b) energjisë (përdorim të burimeve të rinovueshme të energjisë për përpunimin e produkteve bujqësore) dhe (c) transporti (rritje e performancës së zinxhirit të furnizimit (rritjes së efikasitetit të rrjetit bujqësor në grumbullimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore).
- Krijimi i qendrave/terminaleve bujqësore bazuar në traditat bujqësore lokale (bazuar në traditën e kultivimit të kulturave vendase).
- Prodhimi i produkteve të certifikuara, të njohura «Made in Albania» dhe specializim në produktet shqiptare karakteristike (bimë mjekësore, fruta, ullinj, rrush, perime tipike lokale, produkte të standartizuara bujqësore).



Harta 2.2.1.2: Sistemi bujqësor 2030 – fokusim në rajonin që po studiohet –fragment harte (burim: PPK)


Duke u fokusuar në rajonin e studimit, konstatohet se gjendet jashtë zonave dinamike pasi hapësirat e sistemit të bujqësisë janë të kufizuara dhe të shpërndara. Megjithatë, duhet theksuar marrëdhëniet e fqinjësë me qytetin e Shkodrës, i cili është një nga gjashtë polet bujqësore të vendit.

Bazuar në hartën e sistemit bujqësor, në Bashki gjendet, kryesisht, tokë e përzier bujqësore e cila shpërndahet në të gjitha njësitë administrative jashtë Pukës. Gjithashtu në njësitë administrative Gjegjan dhe Qerret gjenden edhe pemishte. Si aktivitet kryesor prodhimi propozohet bletaria.

SISTEMI NATYROR

Duke patur si koncepte udhëzuese për sistemin natyror promovimin dhe aksesueshmërinë, PPK rekomandon:

- Zgjerimin e zonave natyrore, duke rritur rajonet me prioritet, mbrojtjen e mjedisit natyror (20% e zonës kontinentale dhe 15% e hapësirës detare për vitin 2030 dhe deri në 10% të hapësirës detare dhe zonave bregdetare për vitin 2020) dhe arritjen e lidhjes së tyre përmes korridoreve natyrore përgjatë luginave. Korridoret natyrore duhet të konsiderohen pjesë e rrjetit kombëtar të zonave të mbrojtura dhe janë zona të përshtatshme për zhvillimin e butë të infrastrukturës miqësore me mjedisin.
- Përcaktimi i tre fushave strategjike, zhvillimi i të cilave do të ketë prioritet ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit natyror dhe vlerave të tij : parkun e Alpeve, Parkun Buna dhe Parkun Vjosa.
- Krijimi i zonave rekreative dhe atraksioneve natyrore përgjatë luginave të lumenjve.
- Integrimi i zonave të rrjetit Emerald në sistemin e zonave të mbrojtura.
- Menaxhimi i qëndrueshëm i zonave të mbrojtura.
- Krijimi i një "rrjeti kombëtar të çiklizmit" i cili do të sigurojë qasje dhe lidhje në rajone të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe historike.
- Pyllëzimi dhe rigjenerimi i zonave të degraduara nga fenomene të tilla si erozioni dhe përmytjet.
- Integrimi i sistemit natyror në ekonomi (Përfshirja e sistemit natyror në zinxhirin e zhvillimit ekonomik).
- Mbështetje dhe zhvillim i rekreacionit dhe ekoturizmit përmes menaxhimit të qëndrueshëm të sistemit natyror.
- Integrimi i Shqipërisë në kuadrin ballkanik dhe evropian përmes projektit "Dinaric Arc Ecoregion (Eko-rajon i zonës Dinarike)" dhe "European Green Belt (Brezi i Gjellbërt European)".
- Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje në lidhje me menaxhimin e sistemit natyror.
- Rritja e efikasitetit të menaxhimit të natyrës, të zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit nga organet qendrore dhe ato lokale.
- Integrimi i planeve të menaxhimit në sistemin e planifikimit dhe të planeve vendore.
- Përgatitje paralele e PPV dhe planeve të menaxhimit, me synim për të arritur qëndrueshmërinë dhe rëndësinë e parashikimeve, të mjeteve dhe afateve.



Harta 2.2.1.4: Sistemi natyror 2030 – fragment Harte (burimi: PPK)

Ndërlidhja e sistemit natyror me sektorët e tjerë ekonomikë është një nga qasjet e PPK-së për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Në këtë drejtim mënyrat e përafrimit ndaj tij ndryshojnë sipas karakteristikave të qendrave urbane ku ndodhen. Konkretisht për rajonin që po studiohet propozohen si më poshtë vijon:

Në *qendrat lokale dhe lokalitetet*, ku kërkohet kooperim dhe përforsim:

- Zhvillimi urban duhet inkurajuar brenda zonave të urbanizuara që shfrytëzojnë infrastrukturën ekzistuese të ndërtuar.
- Toka me karakteristika të mira pjellore, por që nuk mund të përdoren më për bujqësi, duhet të pyllëzohen aty ku është e mundur. Kjo do të rriste mundësitë ekonomike të zonës për shfrytëzim të lëndës drusore ose për përmirësim të peizazhit natyror dhe rritjen e atraksioneve turistike.
- Në tokat me karakteristika jo të mira bujqësore inkurajohet përdorimi i tyre për parqe fotovoltaike apo eolike sidomos për zonat pranë stacioneve dhe rrjetit ekzistues elektrik.
- Në tokat me shfrytëzim intensiv të bujqësisë rekomandohet ripërdorimi i mbetjeve bujqësore për gjenerimin e energjisë elektrike. Kjo do të mundësonte zhvillimin e energjisë së rinovueshme dhe mbrojtjen e cilësisë së rrjedhave ujore nga shpërhapja e mbetjeve bujqësore.
- Promovimi i rrjedhave ujore për sportet dhe aktivitetet ujore.


Në *qendrat urbane terciare* ndërmjet të tjerave, ku kërkohet konsolidim dhe fuqizim, propozohet:

- Parandalimi i shpërhapjes urbane.
- Ndalimi ku është e mundur dhe reduktimi i humbjes së tokës bujqësore dhe tokës së lirë natyrore, për shkak të përdorimit urban.

- Mbrojtja e karakteristikave të peizazhit rural dhe minimizimi i fragmentimit të tij, duke ruajtur sa më qartë diferencat karakteristike midis peizazhit urban dhe atij rural.
- Krijimi i infrastrukturës së gjelbër për qytetet e mëdha e të vogla, që do t'i mundësojnë banorëve akses në zonat natyrore dhe në aktivitetet rekreative që do të zhvillohen në to.
- Ruajtja dhe aty ku është e mundur shtimi i zonave të mbrojtura mjedisore dhe biodiversitetit në to.
- Mbrojtja e objekteve dhe strukturave ndërtimore, me vlera karakteristike të peizazhit të traditës historike e kulturore.

Në qendrat *qendrat terciare dhe qendrat lokale* ndërmjet të tjerave, ku kërkohet rigjenerim:

- Mjedisit si produkt turistik që tërheq vizitorët nga cilësia e peizazhit natyror, historiko - kulturor dhe biodiversitetit, si edhe nga një gamë e gjerë mundësish për zhvillimin e aktiviteteve natyrore;
- Tërheqja e sipërmarrjeve dhe njerëzve që karakterizohen nga aftësi dhe një spektër i gjerë ekspertize teknike dhe intelektuale, për të cilët jetesa në qytete të vogla ku garantohet cilësia mjedisore, i mundëson atyre cilësinë e jetës që ata kërkojnë;
- Zhvillimi i avancuar i infrastrukturës së komunikimit, e cila mund të sigurojë zgjerimin e shkallës së aktiviteteve ekonomike si dhe të sipërmarrjeve të vendosura në një vend të caktuar.



Grafiku 2.2.1.3: Sistemi natyror: Situata aktuale 2015 (majtas) – Propozimet territoriale 2030 (djathtash) (burimi: PPK)

Në mënyrë të veçantë për zonën e studimit dhe duke u bazuar në hartën e PPK, elementë kryesorë të sistemit natyror janë si më poshtë:

Dy korridore të gjelbërta: një përgjatë gjatësisë së lumit të Drinit (përshkon vendin nga perëndimi deri në lindje – lidhje me liqenin e Shkodrës dhe Kosovë) dhe lumi i Fanit të Madh (lidhje me lumen e Matit).

- Monumente natyrorë, të cilat grumbullohen përreth zonave turistike dhe përgjatë gjatësisë së korridorit për çiklizëm.
- Zona të shumta pyjore, në gjithë territori të Bashkisë.


- Dy zona me prioritet zhvillimin e turizmit: njëra më e shtrirë përreth qendrës urbane Pukë, dhe tjetra, në fqinjësië direkte, përreth fshatit Kabash.
- Pjesë e rrjetit të korridoreve për çiklizëm që zhvillohet përgjatë rrugës SH5 Vau i Dejes-Pukë-Fushë Arrëz (drejtimi L-P) përgjatë rrugës SH30 Pukë- Gjegjan-Rrëshen (drejtimi V-J) përmes të cilës lidhet me Bashkinë Mirditë.
- Rrugëtimi eko - turistik kanotazhi (itinerar vozitës) përgjatë Lumit të Drinit dhe liqeneve që formohen në të që nga Kukësi deri në det, zhvillohet në kufirin verior të Bashkisë.

SISTEMI UJOR

Në lidhje me sistemin uJOR PPK identifikon një sërë dobësish dhe problemesh që kanë të bëjnë me çështje si: (a) të menaxhimit, (b) të sasisë së burimeve uJore, (c) të cilësisë së burimeve uJore (d) ndotjes nga burime të ndryshme dhe përparon në rekomandimet përkatëse, si psh përdorim racional i ujit, kontroll të aktiviteteve ilegale, koordinim dhe bashkëpunim midis shërbimeve lokale, rajonale dhe qendrore, me synim për të përmirësuar kuadrin institucional në lidhje me monitorimin, menaxhimin e qëndrueshëm të uJërave nëntokësore, duke përfshirë pusët, kontrollin dhe shfrytëzim të uJërave të shiut, investime për kërkime dhe njohuri mbi burimet uJore.

Propozimet kanë të bëjnë me:

- Miratimin e politikave të dendësimit urban.
- Krijimin e korridoreve natyore të mbrojtjes përgjatë luginave të lumenjve.
- Përcaktim të vijës blu për mbrojtjen e zonave bregdetare nga përdorime të ndaluara, monitorimin e aktiviteteve dhe rigjenerimin e korridoreve natyrore
- Njohjen dhe mbrojtjen e vlerave të peizazhit natyror në të gjithë territorin kombëtar të vendit, që nga bregu deri në kreshtat e rajoneve malore.
- Mbrojtjen e basenit të Vjosës për shkak të karakteristikave të saj të veçanta: shkallën e lartë të ujëshmërisë, ndërtimin gjeologjik të formacioneve dhe larminë e peizazheve përgjatë luginës.



Harta 2.2.1.5: Sistemi uhor 2030: risqet e vërshimit të ujit, erozioni dhe ndotja e lumenjve – fragment harte (burimi: PPK)


Bazuar në foton e mësipërme, në zonën e studimit dallohet presioni dhe gjendja e rënduar e burimeve ujore. Regjistrohen vatra të izoluar të ndotura për shkak të depozitimit të mbeturinave dhe nga aktivitetet urbane dhe ato industriale, ndërsa mbi lumin Fan i Madh ushtrohet presion i madh dhe ngarkesa ndotëse.

SISTEMI INFRASTRUKTUROR

Qëllimi i PPK është të mbështesë zhvillimin e integruar të rrjeteve të infrastrukturës të cilat përbëhen nga elementet e mëposhtme:


- Transportet (si ai hekurudhor, ajror dhe transporti detar, transportin publik).
- Energjia (duke përfshirë energjinë elektrike, naftën, gazin, burimet minerale).
- Komunikimi (duke përfshirë rrjetin e telekomunikacionit, fibër optike, etj).

Propozohet zhvillimi i një sistemi multimodal, të integruar dhe miqësor me mjedisin i transportit, i cili do të sigurojë lidhjen dhe aksesin në nivel kombëtar, do të zhvillojë lidhjen ndërkufitare, do të promovojë transportin publik dhe mjetet alternative (p.sh. biçikletë) dhe do të lidh akset transportuese me korridore turistike dhe historike.



Harta 2.2.1.6: Sistemi infastruktural 2030: transporti – fragment harte (burimi: PPK)

Zona e studimit përshkohet nga aksi interurban Shkodër - Vau i Dejës - Kukës, i cili i takon akseve tërthore mbështetëse. Nga Lindja lidhet me korridori strategjik tërthor, në pjesën veriore, "Rruga e Kombit" dhe me nyjen ndërkombëtare (hub ndërkombëtar) Kukës dhe në perëndim me korridori strategjik gjatësor Autostrada Veri-Jug dhe me hub ndërkombëtar Shkodër.




Grafiku 2.2.1.4: Intralinjat dhe interlinjat hekurudhore / Stacionet sipas funksionit / Nyjat logjistike (burimi: PPK)

PPK bën propozime edhe në lidhje me infrastrukturën e energjisë me synim zhvillimin e një rrjeti efikas të energjisë:

- Zero importe të energjisë.
- Konsolidimin e dy porteve kryesore: Porto Romano dhe Vlorë 2 - Terminali Petrolifera me infrastrukturën e duhur në lidhje me magazinimin - shpërndarjen e produktet të naftës dhe gazit të lëngshëm.
- Ndërtimi i korridoreve të gazit natyror: TAP - IAP - IAP Kosove dhe linjave të tyre të interkoneksionit.
- 15% kursim të energjisë, 20% përdorim të burimeve të rinovueshme të energjisë, 20% rritje të efikasitetit të energjisë, 20% ulje të emisioneve të gazrave CO2.
- Arritje të tre objektivave - makro (makro-objektiva) për krijimin e një tregu të brendshëm të energjisë: Konkurrueshmëria, furnizim të sigurt, qëndrueshmëria.

Gjithashtu, vendos kornizën udhëzuese për zhvillimin si të energjisë me bazë hidrokarburet ashtu edhe të gjitha formave të e energjisë së rinovueshme (diellore, eolike, hidro, gjeotermale, biomasa).



Harta 2.2.1.7: Sistemi infrastrukturore 2030: energji & industri – fragment harte (burimi: PPK)

Së fundi, në fushën e telekomunikacioneve, PPK vendos si prioritet maksimal zhvillimin e infrastrukturës dixhitale dhe broadband, propozon për të përfshirë në planin themelor projekte specifike (si lidhjen e të gjitha institucioneve të edukimit dhe institucionet kërkimore shtetërore me rrjetet e kërkimit ndërkombëtare), dhe promovon menaxhimin e integruar të korridoreve për infrastrukturën.

Në lidhje me Bashkinë për të cilën po hartohet studimi, bazuar në hartat e PPK, ajo është një zonë me rezerva të shumta të bakrit dhe mineraleve jo-metalike. Gjithashtu, përshkohet nga linjat ekzistuese dhe të propozuara të transmetimit të energjisë të llojeve të ndryshme. Së fundi, konstatohet se nuk është rajon prioriteti për zhvillimin e energjisë së rinovueshme, por ka potencial për energjinë eolike dhe energjinë nga biomasa.

RAJONALIZIMI

Një parakusht për arritjen e qëllimeve strategjike kombëtare është krijimi i një baze për një zhvillim të barabartë rajonal. Në këtë drejtim, PPK identifikon 7 pole të nivelit kombëtar:


1. Shkodër-Lezhë
2. Tiranë-Durrës
3. Elbasan
4. Fier-Vlorë-Berat
5. Kukës-Has- Tropojë
6. Gjirokastër-Sarandë
7. Korçë-Pogradec

si edhe *katër zona të zhvillimit specifik*:


1. Malësi e Madhe - Tropojë (rajoni i Alpeve), rajon i cili është shumë interesant dhe një zonë natyrore e bukur dhe është ideale për turizmin malor.
2. Dibër - Klos - Bulqizë, rajon i cili disponon burime të shumta minerare dhe ekspertizë në përpunimin e mineraleve.
3. Këlcyrë - Përmet - Skrapar, rajon me përvojë në kultivimin, grumbullimin dhe përpunimin e bimëve aromatike dhe medicinale, pemët frutore, bujqësinë, zhvillimin e blegtorisë dhe turizmin mjedisor.
4. Pukë - Mirditë - Fushë Arrëz.

Zona e studimit është pjesë e zonës së veçantë të zhvillimit Pukë - Mirditë - Fushë Arrëz. Tipare të rëndësishme të kësaj zone janë nxjerrja e mineraleve dhe përpunimi i tyre, zhvillimi i industrisë përkatëse dhe teknologjisë. Në veçanti, ka rezerva të konsiderueshme të bakrit në pjesën veriore të Bashkisë Mirditë, në lindje të Bashkisë Pukë dhe në Bashkinë Fushë Arrëz, dy miniera në Lakrosh dhe Munellë, si edhe uzinën e pasurimit të bakrit. Minierat e bakrit kanë një ndikim të drejtpërdrejtë negativ në lumenj, për këtë arsye, duhet të merren masa për rehabilitimin dhe minimizimin e ndotjes. Përveç kësaj, rajoni disponon elementë natyrorë dhe peizazhe të cilat duhet të ruhen dhe zhvillohen më tej. Ka mundësi për prodhimin dhe kultivimin e lajthisë, arrave dhe gështenjave, dhe për këtë arsye ka nevojë për forcimin e një zinxhiri të integruar të prodhimit: kultivim-mbledhje-përpunim.

Gjithashtu, ndodhet në zonën e menjëhershme të ndikimit të polit Shkodër-Lezhë, i cili shërben si porta perëndimore e rajonit malor verior të vendit.



Harta 2.2.1.8: Poli i propozuar i zhvillimit rajonal Shkodër-Lezhë – fragment harte (burimi: PPK)



Harta 2.2.1.9: Zona e propozuar me specifikë zhvillimi Pukë - Mirditë - Fushë Arrëz - fragment harte (burimi: PPK)

Sipas një studimi nga INSTAT, nënjësitë vendore (LGU363) klasifikohen në gjashtë grupe bazuar në ndërveprimet dhe marrëdhëniet funksionale në mes tyre dhe qendrat urbane: Grupi 1 "i Madh-periferik", Grupi 2 "i vogël/periferik", Grupi 3 "mesatar-gjysmë-qendror", Grupi 4 "i vogël/qendror (preja)", Grupi 5 "mesatar/qendror (gjysmë-grabitqarë)" dhe Grupi 6 "i vogël/qendror (grabitqarë)".

Grupi i parë përfshihen nënjësitë vendore që karakterizohen nga dendësi të ulët, sipërfaqe të madhe dhe lëvizshmëri të ulët të banorëve (lëvizje jashtë kufijve të tyre). Në të dytën nënjësitë vendore kanë karakteristika të ngjashme, por dendësi më të lartë. Në të tretin karakteristika kryesore është lëvizja e përditshme e rëndësishme e banorëve.

Njësitë administrative të Bashkisë bëjnë pjesë në grupet e mësipërmendura, në përputhje me tabelën e mëposhtme. Gjithashtu, bazuar në sa më sipër, për zonën e studimit ndërhyrja dominante hapësinore është kooperim dhe përforsim.

njesi administrativ	grupi
Pukë	grupi 3 "mesatar-gjysmë-qendror"
Gjegjan	grupi 1 "të madh-periferik"
Rrapë	
Qerret	
Qelëz	grupi 2 "të vogël/periferik"

Tabela 2.2.1.2: Klasifikimi i njësive administrative të bashkisë bazuar në nivelin e ndërveprimeve hapësinore mes tyre dhe qendrave urbane kryesore, si edhe pozicionimin e tyre lidhur me këtë rol (burimi: PPK)

Bazuar në hartën përkatëse, Bashkia përshkohet nga aksi korridori strategjik tërthor, në pjesën veriore (SH5), si edhe nga një rrugë me bukuri peizazhi natyror, e cila lidh Bashkinë me Bashkitë e tjera fqinje të Fushë Arrëzitet dhe atë të Mirditës.

Në lidhje me zhvillimin e turizmit duhet të theksohet se akset kryesore dhe mundësitë për zonën e studimit janë dy zonat me përparësi në zhvillimin e turizmit, monumentet natyrore, korridoret e gjelbra përgjatë lumenjve të mëdhenj dhe dy rrugët turistike me nivel kombëtar të cilat gjenden në veri të Bashkisë: Itinerari Alpino-liqenor që lidhet me parkun e Alpeve dhe itinerari vozitës përgjatë liqeneve artificiale të Komanit-Fierzës (në kontakt me kufirin verior të Bashkisë).

NDRYSHIMET KLIMATIKE

PPK jep drejtimit në lidhje me përballimin dhe përshtatjen me ndryshimet klimatike, të cilat në nivel rajonal përfshijnë, ndërmjet të tjerash:

1. Gjatë planifikimit të çdo ndërtimi të ri, apo zgjerimi të strukturave ekzistuese, duhet të kryhet një analizë ndjeshmërie e infrastrukturës së parashikuar në kushtet ekstreme të motit. Në bazë të rezultateve të saj, duhet të përgatitet një plan masash për të pakësuar në mënyrë të përhershme pasojat e këtyre dukurive.

2. Zbatimi i masave për të ulur ndjeshmërinë e infrastrukturës ndaj kushteve ekstreme të motit duhet të jetë një detyrë qendrore e menaxhimit të çdo lloji infrastrukture. Qëllimi i zbatimit të këtyre masave duhet të bazohet sidomos në zvogëlimin e dëmit të shkaktuar për përdoruesit e infrastrukturës së ndjeshme ndaj motit, nëse ata nuk mund ta përdorin atë.

3. Rehabilitimi, zgjerimi si dhe krijimi i infrastrukturave për furnizimin me ujë duke përfshirë skenarët e ndryshimeve klimatike në këtë sektor. Menaxhimi i kërkesës për ujë përmes ripërdorimit, sigurimit të rezervave ujore të reja, ujit të shiut, shkripëzimit etj.

4. Përmirësimi i efçencës së ujit, infrastrukturës ujitëse, varieteteve të bimëve, sistemit të kullimit, plehërimit si dhe ruajtja e lagështisë së tokës janë disa masa që duhet të ndërmerren në sektorin e bujqësisë, nisur nga ndryshimet e pritshme të klimës (temperaturave).

IMPLEMENTIMI DHE MONITORIMI I PPK

PPK përfshin propozime për aplikimin (në tre faza) dhe monitorimin e planit.

Ndër projektet strategjike të propozuara përfshihen:

- Projekte për trajtimin e ndryshimeve klimatike (p.sh. pyllëzimi, përmirësimi i rrjeteve të ujitjes)
- Rigjallërimin e zonave të vjetra industriale
- Pajisje të zonave me prioritet nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve.
- Shtim të zonave të mbrojtura të mjedisit natyror
- Krijimi i një rrjeti kombëtar të rrugëve për biçikleta
- Rritje të efikasitetit të sistemit të furnizimit me ujë dhe rrjeteve të kanalizimeve dhe krijim/përmirësim të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza, krijim të vendeve të përshtatshme për hedhjen e mbeturinave.
- Hartimi i planeve të menaxhimit për zonat me një trashëgimi të shquar historike dhe kulturore.
- Ngritja e kapaciteteve të pushtetit vendor për planifikimin, zhvillimin, monitorimin dhe qeverisjen e mirë të territorit lokal.

Zbatimi i politikave/strategjive për çdo sistem territorial do të promovojë arritjen e objektivave strategjike dhe do të promovojë planin kombëtar për një Shqipëri të integruar në hapësirën evropiane, qendër të Ballkanit, me një mjedis tërheqës dhe konkurrues urban, natyror dhe kulturor dhe zhvillim të balancuar territorial.



Grafiku 2.2.1.5: Indikatorët e propozuar për monitorimin e zhvillimit të territorit (burimi: PPK)

Duke përmbledhur propozimet specifike dhe udhëzimet e PPK për zonën e studimit, Bashkia Pukë bën pjesë në zonën e zhvillimit të veçantë që përkon me zonën Pukë - Mirditë - Fushë Arrëz, e cila varet dhe ndikohet drejtpërsëdrejti nga poli kombëtar i zhvillimit rajonal Shkodër-Lezhë. Prioritet përbën përmirësimi i lidhjes së tij me këtë dipol - portë hyrjeje e vendit dhe promovimi i bashkëpunimit të tyre. Është e rëndësishme afërsia e bashkisë me dy zona ndërkufitare të bashkëpunimit që përfshijnë edhe nyje mulimodale të transportit ndërkombëtar: Kukës-Prishtinë dhe Shkodër-Podgoricë.

Përshkohet nga një aks të zhvillimit dhe infrastrukturës, i cili përkon me segmentin dytësor rrugor me rëndësi kombëtare SH5. Pranë tij gjendet qendra e bashkisë, e cila është pjesë e qendrave tretësore urbane. Gjegjani është caktuar si qendër lokale e specializuar dhe shtrihet pranë boshtit me vlera natyrore dhe mjedisore dhe mundësi zhvillimi të korridoreve të çiklizmit, përmes të cilit lidhet me bashkinë Mirditë.

Forcimi i bashkëpunimit me bashkitë fqinje Mirditë, Fushë Arrëz dhe Vau i Dejës përbën një prioritet për PPK.

Drejtimet për ekonominë dhe infrastrukturën përfshijnë:

- Vlerësimin e zonave minerare dhe zhvillimin e industrisë minerare dhe përpunimit të mineraleve.
- Zhvillimin e turizmit me fokus zonat me prioritet turistik përreth Pukës dhe Kabashit dhe itinerarin vozitës përgjatë liqeneve artificiale Koman - Fierzë. Gjithashtu, pole dhe akse të

zhvillimit turistik përbëjnë edhe monumentet natyrore, zonat e lumenjve ku është e dëshirueshme të funksionojnë si korridore të gjelbra - ekologjike dhe korridoret e çiklizmit.

- Përmirësimin e aksesit të qendrave lokale nga qendra e bashkisë me nyjet multimodale kombëtare.
- Ruajtjen e tokës bujqësore, zhvillimin e kulturave të specializuara dhe prodhimin e produkteve cilësore lokale.
- Trajtimi i burimeve të ndotjes të mjedisit dhe sidomos të ujërave.

2.2.2. Plani i Integruar Bregdetar Ndërsektorial

Në zbatim të Ligjit 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", të ndryshuar, për hartimin e Planeve Kombëtare Sektoriale (Planet sektoriale për të gjithë territorin ose një pjesë të tij, neni 16, 17) dhe në bazë të Vendimit nr. 14 të Këshillit Kombëtar të Territorit datë 07.3.2014 "Për miratimin e nismës për hartimin e Planit Ndërsektorial të Integruar të Bregdetit" nisi procedura për hartimin e Planit të Përgjithshëm Ndërsektorial të zonës së bregdetit. Hartimi i një modeli përfunduar zhvillimi për zonat bregdetare mund të konsiderohet si një nga prioritetet më parësore të planifikimit në nivel kombëtar, i cili do të pasohet me dokumente të tjera të planifikimit. Vizioni i zhvillimit të rajonit është orientimi drejt një destinacioni turistik shumëplanësh, pjesë integrale e rrjetit të zonës mesdhetare. Koordinimi i administrimit mjedisor, mbrojtjes së mjedisit natyror e kulturor dhe plotësimi i nevojave vendase duhet të aplikohen në të gjithë territorin bregdetar, një burim i rëndësishëm kombëtar.

Programimi i Planit të Integruar Ndërsektorial të Bregdetit (PINS_Bregdeti), morri në konsideratë strategjitë kombëtare sektoriale, studimet e mëparshme për rajonin si dhe udhëzimet evropiane e politikat për menaxhimin e integruar të zonave bregdetare të Mesdheut. Koordinimi me objektivat sektoriale kombëtare, por edhe formësimi i objektivave dhe politikave sipas fushave, vërtetojnë karakterin ndërdisiplinor të studimit. Zona e studimit të PINS_Bregdeti përfshin katër breza me renditje A-D (shiko figurën 2.2.2.1):

- Brezi i parë, zona A, e ashtuquajtur zona det-diell, e cila përfshin bregdetin me portet, strukturat e specializuara për turizëm bregdetar dhe ekosistemet bregdetare natyrore. Ketu përfshihen qytetet bregdetare si Durrësi, Vlora, Saranda, Himara, Ksamili, Velipoja, Lezha dhe Divjaka.
- Brezi i dytë, zona B, përfaqëson zonat për agrikulturë, duke përfshirë qytetet e vijës së dytë dhe lokalitetet e vogla përkatëse, si Tirana, Shkodra, Fushë Kruja, Kavaja, Lushnja e Fieri.
- Brezi i tretë, zona C, me shtrirje në brendësi të zonës, përfshin qytetet me vlera në trashëgiminë historike, kulturore, folklorike, artistike dhe të monumenteve. Këtu përmendim qytetet si Berati, Gjirokastra, Kruja, Elbasani e Tepelena.
- Brezi i katërt, zona D, e cila shtrihet në zonën e detare me gjerësi 12 milje, duke përfshirë të gjithë pasurinë ujore e nënujore si dhe vijën bregdetare.

Të katër zonat kanë karakteristika të ndryshme si dhe paraqesin nevoja të veçanta aspektin e planifikimit dhe ritmin e rritjes, por janë pjesë integrale e zonës në studim. Për këtë, nevojitet një qasje e përgjithshme që do të kombinojë politikat e ndryshme shënjestruese dhe do të përmirësojë ndërveprimin midis zonave me qëllim final zhvillimin e qëndrueshëm të integruar.

Zona e studimit e PINS_Bregdeti ndahet edhe në planin horizontal, në bazë të morfologjisë, mjedisit, zhvillimit urban, faktorëve natyrorë, zonave të mbrojtura dhe karakteristikave të veçanta. Në bazë të diferencimit në planin horizontal propozohet ndarja në 4 zona me mundësi ekonomike zhvillimi:

- Zona e ekoturizmit. Shtrihet nga Hamallaj në Durrës deri në grykë-derdhjen e Bunës, duke përfshirë bashkitë e Kurbinit, Lezhës dhe Shkodrës. Zhvillimi ekonomik shikohet kryesisht drejt ekoturizmit (peshkim, bujqësi, blegtori), për shkak të vlerave mjedisore me ekosisteme të pasura natyrore.
- Zona e turizmit të shërbimeve përfshin qytetet e Durrësit dhe Kavajës, ku mbizotërojnë aktivitetet ekonomike si logjistika, shërimet, përpunimi e fasoneria. Shërbimet turistikë kanë karakter masiv detar, ditor, por me ndikim të drejt-përdrejtë në nivel kombëtar e më gjerë.
- Zona e agroturizmit. Shtrihet nga Golemi në Kavajë e deri në Pyllin e Sodës në Vlorë, duke përfshirë bashkitë Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Vlorë dhe Fier. Karakteri dominues bujqësor, industria nxjerrëse e përpunuese, peshkimi e blegtoria, e orientojnë zonën drejt agroturizmit dhe ekoturizmit.
- Zona e turizmit det-diell dhe kulturor, e cila shtrihet në jugun e Shqipërisë, duke përfshirë bashkitë e Vlorë, Sarandës, Himarës dhe Konispolit. Zona e bregdetit jugor mund të konsiderohet Parku i ri bregdetar me destinacione tërheqëse turistike dhe lidhje të ngushtë me trashëgiminë e pasur kulturore të zonës.

Bashkia Pukë nuk është pjesë përbërëse e drejt-përdrejtë e Planit të Integruar Ndërsektorial të Bregdetit, por mund të konsiderohet si thellim i zonës së rajonit natyror horizontal Shkodër – Kurbini. Prandaj, ndikohet nga drejtimet që jep PINS_Bregdeti sipas sektorëve përkatës.



Figura 2.2.2.1: Katër zonat territorial (Burimi: Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin, Prezantimi publik).




Figura 2.2.2.2: Park Rajonal Potencial (Burimi: Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin, DRAFT i plotë i Planit).

PINS_Bregdeti përcakton objektivat dhe politikat sipas sektorëve, në veçanti për sistemet urbane, infrastrukturën, turizmin, energjinë, ekonominë, bujqësinë dhe mjedisin natyror. Synimet për qendrat urbane kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe formimin e një boshti tradicional arkitektonik. Propozohen:

- Dendësimi i qendrave urbane me qëllim reduktimin e shpërndarjes urbane në zonat natyrore, rurale dhe të mbrojtura (vende arbitrare pa infrastrukturë teknike dhe sociale).
- Rritjen urbane në brendësi të territorit (forcimin e qendrave urbane lokale dhe të specializuara), me qëllim zhbllokimin e bregdetit.
- Zhvillimi policentrik, hierarki e qendrave urbane kryesore, të mesme dhe të specializuara në nivel lokal si dhe fuqizimin analog të tyre.
- Restaurimi dhe rehabilitimi i zonave me rëndësi kombëtare.
- Financime për ndërtimin e banesave tradicionale.
- Promovimi dhe zhvillimi turistik i arkitekturës tradicionale vendore.

Përmirësimi i aksesit dhe i ndërlidhjes në zona të zhvilluara dhe turistike dhe mbulimi i plotë i vijës bregdetare me infrastrukturën themelore të transportit, energjisë, kanalizimeve, etj janë qëllimet kryesore për sektorin e infrastrukturës. Disa prej politikave të propozuara janë:

- Përdorimi i infrastrukturës së butë ('soft') në zonat e ndjeshme natyrore.
- Ndërtimi i rrjetit të përshtatshëm infrastrukturor rajonal për zonat bregdetare.
- Promovimi dhe lehtësimi i lëvizjes së këmbësorëve.
- Forcimi i infrastrukturës detare.
- Forcimi i transportit hekurudhor.

Në sektorin e energjisë, është propozuar përdorimi i qëndrueshëm i energjisë së rinovueshme dhe mbështetja e institucioneve publike dhe private në këtë drejtim. Propozohen mbështetja e iniciativave private për prodhimin e energjisë diellore, duke promovuar përdorimin e materialeve ndërtimore me efikasitet energjetik. Objektivi tjetër është shpërndarja e përshtatshme dhe efektive të energjisë përmes rrjetit ekzistues dhe linjave të reja, si dhe mbulimi i plotë i nevojave të tanishme dhe të ardhshme të energjisë.

Zona bregdetare e vendit karakterizohet nga diversiteti dhe ndryshim në furnizim, prodhimin dhe aktivitetin ekonomik. Përdorimi i qëndrueshëm i karakteristikave unike vendase dhe burimeve të çdo zone (natyrore, kulturore, monumentale, etj) do të japë një avantazh konkurrues dhe do të nxisë zhvillimin ekonomik. Qëllimi është që të bëhet një nga zonat më të zhvilluara të vendit dhe konkurruese në nivel ndërkombëtar për sa i përket turizmit. Disa nga politikat e propozuara për rigjenerimin ekonomik janë:

- Përdorimi i qëndrueshëm i të gjitha burimeve të disponueshme dhe mundësive vendase.
- Informimi, edukimi dhe trajnimi i aktorëve vendas në çështjet ekonomike dhe turistike.
- Pajisja e qendrave urbane dhe zonat turistike me infrastrukturë grumbullimi, dhe informimi.
- Forcimi i sipërmarrjes lokale.

Në veçanti, në sektorin e turizmit, objektivi kryesor është ndërlidhja e turizmit detar me degët e tjera të turizmit dhe shtrirja e sezonit turistik përgjatë gjithë vitit. Ndër të tjera propozohen:

- Diversifikimi i turizmit dhe zhvillimi i formave të veçanta të turizmit alternativ që do të shfrytëzojë burimet historike, kulturore dhe mjedisore, traditat dhe produkte vendase.

- Forcimi i diversitetit, promovimi i duhur i karakteristikave unike vendase (monumente, produkte, etj) dhe ndërlidhja e tyre me rrjetet tematike / rrugët.
- Zhvillimi i butë turistik i zonave të mbrojtura natyrore.
- Kombinimi i formave moderne dhe tradicionale të turizmit.




Figura 2.2.2.3: Promovimi i qendrave locale me anë të vlerave tradicionale arkitektonike (burimi: Prezantim publik, Plani i Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës)

Në bujqësi, qëllimi kryesor është zhvillimi i këtij sektori dhe kalimi i tij si primar ekonominë e zonës, si dhe mbështetja dhe zhvillimi i turizmit. Politikat kryesore të propozuara janë:

- Nxitja e ekonomive të përshkallëzuara në bujqësi.
- Mbrojtja e ullishtave, vreshtave, drurëve frutorë dhe kullotave.
- Bashkëpunimi i sektorit bujqësor dhe turizmit.
- Promovimi i produkteve tradicionale (subvencion, reklamat etj).
- Modernizimi i sistemeve të ujitjes, në mënyrë që të rrisin produktivitetin dhe cilësinë.

Së fundi, në nivel mjedisor, prioritetet të menëhershëm ka mbrojtja e zonës së ndjeshme bregdetare nga erozioni, rrëshqitjet e tokës, përmytjet e rreziqe të tjera dhe rritjen e zonave të mbrojtura. Propozohen:

- Mbrojtja e baseneve të lumenjve (integrimi në zonat e mbrojtura).
- Përcaktimi i kufijve të mbrojtjes së Detit Adriatik dhe bregdetit Jon.
- Mbrojtja e ekosistemeve pyjore dhe pyllëzimet.
- Zhvillimi i infrastrukturës mbrojtëse të bregdetit nga ndotja.

2.2.3. Plani i Integruar Ndër-sektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës

Siç theksohet në PPK, rajoni Tiranë-Durrës është një ndër më të rëndësishmit në nivel kombëtar e rajonal. Hartimi i Planit të Integruar Ndër-sektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës (PINS_DURANA), paraqet modelin e dëshiruar të zhvillimit të zonës në fjalë për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm.

Plani u hartua bazuar në ligjin nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; duke patur si përmbajtje Strategjinë e Zhvillimit të Territorit, Politikat e Zhvillimit dhe Rregulloren përkatëse, shoqëruar nga raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Karakteri ndërsektorial i planit përfshin në vetvete të gjitha strategjitë sektoriale e kombëtare ne fuqi (si Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Turizmit 2014-2020, Strategjia Ndër-sektoriale e Mjedisit 2014-2020, Strategjia e Zhvillimit Ekonomik etj.), të cilat veprojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në zonën e studimit.

Zona metropol Tiranë-Durrës është qendra më e rëndësishme ekonomike e vendit, e cila ka ndjekur ritme të shpejta zhvillimi me rezultat ndikimin e madh në nivel mjedisor. Projekti synon të orientojë zhvillimin ekonomik, mjedisor dhe social të rajonit duke koordinuar planet dhe politikat vendase, për të krijuar një klimë të përshtatshme investimi. Krijimi i një poli konkurrues ekonomi, parashikon gjithashtu përmirësimin e kapaciteteve të fuqisë punëtore për të rritur nivelin arsimor si dhe kapacitetet profesionale; krijimin e një mjedisi sa më tërheqës e me nivel të lartë jetese, modernizimin e infrastrukturës sociale, lehtësimin e lëvizshmërisë dhe qasje më e mire drejt shërbimeve lokale.

Plani ka caktuar katër objektiva strategjike dhe synimet përkatëse si dhe politikat si më poshtë (duke parashikuar realizimin në vitin 2030):

- Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik duke synuar një mjedis konkurrues, i cili nxit risi dhe ekspertiza të kualifikuara, inkurajon krijimin e klasterave¹⁸ dhe zhvillimin e sistemeve të prodhimit të tipit të mbyllur. Propozohen:
 - Krijimi i poleve ekonomike me karakteristika/specifika të veçanta.
 - Mbështetja e klasterave.
 - Promovimi i ekonomisë së gjelbër.
 - Politika mbështetëse për turizmin (me vlerë të lartë ekonomike), si hapja e akteve turistike, krijimin e një fondi të përbashkët nga operatorët turistikë dhe profesionistë të zonës konkrete, etj

¹⁸ Bëhet fjalë për biznese dhe rajoneve gjeografikisht të afërta (universitete, institucione kërkimore), të cilat bashkëpunojnë dhe ndikohen nga njeri-tjetri me ndihmën e teknologjisë për materializimin e energjive në sektorë konkrete (Michael Porter, 1990).

- Politika mbështetëse për sektorin e bujqësisë (duke kontribuar në zhvillimin ekonomik në funksion të zhvillimit të synuar rural), si promovimin / marketingut e produkteve bujqësore, aplikimin e teknologjisë së zgjuar në industrinë bujqësore etj.
- Përmirësimi i cilësisë së zonat urbane dhe rurale me qëllim urbanizimin kompakt (përqëndrim të lartë në zonat urbane krahasuar me pjesën tjetër të vendit) dhe mbrojtjen/rehabilitimin e mjedisit rural/bujqësor. Janë propozuar, midis të tjerash:
 - Zhvillimi policentrik dhe hierarkia e qendrave urbane, me theks në prioritetet e veçanta.
 - Përmirësimi i shërbimeve publike.
 - Rigjenerimi urban.
 - Integrimi i zonave informale në planifikim.
 - Zbatimi i programeve sociale të strehimit.
 - Përdorimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë.
 - Përmirësimi energjetik i blloqeve ndërtimore.
 - Rigjallërimi i qendrave rurale.
- Përmirësimi i infrastrukturës së transportit dhe lëvizshmërisë me qëllim lehtësimin e lëvizshmërisë për bizneset, furnizuesit dhe konsumatorët, përmirësimin e arritshmërisë së banorëve drejt strukturave/shërbimeve dhe përmirësimin e asketit në nivel ndërkombëtar. Ndër të tjera propozohet:
 - Zhvillimi i rrjetit të levizjeve për këmbësorë dhe biçikleta.
 - Përmirësimi i infrastrukturës së transportit në zonat rurale.
 - Përmirësimi / zhvillimi i transportit publik urban.
- Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit natyror për përdorimin e teknologjisë me zero ndikim negativ ndaj mjedisit, përmirësimin aksesit në detin Adriatik, mbrojtjen efektive të ujërave, etj. Ndër të tjera rekomandohet:
 - Trajtimi dhe menaxhimi i rreziqeve nga përmytjet.
 - Menaxhimi i mbetjeve.
 - Ballafaqimi me ndikimet e ndryshimeve klimatike.

Plani i Integruar Ndërsektorial të zonës ekonomike Tiranë-Durrës prek qytetet e Tiranës, Durrësit, Vorës, Shijakut dhe Fushë Krujës. Bashkia Pukë është larg rajonit ekonomik Tiranë-Durrës dhe nuk preket drejtpërdrejtë nga ky plan. Megjithatë, nxitur nga fakti se është plani i parë ndërsektorial i hartuar për një rajon të veçantë të vendit, konsiderohet si shembull përfaqësues për hartimin e planeve të ngjashme në të ardhmen.

Plane të integruara sektoriale mund të hartohen, me ngjashmëri me të parin, për rajone të tjera të rëndësishme të identifikuara nga PPK, si poli i zhvillimit rajonal “Shkodër-Lezhë” me fokus në zonat me specifikë zhvillimi Pukë – Mirditë - Fushë-Arrëz. Zona ka përparësi zhvillimin e industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të mineraleve si dhe teknologjinë përkatëse. Rajoni njihet për pasuri rezervash bakri, të cilat vihen në shfrytëzim nga minierat e bakrit dhe fabrikat e pasurimit të bakrit, aktualisht me ndikim direkt në mjedis. Gjithashtu, rajoni mbart tipare të veçanta natyrore e peisazhistike duke mundësuar zhvillimin e agro-bizneseve si dhe një zinxhiri të prodhimit bujqësor që nga kultivimi e deri në përpunim (rajoni njihet për sektorin e arrorëve si lajthi, arra e gështenja).




Figura 2.2.3.1: Harta e potencialeve ekonomike dhe turistike, Plani i Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës, paraqitet hierarkia e banimit e propozuar, politikat ekonomike dhe projektet prioritare (Burimi: Plani i Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës, miratuar me Vendim nr. 3 të KKT-së, datë 14.06.2016).

2.2.4. Plane rajonale dhe vendore

Për të parë në mënyrë më të gjerë konceptin e zhvillimit të rajonit të qytetit të Pukës, është e domosdoshme të analizohen të gjitha dokumentat që lidhen me strategjitë e zhvillimit. Më poshtë po paraqesim disa nga dokumentat themelore, të cilat shpjegojnë vizionin dhe strategjitë e zhvillimit të rajonit të Shkodrës, ku bën pjesë bashkia Pukë.

- **“Plani rajonal Shkodër-Lezhë, 2005-2020” (EPTISA)**, u hartua në vitin 2005 me synimin për të maksimizuar përdorimin e burimeve vendase dhe kapaciteteve, për të rritur nivelin e ekonomisë vendase dhe ndalimin e migrimeve dhe emigrimeve. Qëllimet kryesore mbi të cilat parashikohet të mbështetet ky plan janë:

- Përforcimin e polit verior Shqiptar, me potencial ekonomik, dhe zhvendosjen e përqendrimit në rajonin metropol Tiranë-Durrës.
- Rritjen e aksesueshmërisë së zonave më të thella malore, më pak të arritshme.
- Rritjen e bashkëpunimit ekonomik, social e kulturor me qytetet kufitare.
- Ripozicionimin dhe stabilizimin e popullësisë së qyteteve që bëjnë pjesë në këtë rajon.
- Krijimin e linjës së transportit Shkodër-Tivar, kalon përmes këtij rajoni duke mundësuar zhvillimin e aktiviteteve.

- Zgjerimin e turizmit bregdetar, duke zgjatur linjën nga Mali i Zi e përgjatë Bunës.
- Mbrojtjen e tokës bujqësore nga urbanizimi.
- Rritjen e sasisë dhe cilësisë së shërbimeve, sidomos atyre arsimore e shëndetësore.
- Përmirësimin e infrastrukturës.




Figura 2.2.4.1: Projektet strategjike të propozuara nga Plani rajonal Shkodër – Lezhë, 2005-2020.

- “Skenarët e Zhvillimit Nënrajonat në Qarkun Shkodër” u hartua në 2015 në kuadër të Programit të Zhvillimit Rajonal të Shqipërisë Veriore, duke përfshirë Bashkitë Shkodër dhe Lezhë. Qëllimi është një zhvillim i qëndrueshëm social dhe ekonomik i këtyre qarqeve, duke zbatuar objektivat e paraqitura nga dokumentat strategjike përkatës, dhe orientim për Planet e Veprimeve të Qarqeve. Fushat prioritare, mbi të cilat janë bazuar qëllimet strategjike, janë: edukimi (krijimi i kapaciteteve të specializuara të fuqisë punëtore), infrastruktura dhe shërbimet, turizmi dhe agrobiznesi, koordinimi ndër-institucional dhe mbrojtja ndaj përmbytjeve.

Pjesë përbërëse e Qarkut të Shkodrës është Bashkia Pukë, e cila konsiderohet se i përket modelit monocentrik të organizimit, me qendër qytetin e Pukës. Rajoni zë një përqindje të konsiderueshme të kullotave në qark, ku produktet tipike janë gështenjat, bimët medicinale, frutat e pyllit, kërpudhat etj. Megjithëse bujqësia e blegtoria nuk kanë potencialin maksimal të zonës, nxitja e prodhueshmërisë mund të bëhet përmes mbështetjes dhe financimit në sektor, reklamimit më të mirë të produkteve vendase, bashkëpunim për shkëmbim të produkteve të ndërsjellta, si dhe zhvillimi i agrobujqësisë, e cila kombinohet edhe me turizmin familjar e rural. Përmes një marketingu të fuqishëm, krijimi i “brand-eve” për diversifikimin e produkteve, mund të realizohet rritja e bashkëpunimit midis sektorëve të ndryshëm, duke patur aktorë vetë fermerët e rajonit të Pukës, Bashkinë si edhe Qarkun. Projektet afatgjatë që parashikohen për nxitjen e turizmit, përfshijnë edhe rehabilitimin e zonave të ndryshme në qytetin e Pukës (p.sh. Blloku 3) duke përmirësuar pamjen mikëpritëse të zonës. Gjithashtu, Qarku parashikon mbështetjen e produkteve të ndërsjellëta Shkodër-Pukë, si bimët medicinale, gështenjat, frutat e pyllit dhe bletaria. Ndërsa

prioriteti i nxitjes së edukimit synohet të realizohet përmes trajnimeve profesionale, krijimit të grupeve vendase aktive dhe informimi më i gjerë i fermerëve.




Figura 2.2.4.2: Nënrajonet me potenciale të ngjashme zhvillimi në sektorin e turizmit (burimi: Skenarët e Zhvillimit Nënrajonal në Qarkun Shkodër)

- “Koncepti strategjik i zhvillimit rajonal” u hartua ne 2010, si rezultat i bashkëpunimit të Këshillit të Qarkut Shkodër dhe GTZ. Dokumenti funksionon si një manual orientimi për Qarkun Shkodër, në lidhje me tërheqjen e investimeve dhe futjen në efikasitet me burimet e veta. Objektivat kryesorë shtrihen në fushat e arsimit, shërbimeve sociale, infrastrukturave, turizmit e agro-biznesit si dhe bashkëpunimit më të mirë midis rajoneve. Rajoni i Pukës shikohet me potenciale të larta për zhvillimin e turizmit familjar dhe ekonomisë vendase. Konsolidimi i turizmit shikohet i mundur përmes çertifikimit të produkteve të zonës, pjesëmarrja në organizime dhe panairë për promovim më të gjerë të këtyre prodhimeve, ritja e bashkëpunimit midis rajoneve si dhe senzibilizim i komunitetit.

- “Plani Menaxhimi për Parkun Kombëtar ‘Alpet e Shqipërisë’”, hartuar në 2015 nga INCA, përcakton tre prioritete kryesore si edhe baza për programet e menaxhimit të parkut:

- a) Menaxhim më i mirë i parkut përmes forcimit të kapaciteteve dhe përmirësimit të biodiversitetit.
- b) Zhvillimi i aktiviteteve sociale e turistike me qëllim përdorimin e shumëanshëm dhe të qëndrueshëm.
- c) Rritjen e ndërgjegjësimit si dhe nxitjen e kërkimeve shkencore.




Figura 2.2.4.3: Zonat e Parkut Kombëtar (burimi: Plani Menaxhimi për Parkun Kombëtar ‘Alpet e Shqipërisë’)

- “Plani Rajonal Shkodër-Lezhë 2005-2020”, hartuar në 2006 nga Eptisa, synon zhvillimin e përbashkët të rajonit duke shfrytëzuar në maksimum kapacitetet dhe burimet vendase, për të nxitur zhvillimin e ekonomisë dhe zvogëlimin e zhvendosjes së popullsisë. Zhvillimi i zonave veriore të

Shqipërisë, do të forcojë ekonominë vendase, duke e futur në konkurrencë me zonat kufitare përreth dhe duke krijuar një pol të ri të drejtuar nga agro-turizmi.

- “Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër”, hartuar në 2016 si bashkëpunim midis Bashkisë Shkodër dhe Universitetit Polis, Arizona State University si dhe Metropolis sh.p.k, përcakton si një nga objektivat e veta strategjike, përmirësimin e aksesit dhe marrëdhënieve rajonale Shkodër-Pukë. P.sh. aksi Shkodër-Vau i Dejës-Pukë, është përshkruar si projekt strategjik me prioritet të mesëm. Ky projekt mund të financohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe ARrSH.

2.2.5. Zonat dhe objektet me rëndësi kombëtare

Duke patur parasysh nenin 33 të VKM-së Nr.671, datë 29.07.2015, në të dhënat dhe në zonat me rëndësi kombëtare përfshihen: (a) zonat e mbrojtura dhe monumentet e mjedisit natyror, (b) zonat e mbrojtura dhe monumentet e mjedisit kulturor, (c) resurset natyrore, (ç) infrastruktura e rëndësishme për prodhimin dhe transferimin e energjisë, (d) qendrat më të rëndësishme urbane, (dh) rrugët shtetërore, (e) zonat minerare dhe (ë) zonat me rrezik natyror.

A. Në përputhje me Ligjin me Nr.8906/6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, **zonat natyrore të mbrojtura** të vendit kategorizohen në gjashtë kategori me kufizime përkatëse, nivele mbrojtjeje dhe zona buferike (shih analitikisht Kapitulli 2.2.6). Kategorizimi u bazua në kriteret e IUCN.¹⁹

Në rajonin e studimit nuk ka asnjë zonë të shpallur të mbrojtur. Gjithashtu, bazuar në VKM nr.676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë të mbrojtur të monumenteve të natyres shqiptare” në Bashki janë shpallur si të mbrojtura një sërë monumentesh natyrore:

Nr.	Emri	Vërejtje
1	Shpella e Kaurit	Sipas Ligjit Nr. 81, datë 4.5.2017 "Për zonat e mbrojtura", monumentet natyrore i përkasin kategorisë III dhe kanë zonë buffer deri në 200m. (neni 17)
2	Fosilet e Kçirës	
3	Peneplena e Gomsiqes	
4	Guri i Shenjtë	
5	Gështenja e Kokdodit	
6	Bungat e Varrezave në Korthpulë	
7	Mrizi i Ndërlugjeve	
8	Mani i Zi	
9	Hurdha e Tisit	
10	Karsti i Munellës	
11	Akacjet e Migjenit	

Tabela 2.2.4.1: Monumente natyrore të mbrojtura në Bashkinë Pukë (burimi: VKM nr.676, datë 20.12.2002)

¹⁹ H IUCN (International Union for Conservation of Nature and Natural Resources) u themelua në vitin 1948 me qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në mbarë botën. Puna e saj ka të bëjë me regjistrimin dhe hulumtimin, edukimin-trajnimin, mbështetjen këshillimore të qeverive, bizneseve dhe palëve të tjera të interesit dhe vetëdijes mjedisore në nivel global.

B. Sipas Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë Kulturore"²⁰ objektet e trashëgimisë kulturore të mbrojtura klasifikohen në Objekt nën vrotim, Objekt në mbrojtje paraprake, Monument kulture të kategorisë II dhe Monument kulture të kategorisë I. Sipas Nenit 32 të Ligjit, institucioni përgjegjës i shpalljes së një monumenti përcakton zonën mbrojtëse për monumentet kulturore në varësi të vlerës së tyre arkitektonike, estetikën e tyre dhe hapësirën përreth. Nëse nuk përcaktohet një zonë e tillë nga legjislacioni në fuqi ose nuk njoftohet nga ministria kompetente, sipas VKM 671, datë 29.07.2015 (neni 96), vlen gjerësia minimale prej 100m.

Monumentet kulturore të Bashkisë Pukë, me vlera arkitektonike e arkelgjike, përkasin kategorisë së I-rë të mbrojtjes, për të cilën vlejné kushtet dhe kufizimet e nenit 28, në përputhje me tabelën e mëposhtme.

Zonat e mbrojtura të mjedisit natyror dhe kulturor të Bashkisë janë përshkruar në detaje në paragrafët përkatës të këtij Raporti Teknik (Kapitujt 4.2 & 5.9).

Nr.	Emri	Kategoria	Vendimi I shpalljes	Zona e mbrojtur
1	Keshtjella dhe kishat e Kabashit	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës / nr.786/1, dt.05.11.1984	Jo
2	Shkolla muze "Migjeni"	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës / nr.8, dt.18.12.1987	Jo
3	Shpella e Kaurit	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës / nr.786/1, dt.05.11.1984	Jo
4	Varrezat e lashta të Komanit	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror / nr.6, dt.15.01.1963	Jo

Tabela 2.2.4.2: Monumente kulturore në Bashkinë Pukë (burimi: <http://imk.gov.al/Pages/Default.aspx>)

C. Burimet natyrore me rëndësi kombëtare përfshijnë ujin, pyjet dhe rezervat minerare. Ata bashkërendojné dhe bashkëveprojné me pasurinë kulturore, janë kritike për mbijetesën e zonës së studimit, veçanërisht për zonat më pak të favorizuara dhe ato malore dhe janë të ndjeshëm ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike.

Rezervat e mineraleve dhe toka pyjore janë të shumta dhe burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore) janë të pasura dhe zakonisht janë në gjendje të mirë. Është i nevojshëm menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve, përmirësimi i menaxhimit të tyre, sigurimi i rezistencës së tyre dhe kontrollimi i metabolizmit dhe vlerësimi i vazhdueshëm i marrëdhënieve ciklike midis burimeve natyrore dhe popullsisë.

Ç. Të rëndësishme në nivel kombëtar quhet infrastruktura kryesore për prodhimin dhe transmetimin e energjisë, dhe specifikisht HEC-et dhe linjat e tensionit të lartë të energjisë elektrike.

D. PPK mbështet zonat me rëndësi kombëtare, duke sygjëruar zgjerimin e tyre apo shpalljen e të reja. Megjithatë, brenda këtyre zonave ka edhe të ashtu-quajturat "ishuj territorialë", të cilat duhet

²⁰ Ligji 9048, datë 07.04.2003, u ndryshua nga ligje të mëvonshme (Ligji 9592/2006, Ligji 9888/2008, Ligji 77/2013) në lidhje me nene dhe rregullore specifike.

të përjashtohen nga kufizimet e zonave me rëndësi kombëtare pasi nuk ndajnë karakteristika të njëjta. Siç është shpjeguar edhe në kapitullin 2.1.2, Bashkia Pukë parashikohet si qendër terciare dhe Gjegan si qendër lokale e specializuar.

DH. Me rëndësi kombëtare janë të gjitha akset rrugore shtetërore (SH) që përshkojnë Bashkinë.

E. Brenda Bashkisë janë përcaktuar zonat minerare të kërkim - zbulimit dhe shfrytëzimit në përputhje me Programin e Veprimit 3 vjeçar, 2016-2018, për zhvillimin e aktivitetit minerar dhe përcaktimin e zonave minerare të rrezikshme (VKM nr.726, datë 2.9.2015 dhe VKM nr.751, 26.10.2016).

Ë. Si zona me rreziqe natyrore përfshihen:

- zonat e rrezikshme, siç përcaktohen në Programin e Veprimit 3-vjeçar, 2016-2018, për zhvillimin e aktivitetit minerar dhe përcaktimin e zonave minerare të rrezikshme (VKM nr.726, datë 2.9.2015 dhe VKM nr.751, 26.10.2016).
- rreshqitje e dimensioneve të ndryshme, të shkaktuara nga faktorët gjeologjikë me karakter aktiv dhe pasiv, sipas studimit të SHGJSH (2014) "Gjeoresurset dhe Gjeorrezizet në Qarqet e Shqipërisë - Qarku i Shkodrës" (shih analitikisht Kapitulli 4.3.3.3).

2.2.6. Shqyrtimi i standardeve eksistuese kombëtare dhe normativat përkatëse

Standarde dhe normativa

Me VKM Nr. 671, datë 29.7.2015 «Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit» u përcaktuan rregullat/standarde për përmbajtjen, strukturën dhe procedurat e trajnimit, zbatimit dhe monitorimit të zbatimit të planeve territoriale të parashikuara nga Ligji 107/2014. Qëllimi është për të arritur uniformitetin në formën dhe strukturën e planeve territoriale të hartuara.

Në kreun e 2-të të vendimit (KREU II) përcaktohen rregullat për procedurat e planifikimit (shpallja, hartimi, konsultimi publik, koordinimi, miratimi, etj). Gjithashtu janë caktuar për secilin lloj të planit territorial, objektivat, autoriteti kompetent zbatues, përmbajtja (strategjia territoriale, analiza e rrjedhjes metabolike, plani i zhvillimit territorial, rregullore, etj), materiali hartografik etj.

Në Kreun e 3-të (KREU III) shpjegon ndarjen e territorit dhe organizimin e sipërfaqes së tokës së një Njësie Administrative për nevojat e planifikimit. Përcakton pesë sistemet territoriale (Sistemet Territoriale), Sistemi urban (UB), Sistemi natyror (N), Sistemi bujqësor (B) Sistemi ujqor (U) dhe Sistemi infrastrukturor (IN). Vetë territori i bashkisë organizohet në zona (Zona), dmth zonat më të gjera që kanë karakteristika të veçanta ose të ngjashme në drejtim të përdorimit të tokës. Zonat janë të ndara në dy ose më shumë njësi (Njësia), e cila është ndarja territoriale më e vogël. Plani përcakton 14 kategori bazë të përdorimit të tokës.

Në Kreun e 4-rt (KREU IV) përcaktohen Standardet dhe treguesit e planifikimit. Në mënyrë të veçantë, në Seksionin 1 specifikohen standardet dhe treguesit e planifikimit për territorin urban, të cilat duhet të aplikohen në njësitë apo zonat, të cilat kanë qenë ose janë të destinuara për përdorim banimi.

Standardet e planifikimit janë të klasifikuara në bazë të popullsisë së secilës zonë të studimit në tre kategori (deri në 10,000 banorë, më shumë se 10,000 banorë, më shumë se 100,000 banorë). Standardet minimale të planifikimit për zonat e banimit dhe njësitë përcaktohen për treguesit e mëposhtëm të planifikimit (neni 81):

- Sipërfaqen bruto të banimit për banor (ambienti për të jetuar, për argëtim, për gjumë, gatim etj.).
- Hapësirën e gjelbër, sipas kësaj rregulloreje.
- Sipërfaqen për kopshte, çerdhe, shkolla 9-vjeçare, sipas kësaj rregulloreje
- Sipërfaqen për struktura me përdorim publik për aktivitete fetare, sociale, shëndetësore, sanitare, administrative, jo në nivel qyteti
- Sipërfaqen sportive, sipas kësaj rregulloreje
- Sipërfaqen për parkim publik, sipas kësaj rregulloreje
- Sipërfaqen për shërbime tregtare të kufizuara dhe zyra, jo në nivel qyteti. Kjo hapësirë mund të jetë në struktura të veçanta ose në strukturën e banimit.

Qendra të banuara	a) Sipërfaqe bruto banimi	b) Hapësire e gjelbër	c) Kopsht, çerdhe, shkolla	ç) Struktura për përdorim publik	d) Territor sportiv	dh) parkim publik	e) Shërbim tregtar i kufizuar	e) Gjithsej
	m ² /banor	m ² /banor	m ² /banor	m ² /banor	m ² /banor	m ² /banor	m ² /banor	m ² /banor
Deri 10,000 banorë	25	5	4	2	1.6	6	5	48.6
Mbi 10,000 banorë	25	9	4.5	2	1.6	6	5	53.1
Mbi 100,000 banorë	25	9	4.5	2	1.6	6	5	53.1

Tabela 2.2.5.1: Standardet minimale për treguesit në zonat e banuara (burimi: VKM 671, datë 29.7.2015)

Përveç sa parashikohet në nenin 81, identifikohen në nenet 82 deri 86 të dhëna më të hollësishme (vlerat dhe cilësimet për nënparagrafet, rregullore të tjera, shpjegime) për hapësirat e parkimit, arsimit, shëndetësisë, sportit, hapësirave publike dhe e gjelbërimit publik. Shkurtimisht përmendim në vijim:

- Për hapësirat e parkimit (neni 82) përcaktohen standarde plotësuese të tokës (m²/përdorues ose m²/familje ose apartment) për raste të veçanta.
- Në strukturat arsimore (neni 83), përcaktohen norma/standarde veçmas për çerdhe, kopshte, për shkolla fillore dhe 9-vjeçare dhe për shkolla të mesme. Janë përmbledhur shkurtimisht në tabelën e mëposhtme (Tabela 2.2.5.2).
- Për strukturat shëndetësore (neni 83) përcaktohen si vijon (Tabela 2.2.5.3).
- Për struktura sportive (neni 84) përcaktohen si vijon:
 - Stadione dhe pallate sporti me palestër, pishina e të tjera të kësaj natyre ndërtohen në nivel qyteti me standard territori 1.5 m²/banor.
 - Struktura dhe territore në nivel territori urban më të madh se qyteti janë kur popullsia është e

barabartë me ose mbi $\geq 100,000$ banorë $2.6 \text{ m}^2/\text{banor}$ dhe për popullsi $< 100,000$ banorë $3.5 \text{ m}^2/\text{banor}$.

- Për sa i përket gjelbërimit publik në territore urbane (neni 86), janë përmbledhur në tabelën 2.2.5.4.

Nivele arsimit	Madhësia e qëndrueshme (llogaritet për)		Rrezja e shërbimit (m)	Sipërfaqja e fushës/përdorues $\text{m}^2/\text{përdorues}$	Shtrirja e parcelës m^2
	(banorë)	(përdorues)			
çerdhe	1,000	25-30 13-15 (zona rurale)	200-300	25-30	900-1,500
kopshte	1,500		250-350 (zona urbane) 500-600 (zona rurale)	18-25	1,000-1,500
shkolla fillore dhe 9-vjeçare	6,000		500-600 (zona urbane) 1,000-1,500 (zona rurale)	20-25	1,500-7,000
shkolla ë mesme	9,000		1,000-1,500 (zona urbane)	20-30	2,000-7,000
			2,000-4,500 (zona rurale)	25-35 konvikt 100-400 vende	4,000-9,000

Tabela 2.2.5.2: Standardet për strukturat arsimore (burimi: VKM nr.671, datë 29.7.2015)

Nr.	Emërtimi	Sipërfaqja (m^2)	Treguesi "1 njësi/ nr. Banorësh"
1	Qendra shëndetësore	300-400	Një për 250-1,500
2	Ambulanca- Konsultore martenteti	400-6,000	
3	Ambulancë- Konsulore	700-1,000	Një për 1,500-2,000
4	Politeknike	2,000-5,000	
5	Dispanseri	3,000	
6	Drejtoria e Higjenës Epidemiologjike	2,000-3,000	
7	Qendër dezinfektimi, deratizimi	2,000	

Tabela 2.2.5.3: Standardet për strukturat shëndetësore (burimi: VKM nr.671, datë 29.7.2015)

Zonat e gjelbra në nivel territori urban	Standardet minimale
a. gjelbërimi i përgjithshëm publik	
për gjelbërim në nivel njësie, përfshirë kënde lojërash për fëmijë, pavarësisht numrit të popullsisë së njësisë	$2.5 \text{ m}^2/\text{banor}$
për gjelbërim masiv në parqe dhe lulishte brenda aglomeratit	$1 \text{ m}^2/\text{banor}$ në qendra deri në 10,000 banorë
	$4 \text{ m}^2/\text{banor}$ në qendra mbi 10,000 banorë
për gjelbërim në rrugë, shëtitore, sheshe dhe brigje ujore	$1.5 \text{ m}^2/\text{banor}$ në qendra deri në 10,000 banorë
	$2.5 \text{ m}^2/\text{banor}$ në qendra mbi 10,000 banorë
për gjelbërim të zonës së pushimit park periferik.	$8 \text{ m}^2/\text{banor}$ në qendra deri në 10,000 banorë
	$17 \text{ m}^2/\text{banor}$ në qendra mbi 10,000 banorë

b. gjelbërimi publik i kufizuar	1 deri në 2 m ² /banor
c. gjelbërimi i veçantë	Në bazë të manualeve të projektimit, numrit të përdoruesve dhe aktiviteteve që parashikohen të kryhen në një zonë të tillë.

Tabela 2.2.5.4: Standardet për Gjelbërimi publik në territore urbane (burimi: nr. VKM 671, datë 29.7.2015)

	distanca minimale të mbrojtjes	vërejtje
objektet industriale, ato të prodhimit, transmetimit e shpërndarjes së energjisë elektrike	200 m (gjerësia minimale e zonës mbrojtëse sanitare 50 m)	rriten sipas llojit të objektit e teknologjisë së përdorur, si dhe shkallës së ndotjes së zonës industriale gjatë projektimit të saj
landfilleve apo të impianteve të tjera të trajtimit dhe përpunimit të mbetjeve të ngurta në nivel rajonal		sipas legjislacionit të posaçëm dhe dokumenteve të planifikimit dhe zhvillimit për çështje të rëndësishme kombëtare
krematorium	150 m	
fermë më e madhe se 10 njësi gjedhi, për shpendë, gjedhë, kuaj, derra, dhi dhe dhen	500 m	
impiantet mekanike/biologjike dhe lagunat e ajrosura për trajtimin e ujërave të zeza	200 m për kapacitet më pak se 5,000 banorë 1,000m për kapacitet 1,000 – 50,000 banorë	
distancat e mbrojtjes nga ndërtimet		përcaktohen në përputhje me legjislacionin e posaçëm për rastet e : a) burimeve dhe trupave ujorë, përfshirë struktura për furnizimin me ujë të pijshëm b) aeroporteve, aerodromeve dhe fushave të fluturimit c) hekurudhave dhe autostradave ç) strukturave që krijojnë valë akustike dhe elektromagnetike d) strukturave dhe impianteve të rritjes së kafshëve dhe shpendëve në afërsi ose brenda zonave urbane dh) zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore e) zonave të mbrojtura natyrore
parqet eolike të prodhimit të energjisë	distanca minimale e kufirit të parkut nga kufiri i zonës së banuar 500m – 2,000m.	
nga bregu i liqeneve	20 m	ndalohet përdorimi i pesticideve, insekticideve, fungicideve, herbicideve dhe fertilizantëve.
nga bregu i rrjedhave ujore	6 m	
territori i varrezave	300 m. nga zonat e ndërtuara	

Tabela 2.2.5.5: Standardet për distancat e mbrojtjes dhe breza mbrojtës sanitare (burimi: VKM nr.671, datë 29.7.2015)

Kufizime dhe Zonat Buferike

Në Seksionin 2 përcaktohen Standarde dhe Tregues planifikimi sektorial. Për brezat mbrojtës sanitar të një zhvillimi (neni 87), që parashikohen në bazë të secilit veprimtari dhe aktivitet, përcaktohen standardet minimale për mbjellje (fidanë për shtrirje dhe lloji i mbjelljes) dhe

sipërfaqja minimale e mbjelljeve për banorë dhe lloji i mbjelljes. Për Distancat e mbrojtjes dhe brezat mbrojtës sanitare (neni 88) janë të vlefshme ato që janë përshkruar shkurtimisht në tabelën 2.2.5.5, përveç kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni.

Në Seksionin 3 (nenet 89-98) përcaktohen kushtëzimet e detyrueshme sektoriale për: përdorim industrial, zona spitalore, territore natyrore, ujëra dhe ligatina, territore bujqësore, zonat turistike, territoret turistike bregdetare, zona dhe objekte të trashëgimisë kulturore, antenat dhe përdorime të ndryshme. I referohet kondicioneve, kushtet dhe marrëveshjet, gjithmonë me referencë të qartë se hartimi dhe zhvillimi në rastet e mësipërme i nënshtrohet legjislacionit të veçantë. Vijon referimi i standardeve të përfshira në këto nene:

- Territori i zënë për objektet spitalore dhe të shëndetit publik përcaktohet me standardi minimal 1m²/banor. Territori i zonës së spitalëve zihet me ndërtime në masën 15% të tij.
- Në zonat turistike në bregdet dhe liqen, rrugët e reja për qarkullimin tranzit, të klasifikuara sipas Kodit Rrugor në kategoritë “autostradë” dhe “rrugë interurbane”, distanca minimale nga bregu përcaktohet nga legjislacioni për burimet e ujit dhe nuk duhet të jetë më pak se 300m.
- Gjerësia minimale e zonave mbrojtëse rreth monumenteve kulturore caktohet 100 m, nëse nuk përcaktohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi ose nga legjislacioni tjetër ose nga organi përgjegjës për ministrinë e trashëgimisë kulturore
- Distanca minimale e kullave të telekomunikacionit me një lartësi >25m, ndërsa nga prona më e afërt është 30m.

Në lidhje me **zonat e mbrojtura natyrore**, Ligji i fundit nr. 81, datë 04.05.2017 "Për zonat e mbrojtura" përcaktoi tetë lloje zonash të mbrojtura që përkojnë me gjashtë kategori të mbrojtjes duke përfshirë kufizimet dhe, sipas rastit, zonat buffer. Në mënyrë specifike:

- **Kategoria I - Rezervë Strikte Natyrore / Rezervat shkencor**
Bëhet fjalë për zona natyrore me karakteristika të veçanta dhe ekosisteme përfaqësuese dhe / ose specie të florës dhe faunës të cilat kanë pësuar shumë pak ose aspak degradim. Ato ndahen në dy nënkategori: a) nënkategoria A, që është “zona e mbrojtur”, e menaxhuar kryesisht për qëllime shkencore ose “rezervat shkencor”, që ruhet dhe menaxhohet për qëllime shkencore dhe mbrojtjen tërësore të botës së gjallë;
b) nënkategoria B, që është “zonë e mbrojtur”, e menaxhuar kryesisht për mbrojtjen e natyrës së egër ose “rezervë strikte natyrore”, që ruhet e menaxhohet në mënyrë të atillë që të ruajnë gjendjen e tyre natyrore.
- **Kategoria II – Park kombëtar**
Bëhet fjalë për zona të mëdha natyrore (në përgjithësi më të mëdha se 1,000Ha), të rëndësishme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, që ruhen dhe menaxhohen për mbrojtjen e ekosistemeve, llojeve, për edukim dhe rekreacion, që rregullojnë përdorimin e qëndrueshëm nga ana e njeriut të burimeve natyrore. Përcaktohet një kuadër i përgjithshëm i qëllimeve të synuara dhe veprimtarive të lejueshme.
- **Kategoria III – Monument natyror**
Monument natyror” shpallet formacioni natyror (përfshirë edhe elemente të veçanta biologjike) formacioni i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë mineralese ose një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe

estetike. Aplikohet shkallë mbrojtjeje e njëjtë me "Rezervën Strikte" dhe zonë mbrojtëse deri në 200 metra nga perimetri i monumentit.

- **Kategoria IV - Rezervat natyror i menaxhuar / Park natyror.**

“Rezervat natyror i menaxhuar ose park natyror” shpallen territoret, që përfaqësojnë zona me ndërhyrje aktive të njeriut për qëllime menaxhimi të llojeve dhe habitateve, në mënyrë që të garantohet ruajtja e habitateve dhe të plotësohen kërkesat specifike të llojeve me rëndësi rajonale e vendore si dhe zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore. Përcaktohen aktivitetet e ndaluara brenda parqeve natyrore. **Kategoria V - Peizazh i mbrojtur.**

Bëhet fjalë për zona të gjera me një peizazh të harmonishëm, një reliev të veçantë, një shumëllojshmëri të ekosistemeve dhe monumenteve historike, brenda të cilave zhvillohen vendbanime dhe aktivitete të tilla si bujqësia, pylltaria dhe peshkimi. Zbatohet shkalla e mbrojtjes që korrespondon me objektin kryesor të peizazhit.

- **Kategoria V – Peisazh i mbrojtur.**

“Peisazh i mbrojtur” shpallen territoret, që përfaqësojnë peisazhe harmonike me reliev kompleks, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore. Pjesë e tyre mund të jenë edhe qendrat e banimit që zhvillojnë aktivitete, si bujqësia, pemëtaria, pylltaria e peshkimi.

- **Kategoria VI - Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara.**

Bëhet fjalë për zona të gjera, relativisht të izoluara, të pabanuara ose me popullim të paktë, të cilat mbizotërojnë kryesisht nga zonat natyrore. Shkalla e mbrojtjes duhet të përshtatet për:

- a) mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit biologjik dhe të vlerave të tjera të zonës për një kohë të gjatë;
- b) dhënien e kontributit në zhvillimin rajonal dhe kombëtar;
- c) nxitjen e praktikës mbarështuese për qëllime të zhvillimit të qëndrueshëm;
- ç) mbrojtjen e burimeve gjenetike ose sistemeve drufrutore me karakteristika natyrore;
- d) mbrojtjen e burimeve natyrore bazë nga përdorimet për qëllime të tjera të tokës që mund të jenë dëmtoese për diversitetin biologjik të zonës.

- **Kategoria IV – Park natyror bashkiak**

“Park natyror bashkiak” përbëhet nga territore ose zona relativisht të vogla, që janë pronë e bashkive dhe që strehojnë elemente dhe vlera të natyrës së egër, si pyje, kullota, rezervuarë, ligatina, sipërfaqe ujore, detare e bregdetare. Sigurojnë përdorim të qëndrueshëm të territorit dhe zhvillimin e veprimtarive, që i përshtaten karakterit të zonës dhe që lidhen ekskluzivisht me nevojat e komunitetit.

- **Kategoria V – Kurorë e gjelbër.**

“Kurora e gjelbër” përbëhet nga territore ose zona relativisht të vogla, që janë pronë e bashkive dhe plotësojnë masën e gjelbër të qyteteve në zonat periferike urbane. Ssiguron përdorim të qëndrueshëm të territorit dhe zhvillim të veprimtarive, që i përshtaten karakterit të zonës dhe që lidhen ekskluzivisht me nevojat e komunitetit.

Miratimi i kritereve dhe procedurave për shpalljen e dy llojeve të fundit të zonave të mbrojtura dhe përcaktimi i rregullave dhe përgjegjësive në lidhje me administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e tyre, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrisë kompetente.

Për sa i përket **burimeve ujore**, Ligji 111, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" (neni 84), përcakton që nga brigjet e lumenjve, përrrenjve, kanaleve, liqeneve dhe ujëmbledhësve, lagunave dhe detrave lihet:

- një sipërfaqe toke e lirë për përdorim publik, me gjerësi prej 5 deri 100m nga brigjet, sipas përkufizimit të bërë në këtë ligj. Gjerësia mund të zgjerohet më tej, kur kushtet topografike dhe hidrologjike e kërkojnë për arsye të sigurisë së njerëzve dhe pronës. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me akte të Këshillit Kombëtar të Ujit.
- Një sipërfaqe toke e lirë për zhvillimin e veprimtarive që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Ujrave, me gjerësi nga 100 m deri në 200 m.

3. ANALIZA E DOKUMENTEVE TË NJËSISË SË PLANIFIKIMIT TË QEVERISË VENDORE TË MËPARSHME

3.1. Analiza e inventarit të territorit të bashkisë

Vlerësimi i të dhënave të marra nga Bashkia Pukë

Në kuadrin e përgatitjes të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Pukë, Bashkia na ka dhënë një numër elementesh që ndihmojnë në njohjen e zonës së studimit dhe analizën e saj të thelluar.

Këto të dhëna mbulojnë një gamë të gjerë të artikujve dhe janë përdorur në përgatitjen e kapitujve të Fazës së I-rë dhe hartave. Kështu:

- Për sa i përket aktivitetit ekonomik dhe prodhues, janë përdorur sa më shumë që të jetë e mundur të dhënat statistikore të mbledhura nga Bashkia si dhe referencat bibliografike për shifrat financiare. Të dhënat e përdorura gjatë analizës ekonomike të Bashkisë kanë lidhje me numrin dhe llojin e ndërmarrjeve, të dhënat sasiore dhe cilësore për produktet bujqësore vendore, të dhënat për të ardhurat dhe shpenzimet e Bashkisë, investimet, funksionimin ekonomik të Bashkisë, informacion mbi strukturën e Bashkisë (organigrama), etj.
- Për analizën dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese të infrastrukturës teknike dhe rrjeteve, si dhe të rrjeteve të transportit rrugor, janë përdorur të dhënat zyrtare të Bashkisë dhe janë informuar për çdo ndryshim ose shtim nga hulumtimi në terren i kryer në përgatitjen e PPV në bashkëpunim me konsulent dhe qeverisjen lokale.
- Përsa i përket infrastrukturës sociale të Bashkisë, janë shqyrtuar të dhënat e ofruara nga Bashkia -tabelat me ndërtesat shkollore, objektet shëndetësore etj.- në gërshetim me gjetjet e regjistrimit të bërë nga grupi i studimit në vend. Në të njëjtën kohë, u shqyrtua infrastruktura kulturore e Bashkisë në bazë të statistikave, studimeve dhe regjistrimeve që na janë dhënë për të gjithë territorin. U dhanë mjaft të dhëna në aspektin e të dhënave sociale (p.sh. të dhënat për personat me aftësi të kufizuara, për përfitime të asistencës për të papunët, etj).
- Përveç kësaj, u dhanë të dhënat mbi punësimin, arritjet në fushën e arsimit, për popullsinë, familjet, të cilat u vlerësuan dhe u përdorën rast pas rasti në analizën demografike të kryer në kuadrin e PPV.
- Për mjedisin natyror, i cili është një kapitull i rëndësishëm i studimit, na u dhanë të dhëna të ndryshme nga Bashkia lidhur me situatën aktuale dhe problemet e hasura. Këto të dhëna janë marrë nga të dhënat zyrtare të Bashkisë, si dhe planet e menaxhimit të burimeve natyrore në nivel lokal dhe rajonal.
- Përsa i përket aktivitetit turistik, u morën parasysh dhe u vlerësuan studimet lokale dhe rajonale, si dhe të dhënat për njohjen e pikave të interesit turistik edhe në gjendjen aktuale të infrastrukturës turistike.
- Janë dhënë gjithashtu, të dhëna në lidhje me planet territoriale më të vjetra të hartuara në zone dhe në veçanti Plani Operacional i Zhvillimit Vendor.
- Përveç kësaj, janë siguruar të dhëna për pronën komunale të cilat janë shqyrtuar në lidhje me regjistrimin e fushës në mënyrë që hartat përkatëse dhe teksti i studimit të mund të përditësohen siç duhet.

- Së fundmi u dhanë të dhënat nga projektet e ndryshme të zbatuara në Bashki, si dhe programi teknik i Bashkisë ku përmenden projektet e planifikuara. Këto të dhëna janë marrë në konsideratë në këtë fazë të studimit, por do të përdoren në një masë më të madhe në fazat e ardhshme të propozimit.

Të dhënat që u morën nga Bashkia për përgatitjen e fazës A të studimit ishin kryesisht materiale hartografike në formë digjitale dhe analoge, tabela, analiza statistikore dhe raporte teknike që pasqyrojnë gjendjen aktuale të Bashkisë. Çdo konflikt ose pasaktësi që rezultoi nga kombinimi i të dhënave të ndryshme midis tyre, kryesisht në lidhje me rrjetet infrastrukturore dhe infrastrukturat sociale, u vendosën në bashkëpunim me Bashkinë dhe shërbimet e saj.

Vlerësimi i të dhënave të marra nga AKPT

Dosjet që janë shkarkuar nga Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit kanë të bëjnë me të dhëna të ndryshme të nevojshme për përgatitjen e PPV dhe janë kryesisht fotografi vektoriale të nevojshme për të përpiluar hartat përkatëse të studimit të fazës I-rë. Kështu, të dhënat e marra nga AKPT përmbajnë informacion rreth:

- kufijtë, siç janë kufijtë administrativë të Bashkisë, zonat kadastrale, kufijtë e zonave të banuara.
- mjedisi i strukturuar siç janë ndërtesat, sistemi i adresave, zonat industriale
- Infrastruktura, si rrjeti rrugor, linjat e energjisë
- mjedisi natyror, siç janë zonat e mbrojtura, monumentet natyrore, rrjeti hidrografik dhe pellgjet e lumenjve.
- mbulimi tokës në përputhje me Corine
- gjeologjia e zonës.

Këto të dhëna janë përpunuar dhe janë bërë ndërhyrjet e duhura në mënyrë që të mos ketë ndërrime mbivendosëse dhe territoriale. Përveç kësaj, në bashkëpunim me Bashkinë dhe departamentet e ndryshme të saj, të dhënat u përdorën për të plotësuar geodatabazën, duke synuar shpërndarjen e bazës së të dhënave të integruara, cilësore dhe territoriale

Duhet të theksohet se kufiri administrativ përfundimtar i Bashkisë rezulton nga bashkimi i "Kufirit Administrativ Pukë" dhe "Kufirit të Ri Administrativ, Dhjetor 2016". Në të njëjtën kohë në hartë pasqyrohet edhe "Kufi i Pretenduar", i cili është propozimi i Bashkisë për ndarjen administrative të territorit të saj.

Vlerësimi i të dhënave të marra nga Institucione të tjera

Përveç të dhënave të marra nga Bashkia dhe AKPT, në kuadër të PPV për Bashkinë Pukë, Bashkia, në bashkëpunim me konsulentin, ka dërguar kërkesa në departamente të ndryshme për të mbledhur të dhëna të besueshme dhe të azhurnuara.

U dërguan aplikime në 32 Institucione, 12 prej të cilave u përgjigjën deri në përfundimin dhe dorëzimin e fazës së parë "Analiza dhe Vlerësimi i Gjendjes Aktuale të Bashkisë", sipas grafikut të miratuar të studimit. Konkretisht:

- Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) u përgjigj me shkresën me nr. prot. 6484/2 date 23-8-2017 për kategorizimin e rrjetit rrugor duke bashkangjitur një tabelë në të cilin regjistrohet kategorizimi i rrjetit rrugor në Bashkinë Pukë.

- Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare (DRKK) Shkodër, pas një takimi që u realizua në Shkodër, na dha informacion (vendime, karta, fotografi, etj.) për monumentet kulturore të shpallura.
- Instituti i Transportit (IT) ne pergjigje të shkresës nr. prot. 1539/89 datë 8-8-2017 te Bashkise Pukë në lidhje me kategorizimin e rrugëve, elementët e rrezikshëm dhe kufijtë e shpejtësisë na dërgoi pikat e rrezikshme, na dërgoi pikat e rrezikshme, si dhe një hartë ku përshkruhet informacioni i mësipërm.
- Autoriteti i Mediave Audiovizive me shkresën nr. prot. 2660/1 datë 23-8-2017 na dërgoi një tabelë koordinimi për vendndodhjen e antenave televizive. Koordinatat u shfrytëzuan pas përpunimit dhe transformimit të tyre në sistemin e projektimit të Shqipërisë
- Shërbimi i telefonisë ALBTelekom u pergjigj me shkresën nr.1 date 17.08.2017 duke dërguar një skedar autoCAD në rrjetin e telekomunikacionit, i cili është shfrytëzuar në materialin studimor kartografik.
- Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) me shkresën nr. prot. 5983/2 date 31-8-2017 u pergjigj duke dërguar të dhëna për energjinë hidroelektrike që prodhohet ose do të prodhohe brenda kufijve të Bashkisë dhe dërgoi një tabelë me të gjitha hidrocentralet e zonës si dhe një hartë shoqëruese.
- Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP) me shkresën me nr. prot.3181/1datë 23-8-2017 dërgoi zonat kadastrale në një format table, elemente që u kryqezuan dhe u vlerësuan në lidhje me të dhënat përkatëse që morëm nga AKPT në fillim të studimit.
- Ministria e Arsimit dhe Sportit/ Zyra Arsimore Pukë me shkresën me nr. prot. 85/17.08.2017 bashkangjiti të dhëna lidhur me numrin e infrastrukturës arsimore të Bashkisë.
- Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) dhe Shërbimi Gjeologjik Shqipëtar derguan të dhëna për gjeologjinë, resurset gjeologjike, rreziqet gjeologjike dhe mjedisin. Materiali përbëhej nga harta dhe tekste dhe ishte veçanërisht i dobishëm për studimin.
- Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) nuk u pergjigj me shkrim, por na dha informacion mbi pjellorinë e tokës pas një takimi të mbajtur në zyrën e saj në Shkodër.
- ALUIZNI pas një takimi në Shkodër na dha informacion në lidhje me ndërtimet informale.
- Instituti Gjeografisë Ushtarake i Shqipërisë (IGJU) u pergjigj se dispononte harta, por ne i gjykuam se janë mjaft të vjetra dhe në një shkallë që nuk është e volitshme për zonën e studimit.

3.2. Rishikimi i Planeve ekzistuese të Përgjithshme Vendore

Planet e fundit strategjike dhe zhvillimore për Bashkinë Pukë kishin një horizont programatik në periudhën trevjeçare 2011-2014. Për këtë periudhë programimi janë hartuar dhe miratuar nga Këshilli Bashkiak Plani Strategjik për vitet 2011-2014 dhe Plani i Zhvillimit Urban.

Në lidhje me Planin Strategjik për periudhën e programimit 2011-2014, u vendosën 4 objektiva kryesore zhvillimore për sa i përket qeverisjes së duhur të mjedisit urban përmes mbështetjes dhe trajnimit të burimeve njerëzore, hartimit dhe menaxhimit të infrastrukturës së transportit, duke promovuar kështu turizmi malor të Bashkisë, përfundimit të infrastrukturës sociale dhe shërbimit të qytetarëve.

Bashkia Pukë ka hartuar që prej marsit 2016 **Planin Operacional të Zvillimit Vendor** në kuadrin e programit Star 1, me qëllim zhvillimin e integruar të Bashkisë. Nëpërmjet planit operativ kryhet analiza e situatës aktuale të Bashkisë së re siç ajo rezulton nga reforma e re administrative në Shqipëri dhe shënimi i sfidave me të cilat do të përballet si dhe nevojat e saj. Në shtrirje të analizës rezultoi gjithashtu përkufizimi i akteve dhe prioriteteve si dhe i masave e projekteve për secilin aks. Prioritetet e projektit janë pjesë e buxhetit të Bashkisë për vitin 2016. Projektet prioritare të përcaktuara në këtë plan do të kryhen gjatë tri viteve të ardhshme.

Akset kryesore të prioritetit për zhvillimin e Bashkisë kanë të bëjnë me fushat e mëposhtme:

- Menaxhimi i çështjeve të brendshme të Bashkisë që lidhen me zhvillimin e burimeve njerëzore dhe studimet strategjike e zhvillimore.
- Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve në lidhje me veprimet dhe programet e Bashkisë, duke siguruar kështu transparencën dhe menaxhimin meritokratik të burimeve të investimeve.
- Promovimi i të drejtave dhe barazisë së grave, duke synuar pjesëmarrjen e tyre aktive në jetën shoqërore dhe politike të qytetit.
- Zhvillimi i aktivitetit turistik, sidomos i turizmit malor dhe kulturor, duke përdorur burimet natyrore dhe peizazhet e bukuri së bashkë me zonën.
- Forcimi i aktivitetit rural nëpërmjet promovimit të produkteve vendase dhe organizimit të procesit të prodhimit të tyre.

Tre projektet kryesore prioritare për 3 vitet e ardhshme në Bashkinë Pukë përfshijnë restaurimin e fasadave të ndërtesave dhe përmirësimin e rrjetit të kanalizimit në selinë e Bashkisë, projektet e përmirësimit dhe ripërdorimit të liqenit artificial që ndodhet në hyrje të qytetit dhe ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për vendbanimin Luf të Njësisë Administrative Luf-Qerret.

Në nëntor të 2016 u krye studimi “**Vlerësimi i Shpejtë i Zhvillimit të Zinxhirit të Vlerës së Turizmit në Zonën e Pukës**”, nga Shoqata Agropuka në bashkëpunim me Fondacionin e Partneritetit të Zhvillimit dhe We- Effect dhe përfshin Bashkinë Pukë dhe Bashkinë Fushë Arrëz. Objektivi i kryerjes së këtij studimi është të analizojë situatën aktuale në aspektin e veprimitarisë turistike në zonë dhe identifikimin e problemeve dhe avantazhet krahasuese për të zhvilluar këtë sektor. Ky program është strukturuar në pesë kapituj dhe janë vendosur shtatë akse prioritari në bazë të së cilave janë propozuar dhe ndërhyrjet afatgjata, afatmesme dhe afatshkurtra për turizmin. Shtatë akset e prioritetit të studimit përmenden shkurtimisht më poshtë:

- Informimi dhe sensibilizimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore të përfshira në sektorin e turizmit me qëllim që të arrihet shfrytëzimi i plotë i avantazheve krahasuese për zhvillimin e aktivitetit turistik.
- Promovimi i zonave turistike dhe produkteve lokale dhe përfundimi i identitetit turistik të zonës.

- Përforcimi i identitetit të produkteve lokale.
- Trajnimi i burimeve njerëzore.
- Përmirësimi i qeverisjes lokale dhe bashkëpunimit në sektorin e turizmit.
- Përmirësimi i infrastrukturave dhe shërbimeve.
- Rritja e bashkëpunimit me organet e tjera vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të forcimit dhe promovimit të Bashkisë.

Nga analiza SWOT e studimit kanë rezultuar pikat e forta dhe mundësitë për zhvillimin e aktivitetit turistik, si dhe dobësitë dhe kërcënimet që mund të hasë ky sektor. Më poshtë është tabela SWOT siç rezulton nga analiza e studimit.

<p>PIKAT E FORTA</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pasuri e mjedisit natyror dhe vëndeve të atraksionit për turistike. • Lehtësi hyrjeje në zonë përmes rrugëve Shkodër – Vau i Dejës – Pukë dhe Tropojë – Fierzë – Fushë-Arrëz. • Cilësi disi e mirë e rrugëve kryesore: nga Vau i Dejës – Pukë – Fushë-Arrëz – Fierzë; dhe nga rruga Kryezi – lballë që sjellin hapjen e destinacioneve të reja për turistët. 	<p>PIKAT E DOBËTA</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mungesë e vizionit strategjik, drejtim, bashkëpunimin dhe kordinimin. • Numër i kufizuar dhe i pazhvilluar produkteve turistike (itinerare, paketa turistike). • Informacion dhe promovim i pamjaftueshëm i burimeve turistike dhe aktiviteteve aventureske të Pukës, veçanërisht online. • Infstrukturë e dobët dhe cilësi shërbimesh e dobët, sidomos në zonat rurale
<p>MUNDESITË</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rritje e numrit të turistëve aventuresk të interesuar për zonat malore të Shqipërisë. • Disa itinerare ekzistuese, edhe pse të reja, tregojnë atraksion dhe potencial për promovim e Pukës si destinacion turistik malore. • Afërsi me Shkodrën dhe liqenin e Komanit. • Sinergji potenciale për tu zhvilluar me itineratet dhe vendet turistike të zonave fqinje. 	<p>KERCENIMET</p> <ul style="list-style-type: none"> • Turistët që kalojnë në autostradën Rubik-Kukës dhe anashkalojnë zonën e Pukës. • Turistët që udhëtojnë me tragetin e Komanit dhe anashkalojnë zonën e Pukës. • Gatishmëri e lartë e të rinjve për tu larguar nga zona, duke reduktuar forcën e punës në turizëm. • Konkurrencë e lartë nga zonat malore fqinje si Thethi, Vermoshi and Valbona.

Tabela 3.1.1 SWOT për zinxhirin e vlerës së turizmit (burimi: Vlerësimi i Shpejtë i Zhvillimit të Zinxhirit të Vlerës të Turizmit në Zonën e Pukës)

Së fundmi, ky studim përfundon me disa propozime me objektiva afatshkurtra dhe afatmesme. 7 propozimet kanë të bëjnë me sa më poshtë:

1. Informimi dhe sensibilizimi i shoqërisë me realizimin e tyre përmes veprimeve afatshkurtra, siç është regjistrimi i burimeve turistike për shfrytëzimin e tyre dhe pjesëmarrja e shoqërisë lokale në njohjen e tyre. Objektivat afatmesme kanë të bëjnë me vlerësimin e zonave turistike dhe përgatitjen e një studimi që synon përmirësimin dhe evidentimin e tyre.
2. Informimi turistik, promovimi dhe marketingu. Qëllimet afatshkurtra kanë të bëjnë me trajnimin profesional të subjekteve të përfshira, në krijimin dhe promovimin e faqes së internetit për promovimin e turizmit të zonës dhe në marketingun e duhur si të destinacioneve ashtu edhe të produkteve lokale. Objektivat afatmesme kanë të bëjnë me

- trajnimin e punëtorëve në sektorin e turizmit për të përforcuar produktet vendore dhe paketat turistike.
3. Përmirësimi i prodhimeve lokale. Objektivat afatshkurtra kanë të bëjnë me informimin dhe trajnimin e grupeve të interesit mbi ciklin e jetës së produkteve dhe krijimin e paketave turistike të bazuar në agroturizëm. Objektivat afatmesme kanë të bëjnë me përmirësimin e produkteve lokale dhe vlerësimin e cilësisë së tyre, sinjalizimin e atraksioneve turistike dhe përmirësimin e shërbimeve të përfshira në zhvillimin e aktivitetit turistik.
 4. Burimet njerëzore. Objektivat afatshkurtra kanë të bëjnë me shfrytëzimin e programeve të trajnimit për punonjësit në sektorin e turizmit dhe vlerësimin e burimeve të turizmit që do t'u jepet përparësi zhvillimi. Objektivat afatmesme kanë të bëjnë me forcimin e shërbimeve në lidhje me trajnimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin e programeve që synojnë trajnimin e burimeve njerëzore që punojnë në bizneset e sektorit të turizmit.
 5. Qeverisja dhe bashkëpunimi. Objektivat afatshkurtra kanë të bëjnë me zhvillimin e strukturave për menaxhimin e destinacioneve turistike në mënyrë që të krijohet mjedisi i përshtatshëm për zhvillimin e turizmit. Objektivat afatmesme kanë të bëjnë me hartimin e një plani veprimi për zhvillimin turistik.
 6. Infrastrukturat dhe shërbimet. Objektivat afatmesme kanë të bëjnë me përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së turizmit duke filluar nga infrastruktura ekzistuese e turizmit. Objektivat afatgjata kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës së transportit të lidhur me destinacionet turistike, përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore dhe evidentimin e monumenteve natyrore dhe kulturore që mbeten të paeksploruara.
 7. Lidhja me sektorë të tjerë. Objektivat afatmesme kanë të bëjnë me zhvillimin e tregtisë për promovimin e produkteve të turizmit. Mbështetja e prodhuesve lokalë për të përmirësuar cilësinë e produkteve dhe respektimin e rregullave të higjienës në prodhim dhe standardizim, si dhe krijimin e një rrjeti turesh në nivel kombëtar.

Kjo strategji miratohet nga Bashkia dhe prandaj do të merret parasysh nga PPV në formulimin e objektivave strategjike dhe specifike dhe planin e veprimit në fazat e ardhshme.

“Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Pukë”, hartuar me 2008, është pjesë e Programit për Decentralizimin dhe Zhvillimin Vendor në rajon. Ky plan zhvillimi thekson krijimin e policentrik Shkodër-Lezhë për të parandaluar lëvizjen në vazhdim të popullësisë, si dhe zhvillimin e turizmit i cili duhet të marrë përkrahjen e duhur. Për këtë, synohet gjetja e financimeve për hartimin dhe zbatimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturave ekzistuese, shërbimeve publike, dhe rivitalizimit të ekonomisë vendase. Duke qenë se Bashkia Pukë zotëron vende me potenciale të mëdha natyrore, biznesi vendas ndjen nevojën e mbështetjes ekonomike, me qëllim nxitjen e zhvillimit të turizmit familjar e malor, përmirësimin e kapaciteteve turistike si dhe marrjen e masave përkatëse për mbrojtjen e turizmit. Të rindësishëm shikohen gjithashtu edhe zhvillimi i sektorëve si pylltaria, industria e drurit dhe aktiviteteve që nxjerrin në pah traditat e zonës. Krijimi i një klime të përshtatshme për investimet vendase dhe të huaja, do ti jepte një shtysë të madhe ekonomisë vendase. Rritja e cilësisë së shërbimeve dhe infrastrukturës, duhet të shoqërohet me kapacitete më të mira administruese dhe nivel më të lartë të të ardhurave vendore.



Figura 3.1.1: Plani Strategjik (burimi: Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Pukë, 2008)

Ky plan nuk është miratuar, nuk është zbatuar dhe as nuk është marrë parasysh në hartimin e planifikimit nga vetë Bashkia. Megjithatë, vihet re se disa nga parashikimet e Planit përkojnë me zgjedhjet kryesore dhe prioritetet e qytetit, si: kosolidimi dhe rikualifikimi i qytetit dhe krijimi i kurorë së gjelbër të qytetit.

4. ANALIZA E ELEMENTEVE TË MJEDISIT – NIVELET E NDOTJES – ZONAT E MBROJTURA

4.1. Elementet e Mjedisit

4.1.1. Burimet ujore

4.1.1.1. Resurset ujorë sipërfaqësorë

Në rrjetin hidrografik të qarkut bëjnë pjesë lumi Drin.

Lumi Drin

Si formues i këtij baseni është më i madhi, në tërë bregdetin Adriatik të Gadishullit Ballkanik, për sa i përket sipërfaqes së pellgut ujëmbledhës ashtu edhe shkallës së ujëshmërisë. Pellgu ujëmbledhës i Drinit ndodhet në pjesën Veriore e Lindore të vendit. Sipërfaqja e përgjithëshme e tij është 14173 km², prej të cilave 5973 km² shtrihet Brenda territorit të Shqipërisë, ndërsa pjesa tjetër ndodhet në Kosovë, FYROM e Greqi. Por në basenin e Drinit bëjnë pjesë tërësia e Liqenit të Shkodrës, lumi Drin dhe lumi Buna që formojnë një sistem të vetëm hidrografik, që grumbullon ujrën e një pellgu me një sipërfaqe të përgjithëshme prej 19.582 km².

14,173 km² i përket lumit Drin dhe 5,187 km² lumit Buna. Drini formohet nga dy degë kryesore: Drini i Zi, me një sipërfaqe prej 5,885 km², i cili rrjedh nga FYROM dhe Drini i Bardhë, që rrjedh nga Kosova.

Drini i Zi rrjedh nga Liqeni i Ohrit në Strugë dhe kalon nëpër FYROM dhe Shqipërisë. Drini i Bardhë vjen nga Mali i Tljev, në veri të qytetit të Pejës në rajonin e Dukagjinit të Kosovës dhe shkon përmes Shqipërisë. Pjesa kosovare e lumit të Drinit të Bardhë përbëhet nga 4,360 km². Në këtë rajon ujërat e lumit përdoren për ujësjellësin e qyteteve të mëdha aty pranë, për ujë dhe prodhim të energjisë elektrike (sidomos në degët e tij të drejta). Në vendkalimin kufitar Vrbnica-Shalqin, lumi futet në rajonin lindor Shqiptar të Trektanit. Pjesa shqiptare e lumit është 19 km i gjatë me zonë kullimi prej 604 km². Në këtë rajon të lumit nuk ka vendbanime dhe nga ana e majtë bashkohet dhe merr lumin Lumë. Së fundmi, Drini i Bardhë arrin në qytetin e Kukësit, ku edhe bashkohet me lumin e Drinit të Zi dhe së bashku formojnë lumin e Drinit. I matur qysh atje deri në fund të tij në detin Adriatik, Drini është i gjatë 160 km. Por, i matur nga burimi i Drinit të Bardhë, gjatësia e tij është 335 km, duke e bërë lumin më të gjatë që kalon nëpër Shqipëri.

Lumi Drin për periudhën 1951-1985 kishte një mesatare vjetore rrjedhjeje prej 680m³/s, prej të cilave 360m³/s vinin nga vetë lumi i Drinit dhe 320m³/s nga lumi Buna. Shkarkimi specifik rezultues ishte rreth 35l/s.km² dhe koeficienti i rrjedhjes 0.74. Këto vlera të larta janë kryesisht për shkak të sasisë shumë të lartë të ujërave të lumit të Bunës, të cilat nuk mund të shfrytëzohet shumë - përveç lundrimit. Duke pasur parasysh përdorimin e ujit në Shqipëri, lumi më i rëndësishëm është ai i Drinit, me karakteristikat e mëposhtme:

- vëllimi vjetor i shkarkimit: 11,1 km³
- shkarkimi specifik: 24.8l/s.km²

- raporti muaj më i keq (dhjetor) deri në muajin më të thatë (gusht): 5.7
- rrjedhja më e madhe në 10 vjet : rreth 13 herë nga moduli i lumit
- kapaciteti i mbledhjes në rezervuarin e Fierzës: 2.700 milion m³ (rreth 25% e rrjedhës vjetore).

Analizat kimike të mostrave të marra nga ujërat e lumit të Drinit treguan një ujë me cilësi të mirë, me përbërje të qëndrueshme minerale përgjatë rrjedhës së tij. Jonet metalike janë të pranishme në sasi të vogla, përveç në disa raste të prezencës së hekurit. Duket se, në lidhje me cilësinë e ujit të Drinit, asnjë kufizim nuk mund të ketë për përdorimet e tanishme (hidrocentralet, ujitje).

Bashkia e Pukës nuk përdor ujërat sipërfaqësore të lumit Drin dhe rrjedhat më të vogla të tij për ujitje ose furnizim me ujë. Përdorim i paketë i ujit sipërfaqësor bëhet vetëm në sektorin e energjisë.

4.1.1.2. Resurset dinamike të ujërave nëntokësore dhe shfrytëzimi i tyre

Ujrat nëntokësore kanë një rëndësi të madhe për të qenë burimi i vetëm i furnizimit me ujë të pijshëm.

Sipas kushteve lokale, ujërat nëntokësore shfrytëzohen përmes puseve, kryesisht në rrafshinat dhe luginat, ose përmes burimeve, më shpesh në zonat kodrinore dhe ato malore. Prezenca dhe përdorimi i tyre janë mjaft të zakonshme në të gjithë vendin. Siç ndodh shpesh, dhe veçanërisht kur zonat e mëdha karstike ndikojnë në lëvizjen e ujërave nëntokësore, pellgjet lumore nuk përkojnë me njësitë e ujërave nëntokësore.

Pjesa më e madhe e ujërave nëntokësore në pellgun e Drinit merren nga burimet, 65 prej të cilave kanë një shkarkesë ujore mbi 100 l/s, kryesisht në rrethin e Malësisë së Madhe, Tropojë, Kukës, Dibër dhe Bulqizë. Cilësia e këtyre burimeve në përgjithësi është e mirë, ato japin një sasi mjaft të qëndrueshme të ujit me fortësi të ulët (në shumicën e rasteve 5 deri në 8 gradë gjermane).

Në Bashkinë Pukë resurset ujore nëntokësore janë të lidhur me akuiferë të disa llojeve.²¹

Në Akuifer me porozitet çarjes - karst, drenojnë edhe 5 burime, njëri prej të cilëve në fshatin Mushtë ka prurje relativisht të lartë, rreth 150 l/s. 4 burime të tjerë kanë prurje më të ulta që luhaten nga 0.4 l/s deri në 4 l/s.

Ujërat nëntokësorë që mbushen nga ky akuifer janë rreth 163 l/s.

Në *akuifer me porozitet çarjesh* takohen mjaft burime të cilët kanë prurje mbi 0.1 l/sek. Prurjet e tyre më të zakonshme luhaten nga 0.2 l/sek deri në 1 l/sek. Burimet me prurje më të madhe drenojnë kryesisht në pjesën veriperëndimore të rajonit, në zonën e fshatrave Qelzë, Tmug e Sapaç, Disa nga burimet me prurje më të larta që drenojnë në akuifer janë: Dy burimet që derdhen në afërsi të majës së Krrabit, me prurjet respektivisht 25 l/sek dhe rreth 9 l/sek; burimi në fshatin Raç (përroi i Sapaçit) me prurje 8 l/sek; burimi në fshatin Boidan i Epërm me prurje 5 l/sek; burimi në fshatin Qelzë me prurje 5 l/sek. Në akuiferin e Krrabit drenojnë edhe mjaft burime ujore që kanë prurje nga 0.5 – 3 l/sek deri në 5 l/sek. Karakteristikë e tyre është drenimi sipërfaqësor në front të gjerë, ose sipërfaqe e madhe në formën e burimeve të vegjël që mbledhen pastaj në një kolektor të

²¹ Shërbimi Gjeologjik të Shqipërisë, 2016 “Gjeologjia - Gjeoresurset - Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë”

përbashkët. Në pjesën verilindore dhe lindore e akuiferit burimet kanë pruje më të ulta. Prurjet e tyre në këtë zonë luhaten nga 0.1 l/sek deri në 0.3 l/sek.

Pasuritë ujore për në akuiferët me porozite çarjesh në bashki vlerësohen rreth 153 l/s.

4.1.2. Resurset natyrore

Në burimet natyrore përfshihen burimet minerale (metalike dhe mineralet jo metalike dhe gurë) dhe burimet energjetike (të rinovueshme dhe jo-rinovueshme).

4.1.2.1. Burimet minerale

Struktura gjeologjike e Bashkisë disponon pasuri minerare, megjithatë, sasia nuk mund të llogaritet gjithmonë.

Sipas studimit "Gjeoresurset dhe Gjeorrezizet ne Qarqet e Shqipërisë" për rajonin e Shkodrës dhe hartës Gjeologjike të Prefekturës Shkodër, shkalla 1:100,000 e Institutit Gjeologjik Shqiptar, në bashkinë e Pukës gjenden tre grupe burimesh minerare.

- Mirerale metalike (Krom, bakër, zhiva, hekur, titan)
- Minerale industriale jo metalike (Asbest, Gurë dekorativë, Gelqerorë, Granit, Kaolinë, Xham vulkanik, Argjilë, Bazalte, Dausonite, Magnezite)
- Burime minerare energjetike (Qymyr)

4.1.2.2. Burimet e tokës

Toka si burim natyror është veçanërisht e rëndësishme pasi përbën bazën e zhvillimit të veprimtaive njerëzore dhe të rruajtjes të jetës. Mbi të ndërtohen infrastrukturat, zhvillohen pyje dhe toka bujqësore. Duke përfshirë zhvillimin e infrastrukturës, në këtë pjesë të studimit, toka studiohet si një burim natyror për zhvillimin e sipërfaqeve pyjore dhe tokave të kultivuara.

Tokat Pyjore

Pyjet si një burim natyror kanë vlerë të madhe ekonomike pasi përmirësojnë mikroklimën, pastrojnë atmosferën, strehojnë shumë lloje faunash, mbrojnë nga erozioni i tokës si dhe kanë vlerë tregtare. Në produktet pyjore përfshihet kryesisht prodhimi i drurit për përdorim në sektorin e ndërtimit dhe në sektorin e energjisë (për ngrohje).

4.1.2.3. Burimet e ripërtërishme të energjisë

Në Bashki ka pak shfrytëzim të energjisë hidrodinamike. Energjia mekanike e ujit është e shfrytëzueshme në hidrocentralin e vogël që gjendet në rajonin Gjegjan. Ky objekt përbëhet nga një njësi hidroelektrike që merr ujë nga zona e Malit të Syqelës përmes tubacioneve të mëdha. Një tjetër njësi hidroelektrike ndodhet në përroin e S.Vaneshih, në veri të vendbanimit të Kabashit.

Një digë e vogël hidroelektrike ndodhet në veri të fshatit Rras në lumin e Fanit i Madh.

Instalime të tjera hidroelektrike priten të ndërtohen në zonën jugore të vendbanimit Breg, në kryqëzimin e prr. S.Madh me lumin Fani i Madh dhe zonën e vendbanimit Vrith.

4.1.3. Biodiversiteti

Që nga viti 2000, Shqipëria ka bërë përparim në mbrojtjen e biodiversitetit, të të gjitha ekosistemeve dhe specieve biologjike të gjetura në zonë, përmes zhvillimit dhe zbatimit të një kuadri institucional dhe legjislativ. Konkretisht, Shqipëria, për të përmbushur detyrimet sipas nenit 6 të Konventës Ndërkombëtare për Diversitetin Biologjik dhe për të arritur objektivat (e njohura si objektivat e Aichit) e Planit Strategjik për Biodiversitetin deri në vitin 2020 të miratuar në Konferencën e fundit të Palëve të Konventës për Diversitetin Biologjik (COP 10, Nagoya Japoni, 2010), hartoi një Plan Veprimi Strategjik me këto objektiva kyç²²:

- Përfundimi i kuadrit ligjor kombëtar mbi natyrën dhe biodiversitetin.
- Shtrirja e zonave të mbrojtura në Shqipëri, me rritjen e sipërfaqes së tyre në 17% të sipërfaqes së zonave kontinentale të ndjeshme dhe 6% të zonave bregdetare dhe detare.
- Hartimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit të Zonave të Mbrojtura.
- Mbrojtja dhe ruajtja e habitateve
- Inventarizimi dhe monitorimi i vegjetacionit barishtor
- Promovimi dhe ringjallja e rigjenerimit natyror të tokave pyjore autoktone.
- Vlerësimi i burimeve gjenetike për të identifikuar llojet kryesore të pyjeve dhe për të ruajtur diversitetin
- Vlerësimi i vegjetacionit të kërcënuar që gjendet në habitate shkëmbore
- Ruajtja e habitateve detare, lumore dhe liqenore dhe specieve të peshkut të vendit
- Monitorimi i zonave të mbrojtura të rëndësishme
- Inventarizimi dhe monitorimi i llojeve të rrezikuara të faunës
- Krijimi i një baze të dhënash elektronike për regjistrimin e faunës
- Monitorimi i të gjitha llojeve të peshqve dhe regjistrimi i specieve më të rëndësishme të gjetura në zonat detare, lumore dhe liqenore në studim
- Monitorimi i zonave natyrore të prekura nga hidrocentralet
- Plani i Veprimit për Speciet e faunës së egër
- Planet e veprimit për ruajtjen dhe mbrojtjen e peshkut
- Kryerja e studimeve dhe anketimeve për të identifikuar speciet për të cilat të dhënat janë jo të plota
- Kryerja e studimeve dhe hulumtimeve për të kuptuar strukturën e organizmave të lumenjve dhe liqeneve
- Edukimi i qytetarëve dhe publikimi e rëndësisë së çështjes
- Hulumtime për të rritur ndërgjegjësimin publik për biodiversitetin
- Përgatitja e aktorëve të përfshirë në projekte dhe programe

²² Dokumenti Strategjik për Mbrojtjen e Biodiversitetit, 2015

- Zbatimi i ligjeve

Bashkia Pukë, e cila ka një sipërfaqe mjaft të gjerë pyjore, me florë dhe faunë të pasur. Bimësia pyjore në malet e Bashkisë është e pasur dhe e larmishme me rreth 160 specie me pemë; ku më të përhapurat janë shkurret Mesdhetare, dushk, ah, pisha e zeza, bredhi i bardhë, shkoza, etj.

Përsa i përket florës, janë bërë përpjekje për të listuar bimët mjekësore të Bashkisë që nga viti 1980, atëherë u regjistruan në nivel vendi 19 lloje. Më vonë, në vitin 1988, u bë regjistrimi i bimeve mjekësore nga një grup pune i specialiteteve të ndryshme. Nga ky studim janë identifikuar 210 lloje bimësh në të gjithë vendin, nga të cilat 17 lloje janë identifikuar në nivel rajonal dhe janë si në vijim: bliri, arra, boronica, gështenja, akacja, dellinja e kuqe, shqema, lajithia, shtogu, murrizi, lisra, melisa, rigoni, hithra, lulebalsami (lulegjaku), mullaga dhe trumeza.

Sa i përket hulumtimit gjeo-botanik të bimëve që mbulojnë Bashkinë (përgatitur në vitin 2002), janë regjistruar 187 lloje bimësh medicinale dhe aromatike. Sasia dhe natyra e tyre është një proces dinamik që pëson ndryshime gjatë viteve nga shkaqe të ndryshme, si djegia, prerja e vegjetacionit, tharja e sipërfaqes së tokës, erozioni i tokës, kullotja etj. Pra, është i nevojshëm që inventari i territorit të bëhet çdo tetë deri në dhjetë vjet. Në zonën e studimit, vlen të përmendet eko-sistemi i tokës bujqësore (Ekosistemi i tokave të kultivuara bujqësore), i cili është veçanërisht i pasur. Takohen përafërsisht 60 bimë medicinale dhe fruta pyjore. Ky ekosistem është i vendosur kryesisht pranë rrjedhave. Gjenden zakonisht manaferra (*Rubus fruticosus*), thana (*Cornus mas*), gështenja (*Castanea sativa*), arra (*Juglans regia*), karraota e eger (*D. carraota*), shëlgjet (*Salix spp*), cikoria (*C. intybus*), shtogu (*Sabruscus nigra*), bari i bletës (*Melissa officinalis*), menta (*Metha spp*).



Figura 4.3.1.1: Arra/ Juglan regia (burimi: Gjendja e bimëve mjekësore – tanifere dhe frutave të pyllit në territorin e Bashkisë Pukë




Figura 4.3.1.2: Dëllinja e kuqe/ Juniperus oxycedrus (burimi: Gjendja e bimëve mjekësore – tanifere dhe frutave të pyllit në territorin e Bashkisë Pukë



Figura 4.3.1.3: Lulegjaku/ *Hypericum perforatum* (burimi: Gjendja e bimëve mjekësore – tanifere dhe frutave të pyllit në territorin e bashkisë Pukë

Figura 4.3.1.4: Bari i bletës/ *Melisa officinalis* (burimi: Gjendja e bimëve mjekësore – tanifere dhe frutave të pyllit në territorin e bashkisë Pukë

Ekosistemet kontinentale në zonën e studimit klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Zona bimore e ahut. Ndodhet në një lartësi prej 900-1700 m dhe speciet e saj janë pisha e zezë, ahu dhe bredhi.
- Zona bimore e dusheve. Ndodhet midis zonës së makjes dhe zonës bimore me çaj, në një lartësi prej 230 deri 900 m mbi nivelin e detit. Është e ndarë në zona të veçanta dhe përfshin zonën e dushqeve (*Q.sessiliflora*, *Quecus* sp), qarrit të bardhë (*Q.cerris* L), frashërit (*F.ornus*), ulzës (*A.tartaricum*), dëllinjës së kuqe (*J.Oxycedrus*), boshtres (*Forsyca europea* L), shqemës dhe cermedellit (*Rus coriaria* L e *R continus*) etj.
- Zona bimore e makjes. Ka një sipërfaqe të kufizuar dhe përfshin ekosistemin e lisit (Tokat e ekosistemit të maresë - *Arbutum unedum*) dhe ekosistemet e tokës (Tokat e ekosistemit të shqopës - *Erica arborea*). Takohen lloje si e kuqe, frashëri, trumëza, lisra, dhe fishkarta, në tokat kënetore takohen gjithashtu: shega (*Punica granitum*), lisra, trumëza, gjëmbori, rushkulli (*Ruscus aculatus*), (*F.vulgaris*), rrushqyqja (*Idum acer*), (*Inila viscaria*), mënishtja, (*Citrus villosus*), fishkarta, fiku (*F.carica*) etj.
- Tokat e punuara.

Pyjet e Bashkisë së Pukës kanë një faunë të pasur. Kështu takohen disa lloje kafshesh të egra si: ujku, dhelpra gri dhe e kuqe, lepuri, borxh, derri i egër, mace e egër, ariu i murrmë, dreri, lepuri, iriqi dhe shumë zogj si shqiponja, frëngji, pëllumbat e egër. Në malin e Munellës gjendet më shpesh rrëqebulli (*Lynx*), por gjithashtu takohen edhe gjitarë të tjerë, amfibë dhe zvarranikë. Gjithashtu vlen të përmendet se shpatet e Malit të Munellës janë një nga zonat e pakta ku riprodhohet urithi.



Figura4.3.1.5:Rrëqebulli i Ballkanit (*Lynx lynx balcanicus*) (burimi: Çelsi Turistik Pukë)

Figura4.3.1.6: Kaprolli (*Capreolus capreolus*) (burimi: Çelsi Turistik Pukë)



Figura4.3.1.17: Ariu i Murrmë (*Ursus arctos*) (burimi: Çelsi Turistik Pukë)

Figura 4.3.1.8: Macja e egër (*Felis silvestris*) (burimi: Çelsi Turistik Pukë)

4.2. Zonat e mbrojtura natyrore

Në bazë të VKM nr.676, datë 20.12.2002, një sërë elementësh të mjedisit natyror u deklaruan të mbrojtura në të gjithë Shqipërinë. Brenda kufijve të Bashkisë Pukë përfshihen:

Nr.	Emërtimi	Monitorimi i situatës aktuale	Masat që propozohen
1	Shpella e Kaurit	shumë mirë	Mirëmbajtje
2	Fosilet e Kçirës	mirë	Mirëmbajtje
3	Penepena e Gomsiqes	mirë	Mirëmbajtje

4	Guri i Shenjtë	shumë mirë	Mirëmbajtje
5	Gështenjat e Kokdodit	mirë	Mirëmbajtje
6	Bungat e varrezave ne Korthpule	mire pjeserisht	Mirëmbajtje e Sistemit
7	Mrizi i Ndërlugjeve	mirë	Mirëmbajtje e Sistemit
8	Mani i Zi	mire pjeserisht	Mirëmbajtje
9	Hurdha e Tisit	mirë	Mirëmbajtje
10	Karsti i Munellës	mirë	Mirëmbajtje
11	Akacjet e Migjenit	mirë	Mirëmbajtje e Sistemit

Tabela 4.2.1: Monumente natyrore brenda Bashkisë Pukë (burimi VKM 676/20-12-2002, AdZM Shkodër)

Më poshtë, trajtojmë një përshkrim më të detajuar të këtyre zonave të mbrojtura, bazuar në të dhënat e mbledhura nga AKZM²³:

Shpella e Kaurit

Eshtë një shpellë që i përket zonës Qelëz, të Bashkisë Pukë. Shpella ndodhet pranë fshatit Lëvrushk, në malin Kollata. Besohet të jetë një kasolle për heremitët. Ka të ngjarë të jetë përdorur nga ushtria si një pikë vëzhgimi.



Figura 4.2.1: Shpella e Kaurit (burimi: http://www.akzm.gov.al/apps/akzm_cd/Shkoder/Sh_Mon/SH75.htm)

Fosilet e Kçirës

Është një zonë me përqëndrim fosilesh. Ajo është e vendosur në fshatin Kçiraj, 600 metra mbi nivelin e detit. Dallohen disa lloje të njohura të fosileve të tilla si: *Sagaceras albanicum*, *Pronorites osmanicus*, *Procarnites skanderbegis* dhe të tjera. Ka një interes të veçantë në fushat e gjeologjisë dhe gjeografisë. Ky përqëndrim i fosileve mbulon një sipërfaqe prej 4500 m². Për të vizituar këtë monument, duhet të ndjekësh rrugën automobilistike Shkodër-Pukë dhe të vazhdosh në kryqëzimin e vendbanimit Kçiraj.

Peneplena e Gomsiqes

²³ Burimi: http://www.akzm.gov.al/apps/akzm_cd/Mon_Hyrje/List_Mon.htm

Bëhet fjalë një pllajë pranë Gomsiqes, 800 metra mbi nivelin e detit. Pllaja u krijua mijëra vjet më parë për shkak të erozionit dhe lëvizjes së pllakave tektonike. Është një monument i rëndësishëm natyror, pasi ka një vlerë të lartë shkencore, ekologjike dhe kulturore. Qasja bëhet nëpërmjet rrugës automobilistike Shkodër – Pukë.



Figura 4.2.2: Peneplena e Gomsiqes (burimi: http://www.akzm.gov.al/apps/akzm_cd/Shkoder/Sh_Mon/SH77.htm).

Guri i Shenjtë

Ndodhet pranë fshatit Zezaj, në lindje të Pukës, në 538 metra mbi nivelin e detit. Është një shkëmb granit në formë të një poligoni. Ka pasur disa mite dhe histori rreth këtij monumenti natyror, duke i dhënë atij një rëndësi të veçantë. Disa thonë se është e lidhur, sipas mitit, me Skënderbeun, sepse thuhet se mbi shkëmb ndodhet një gjurmë e thundrës së kalit të tij. Ka interes shkencor dhe kulturor. Mund ta vizitosh atë nëpërmjet rrugës Pukë – Zezaj. Pranë shkëmbit ndodhet Kalaja mesjetare e Lekë Dukagjinit e ndërtuar në shekullin e 15-të.



Figura 4.2.3: Guri i Shenjtë (burimi: http://www.akzm.gov.al/apps/akzm_cd/Shkoder/Sh_Mon/SH78.htm)

Gështenja e Kokdodit

Është një pyll gështenjash, 980 metra mbi nivelin e detit, pranë fshatit Kokdodit. Pylli ka një sipërfaqe prej përafërsisht 10 ha drurit gështenje të egër. Ka formë te parregullt dhe është në gjendje të mirë pavarësisht nga sëmundjet që i shkaktohen pemëve. Lartësia e pemëve është 10-15 metra, dhe moshja e tyre është mbi 100 vjeçare. Është një monument i rëndësishëm natyror për shkak të vlerës ekologjike, shkencore, ekonomike dhe turistike. Është i arritshëm përmes pikës së përbashkët Pukë – Iballë – Kokdodë.



Figura 4.2.4: Gështenja e Kokdodit, (burimi: http://www.akzm.gov.al/apps/akzm_cd/Shkoder/Sh_Mon/SH79.htm)

Bungat e varrezave në Korthpulë

Kjo zonë e mbrojtur ka të bëjë me dy pemë që gjenden në Varrezat e fshatit Korthpulë, 500 metra mbi nivelin e detit. Këto pemë lisi janë mbi 15 m të larta dhe mbi 300 vjet të vjetra. Me degët e tyre mbulojnë të gjithë varrezat. Ka vlerë shkencore, estetike dhe gjithashtu turistike. Qasja është e mundur përmes rrugës që lidh Pukën dhe vendbanimet Gomsiqe – Korthpula.

Mrizi i Ndërlugjeve

Këto janë 4 pemë (pemë lisi) të vendosura pranë njëra-tjetrës, me një lartësi prej 10-15 metrash. Ato ndodhen në një lartësi prej 800 metra mbi nivelin e detit, pranë fshatit Meçe, në zonën Rrapë. Moshja e tyre është rreth 200 vjeçare. Ka interes shkencor, estetik dhe turistik. Monumenti mund të vizitohet nga rruga që lidh fshatin Meçe me qytetin e Pukës.



Figura 4.2.5: Mrizi i Ndërlugjeve (burimi: http://www.akzm.gov.al/apps/akzm_cd/Shkoder/Sh_Mon/SH84.htm)

Mani i Zi

Ndodhet në periferinë jugperëndimore të qytetit të Pukës, në një lartësi prej 800 metrash mbi nivelin e detit. Ai është një man i zi i veçantë, 9 metra i lartë dhe rreth 400 vjeçar. Ruhet në gjendje të mirë. Ka një vlerë të veçantë shkencore, historike, fetare dhe turistike. I ndodhur në periferi të qytetit të Pukës, është lehtë i arritshëm në pak minuta.

Hurdha e Tisit

Ndodhet në luginën Gomsiqe pranë fshatit Pezhë në qarkun e Pukës. Ka një lartësi prej 650 metrash mbi nivelin e detit. Është një pemë halore, në një zonë shkëmbore që është në gjendje shumë të mirë. Moshja e saj është rreth 250 vjeçare. Është me interes shkencor dhe turistik. Nuk është lehtësisht e arritshme, pasi kushdo që dëshiron ta vizitojë duhet të ndjekë një rrugë të paasfaltuar që të çon atje.



Figura 4.2.6: Mani i Zi (burimi: http://www.akzm.gov.al/apps/akzm_cd/Shkoder/Sh_Mon/SH85.htm).

Karsti i Munellës

Janë formacione karstike të vendosura 1800-1990 metra mbi nivelin e detit, pranë fshatit Tuç. Është një peizazh karstik me shumë pellgje dhe kavitete, i cili formohet natyrshëm nga ujrat dhe shkëmbinj të gëlqerorë të Malit Munella. Në male ka një bimësi barishtore dhe livadhe të shumta. Ka interes shkencor, estetik, turistik dhe ekonomik. Për ta arritur ndiqet rrugëtimi Fushë Arrës - Tuç – mali i Munellës.




Figura 4.2.7: Karsti i Munellës (burimi: Çelsi Turistik Pukë)

Akacjet e Migjenit

Bëhet fjalë për akacie, të vendosura në Muzeun e Migjenit, në qytetin e Pukës. Ato kanë rëndësi historike, ndërsa thuhet se nën hijen e tyre, vdiq poeti Migjen.



Figura 4.2.8: Akacjet e Migjenit (burimi: http://www.akzm.gov.al/apps/akzm_cd/Shkoder/Sh_Mon/SH90.htm)

Në Bashkië Pukë nuk është identifikuar asnjë zonë e deklaruar e Mbrojtjes Absolute.

AKZM propozon shpalljen e Gështenjës së Rrapës, Mrizi i Memajve, Panja dhe QafeBari, Guri i Vashes si Monumente Natyrore.

Monumentet natyrore që Bashkia konsideron se duhet të mbrohen, por që nuk janë deklaruar të mbrojtura janë si në vijim:

- “Kroni Askerit”, Pukë, Laçaj.
- “Barka Leks”, Kabash, Llukët e Epër.
- “Kroni Shkall Bushtres”, po aty.
- “Mrizi Mems”, në jug-perëndim të Rrapës.
- “Fusha Jovs”, Rrapë.
- “Kshteja Hanit” (Kshteja Rrapës).
- “Kroni Prendush Gega”, Ltuk, veri Rrapës.
- “Mrizi Prendush Gega”, po aty.
- “Livadhi Madh”, në veri-lindje të Rrapës.
- “Qafa Ajtyrs”, mes Blinishtit e Bicajt.
- “Sarajet’e Leks”, Fushblinisht.
- “Guri Filxhanash” (i Lekë Dukagjinit), lindje Fushblinishtit.
- “Kroni Lek Dukagjinit”, në jug, poshtë Fushblinisht, Blinisht.
- “Rana Madhe”, vp Fushblinisht, Blinisht.
- “Hurdha Caks” lindje Meçes, jl “Livadhit Dems”, Meçe, Kabash.

- “Guri Madh”, Koderlluk, Meçe, Kabash.
- “Podi Hurrdhs Zezë” (Rrafsh I Hurrdhës së Zezë), Shkallë, Meçe.
- “Fusha Korit”, në veri të Meçes, mbi “Mrizin Nderlugj”, Kabash.
- “Guri Haxhibegit”, në Kunorë t’ Eper, jug majës së Krrabit, Meçe.
- “Gur’ i Msyshit” afër “Gurit Haxhibegit, Meçe, Kabash.
- “Hurdha Gavixhit”, në veri-perëndim të të Furrikëve, Grykë –Kabash, Kabash.
- “Nershej” (Nershejti) mes Krrabit e “Gurit Haxhibegit”, Meçe.
- “Guri Delmeres”, fshati Lëvrushk, në veri-lindje “Shpella Murgje”, Qelëz.
- “Kroni Katundit”, Qerret i Madh.
- “Nenkishza” (diku afër kishëza), Kryekatund, Qerret i Madh.
- “Podi Shmris” (Shën Mërisë, diku afër kisha), në veri-perëndim të Qerretit.
- “Podi Kishs” (duket I Kishës së Shën Ndreut) perëndim Qerretit.
- “Guri Bardh” (Guri Zanave), në veri-perëndim të Qerretit të Madh.
- “Mullin i Zanave”, Gurit Bardh nga mesi I shkëmbit, Qerret.
- “Shkam i Zanave”, vazhdim i “Gurit Bardh” nga perëndimi I tij.
- “Shpella e Shkemit’ t’ Zanave”, nga mesi i shkëmbit, Qerret.
- “Maja Cung”, në veri-perëndim të lagjes Shënkoll, maja e shkëmbit të kalasë.
- “Gurri Shqelit”, në jug-perëndim të Lufit, përball lagjes Kishaxhi, Kçirë.
- “Shpella Currit Shqelit”, brenda “Currit Shqelit”, Kçirë.
- “Guri Farks” në veri-perëndim “Currit Shqelit”, Kçirë.
- “Kshtejat e Kërthpuls”, Katund, Korthpulë.

Vlen të përmenden shpellat, prej të cilave më shumë se 50 janë të njohura dhe disa prej tyre janë afër zonave të banuara ose vendeve të lashta. Nga këto, përmendim Shpellën e Zanave pranë Kalasë së Dalmacies, të cilën e takuam edhe në listën e sipërcituar për shpallje të Bashkisë. Dimensionet e tyre ndryshojnë.



Figura 4.2.9: Shkemb i Zanave



Figura 4.2.10: Shpella Currit Shqelit

4.3. Problem mjedisore – ndotja

4.3.1. Ndotja industriale

Ndotja industriale në zonën e Bashkisë lidhet drejtpërsëdrejti me Industrinë Minerare.

Industria Minerare lulëzoi në dekadat e para të vitit 1990 me një aktivitet të madh të minierave të nxjerrjes së minerale, shkëmbinjve dekorativë dhe materialeve inerte. Ajo ka pasur një ndikim pozitiv në punësimin dhe rritjen ekonomike, por edhe një ndikim negativ në mjedis. Teknikat e nxjerrjes së mineraleve, magazinimit dhe pasurimit gjatë asaj periudhe nuk kishin kufizime dhe kushte të përshtatshme dhe si rrjedhim kanë shkaktuar degradim të ndjeshëm mjedisor në ajër dhe në ujëra (ato nëntokësore dhe sipërfaqësore). Në ditët e sotme aktiviteti i minierave është më i kufizuar, por ende sot kjo industri mbart të njëjtat rreziqe mjedisore.

Për shembull, stoqet e sterileve të mineralizimeve të bakrit përmbajnë copra minerali sulfur si dhe vetë rreshpet dhe bazaltet përmbajnë pikëzime sulfuresh. Në kushtet e agjentëve atmosferik si lagështia e oksigjeni, ndodhë procesi i oksidimit dhe elementët e çliruar shpërndahen nga rrjedhjet ujore sipërfaqësore si dhe me anë të vaditjes, në tokat poshtë minierës, duke shkaktuar ndotje të tyre, ku ndikojnë edhe ndotjet që vijnë nga pluhurat që ngrihen nga dherat e karrierave dhe nga stoqet e sterileve, si pasojë e të cilave rrjedh degradimi i florës dhe faunës së këtyre zonave. Përveç kësaj nga gropat e karrierave, (shfrytëzimi sipërfaqësor), shembjet dhe rrëshqitjet e krijuara në terren, rrezikohet jeta e njerëzve dhe e kafshëve.

4.3.2. Cilësia e ajrit – ndotja akustike – ndotje të tjera

4.3.2.1. Ndotja akustike

Fillimisht, në shkallë kombëtare, sipas matjeve të vitit 2017 (www.numbeo.com), indeksi i ndotjes akustike të Shqipërisë shkon në nivele të moderuara (51.25, 100 është niveli më i lartë).

Në përgjithësi, burimet bazë të ndotjes akustike mund të jenë:

1. Autostradat, akset rrugore primare dhe dytësore (rrugët lokale nuk janë burim domethënës i ndotjes akustike për shkak të faktorëve të ndryshëm).
2. Zonat ku ka rrjet hekurudhor.
3. Zonat industriale dhe zonat tregtare kanë gjithmonë limit të ndotjes akustike.
4. Të gjitha dyqanet dhe restorantet karakterizohen si prodhues të ndotjes akustike.
5. Shumica e ndërtesave rekreative janë zona të prodhimit të ndotjes akustike, të tilla si bare, vende të veçanta eventesh.
6. Disa objekte sportive.
7. Disa infrastruktura turistike dhe zona për shkak të përqendrimit të lartë të njerëzve.

Më konkretisht, zonat e ndotjes akustike ndahen në tre nivele ndotjeje akustike.

Zonë	Db
L1	≥ 65
L2	55 - 64.9
L3	45 - 54.9

Akse rrugore:

Tag	L1	L2	L3
Superstradë	60m	220m	500m
Linjë kryesore e autostradës	50m	190m	400m
Autostradë=primare	35m	160m	300m
Autostradë =sekondare	-	80m	125m
Autostradë =terciare	-	35m	65m

Rrjet hekurudhor:

Tag	L1	L2	L3
Hekurudhat = [traseja, binar i ngushtë, e ruajtur]	30m	60m	100m
Transporti hekurudhor = [hekurudhë e lehtë, tramvajë, teleferik, tren me një shinë]	-	30m	60m

Zona industriale dhe zona tregtare:

Tag	L1	L2	L3
Përdorimi i tokës-industrial	-	50m	100m
Përdorimi i tokës - njësi	-	70m	180m

Ambiente rekreative:

Tag	L1	L2	L3
dyqan=[të çdo lloji]	-	30m	65m
ndotje e ulët=[bar, zgarë, kafe, kënd për birra, biergarten, fast food, kënd ushqimi, akullore, pub,	-	35m	75m
Ndotje e lartë =[kinema, kazino, klub nate, lojra fati teatër, qendra komunitare]	40m	70m	150m
për kohën e lirë=[plazhe, resort, zone noti, park uji]	35m	55m	75m
tourizmi=[zona kamping, muze, zona pikniku, parqe, kopësht zoologjik	35m	55m	75m

Ambiente sportive:

Tag	L1	L2	L3
Sporte= [futboll, futboll amerikan, futboll kanadez, volejboll, bajsboll, basketboll, volejboll në plazh, gara me biçikleta (bmx), ndeshje gjelash, ndeshje qensh, cricket, fushë hockey, gara me kuaj, hockey në akull, patinazh në akull, gara me pengesa, gara me makina, rugby league, rugby union, qitje, tenis, ski në ujë]	40m	60m	80m

Bashkia Pukë

Në figurat hartografike të mëposhtme ilustrohen nivelet e ndryshme të ndotjes akustike të regjistruara brenda kufijve administrative të Bashkisë Pukë të Qarkut Shkodër. Vihet re se burimet kryesore të ndotjes akustike i atribuohen autostradave të mëdha të tilla si rruga shtetërore SH5 (aks i cili përbën aksin kombëtar Shkodër-Kukës (SH5) që lidh Shqipërinë me Kosovën), si edhe pjesës tjetër të rrugëve primare dhe atyre sekondare. Ndotja akustike në qytetin e Rrëshenit (qëndër e Bashkisë), në një pjesë të madhe të tij karakterizohet nga e moderuar deri në e lartë për shkak të kalimit në këtë territor të akseve rrugore të rëndësishme, ndërsa në pjesën tjetër të tij, nga e moderuar deri në e ulët, për shkak të përqendrimit të shërbimeve, dyqaneve, ambienteve të argëtimit dhe rekreative dhe zhurmave të vogla etj.




Figura 4.3.2.1.1: Nivelet e ndotjes akustike në selinë e Bashkisë Pukë*




Figura 4.3.2.1.2 & 4.3.2.1.3: Nivelet e ndotjes akustike rrugët automobilistike të Bashkisë Pukë*

*Në model shtohet një zonë (një buffer) përreth përdorimeve të zhurmshme të tokës. Kjo është zona e cila mund të ndikohet nga zhurma. Objektet shumë të zhurmshme shënohen me një buffer me ngjyrë të errët, ndërsa objektet më pak të zhurmshme me një buffer me ngjyrë të hapur.

4.3.2.2. Cilësia e ajrit – ndotje të tjera

Aktiviteti minerar i agregateve dhe veçanërisht gërmimet e pastudjuara si në thellësinë dhe në gjërësinë e shtratit, sjellin shëmbje të brigjeve, duke humbur sipërfaqe toke si dhe duke rritur rrezikun për shkatërrimin e trojeve dhe banesave. Shfrytëzimi intensiv ka çuar deri në devijim dhe në zgjerim të shtratit dhe në përmytjen e tokave përreth, si dhe në zbulimin e këmbëve të urave etj.

Në Bashkinë e Pukës përveç ndotjeve nga industria minerare, janë shkaktuar probleme edhe nga industria ndërtimore, duke nisur që nga hapja e gropave të bazamenteve të pallateve, transportimi i këtyre dherave, ku pothuajse nuk zbatohen as normat elementare për mbrojtjen e mjedisit, duke dëmtuar rrugët si dhe hedhja ku të munden e këtij materiali. Po kështu edhe pluhurat e shumta që vijnë nga inertet që përdoren në fabrikat e betonit, të cilat ndodhen brenda ose shumë afër qendrave të banimit. Probleme kryesore në ndotjen urbane sjellin pluhurat dhe materialet inerte nga prishja e ndërtimeve të vjetra dhe e atyre informale. Përmbajtja e grimcave totale (LNP) dhe atyre të respirueshme (PM10, PM2.5, PM1), në atmosferën e qyteteve veriore nuk është sinjifikative, ku përgjithësisht është brenda normave të lejuara të Standartit Shqiptar, (Min. Mjedisit 2012-'14)

Lidhur me menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri, një pjesë fare e vogël e mbetjeve riciklohen, shumë pak groposen dhe në të shumtën e rasteve depozitohen në zona të caktuara dhe digjen në natyrë. Sasi të konsiderueshme të mbetjeve, shpesh edhe të rrezikshme, janë trashëguar nga industria e së kaluarës, ndërkohë që mjaft biznese private kanë fluar të lulëzojnë, duke gjeneruar mbetje të shumëllojshme.

Mbetjet klasifikohen si: mbetje organike; mbetje të ngurta; mbetje patologjike dhe spitalore; mbetje industriale dhe mbetjet agrokulturore.

Tipet e ndryshme të mbetjeve janë të klasifikuara si më poshtë:

1. Mbetje jo të rrezikshme, të cilat quhen ndryshe mbetje urbane ose “plehra” në gjuhën e përditëshme, të cilat edhe pse quhen si jo të rrezikshme mund të rezultojnë shumë të dëmshme për popullsinë dhe mjedisin, sidomos kur ato digjen në natyrë.
2. Mbetje të rrezikshme, të cilat siç e theksuam më sipër, kanë karakteristika kimiko-fzike toksike, gjërryese, kancerogjene me efekte të dëmshme tek organizmat deri në vdekshmëri. Ish industria publike dhe teknologjia e vjetër që përdorte, prodhonte shumë mbetje të tilla duke sjellë probleme serioze nga kontaminimi i ajrit, ujërave dhe tokave me ndotjet e mesipërme.

Duke patur parasysh numrin e popullsisë sipas INSTAT dhe shumën totale vjetore të mbetjeve të ngurta urbane, rezulton se sasia mesatare është 332 kg për banor në vit. Mbetjet bashkiake kanë një përqindje të lartë të mbetjeve organike dhe nuk përdoret ndonjë metodë riciklimi për të reduktuar sasinë e këtyre mbetjeve organike që hidhen në venddepozita. Mbetjet organike në venddepozita janë burimi kryesor i emetimit të CH₄ në ajër, (Ministria e Mjedisit-2012). Gjithashtu si pasojë e shkarkimeve të lëngëta urbane rritet përmbajtja e NH₄, ndërsa nga shkarkimet e ujërave të zeza rritet përmbajtja e NO₂ dhe NO₃.

Administrimi i mbetjeve urbane është i decentralizuar, ku në qytete menaxhohen nga bashkitë ndërsa zonat rurale nuk janë të mbuluara akoma nga shërbimet e menaxhimit të mbetjeve. Pjesa më e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër lumenj, hidrovore, ose në anë të rrugëve, të

cilat zhvendosen nga përrrenjët ose grumbullohen në venddepozita të hapura në natyrë, mbi depozitime të shkriфта, toka bujqësore (kuaternare), të cilave nuk ju bëhet asnjë lloj përpunimi, digjen në gjendje të lirë etj.

Në Bashkinë Pukë funksionojnë dy vend-depozitime, josanitare dhe të paorganizuara, sipas Ministrisë së Zhvillimit Urban (<http://mbetjet.zhvillimiurban.gov.al>), por edhe të kërkimeve në terren. Njëri gjendet në kufijtë me Bashkitë Fushë-Arrëz, ndërsa i dyti, në perëndim dhe në afërsi të qytetit Pukë. Gjithashtu, në bazë të autopsive të kryera, u konstatuan të shpërndara në të gjithë territorin e Bashkisë vende të tjera të vogla të deponimit të pakontrolluar.

Riciklimi është përkufzuar si një operacion tjetër rikuperimi nga ku mbetjet përpunohen në produkte, materiale ose substanca për qëllime parësore ose të tjera. Aktualisht në vendin tonë ka disa kompani private riciklimi që grumbullojnë dhe përpunojnë tipe të ndryshme mbetjesh: skrap, alumin, letër, dru, plastikë, tekstile, tulla, mbetje vajore, goma të përdorura etj. Ka rreth 12000 grumbullues individual, informal dhe rreth 60 kompani grumbulluese për mbetje të ndryshme të riciklueshme. Për shëmbull mbetjet organike, si ato nga mbetjet urbane ashtu edhe ato nga aktivitetet industriale dhe bujqësore, mund të mblidhen, kompostohen dhe të trajtohen për të prodhuar pleh me përmbajtje të lartë organike, për të plotësuar nevojat për lëndë organike të tokave bujqësore. Ky riciklim do të ishte shumë produktiv në disa drejtime: si për zvoglimin e volumit ashtu edhe të ndotjeve të tyre.

Ujërat e zeza për vetë Qytetin e Pukës nuk përbëjnë ndonjë problem sepse tashmë janë të sistemuara në një kanal përmbledhës të tyre, i cili shkarkohet në një përrua në V L të qytetit, por të patrajtuara, duke shkaktuar ndotje në vazhdimin e tij.

4.3.3. Rreziqet- impakti

4.3.3.1. Presionet mbi akuiferët

Presionet mbi akuiferët e Bashkisë Pukë janë përqëndruar në:

- Kërkesën më të mëdhe për resurset ujore (turizmi dhe bujqësia) në periudhën e thatë (Qershor - Shtator), kur disponibiliteti i resurseve të ujërave nëtokësore është më i ulët.
- Shpërndarjen e ndotësve toksikë, të rrezikshëm përmes shtresës së tokës nga mbetjet industriale dhe të minierave.
- Shpërndarjen e ndotësve mikrobialë, të rrezikshëm përmes tokës nga mbetjet urbane.
- Rritjen e bashkimeve azotike dhe fosfateve për shkak të përdorimit të tepërt të plehrave kimike.

4.3.3.2. Formacionet litologjike, inkuadrimi gjeologjik i tyre

Sipas studimit "Gjeoresurset dhe Gjeorrezizet në Qarqet e Shqipërisë" për rajonin e Shkodrës dhe hartës Gjeologjike të Prefekturës Shkodër, shkalla 1: 100,000 e Institutit Gjeologjik Shqiptar, ne varësi të veçorive fiziko-mekanike në territorin e qarkut të Shkodrës shfaqen 6 tip të ndryshme

litologjike: shkëmbinj të fortë, shkëmbinj mesatarë, shkëmbinj të butë (kriteri i ndarjes së tyre është rezistenca në shtypje një boshtore (Rsh), e cila për shkëmbinj të fortë ka vlera më të mëdha se 500 kg/cm², për shkëmbinj të mesatarë 50–500 kg/cm² dhe për shkëmbinj të butë < 50 kg/cm²), dhera pa kohezion, dhera me kohezion, dhera me veti speciale.

Pra kriteri i ndarjes së dherave ka qenë kohezioni (forcat lidhëse midis kokrrizave përbërëse). Nëse dherat janë pa kohezion (rërat, zhavorret, etj), kokrrizat përbërëse të tyre lëvizin lirisht të pavarura nga njëra tjetra, në mënyrë të menjëhershme, sapo mbi to të veprojnë ngarkesa të lindura si rezultat i aplikimit të ndërtimeve mbi to. Kurse në dherat me kohezion (argjilat, suargjilat, surerat), kokrrizat përbërëse të tyre janë të lidhura me forca kohezive midis tyre, për pasojë sjellja e tyre ndaj ngarkesave të ndërtimeve të ngritura mbi to, është e ngadaltë, e shtrirë në kohë dhe ato paraqesin sjellje uniforme ndaj këtyre ngarkesave. Dherat me veti speciale janë dhera të dobët, ose dhera që paraqesin veti të ndryshme në drejtime të ndryshme të aplikimit të forcave mbi to. Nga pikëpamja gjeologjike – inxhinierike këto formime kërkojnë në mënyrë kategorike përmirësim të vetive gjeoteknike gjatë hapjes së themeleve për ndërtim. Përshkrimi është bërë mbi kritere thjesht litologjike, pavarësisht nga mosha dhe përkatësia në zonat tektoniko – faciale. Shpesh ndodh që e njëjta moshë gjeologjike të ketë përbërje të ndryshme litologjike, kjo në vartësi të përkatësisë së cilës zonë tektoniko – faciale i përket. Në raste më të rralla, ndodhin ndryshime litologjike, në shtrirje, të të njëjtës moshe gjeologjike dhe të të njëjtës zone tektoniko – faciale.

1– Shkëmbinj të fortë, Rsh >500 bar. (Në hartë të ngjyrosura me ngjyrë të kuqe).

Shkëmbinj të intruzive magmatikë ultrabazikë (Iu) janë të përhapur vetëm në zonën strukturoro-faciale “Mirdita”. Kanë përhapje të madhe duke formuar masive ultrabazike: në Krrabë, Pukë, dhe Gomsiqe. Mosha e tyre është e Jurasikut të Mesëm. Në këto masive takohen lloje të ndryshme të shkëmbinjve ultrabazikë si intruzione ultramafike, piroksenite, dunite, lercolite, harzburgite etj. Në të gjithë masivet tektonika është e zhvilluar kryesisht në kontaktet me shkëmbinj të rrethues dhe më pak brenda tyre.

Jane shkëmbinj kompakt me çarje me orientim të ndryshëm. Korja e tjetërsimit arrin deri në 5 m.

Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

Pesha specifike $\gamma = 2,95 - 3,09 \text{ gr/cm}^3$

Pesha volumore $\Delta = 2,88 - 3,00 \text{ gr/cm}^3$

Poroziteti $n = 2 - 15 \%$

Rezistenca në shtypje njëboshtore Rsh 500 - 1100 kg/cm²

Rezistenca në shtypje një boshtore e ngopur me ujë Rng > 500 kg/cm²

Rezistenca në tërheqje Rt = 30 - 100 kg/cm²

Moduli i elasticitetit E = $6 \times 10^5 - 1,2 \times 10^5$ bar

Koeficienti i Puasonit $\nu = 0,2 - 0,25$

Koeficienti i zbutjes $K_z = 0,89 - 0,96$

Kohezioni $c = 50 - 200 \text{ kg/cm}^2$

Këndi i fërkimit të brendshëm $\varphi = 22^\circ - 38^\circ$

Ngarkesa e lejuar $\sigma > 6 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë intruzive magmatikë bazikë (Ib) janë të përhapur vetëm në zonën strukturoro-faciale “**Mirditë**”. Kanë përhapje të kufizuar kryesisht në lindje të rrethit të Pukës dhe më pak në zonën perëndimore. Mosha e tyre është e Jurasikut të Mesëm (nJ2). Në këtë grup shkëmbinjtë janë përfshirë norite, gabronorite, gabro, gabroamfibolite, troktolite etj. Gjenden në lindje të Pukës në rajonin Blinsht, Rrapja dhe Bicaj. Më në jug në rajonin Shkozë dhe Gjegjan. Në zonën perëndimore takohen në formën e një brezi me gjerësi rreth 5km dhe gjatësi rreth 30km, në zonën Tejkoder në jug, deri në Bushat në veri. Tektonika është e zhvilluar kryesisht ndërformacionale afro vertikale.

Janë shkëmbinj kompakt me çarje me orientim të ndryshëm. Korja e tjetërsimit arrin deri në 5 m

Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

$$\text{Pesha specifike } \gamma = 2,90 - 3,01 \text{ gr/cm}^3$$

$$\text{Pesha volumore } \Delta = 2,6 - 2,8 \text{ gr/cm}^3$$

$$\text{Poroziteti } n = 2 - 17 \%$$

$$\text{Rezistenca në shtypje njëboshtore } R_{sh} = 500 - 1200 \text{ kg/cm}^2$$

$$\text{Rezistenca në shtypje një boshtore e ngopur me ujë } R_{ng} > 500 \text{ kg/cm}^2$$

$$\text{Rezistenca në tërheqje } R_t = 30 - 110 \text{ kg/cm}^2$$

$$\text{Moduli i elasticitetit } E = 4 \times 10^5 - 1,3 \times 10^5 \text{ bar}$$

$$\text{Koeficienti i Puasonit } \nu = 0,2 - 0,26$$

$$\text{Koeficienti i zbutjes } K_z = 0,90 - 0,97$$

$$\text{Kohezioni } c = 50 - 200 \text{ kg/cm}^2$$

$$\text{Këndi i fërkimit të brendshëm } \varphi = 23^0 - 38^0$$

$$\text{Ngarkesa e lejuar } \sigma > 6 \text{ kg/cm}^2$$

Shkëmbinjtë intruzive magmatike mesatare dhe acide (Ima) janë të përhapur vetëm në zonën strukturoro faciale “**Mirditë**”. Gjenden gjithashtu në Kuzhnen, Domi, Gojan i Vogël, Kimza, në Qafa e Helmit, në fshatin Lumz. Gjithashtu edhe në majën e malit Levrushk. Mosha e tyre është e Jurasikut të Mesëm (gJ2). Tektonika është e zhvilluar kryesisht ndërformacionale afro vertikale në masivet e Levrushkut.

Janë shkëmbinj kompakt me çarje me orientim të ndryshëm. Korja e tjetërsimit arrin deri në 30 m në granitet e Fierzës.

Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

$$\text{Pesha specifike } \gamma = 2,91 - 3,04 \text{ gr/cm}^3$$

$$\text{Pesha volumore } \Delta = 2,7 - 2,85 \text{ gr/cm}^3$$

$$\text{Poroziteti } n = 2 - 15 \%$$

$$\text{Rezistenca në shtypje njëboshtore } R_{sh} = 500 - 1500 \text{ kg/cm}^2$$

$$\text{Rezistenca në shtypje një boshtore e ngopur me ujë } R_{ng} > 500 \text{ kg/cm}^2$$

$$\text{Rezistenca në tërheqje } R_t = 30 - 100 \text{ kg/cm}^2$$

$$\text{Moduli i elasticitetit } E = 0,5 \times 10^5 - 8,8 \times 10^4 \text{ bar}$$

$$\text{Koeficienti i Puasonit } \nu = 0,1 - 0,26$$

$$\text{Koeficienti i zbutjes } K_z = 0,88 - 0,96$$

$$\text{Kohezioni } c = 60 - 130 \text{ kg/cm}^2$$

$$\text{Këndi i fërkimit të brendshëm } \varphi = 22^0 - 39^0$$

Ngarkesa e lejuar $\sigma > 6 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë efuzive magmatikë bazikë (Eb) janë të përhapur vetëm në zonën strukturoro faciale “Mirditë”. Gjenden edhe në rajonin Kabash, në pjesën verilindore të vendbanimit Lumz dhe më pak në Munellë. Mosha e tyre është e Jurasikut të Mesëm (bJ2). Përfaqësohen nga llava jastëkore bazaltike, bazalto-andezitike dhe shkëmbinj vullkanik të serisë bazaltike. Tektonika është e zhvilluar kryesisht ndërformacionale afro vertikale në drejtime të ndryshme.

Janë shkëmbinj kompakt me çarje me orientim të ndryshëm. Korja e tjetërsimit arrin deri në 5 m, rrallë me tepër.

Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

Pesha specifike $\gamma = 2,65 - 2,75 \text{ gr/cm}^3$

Pesha volumore $\Delta = 2,61 - 2,70 \text{ gr/cm}^3$

Poroziteti $n = 2 - 10 \%$

Rezistenca në shtypje njëboshtore Rsh 500 - 800 kg/cm^2

Rezistenca në shtypje një boshtore e ngopur me ujë Rng $> 500 \text{ kg/cm}^2$

Rezistenca në tërheqje Rt = 20 - 60 kg/cm^2

Moduli i elasticitetit $E = 2 \times 10^5 - 8 \times 10^5 \text{ bar}$

Koeficienti i Puasonit $\nu = 0,15 - 0,24$

Koeficienti i zbutjes $K_z = 0,81 - 0,95$

Kohezioni $c = 50 - 150 \text{ kg/cm}^2$

Këndi i fërkimit të brendshëm $\varphi = 23^0 - 39^0$

Ngarkesa e lejuar $\sigma > 6 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë efuzivë magmatikë mesataro-acide (Ema) gjenden në lindje të Lumzit, në rrethinat e malit të Munellës, në lindje të Gjegjanit. Mosha e tyre është e Jurasikut të Mesëm (LJ2). Përfaqësohen nga andezitobazalte, boninite, andezito - dacite, dacite, riodiacite dhe riolite. Takohen në trajtë brezash dhe rrallë në trajtë pullash. Tektonika është e zhvilluar kryesisht ndërformacionale afro vertikale në drejtime të ndryshme.

Janë shkëmbinj kompakt me çarje me orientim të ndryshëm. Korja e tjetërsimit arrin deri në 5 m rrallë më tepër.

Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

Pesha specifike $\gamma = 2,7 - 2,8 \text{ gr/cm}^3$

Pesha volumore $\Delta = 2,67 - 2,75 \text{ gr/cm}^3$

Poroziteti $n = 2 - 12 \%$

Rezistenca në shtypje njëboshtore Rsh 500 - 1000 kg/cm^2

Rezistenca në shtypje një boshtore e ngopur me ujë Rng $> 500 \text{ kg/cm}^2$

Rezistenca në tërheqje Rt = 30 - 100 kg/cm^2

Moduli i elasticitetit $E = 3 \times 10^5 - 8 \times 10^5 \text{ bar}$

Koeficienti i Puasonit $\nu = 0,16 - 0,25$

Koeficienti i zbutjes $K_z = 0,85 - 0,96$

Kohezioni $c = 50 - 150 \text{ kg/cm}^2$

Këndi i fërkimit të brendshëm $\varphi = 22^0 - 38^0$

Ngarkesa e lejuar $\sigma > 6 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë metamorfike rreshpore (Rm). janë të përhapur vetëm në zonën strukturoro faciale “**Mirditë**”. Këta shkëmbinj përfaqësohen nga rreshpe të zeza graptolitike, rreshpe dhe gëlqerorë krinoidale të moshës silurian - devonian; shtroja metamorfike e përfaqësuar nga amfibolite të Jurasikut të Mesëm; shkëmbinjtë metamorfike oqeanikë, metabazaltet e jurasikut të mesëm. Amfibolitet takohen në formë pullash të vogla në Kaftallë dhe Karmë. Metabazaltet takohen në formë pullash të vogla me gjerësi 0,5 km dhe gjatësi 1,5 km kryesisht në masivin ultrabazik të Krrabit dhe më pak në atë të Pukës.

Janë shkëmbinj të përbërjes litologjike të larmishme. Brenda tyre ekzistojnë shkëmbinj shumë të fortë dhe të forte por që janë të coptueshëm e të ndrydhur tektonikisht.

Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

Pesha specifike $\gamma = 2,4 - 3,2 \text{ gr/cm}^3$

Pesha volumore $\Delta = 2,0 - 2,8 \text{ gr/cm}^3$

Poroziteti $n = 1 - 30 \%$

Rezistenca në shtypje njëboshtore $R_{sh} 500 - 1300 \text{ kg/cm}^2$

Rezistenca në shtypje një boshtore e ngopur me ujë $R_{ng} > 500 \text{ kg/cm}^2$

Rezistenca në tërheqje $R_t = 10 - 200 \text{ kg/cm}^2$

Moduli i elasticitetit $E = 10^5 - 3 \times 10^5 \text{ bar}$

Koeficienti i Puasonit $\nu = 0,1 - 0,35$

Koeficienti i zbutjes $K_z = 0,82 - 0,98$

Kohezioni $c = 50 - 200 \text{ kg/cm}^2$

Këndi i fërkimit të brendshëm $\varphi = 22^\circ - 38^\circ$

Ngarkesa e lejuar $\sigma > 6 \text{ kg/cm}^2$

Gëlqerorët (G): Gjejnë përhapje në zonat tektoniko – faciale “Gashi”, “Alpet Shqiptare”, “Mirdita”, “Krasta - Cukali” dhe “Kruja”.

Në zonën “**Mirdita**” kanë përhapje të kufizuar. Përhapen në veriperëndim të kurrizit të Karmës, në malin e Munellës. Mosha gjeologjike e tyre është Triasik i Sipërm - Jurasik i Poshtëm (T3-J1), triasik i poshtëm - mesëm (T₁₋₂) dhe kretak i poshtëm (Cr1). Mbizoterojnë gëlqerorët me megalodonte, gëlqerorët amonitike dhe conglomerate etj, të dolomitizuar dhe dolomitet. Janë të prekur nga një sistem çarjesh shumë i zhvilluar sipas së cilave zhvillohen fenomene karstike si gropa dhe hinka karstike.

Në zonën “**Krastë – Cukali**” gëlqerorët kanë përhapje mesatare. Mosha gjeologjike e tyre është e Triasikut të Sipërm (T3), Jurasikut të Poshtëm - Mesëm (J₁₋₂) dhe Kretak i Sipërm (Cr2). Përhapen në formë brezash dhe pullash në afërsi të Brashtës, dhe Komanit. Janë të përbërjes gëlqerore biomikritike me globotrunkana, gëlqerorë turbiditike dhe më rrallë gëlqerorë silicore. Kanë strukturë pllakore shtresë të vogël (1 – 2 cm) deri në 40 cm rrallë masive.

Janë shkëmbinj kompakte masive deri pllakore. Në ta është prezent fenomeni i karstezimit, kryesisht është i përhapur karsti i çarjeve i drejtimit vertikal dhe të kombinuar me fenomenin e

mbushjeve të tyre me material kryesisht çimento karbonatike që vjen nga tretja kimike e gëlqerorëve dhe me pak material argjiloro – humusor që vjen nga shpatet duke lëvizur nën veprimin e ujrave rrjedhës sipërfaqësore e nëntokësore.

Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

Pesha specifike $\gamma = 2,5 - 2,9 \text{ gr/cm}^3$

Pesha volumore $\Delta = 2,2 - 2,6 \text{ gr/cm}^3$

Poroziteti $n = 1 - 25 \%$

Rezistenca në shtypje njëboshtore $R_{sh} 500 - 1100 \text{ kg/cm}^2$

Rezistenca në shtypje njëboshtore e ngopur me ujë $R_{ng} > 500 \text{ kg/cm}^2$

Rezistenca në tërheqje $R_t = 10 - 100 \text{ kg/cm}^2$

Moduli i elasticitetit $E = 10^5 - 3 \times 10^5 \text{ bar}$

Koeficienti i Puasonit $\nu = 0,15 - 0,30$

Koeficienti i zbutjes $K_z = 0,85 - 0,96$

Kohezioni $c = 50 - 150 \text{ kg/cm}^2$

Këndi i fërkimit të brendshëm $\varphi = 22^\circ - 38^\circ$

Ngarkesa e lejuar $\sigma > 6 \text{ kg/cm}^2$

Gëlqerorët silicorë (Gsi): Në zonën e Bashkisë gjetjet janë të vogla dhe të shpërndara dhe i përkasin zonave tektoniko-faciale "Krasta-Cukali" dhe "Mirditë". Shfaqjet që i përkasin zonës "Mirditë" janë pjesë të copëtuara të një zone të përgjithëshme Veri Lindje - Jug Perëndim, në pjesën perëndimore të Bashkisë. Gjetje ka në zonën e Kaftallisë, në krahinën Kçira, dhe në veri në krahinat e Dushit, Qerret i Vogël, Ukth. Bëhet fjalë për gëlqerorë pllakorë me silicorë të moshës Triasik i Mesëm-Jurasik i Poshtëm.

Gjetjet që shfaqen në zonën e Cukalit (Në zonën "Krasta-Cukali") ndodhen në kufirin e Bashkisë me Vaun e Dejës përgjatë lumit Drin. Përbëhen nga ndërthurje të gëlqerorëve shtresëhollë me silikore të kuqërremta. Janë të moshës Jurasik i Sipërm, Kretak i Poshtëm (J3-Cr1).

Edhe këta, si gëlqerorët, janë shkëmbinj kompakt, kryesisht pllakorë, por nuk mungojnë rastet kur kemi ndërthurje të shtresave gëlqerore me ato silicore, ose kur shkëmbinjtë me pamje silicore shfaqen brenda gëlqerorëve në formë të linxave. Në këta shkëmbinj, në përgjithësi nuk gjen përhapje fenomeni i karstezimit.

Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

Pesha specifike $\gamma = 2,6 - 3,0 \text{ gr/cm}^3$

Pesha volumore $\Delta = 2,4 - 2,8 \text{ gr/cm}^3$

Poroziteti $n = 1 - 10 \%$

Rezistenca në shtypje njëboshtore $R_{sh} 500 - 1000 \text{ kg/cm}^2$

Rezistenca në shtypje njëboshtore e ngopur me ujë $R_{ng} > 500 \text{ kg/cm}^2$

Rezistenca në tërheqje $R_t = 10 - 120 \text{ kg/cm}^2$

Moduli i elasticitetit $E = 10^5 - 3 \times 10^5 \text{ bar}$

Koeficienti i Puasonit $\nu = 0,15 - 0,35$

Koeficienti i zbutjes $K_z = 0,89 - 0,96$

Kohezioni $c = 50 - 140 \text{ kg/cm}^2$

Këndi i fërkimit të brendshëm $\varphi = 22^0 - 38^0$
Ngarkesa e lejuar $\sigma > 6 \text{ kg/cm}^2$

2 – Shkëmbinjtë mesatarë, Rsh 50 – 500 bar (në hartë janë ngjyrosur me ngjyrë manushaqe).

Shkëmbinjtë efuzivo - sedimtare (Es). Takohen në formën e një brezi me shkëputje në pjesën perëndimore dhe veriperëndimore të zonës “Mirdita”, nga Vig-Mnela-Karma deri në Porav - Miliska. Brenda Bashkisë gjenden edhe në rajonin e Kçirës. Janë të moshës Triasik i Mesëm - Jurasik i Poshtëm (T2 - J1). Përfaqësohen kryesisht nga diabaze të ndërthurura nga rreshpe argjilo - silicore të kuqe. Kontaktojnë kryesisht tektonikisht me shkëmbinjtë rrethues.

Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

Pesha specifike $\gamma = 2,2 - 2,76 \text{ gr/cm}^3$
Pesha volumore $\Delta = 2,0 - 2,4 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti $n = 15 - 50 \%$
Rezistenca në shtypje një boshtore $R_{sh} < 500 \text{ kg/cm}^2$
Rezistenca në tërheqje $R_t = 15 - 40 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i elasticitetit $E = 5 \times 10^4 - 6 \times 10^5 \text{ bar}$
Koeficienti i Puasonit $\nu = 0,36 - 0,41$
Koeficienti i zbutjes $K_z = 0,75 - 0,79$
Kohezioni $c = 10 - 110 \text{ kg/cm}^2$
Këndi i fërkimit të brendshëm $\varphi = 22^0 - 38^0$
Ngarkesa e lejuar $\sigma = 3 - 6 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë flishore dhe me pamje flishore (Fl) Zënë një pjesë të konsiderueshme të territorit të qarkut. Këta shkëmbinj gjejnë përhapje në zonat tektoniko – faciale “Mirditë”, Alpet Shqiptare; “Krasta - Cukali” dhe “Krujë”. Moshë gjeologjike e tyre varion që nga Jurasiku i Sipërm deri paleocen. Në zona të ndryshme shkëmbinjtë flishore dhe ata me pamje flishore kanë moshë të ndryshme litologjike dhe përbërje po ashtu të ndryshme. E përbashketa e tyre është ndërthurja ritmike midis përbërësve litologjikë argjilore, alevrolitore dhe ranore (me rrallë edhe brekçe). Në rajonin e Bashkisë i përkasin nënzonës “Cukali”, dhe kanë moshë Maastrichtian-Eocene. (Cr2m-Pg2). Gjenden në rajonin Karma. Vendoset sipër gëlqerorëve të Cr2 nëpërmes pakos kalimtare dhe paraqiten me ndërthurje me ritëm të hollë të komponentëve alevrolitore, argjilave, mergeleve dhe ranorë, rrall ndërshtresa gëlqerori. Në sipërfaqe ky flish paraqitet shumë i copëtuar dhe i prekur nga tektonikat rrudhosëse.

Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

Pesha specifike $\gamma = 2,6 - 2,74 \text{ gr/cm}^3$
Pesha volumore $\Delta = 1,95 - 2,2 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti $n = 30 - 65 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore $R_{sh} < 500 \text{ kg/cm}^2$
Rezistenca në tërheqje $R_t = 10 - 30 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i elasticitetit $E = 5 \times 10^4 - 6 \times 10^5 \text{ bar}$
Koeficienti i Puasonit $\nu = 0,35 - 0,4$
Koeficienti i zbutjes $K_z = 0,61 - 0,75$

Kohezioni $c = 35 - 65 \text{ kg/cm}^2$
Këndi i fërkimit të brendshëm $\varphi = 18^0 - 28^0$
Ngarkesa e lejuar $\sigma = 2.4 - 3.2 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë mollasik ranoro-konglomeratike (Mrk): Gjejnë përhapje vetëm në zonen “Mirdita”. Takohen në Korthepute Keçirë, Gurth dhe Qafë Bari. Kanë kontakte tektonike me shkëmbinjtë e tjerë. Janë të moshës së Pliocen - Pleistocen i poshtëm (N₂-Q) dhe jurasikut të sipërm (J₃). Përfaqësohen nga konglomerate ranore dhe më pak argjila. Zënë sipërfaqe të kufizuar në formë pullash dhe rrallë në formë brezash.

Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

Pesha specifike $\gamma = 2,5 - 2,8 \text{ gr/cm}^3$
Pesha volumore $\Delta = 1,85 - 2,0 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti $n = 10 - 50 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore $R_{sh} < 500 \text{ kg/cm}^2$
Rezistenca në tërheqje $R_t = 10 - 30 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i elasticitetit $E = 5 \times 10^4 - 6 \times 10^5 \text{ bar}$
Koeficienti i Puasonit $\nu = 0,35 - 0,4$
Koeficienti i zbutjes $K_z = 0,76 - 0,8$
Kohezioni $c = 5 - 100 \text{ kg/cm}^2$
Këndi i fërkimit të brendshëm $\varphi = 22^0 - 38^0$
Ngarkesa e lejuar $\sigma = 3 - 6 \text{ kg/cm}^2$

3 – Shkëmbinjtë e dobët, $R_{sh} < 50 \text{ bar}$ (në hartë paraqiten me ngjyrë jeshile).

Serpentinitet (Ms) takohen vetëm në zonën strukturoro - faciale “Mirditë” në formën e një brezi me gjerësi 0.3 km dhe gjatësi rreth 6 km nga Berisha deri në Bugjon. Janë shkëmbinj të përpunuar dhe millonitizuar. Kontaktojnë tektonikisht me shkëmbinjtë rrethues. Në rajonin e Bashkisë gjenden në sasi të pakët në zonën e Komanit.

Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

Pesha specifike $\gamma = 2,7 - 2,8 \text{ gr/cm}^3$
Pesha volumore $\Delta = 2,6 - 2,7 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti $n = 40 - 70 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore $R_{sh} < 50 \text{ kg/cm}^2$
Rezistenca në tërheqje $R_t = 2 - 5 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i elasticitetit $E = 10^4 - 10^5 \text{ bar}$
Koeficienti i Puasonit $\nu = 0,31 - 0,4$
Koeficienti i zbutjes $K_z = 0,6 - 0,65$
Kohezioni $c = 3 - 65 \text{ kg/cm}^2$
Këndi i fërkimit të brendshëm $\varphi = 18^0 - 38^0$
Ngarkesa e lejuar $\sigma = 0.5 - 1.0 \text{ kg/cm}^2$

4 – Dhera pa kohezion (në hartë paraqiten me ngjyrë portokalli).

Rrjeti hekurudhor

Për sa i përket rrjetit hekurudhor të vendit, ai karakterizohet me mangësi, jo i plotë dhe, duke pasur parasysh shpejtësinë e zhvillimit të rrjetit rrugor, ai ka mbetur në haresë. Rrjeti është relativisht i vogël (447 km në linjën kryesore dhe 230 km në linjën sekondare 23) duke pasur parasysh gjeografinë e vendit. Shtrihet mbi bregun perëndimor (Shkodër - Vlore) dhe përgjatë korridorit perëndimor-lindor (korridori 8). Ka disa linja që lejojnë hyrjen në zonat e brendshme të vendit, por përdoren vetëm për qëllime tregtare. Numri i udhëtarëve që përdorin linjën hekurudhore është shumë i ulët, për shkak të faktit se preferohet të udhëtohet nëpër rrjetin rrugor dhe cilësisë shumë të ulët që ofrohet nga shërbimi hekurudhor. Rrjeti hekurudhor është kombëtar dhe jo rajonal, me rezultat të lidh vetëm qendrat e mëdha urbane dhe nuk ofron shërbime për vendbanimet brenda rajoneve. Rrjeti gjithashtu është tepër i rrënuar dhe kërkon kosto të mëdha për rindërtim dhe modernizim.

Ujësjellës - Kanalizimet

Për sa i përket infrastrukturës në sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimeve, sipas raportit vjetor të Shqipërisë për vitin 2013, në sektorin e burimeve ujore, në këtë rajon funksionon shoqëria e ujësjellës - kanalizimeve "Sh.A. UK Pukë". Më poshtë është një tabelë me informacion që ka lidhje

me përmbushjen e nevojave të ujit dhe kanalizimeve, nivelin e matjes së sasisë së ujit të prodhuar, cilësinë e burimeve ujore dhe orarin e furnizimit me ujë për vitet 2013-2014.

Sh.A. UK Puke				
Shërbimet UK		Njësi	2013	2014
1	Uji i pa-faturuar (humbjet)	%	68,0	66,0
2	Niveli i matjes	%	44,0	70,0
3	Cilësia e ujit		Normal	Normal
4	Orari i furnizimit	orë/ditë	9,0	10,0
5	Eficienca e stafit	personeli/000/lidhje	11,1	10,0
6	Mbulimi me ujë	%	53,0	60,0
7	Mbulimi i kanalizimeve	%	53,0	54,0

Tabela 5.8.6: Të dhëna të UK Pukë sh.a.

Nga tabela e mësipërme rezulton se humbjet e rrjetit në rajonin e Pukës janë 68% për 2013 dhe 66% për 2014. Për sa i përket nivelit të matjes, në vitin 2013 ishte 44%, ndërsa në vitin 2014 shifra u rrit në 70%. Cilësia e burimeve ujore konsiderohet normale. Për sa i përket furnizimit me ujë, ai arrin në 9 dhe 10 orë në ditë për vitet 2013 dhe 2014 respektivisht. Furnizimi me ujë është në një nivel shumë të ulët, ndoshta për shkak të vjetërsisë së rrjeteve dhe shkallës së lartë të humbjeve, fakte të cilat bëjnë që rrjeti të konsiderohet i kushtueshëm dhe të funksionojë vetëm në kohë të caktuara të ditës.

Nga Tabela e mësipërme, gjithashtu konstatohet se vetëm 53% dhe 60% e zonës shërbehet nga rrjeti i furnizimit me ujë në vitin 2013 dhe 2014, ndërsa për sektorin e kanalizimeve gjendja është më e keqe, pasi për vitet 2013 dhe 2014 përqindja e mbulimit ishte 53% dhe 54% respektivisht.

Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta

Në Pukë ekziston një rrjet kolektiv i kanalizimeve që mbulon vetëm pjesën qendrore të saj. Kohët e fundit ka përfunduar një projekt rindërtimi dhe përmirësimi i këtij rrjeti. Sasia ditore e mbeturinave bashkiake të prodhuara nga bashkia e Pukës është dhënë në tabelën vijuese:

Pukë	Numri i kategorive që përfitojnë shërbimin	Norma e gjenerimit	Prodhimi ditor		Raporti sipas gjenerimit
		Kg/dite/banor	kg/dite	ton/dite	(%)
Banorë qyteti	4,400	0.7	3,080	3.08	63%
Banori Pukë- fshat	882	0.4	353	0.35	7%
Banori Lajthizë- fshat	190	0.4	76	0.08	2%
Biznese të mëdha	20	15.0	300	0.30	6%
Biznese të vogla	161	6.0	966	0.97	20%
Institucione	20	6.0	120	0.12	2.5%
Totali			4,895	4.89	100%

Tabela 5.8.7: Sasi të mbetjeve të ngurta sipas kategorisë së aktivitetit në bashkinë Pukë

Sic mund të shihet nga tabela e mësipërme, vëllimi më i madh i mbetjeve të ngurta bashkiake prodhohen nga banorët e zonës me 71.78% të totalit të mbetjeve të ngurta urbane, të ndjekura nga ndërmarrjet e vogla, të cilat prodhojnë 19.84% të mbetjeve të ngurta urbane


Infrastruktura sociale

Për sa i përket infrastrukturës arsimore është vërejtur se të gjitha vendbanimet e bashkisë shërbehen nga të gjitha nivelet e arsimit, ndërsa në lidhje me infrastrukturën shëndetësore Spitali i qytetit Pukë, qendra shëndetësore në Gjegjan dhe 13 ambulanca të shpërndara në disa vendbanime gjykohet se kanë nevojë për përmirësim dhe rikonstruksion.

Për sa i përket infrastrukturës administrative, ajo gjendet vetëm në selinë e Bashkisë, me rezultat të krijojnë probleme aksesueshmërie për shkak të distancave dhe mangësive të vërejtura në infrastrukturën e transportit.

Të ardhura

Sipas studimit “Drejt Programit Rajonal Operacional” (2015), Bashkia Pukë për vitet 2013-2014 kishte të ardhura totale prej 328.244.000 lekë dhe 348.204.000 lekë respektivisht. Përsa i përket të ardhurave për frymë të Bashkisë, në vitin 2013 arritën në 29.654 lekë, ndërsa në vitin 2014 pati një rritje prej 6,1%, ku të ardhurat për frymë arritën në 31.458 lekë. Më poshtë janë renditur grafiku dhe tabela me të ardhurat për frymë në pesë (5) Bashkitë e Qarkut Shkodër.



Grafiku 5.8.2: Të ardhurat për frymë në Bashkinë Pukë për vitet 2013-2014 (burimi: Ministria e Financave, Instat & SDC)

Qarku	Bashkitë	Të ardhurat e përgjithshme (në 000 në lek)		Të ardhurat totale për frymë (Lek)		Ndryshimi vjetor (%)
		2013	2014	2013	2014	2014/2013
Shkodër	Shkodër	2.624.439	2.608.080	19.353	19.232	-0,60%
	Malësi Madhe	555.522	601.907	18.023	19.528	8,30%
	Vau i Dejës	666.676	700.919	21.903	23.028	5,10%
	Pukë	328.244	348.204	29.654	31.458	6,10%
	Fushë Arrëz	247.531	257.329	33.428	34.751	4,00%

Figura 5.8.8: Të ardhurat për frymë në Bashkinë Pukë për vitet 2013-2014 (burimi: Ministria e Financave, Instat & SDC)

Probleme sociale

Për sa i përket problemeve sociale p.sh. përjashtimi social apo kriminaliteti, nuk ka të dhëna hapësinore që mund të përdoren për analizën rajonale të Bashkisë.

Përfundime

Përsa i përket pabarazive rajonale, mund të vërejmë se ekziston një diferencim në sektorin e infrastrukturave në lidhje me qendrat ekonomike të Shqipërisë dhe i cili duket edhe nga ndryshimi i popullsisë së tyre drejt qendrave të mëdha urbane të vendit, si për shkak të urbanizimit, ashtu edhe për shkak të mungesës së infrastrukturave në Bashkinë në të cilën është kryer studimi.

Më konkretisht, Bashkia karakterizohet nga aksesueshmëri mesatare drejt të lartës, përsa i përket qendrave më kryesore ekonomike të vendit, urbanizim i ulët, ndërsa aksesimi në shërbimet bazë si furnizimi me ujë – kanalizimet dhe administrimi i mbetjeve inerte është i ulët, ndërsa vetëm në qendrat urbane të Bashkisë dhe në disa komuna bashkiake, përfitohet nga këto shërbime.

Përmirësimi i aksesueshmërisë mund të ketë ndikim pozitiv në:

- Shkallë lokale (psh. dekonstrukcioni i qytetit, lëvizje e përditshme),
- Shkallë rajonale (psh. konsolidimi i ofrimit të shërbimeve dhe mallrave tregtarë në të gjithë brendësinë e Qarkut)
- Shkallë ndërajonale/ndërkufitare (psh. rritje e investimeve, specializim në sektorë individualë).

Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturave bazë, si furnizimi me ujë – kanalizimi dhe administrimi i mbetjeve inerte do të ketë ndikim pozitiv në:

- Shkallë lokale: Në përmirësimin e kushteve shëndetësore të banorëve të zonës dhe për rrjedhojë në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, në atraksionin e investimeve në fushën e turizmit dhe në sektorin tregtar dhe në krijimin e vendeve të reja të punës, në zbutjen e fenomenit të urbanizimit të popullsisë drejt qendrave të mëdha urbane.
- Shkallë rajonale: Në konsolidimin e ofrimit të shërbimeve dhe në rritjen e konkurrencës në brendësi të Qarkut.
- Shkallë ndërajonale/ndërkufitare: Në rritjen e investimeve dhe në specializimin e mëtejshëm në sektorët individualë.

5.9. Monumente dhe zona të trashëgimisë kulturore dhe historike

Mjedisi kulturor i zonës së studimit përbëhet nga trashëgimia historike, elementët arkeologjike dhe arkitektonike, veprimtaria kulturore lokale (evente, festime, etj.) dhe nga gjithë tradita popullore (zakonet dhe traditat, legjendat etj.).

Zona është e njohur për traditën e pasur folklorike, me shprehje kryesore muzikën dhe vallet lokale. Eventet muzikore mbajnë të gjallë muzikën lokale dhe trashëgiminë e valleve dhe e ndajnë atë edhe jashtë kufijve.⁴⁶ Zona gjithashtu ka traditë në prodhimet e qeramikës (zona Gojan), zdrukhtarisë, prodhimin e instrumenteve muzikore dhe kostumeve tradicionale të zonës.

⁴⁶ Ansambli Puka në vitin 2001 fitoi çmimin europian “Alfred Toepfer“ për kulturën e artin. (burimi: Çelsi Turistik, Bashkia Pukë)



Fotos 5.9.1.-5.9.2: Instrumente muzikore tradicionale (burimi: Çelsi Turistik, Bashkia Pukë)



Fotos 5.9.3.-5.9.4: Evente muzikore me kostume lokale (burimi: Çelsi Turistik, Bashkia Pukë)

Punime përfaqësuese dhe objekte të artistëve vendas, si instrumente muzikore, vegla, veshje tradicionale etj. që janë ekspozuar në Ekspozitën Etnokulturore në Pallatin e Kulturës Pukë. Ekspонатet tipike janë violina e parë shqiptare e prodhuar në zonë, çmimi evropian “Alfred Topfer” që fitoi Ansambli Puka si dhe objekte të tjera që lidhen me aktivitetin e asambllit.⁴⁷

⁴⁷ Burimi: Çelsi Turistik, Bashkia Pukë



Fotos 5.9.5.-5.9.6: Ekspozitatet në Ekspozitën Etnokulturore Pukë (burimi: Çelsi Turistik, Bashkia Pukë)

Bashkësia lokale e mban gjallë trashëgiminë kulturore, qoftë përmes pjesëmarrjes në festivale kulturore, evenimente sociale dhe fetare etj., qoftë përmes vazhdimësisë dhe transmetimit të traditatave, legjendave, zakoneve etj. brezave të rinj. I çmuar është edhe kontributi i artistëve vendas, të cilët komunikojnë me veprat e tyre, historinë dhe traditën në një shkallë më të gjerë (jashtë kufijve të Bashkisë).

Rezerva arkeologjike e Bashkisë disponon prova të mrekullueshme që dëshmojnë për historinë e zonës dhe pasqyrojnë arkitekturën tradicionale lokale. Disa prej tyre janë karakterizuar monumente kulture me rëndësi arkeologjike ose historike dhe me status mbrojtje të posaçme. Shembuj tipikë të arkitekturës lokale janë shtëpitë kulla, banesa që janë të shprehura në tipin e kullave). Sipas Institutit të Monumenteve të Kulturës, monumentet kulturore të bashkisë së Pukës janë renditur në tabelën e mëposhtme:

EMRI I MONUMENTIT	INSTITUCIONI I SHPALLJES	Nr. VENDIMI	DATA E SHPALLJES
Kalaja e Dalmacës në fshatin Koman	Rektorati i Universitetit Shtetror	6	15.01.1963
Kështjella dhe Kishat e Kabashit, Rrapë	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	786/ 1	05.11.1984
Shkolla muze "Migjeni", Pukë, Pukë	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	8	18.12.1987
Shpella e Kaurit, Qelëz	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	786/ 1	05.11.1984
Varrezat e lashta të Komanit, Qerret	Rektorati i Universitetit Shtetror	6	15.01.1963

Tabela 5.9.1: Monumentet kulturore të Pukës

Kalaja e Dalmacës, sipas Vendimit nr. 6 datë 15.01.1963 të Rektoratit të Universitetit Shtetëror, i përket mbrojtjes së kategorisë së 1^{re}. Bëhet fjalë për gërmadha/ mbetje banimesh të zbuluara në vitin 1899 në veriperëndim të Bashkisë (në zonën e Komanit), në një sipërfaqe prej 2 hektarësh në

570 metra lartësi. Gjetjet në nivelin e mesëm tregojnë grumbullim të dëndur ndertimesh të dokumentuara dhe mure të shumta, që shtrihen në një zonë 105m² dhe që datojnë (faza e parë) fundi i periudhes antike). Në nivelin e ulët (230 metra katrorë), janë shpëtuar mure që datojnë midis shekujve të 8 dhe të 12^{-të}. Në këtë zonë u gjetën armë, vegla, bizhuteri dhe objekte të tjera që demonstrojnë banimin dhe vazhdimin e kulturës Iliro-Arbnore.

Analitikisht, Keshjtella dhe Kishat e Kabashit ndodhen në zonën Rrapë. Është një kështjellë e ndërtuar në veri të Shqipërisë në shekullin e 17^{të} nga Koroneli, i njohur edhe si "kala druri Gabassu". Kanë mbetur mbetje të mureve, të cilat tregojnë një pikë vëzhgimi dhe fortifikimi. Në këtë zonë, u ndërtua një platformë ku më vonë u ndërtua kisha e Shen Palit. Për ndërtimin e platformës u përdorën gurë 25 m të gjatë, duke i dhënë asaj një formë gjysmërrethe si një hark. Poshtë platformës, kishte mbetje nga një ndërtesë e vjetër. Materiali i tavanit ka të njëjtin stil dallues si kështjellat Vig dhe Bushat të shekullit të 4^{rt}. Fillimisht, në shekullin e 4^{rt} u ndërtua një kishë. Më vonë, pas shkatërrimit të saj, u ndërtua një kishë mesjetare dhe në fund u zëvendësua me një kishë të re. Zona e Kabashit ishte një pikë me rëndësi ushtarake dhe ekonomike për rajonin.



Foto 5.9.7.-5.9.8: Kishat e Kabashit (burimi: grupi i studimit)

Shkolla Muze "Migjeni" gjendet në zonën e Pukës, 200 m larg nga qendra e qytetit. Shkolla e mori emrin nga poeti Migjeni, i cili mbërriti në Pukë më 1936. Është një ndërtesë që funksiononte si shkollë me një mësues dhe një drejtor (midis të tjerash) njohur për punën e Migjenit dhe tani shtëpi muze me fotografi, libra dhe materiale të tjera për jetën dhe punën e tij. Ndërtesa është njëkatëshe me elementë guri, betoni dhe hekuri dhe ka një shkallë të jashtme. U ndërtua në vitin 1936 dhe që atëherë ka qenë subjekt i riparimeve dhe ndërhyrjeve që kanë ndryshuar në një farë mase karakterin e saj origjinal.



Foto 5.9.9: Shkolla Muze "Migjeni"



Foto 5.9.10: Tabela me emrin "Migjeni"

Në hapësirat arkeologjike të qytetit, përfshihen Shpella e Kaurit, e cila edhe u analizuar në kapitullin 4.2 së bashku me elementët e mbrojtura të mjedisit natyror, dhe Varrezat e Lashta të Komanit. Bëhet fjalë për një varrezë që e morri emrin nga Komani, vendi ku ajo edhe ndodhet. Më konkretisht, ajo i takon rajonit të Qerretit dhe ndodhet në një kodër të lartë 586 metra. Bazuar në gjetjet, vlerësohet se varrezat janë të shekullit të 6^{të}. Në varrezë ka më shumë se 150 varre. Gërmimi i parë ishte 1898 nga Degrand dhe më vonë në 1902 nga Han dhe T. Ippen. Qysh atëherë, shumë arkeologë shqiptarë janë përfshirë në gërmimet në këtë zonë.

5.10. Të dhëna për Personat me Përgjegjësi të Kufizuar

Në regjistrimin e vitit 2011 u bë përpjekja e parë për të përcaktuar numrin e popullsisë banuese, 15 vjeç e lart, sipas gjendjeve të ndryshme dhe llojit të aftësisë së kufizuar. Në Bashkinë Pukë, 7.35% e popullsisë ka ndonjë aftësi të kufizuar (p.sh. në shikim, lëvizshmëri, komunikimi).

Përbërja është pothuajse e barabartë midis meshkujve dhe femrave. Megjithatë, në Qerret femrat janë dukshëm më të shumta, ndërsa në 4 njësitë e tjera administrative mbizotëron përqindja e meshkujve.

	GJINIA DHE GJENDJA E AFTËSISË SË KUFIZUAR					
	Gjithsej		Meshkuj		Femra	
	Pa aftësi të kufizuar	Me aftësi të kufizuar	Pa aftësi të kufizuar	Me aftësi të kufizuar	Pa aftësi të kufizuar	Me aftësi të kufizuar
Qarku SHKODËR	156510	12318	76955	5722	79555	6596
Bashkia PUKË	7874	625	3919	319	3955	306
PUKË	2647	107	1302	62	1345	45
GJEGJAN	2033	152	1003	77	1030	75
RRAPË	977	87	490	47	487	40
QELËZ	1232	102	619	55	613	47
QERRET	985	177	505	78	480	99

Tabela 5.10.1 : Popullsia banuese 15 vjeç e lart sipas gjinisë dhe gjendjes së aftësisë së kufizuar

	GJINIA DHE GJENDJA E AFTËSISË SË KUFIZUA		
	Popullsia mbi 15 vjet (gjithsej)	Popullsia mbi 15 vjet me aftësi të kufizuar	Përqindja e njerëzve mbi 15 vjeç që kanë një të kufizuar
Qarku SHKODËR	168828	12318	7.30%
Bashkia PUKË	8499	625	7.35%
PUKË	2754	107	3.88%
GJEGJAN	2185	152	6.96%
RRAPË	1064	87	8.18%
QELËZ	1334	102	7.65%
QERRET	1162	177	15.23%

Tabela 5.10.2: Norma e popullsisë banuese, 15 vjeç e lart, me aftësi të kufizuar

Është vërejtur (Tabela 5.1.10.2) se përqindjet nuk janë shumë të larta në tërësinë e Bashkisë dhe bëjnë dallim midis njësiteve administrative. Varion nga 3.88% në qendrën e Bashkisë, ku është gjetur norma më e ulët, deri në 15.23% në Qerret. Në mes janë njësitë administrative Gjegjan, Rrapë dhe Qelëz, Normat e të cilëve janë të ngjashme dhe në veçanti në rangun e 7-8%. Bashkia dhe Qarku shfaqin imazh të ngjashëm.

	Gjithsej	Lloji i aftësisë së kufizuar					
		Në shikim	Në dëgjim	Në ecje	Në kujtесе	Në kujdesin ndaj vetes	Në komunikim
SHKODËR (Qarku)	12318	4286	3058	7771	3137	3423	2692
PUKË (Bashkia)	625	192	163	389	162	153	159
PUKË	107	38	24	63	29	30	21
GJEGJAN	152	36	46	74	45	38	55
RRAPË	87	15	17	67	19	19	22
QELËZ	102	49	30	65	23	25	19
QERRET	177	54	46	120	46	41	42

Tabele 5.1.10.3 : Popullsia banuese 15 vjeç e lart, sipas llojit të aftësisë së kufizuar

Nga grafiku i mësipërm vërehet se aftësia e kufizuar më e zakonshme e regjistruar është vështirësia në lëvizje në normën 62.24% për të gjithë personat mbi 15 vjeç, të cilët kanë ndonjë aftësi të kufizuar dhe respektivisht 4.58% të popullsisë së përgjithshme të Bashkisë. Llojet e tjera të regjistruara të aftësisë së kufizuar (në shikim, në dëgjim, në kujtесе, në kujdesin ndaj vetes, në komunikim), shfaqen në përqindje të ngjashme duke filluar poshtë 30%.

Bazuar në të dhënat e regjistrimit të INSTAT për të gjithë territorin e Shqipërisë rezulton se 55.6% e popullsisë me aftësi të kufizuara të moshës mbi 15 vjeç ka përfunduar arsimin e detyrueshëm (arsimin e mesëm të ulët) ndërsa 24.3% nuk e ka ndjekur fare shkollën. Ekziston një përqindje e vogël e personave me aftësi të kufizuar (3.3%) që kanë përfunduar arsimin e lartë dhe atë pasuniversitar.

5.11. Të dhëna mbi arsimin profesional⁴⁸

Arsimi i mesëm në Shqipëri përfshin arsimin e përgjithshëm dhe atë profesional. Para viteve 1990, shkollat profesionale përbënin shumicën e arsimit të mesëm (53% e të gjithë gjimnazeve në vitin 1990) kundrejt arsimit të përgjithshëm (26%).

Megjithatë, pas ndryshimit të sistemit politik dhe qysh në pesë vitet e para, situata ndryshoi, duke vënë në plan të parë kërkesën për arsim të përgjithshëm. Gjatë dekadës së kaluar shkollat profesionale përbëjnë rreth 10% të totalit. Reduktimi ka lidhje me gjithë arsimin e mesëm profesional dhe në mënyrë të veçantë shkollat me drejtim bujqësor apo ndërtimor.

Me bazë kuadrin e më lart përmendur, në Bashkinë Pukë nuk funksionon asnjë shkollë profesionale.

⁴⁸ Nuk janë gjetur të dhëna statistikore në nivel bashkie, apo njësie administrative, megjithese për sigurimin e të dhënave ju është dërguar kërkesë zyrtare autoriteteve të mëposhtme (kërkesë në INSTAT N.Pr. 774/10-2-2016).




Diagrama 5.11.1: Përqindje e njëzive shkollore në Arsimin e Përgjithshëm dhe atë profesional (burimi: Të dhëna të raportit vjetor të Shqipërisë)

Viti shkollor	Numri i institucioneve për nga lloji i tyre		
	Totali	9 vjeçare-gjimnaz	Shkolla profesionale
2004-2005	581	515	66
2005-2006	589	530	59
2006-2007	597	538	59
2007-2008	601	544	57
2008-2009	600	543	57
2009-2010	604	546	58
2010-2011	608	548	60
2011-2012	606	546	60
2012-2013	609	550	59
2013-2014	610	552	58

Tabela 5.11.1: Numri i institucioneve të Arsimit të mesëm sipas llojit në Shqipëri

6. ANALIZA DHE VLERËSIMI I PËRDORIMEVE TË TOKËS DHE MJEDISIT TË NDËRTUAR

Në këtë kapitull bëhet klasifikimi i përdorimeve të tokës në 5 sistemet territoriale: natyrore, ujore, bujqësore, urbane dhe të infrastrukturës. Tabela tregon përqindjen e tokës që mbulon secili sistem në Bashkinë e Pukës.

SISTEMI TERRITORIAL	PËRQINDJA %
Sistemi natyror	92.4%
Sistemi ujor	1.5%
Sistemi bujqësor	4.4%
Sistemi urban	1.0%
Sistemi infrastrukturor	0.7%

Tabela 6.1 : Përqindjet e sistemeve territoriale në Bashkinë Pukë

Nga tabela rezulton se përqindja më e madhe e territoreve në Bashkinë Pukë mbulohet nga sistemi natyror me 92.4%, ndërkohë që pasojnë sistemi bujqësor me përqindje 4.4%. Pason sistemi urban me 1.5%, ndërsa sistemi urban dhe sistemi infrastrukturor mbulojnë nën 1% dhe 0.7% të sipërfaqes së Bashkisë.

6.1. Sistemi natyror i përdorimit të tokës

Sistemi natyror i përdorimit të tokës përfshin të gjitha ato përdorime që lidhen me zonat natyrore: pyjet, kullotat, livadhet dhe zonat jo pjellore të relievit gjysmëmëlor. Më poshtë jepen të dhënat për përdorimin e tokës në sistemin natyror:

- Në jug të Pukës shtrihen bjeshkët e Tërbunit që përbën elementi natyror më karakteristik të sistemit, si për shkak të madhësisë së tij, ashtu edhe vlerave të tij natyrore dhe kulturore. Mali mbetet i paprekur dhe aktivitetet në të janë të kufizuara dhe periodike.
- Zonat e gjera pyjore mbulojnë pjesën më të madhe të Bashkisë Pukë, kryesisht në jug dhe në perëndim të qytetit me të njëjtin emër. Një karakteristikë e përbashkët e këtyre zonave është se karakteri i tyre nuk është ndryshuar, pasi qasja në to bëhet kryesisht përmes përdorimit të monopateve të paarrtshme dhe në pika të veçanta përmes segmenteve rrugore që çojnë në vendbanimet dhe njësitë administrative pranë Bashkisë. Ky fakt ka rrezikun që në rast zjarri, bëhet e vështirë qasja e drejtpërdrejtë e automjeteve e zjarrfikëseve në lidhje me terrenin gjysmëmëlor.
- Për sa i përket tokave kullotëse, ato zakonisht ndodhen brenda një rrezeje të shkurtër rreth vendbanimeve me orientim kryesor ekonomik blegtorinë, por që normalisht i shërbejnë nevojave jetësore të banorëve dhe i përkasin sipërfaqeve gjysmëmëalore që nuk ofrojnë ndonjë mundësi tjetër shfrytëzimi.

6.2. Sistemi i përdorimit të vijave të tokës

Vëllimet e ujit që përshkojnë ose vijnë nga Bashkia Pukë janë lumenjtë Fan i Madh, Gomsiqe, Gjadri dhe Gomina. Më i madhi nga të gjithë, Lumi i Fanit të Madh është i vendosur në pjesën juglindore të Bashkisë dhe rrjedh nga veriu në jug, lumi Gjadri rrjedh në jugperëndim të Bashkisë në kufi me Bashkinë e Mirditës, ndërsa Gomina rrjedh në veri të Bashkisë. Shtrati i lumit i lumit Fan i Madh nuk paraqet gjerësi konstante përgjatë gjithë gjatësisë së tij, kryesisht për shkak të strukturës gjeologjike të tokës. Kalimi i Fanit të Madh bëhet me anë të veprave të vogla teknike (kryesisht ura dhe ura për këmbësorë), të cilat bazohen në shpatet natyrore të lumit. Në zonën pranë shtratit të Fanit të Madh nuk ka përdorime të konsiderueshme industriale dhe tregtare, kështu që problemi i hedhjes së mbetjeve të lëngshme në lumë lidhet me aktivitetet e banimit dhe bujqësore e blegtorale dhe nuk është intensiv. Megjithatë, në shtratin e lumit derdhet një përrua i vogël, i cili vjen nga vendbanimi Kimëz ku, për shkak të ekzistencës së minierave për nxjerrjen e bakrit dhe mineraleve të tjera, kjo përbën eventualisht një burim të mundshëm kontaminimi. Në zonat e tjera, lumi është afër përdorimeve bujqësore dhe është në distancë të sigurt nga vendbanimet. Aktivitetet e peshkimit dhe notit janë veçanërisht të kufizuara.

Për shkak të gjeomorfologjisë së veçantë të Bashkisë së Pukës, në sajë të maleve Munella dhe Tërbun janë formuar gjatë viteve shumë pellgjeve ujëmbledhës, përmes të cilave ujërat e shiut kanalizohen në pellgje natyrore të vogla por edhe përrenj (sezonalë ose jo) duke përfunduar në lumenjtë e lartpërmendur. Morfologjia e tokës shkak të ekzistencës të malit të Munellës me shpatet e pjerrëta favorizon formimin e tyre. Përrenjtë kalojnë kryesisht nëpër pyje dhe, në disa raste, nga vendbanimet, p.sh. Kimëz, Mesul, Kaftallë, duke krijuar rreziqe të erozionit të tokës së tyre.

6.3. Sistemi i përdorimit të tokës bujqësore

Në këtë sistem përfshihen të gjitha kulturat bujqësore brenda kufijve të Bashkisë dhe të gjitha infrastrukturat e tyre mbështetëse, siç janë rrjetet e ujitjes, serrat, depot dhe njësitë e mbarështimit të shpeshëve/kafshëve. Mund të bëhet dallimi i këtyre zonave në dy nën-kategori: ato që ndodhen në zonat fushore të Bashkisë, si p.sh. përgjatë lumit Fan i Madh dhe Gomina, në zonën e Qerret, Kçirë (Luf, Luf-Plan) në luginën Kaftallë, etj, dhe atyre që gjenden në pjesën më malore të saj. Shumica e kulturave fushore nuk janë të rrethuara, ato kanë të bëjnë me prodhimin e bimëve foragjere dhe vreshtave të vogla dhe janë të ujitura. Në përgjithësi, në Bashki nuk hasen zona që përdorin serra.

Në vendbanimet më veriore dhe në ato me lartësi më të madhe ka sipërfaqe të punueshme shumë të kufizuara, të cilat kufizohen nga vegjetacioni natyror dhe nuk janë lehtësisht të arritshme për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore të mjaftueshme dhe të relievit.

Rrjeti i ujitjes përfshin një numër të vogël të rezervuarëve, kanaleve me gjatësi të madhe (si të ndërtruara, ashtu dhe kryesisht me tuba plastikë) dhe depozitave në pronësi bashkiake dhe kryesisht private, dhe vitet e fundit ka pasur projekte për përmirësimin e tij.

Objektet bletorale janë të kufizuara dhe zakonisht janë të vendosura në ambientin e banimit.

Theksohet se në kuadër të sistemit bujqësor janë përfshirë edhe banesat individuale të vendosura brenda kulturave bujqësore. Këto janë vendbanime të përhershme të bujqve.

Së fundmi, sqarohet se për shkak të madhësisë, rregullimit dhe shpërndarjes së tokës bujqësore, nuk ka rrugë të veçanta për shërbimin e kulturave.

6.4. Sistemi i përdorimit të tokës urbane

Rrjeti urban i Bashkisë Pukë ka si qendër qytetin e Pukës dhe një numër vendbanimesh të tjera, të cilat shtrihen në të gjithë sipërfaqen e njësisë administrative të Rrapës, Gjegjanit, Qerretit dhe Qellëzit, me përjashtim të Tërbunit.

Qyteti i Pukës është qendra ekonomike e Bashkisë me të njëjtin emër por edhe e zonës më të gjerë, duke qenë se është një qendër ku janë grumbulluar shërbimet. Përveç qytetit të Pukës, i cili do të analizohet më pas, vendbanimet e tjera janë vetëm për përdorim banimi dhe vetëm në më të mëdhatë prej tyre hasen disa shërbime elementare, të tilla si dyqan argëtimi (kafene) dhe dyqane ushqimore, të cilat u shërbejnë nevojave të përditshme të popullsisë lokale, por edhe kalimtarëve. Gjithashtu, ka shërbimet publike bazë (p.sh. shkolla, ambulanca), ndërsa në qendrat e ish-komunave ndodhet në pikë qendrore zyra e komunës, që mbulon nevojat direkte të të gjithë popullsisë. Së fundmi, kudo, madje edhe në vendbanimet periurbane, ka kopshte me perime dhe kultura bujqësore në hapësira të vogla ndërmjet shtëpive.

Në qytetin e Pukës ka grumbullim të shërbimeve. Përdorimet e banimit, tregtisë private dhe shërbimeve publike shpërndahen ndërmjet tyre dhe janë të organizuara në mënyrë lineare përgjatë rrugës kryesore të qytetit, pjesë e së cilës do të bëhet me trotuar. Në hyrje të qytetit janë ngjitur me njëra-tjetrën ndërtesa e policisë dhe gjykatës dhe përgjatë rrugës kryesore ka banka, dyqane këmbimi valutor, ofrim shërbimesh të telefonisë celulare si dhe restorante - argëtim, shërbime arsimore dhe shëndetësore (spital), dyqanet e shitjes me pakicë, hotele. Siç mund të shihet, përdorimet e tregtisë dhe shërbimeve private janë të organizuara kryesisht në mënyrë lineare përgjatë dy akseve rrugore kryesore të qytetit. Ka mundësi parkimi të përkohshëm për automjetet për t'u shërbyer qytetarëve në ambientin e ri pas Qendrës Kulturore.

Përdorimet e industrisë janë të kufizuara dhe hasen në zonën në veriperëndim të rrjetit urban në distancë shumë të afërt me të, si për shkak të hapësirës së disponueshme dhe infrastrukturave ashtu dhe në shërbim të qasjes në këto njësi për fuqinë punëtore dhe për makineritë e furnizimit. Më konkretisht, në këtë zonë janë vendosur një njësi e vogël me aktivitet prodhimin e materialeve të ndërtimit dhe gjithashtu një njësi e vogël e prodhimit të këpucëve por me vetëm me karakter eksporti. Në qendër të qytetit ka një fabrikë birre me kapacitet të vogël.

Vlen të përmendet se brenda kufijve të Bashkisë Pukë ka vende për gjermimin e burimeve minerare, kryesisht gurë gëlqerorë, të cilat zakonisht përdoren në punimet e ndërtimit dhe në vepra të ndryshme teknike. Vendet e gjermimit të gurëve gëlqerorë ndodhen pranë vendbanimeve të Gomsiqe, Plet dhe Korthpulë etj.

Njësitë arsimore përfshijnë kopshte, shkolla 9-vjeçare dhe shkolla të mesme të përhapura në tërë zonën e Bashkisë, me përqendrim më të lartë në qytetin e Pukës (shih Kapitullin 5.6). Sot funksionojnë gjithsej 16 shkolla 9-nëntëvjeçare, 8 shkolla fillore, 1 shkollë e mesme, 3 shkolla të mesme të bashkuara dhe 19 kopshte.

Përdorimet shëndetësore në Bashkinë e Pukës janë të organizuara në tri kategoritë kryesore, si: a) ambulancë, b) qendra shëndetësore, dhe c) spitale. Më konkretisht, ambulancat, të cilat ofrojnë shërbimet bazë, ekzistojnë në pothuajse të gjitha vendbanimet e Bashkisës së Pukës përveç qytetit dhe fshatrave (Gjegjan, Luf, Qelza) që shërbehen nga qendra shëndetësore. Në qytetin e Pukës gjendet edhe Spitali-Poliklinika në aksin rrugor kryesor të qytetit.

Në qytetin e Pukës ka 2 objekte sportive kryesore: një fushë futbollit me një podium për shikuesit, që ndodhet jashtë bërthamës urbane dhe një palestër e mbyllur e sapondërtuar. Mungojnë fushat e vogla, të hapura, sportive për fëmijë me përdorime të ndryshme të shpërndara në pjesën tjetër të vendbanimeve, përveç shumë pak rastesh që nuk janë në gjendje të mirë.

Gjithashtu dhe infrastrukturat janë të pakta dhe të kufizuara në qytetin e Pukës: një Qendër Kulturore që përmban dhe hapësirë ekspozite dhe një muze i vogël kushtuar poetit Migjeni.

Në përdorimet e veçanta të tokës përfshihen varrezat. Këto ekzistojnë në të gjitha vendbanimet e Bashkisë, zakonisht në disa pika të skajshme (ose në hyrje ose në dalje të fshatit). Në Pukë, varrezat ndodhen në autostradën SH 5 që kalon në mënyrë perimetrike në qytet.

Brenda Bashkisë Pukë ka shumë objekte ushtarake, të cilat nuk janë më funksionale. Më konkretisht, në hyrjen perëndimore të qytetit ka dy hapësira objektsh ushtarake, tani joaktive, si dhe pranë komunës Gjegjan. Përveç kësaj, në zonat malore ka objekte të braktisura ushtarake, si p.sh. në Tërbun.

Objektet fetare brenda Bashkisë ndahen në dy kategori:

- Së pari: kishat katolike dhe vendet përkatëse të kultit. Në qytetin e Pukës nuk ka kishë, por dy vende kulti, një kishëz dhe tjetra që i përket Urdhrit të Nënës Terezë. Në vendbanime të tjera ekzistenca e kishave apo jo është e lidhur drejtpërdrejt me popullsinë që jeton në to.
- Së dyti: xhamitë. Në Pukë ndodhen dy xhami, dhe një e madhe e ndërtuar së fundmi në Qerret i Madh.

Së fundi, zonat e gjelbra publike (p.sh. parqet, sheshet, këndet e lojërave) janë mjaft të kufizuara në të gjitha vendbanimet e Bashkisë, madje edhe në qytet, ku, megjithatë, janë duke u zhvilluar projekte cilësore dhe sasiore.

6.5. Sistemi i përdorimit të tokës së infrastrukturës

Aksi rrugor kryesor që përshkon Bashkinë e Pukës dhe është pjesë e Rrjetit Rrugor Kombëtar të Shqipërisë është rruga SH5 që lidh qytetin e Shkodrës në veriperëndim me qytetin e Kukësit në verilindje. SH5 përbëhet nga një korsi për drejtim, është ndërtuar pa një trafikndarës dhe ka degëzime me rrugë lokale që çojnë në vendbanimet e tjera të Bashkisë. Si SH5 ashtu dhe rrugët lokale përshkojnë në pjesën më të madhe të tyre sipërfaqe natyrore.

Një tjetër aks i rëndësishëm rrugor, i cili është gjithashtu pjesë e Rrjetit Rrugor Kombëtar, është aksi SH30, i cili shkon nga veriu në jug dhe fillon nga njësi administrative Rrapë, vazhdon drejtimin përgjatë lumit Fan i Madh, përshkon Gjegjanin dhe përfundon në Jug në Bashkinë Mirëditë. Edhe ky është i përbërë nga një korsi për drejtim dhe gjithashtu është ndërtuar pa

trafikndarës dhe në këtë kohë kryhen punime për rindërtimin e sipërfaqes së rrugës dhe rritjen e sigurisë.

Vlen të përmendet se në përgjithësi ka një lidhje të pamjaftueshme ndërmjet vendbanimeve të ndryshme, që ka si rezultat rëndimin më të madh të rrugëve shtetërore SH5 dhe SH30, pasi nëpërmjet tyre bëhet lidhja rrugore e komunave të ndryshme. Megjithatë, ngarkesa e tyre e trafikut është relativisht e vogël.

Për sa i përket infrastrukturave të tjera, shënohen një numër objektesh që zakonisht gjenden brenda sistemit natyror:

- tre hidrocentrale në zonën e gjerë të fshatrave Kabash dhe Qelëz dhe në njësinë administrative Gjegjan, ndërsa diga e Komanit ndodhet në kufijtë e Bashkisë me Bashkinë Vau i Dejës.
- infrastruktura e transmetimit të energjisë elektrike, si transformatori dhe kabina elektrike, zakonisht të vendosura brenda zonave të banuara.
- një nënstacion elektrik brenda qytetit Pukë.
- 2 vende aktive për deponimin e mbeturinave (një që i shërben Bashkisë dhe tjetri bashkisë fqinje të Fushë-Arrëzitet), të cilat rrethohen me sipërfaqe natyrore.
- stacionet dhe antenat e telekomunikacionit

6.6. Kategoritë bazë të përdorimit të tokës

Lidhur me përdorimin e tokës që u përdoren në studim, është bërë evidentimi i gjendjes aktuale duke përdorur përdorimet e propozuara të VKM-së e cila është në proces miratimi (rishikimi i VKM nr.671/2015) dhe në veçanti 22 kategoritë e përdorimit të tokës, sipas tabelave 1.6.1. në 1.6.5.

SISTEMI URBAN		
KATEGORI	NËNKATEGORI	PËRDORIME SPECIFIKE
Banimi	A1-Banim Një-Familjar A2-Banim Shumë-Familjar	A1-1.Banim + Shërbime A1-3.Ambiente ndihmëse A1-5.Hapësirë e Përbashkët A2-1.Banim + Shërbime
Shërbime	S1-Shërbime Akomodimi dhe Argëtimi S2-Shërbime Tregtare S3-Shërbime Zyre	S1-1.Hotele S1-3.Bujtina S1-6.Bar, Restorant S2-4.Treg pakice S2-6.Dyqane / Profesione te lira S3-1.Zyra
Industri Ekonomi	IE1-Industri e Lehtë IE2-Industri e Rëndë	IE1-2.Ushqimore IE1-3.Veshmbathje IE1-5.Përpunim druri IE2-3.Nyje inertesh IE2-4.Fabrika përpunimi metalesh IE2-5.Gurore IE2-7.Miniera
Institucione	IS1-Administratë Publike IS2-Shërbim Publik	IS1-1.Qëndrore IS1-3.Vendore

	IS5-Institucione Financiare IS6-Institucion Fetar	IS2-1.Policia IS2-2.Posta IS2-4.Shërbime gjyqësore IS2-6.Zjarrëfikëse IS5-2.Bankë e nivelit të dytë IS6-1.Kishë IS6-2.Xhami
Arsim	AS1-Arsim Parashkollor AS2-Arsim i Ulët AS3-Arsim i Mesëm	AS1-2.Kopësht AS2-1.Shkollë fillore AS2-2.Shkollë 9-vjeçare AS3-1.Shkollë e mesme AS3-4.Seminar
Shëndetësi	SH1-Shërbim Ambulator SH2-Shërbim Spitalor	SH1-2.Ambulancë SH1-4.Qendër shëndetësore SH2-1.Spital
Aktivitete Shoqërore & Argëtimi	AR1-Hapësira Publike AR2-Aktivitete Kulturore AR3-Aktivitete Sportive	AR1-1.Parkurban AR1-5.Hapësirë e Gjellbër / e Përbashkët AR1-6.Kënd Lojrash AR2-1.Qendër kulturore AR2-4.Muze AR3-4.Terren sportiv AR3-9.Pallat sporti
Monumente	M1-Monument Kulture	M1-1.Kala M1-3.Ndërtesë (e pabanuar, e rrënuar)
Zona ushtarake	ZU1-Infrastrukturë Ushtarake	ZU2-6.Repart Ushtarak
Varreza	V1-Varreza publike V2-Varreza Dëshmorësh	V1-1.Katolike

Tabela 1.6.1: përdorimet e tokës në sistemin urban bazuar në regjistrimin në vend.

SISTEMI INFRASTRUKTUROR		
KATEGORI	NËNKATEGORI	PËRDORIME SPECIFIKE
Infrastrukturë Transporti	INT1-Infrastrukturë Rrugore	INT1-3.Interubane dytësore (C) INT1-5.Urbane dytësore (E) INT1-6.Lokale (F) INT1-7.Parkim INT1-8.Pika shërbimi karburanti INT1-9.Terminal
Infrastrukturë Energjitike	IEN1-Elektike IEN2-Hidrike	IEN1-2.Nënstacion IEN1-3.Transformator IEN1-4.Kabinë elektrike IEN1-5.Shtylla elektrike IEN2-2.Hidrocentral me derivacion
Infrastrukturë Telekomunikacioni	ITK2-Antena	ITK2-2.Telefonike
Infrastrukturë Ujësjellës Kanalizime	IUK1-Ujësjellës	IUK1-3.Depo uji

Infrastrukturë Menaxhimi Mbetjesh	IMB2-Depozitim mbetjesh	IMB2-2.Pika grumbullimi
---	-------------------------	-------------------------

Tabela 1.6.2: përdorimi i tokës në sistemin e infrastrukturës, bazuar në regjistrimin në vend.

SISTEMI BUJQËSOR		
KATEGORI	NËNKATEGORI	PËRDORIME SPECIFIKE
Bujqësi	B2-Kultura Sezonale	B2-1.Drithëra B2-3.Perime B2-6.Komplekse
Infrastrukturë Bujqësore	IB3-Vaditje + Kullim	IB3-1.Argjinaturë IB3-3.Kanal vaditës IB3-5.Rezervuar
Bujqësi + Banim + Shërbime	BAS1-Banim + Bujqësi	

Tabela 1.6.3: Përdorimet e tokës në sistemin bujqësor, bazuar në regjistrimin në vend.

SISTEMI NATYROR		
KATEGORI	NËNKATEGORI	PËRDORIME SPECIFIKE
Tokë Natyrore	N1-Ryje N2-Kullotë N5-Tokë Pa Frut	N1-1.Të dendur N2-3.E përzier (shkurre) N5-2.Shkëmbore N5-3.Birnësi e rrallë

Tabela 1.6.4: Përdorimet e tokës në sistemin natyror, bazuar në regjistrimin në vend.

SISTEMI UJOR		
KATEGORI	NËNKATEGORI	PËRDORIME SPECIFIKE
Ujëra	U2-Liqen U4-Përrua U5-Burim ujor	U2-2.Artificial U4-1.Përrua i përhershëm U5-1.Burim uji i freskët

Tabela 1.6.5: Përdorimet e tokës në sistemin ujor, bazuar në regjistrimin në vend.

7. ANALIZA DHE VLERËSIMI I INFRASTRUKTURËS

7.1. Transporti

Bashkia e Pukës përshkohet nga rruga SH-5, që lidh Shkodrën me Kalimashin dhe Kuksin dhe nga A1 (Korridorin 7, sipas Rrjetit të Transportit Rajonal të Evropës Juglindore) me Kosovën. Gjithashtu, ajo përshkohet nga SH-30, duke filluar nga Miloti deri në Kaulina, ku kryqëzohet me SH-5. Me këtë infrastrukturë rrugore, Bashkia është e lidhur me A1 (Korridorin 7), i cili fillon nga Miloti deri në Rrëshen si autostradë dhe vazhdon si autostradë deri në kufirin me Kosovën, me përjashtim të disa kilometrave në afërsi të Kuksit. Ekzistenca e këtyre rrugëve (SH-5 dhe SH-30), edhe në kushtet e tyre të tanishme, siguron lidhjen e Bashkisë me qendrën e Qarkut Shkodër në veriperëndim dhe Kuksin në Lindje, me Vorën në Jug dhe në zgjatim me kryeqytetin e vendit. Për më tepër, të njëjtat rrugë, nëpërmjet lidhjes së tyre me SH-1 (SH-5, përmes SH-28 dhe A1 direkt) sigurojnë lidhjen e Bashkisë me Tiranën, Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza" të Tiranës (SH-52, SH-56) dhe Portin e Durrësit (SH-52 dhe SH-2).

Përmirësimi i segmentit Rrëshen - Milot në A1, siç parashikohet nga Strategjia Kombëtare e Transportit, si dhe ndërtimi i atij Thumanë - Vorë / Kashar dhe dyfishimi i rrugës Fushë Krujë - Shkodër në SH-1, do të rrisë lidhjen e Bashkisë me zemrën e vendit, sidomos në qoftë se rrugët kryesore ndër-qytetase (të paktën SH-5 dhe SH-30 - që tashmë po përmirësohen) do të përmirësohen gjithashtu. Për më tepër, A1 siguron lidhjen me aeroportin e Kukësit, i cili parashikohet të përmirësohet deri në vitin 2020.

Përgjatë kufirit të saj verior dhe liqenit të Vaut të Dejës, Bashkia përshkohet për 11,5 km nga SH-25, e cila lidh Qafë Qelën me Komanin. Një projekt i ri për ndërtimin e rrugës Koman-Fierzë është duke u zhvilluar në Bashkinë fqinje të Vaut të Dejës, si pjesë e rrugës Mali Zi - Shkodër - Bushat - Tropojë - Kosovë dhe pritet që të lidhë një zonë me potencial të madh turistik dhe ekonomik.

Lidhur me hekurudhat, rrjeti ekzistues funksionon nga Durrësi/Tirana në Milot, Lezhë dhe Shkodër. Prandaj, SH-5 dhe SH-30 sigurojnë qasje në rrjetin hekurudhor: në drejtim të Shkodrës, e cila konsiderohet nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar si stacioni kryesor hekurudhor për mallra dhe pasagjerë, dhe Repe, Rrëshen dhe Milot ku krijimi i një qendre logjistike do të shqyrtohet sipas Strategjisë Kombëtare të Transportit. E njëjta strategji nuk parashikon ndonjë projekt hekurudhor për lidhjen e Milotit me Rrëshenin, Kukësin dhe Kosovën. Megjithatë, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon zhvillimin e kësaj infrastrukture hekurudhore deri në vitin 2030.

Transporti - Vlerësimi i gjendjes ekzistuese në Bashkinë Pukë

Vlerësimi i infrastrukturës së transportit, kërkesave dhe karakteristikave të tij, presupozon një regjistrim të hollësishëm të gjendjes ekzistuese. Si rrjedhojë, Konsulenti, pas hulumtimeve përkatëse për çështjet e transportit me fokus Bashkinë dhe ofrimin e të dhënave nga Institucionet Kombëtare (Autoriteti Rrugor Shqiptar, etj.), përgatiti një pyetësor të strukturuar, i cili i u dërgua autoriteteve bashkiake në për të përfituar njohuri më të thella mbi sistemin e transportit komunal.

Pyetësori kishte për qëllim mbledhjen e informacionit dhe të dhënave mbi karakteristikat fizike dhe operuese të rrjetit ekzistues të transportit, kërkesat e transportit dhe shërbimet e transportit masiv,

polet e interesit dhe qëllimet e udhëtimit, si dhe nevojat për përmirësim dhe projektet e planifikuara ose të propozuara. Pyetësi, si mjet i mbledhjes së të dhënave, është planifikuar të kombinohet me vizita në terren, takime me palët e interesuara dhe intervista / dëgjesa të shkurtra të organizuara me popullatën lokale.

Përshkrimi i rrjetit të rrugëve komunale

Bashkia e Pukës përshkohet nga rruga SH-5, e cila siguron lidhjen me autostradën Shkodër dhe SH-1 (Korridori SEETO 2b) në anën lindore dhe autostradën Milot-Kukës-Morinë A1 (Korridori SEETO 7) në anën perëndimore. SH-5 klasifikohet si rrugë e kategorisë C dhe është rrugë e asfaltuar, shtrihet në kufijtë e Bashkisë me Shkodrën dhe Kuksin, është 72 km e gjatë dhe përshkohet për gati dy orë. Kjo është rruga kryesore që lidh Pukën me Fushë Arrezin në lindje (guidim 40 minuta) dhe Vaun e Dejes në perëndim (guidim 1 orë).

SH-25 përshkon Bashkinë që lidh Qafë Laçin (Kthtesa Qafë Qelë) me Komanin në Bashkinë fqinje Vau i Dejës përgjatë lumit Drin. Është një rrugë e asfaltuar 34 km e gjatë me gjerësi 6 m. Brenda kufijve të Bashkisë gjatësia e saj është 11,5 km dhe kërkon më shumë se gjysmë ore me makinë.

SH-30, e klasifikuar si rrugë e kategorisë C, shtrihet nga Qafë Benë në kufijtë me Bashkinë Mirditë dhe është 29 km e gjatë dhe përshkon Gjegjanin, Urën Kalivare, Shkozën dhe përfundon në Kryqzimin Hadroj. Është një rrugë e asfaltuar 6 metra e gjerë. Ajo pëshkohet për 1 orë. Konsiderohet si arterie kryesore që lidh Pukën me vendbanimet e Bashkisë.

Një tjetër arterie kryesore për lidhjen me vendbanimet është edhe rruga që lidh Qelzën, e cila është gjithashtu një rrugë e asfaltuar. Koha e ngarjes së makinës është rreth 20-30 minuta.

Së fundmi, SH-43 kalon në rajonin lindor të Bashkisë që lidh SH-40 me SH-5 në Fushë Arrëz. Është klasifikuar si rrugë e Kategorisë F dhe brenda Bashkisë lidh Bardhet me Tucin dhe Qafë Barin, është 19 km e gjatë dhe përshkohet për 1 orë.

Të gjitha rrugët e tjera, duke filluar nga rrugët kryesore të lartpërmendura dhe që lidhin vendbanimet përreth, përveç Pukës - Dedaj - Qelëz - Koderboj, janë rrugë me zhavorr me kalldrëm prej 2-10cm dhe shumë prej tyre janë të aksesueshme duke përdorur automjete 4X4. Gjatë dimrit, shumë vendbanime nuk janë të arritshëm për shkak se mbulohen nga dëborat.

Në përgjithësi, për shkak të distancës, qasja e selisë së Bashkisë me pjesën tjetër të rrjetit kombëtar nuk mund të konsiderohet mjaft e kënaqshme përsa i perket lidhjes me rrjetin kryesor (më shumë se 1 orë me SH-1 dhe pothuajse 2 orë me A1) dhe qytete të tjera të rëndësishme dhe pika nyjore në Shqipëri. Distanca dhe koha e udhëtimit nga Puka në destinacione të ndryshme të rëndësishme kombëtare dhe të tjera fqinje janë përmbledhur në tabelën më poshtë:

Destinacioni	Distanca	Koha e udhëtimit
Tirana	135	2 orë e 35min
Aeroporti Tiranës	120	2 orë e 15min
Porti Duresit	140	2 orë e 30min
Aeroporti Kukësit	114	2 orë e 35min (nëpërmjet SH-30 dhe korridorit 7, e njëjtë nëpërmjet SH-5)
Stacioni hekurudhor Milot	90	2 orë e (nëpërmjet Vaut te Dejës)

Lezhë / Stacioni Hekurudhor	74	1 orë e 30min
Shkodër / Stacionin hekurudhor	55	1 orë e 16min

Duke marrë parasysh gjithashtu se distancat kohore të lartpërmendura kanë të bëjnë me qytetin e Pukës si seli e Bashkisë dhe duke vlerësuar distancat kohore nga Puka në vendbanimet më të rëndësishme të Bashkisë, qasja e përgjithshme e Bashkisë konsiderohet shumë e ulët për qytetet periferike dhe sidomos për fshatrat.

Shpejtësia mesatare aktuale përgjatë rrjetit, siç llogaritet nga distanca kohore, është shumë e ulët (33km / orë). Distancat dhe koha e udhëtimit nga Puka në vendbanimet e ndryshme të Bashkisë dhe qytetet fqinje, siç parashikohet nga autoritetet Bashkiake dhe plotësuar nga Konsulenti, janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Nisja	Destinacioni	Distanca (km)	Koha e udhëtimit (min)	Shpejtësia e udhëtimit (km/orë)
Pukë	Qelëz	15	34	26
	Hadroj – Gjegjan	34	66	31
	Gomsiqe	26	40	39
	Fushë Arrëz	23	40	35

Trafiku dhe mjetet alternative të transportit

Trafiku në përgjithësi është i ulët dhe është më intensiv gjatë fundjavave dhe periudhës së verës. SH-5 përqendron vëllimet më të larta të trafikut, kryesisht përgjatë seksionit Pukë - Hadroj - Fushë Arrëz (trafiku mesatar vjetor ditor ~ 1.300 automjete në ditë). Përqindja më e madhe (92%) e trafikut e përbëjnë autovetura dhe furgonë / minibusë.

Tabela më poshtë përmbledh lëvizjen e qarkullimit të automjeteve në njësi / orë, siç del nga transformimi i trafikut në qarkullimin e automjeteve të pasagjerëve (QAP), bazuar në përbërjen e trafikut dhe nga reduktimi i trafikut mesatar ditor vjetor (TMDV).

Seksioni nisjes	Seksioni britjes	Autovetura TMDV	Kamione TMDV	furgonë / minibusë TMDV	Totali	QAP/ Ditë	QAP/ Orë
Vau Dejës	Qafë Qelë	344	126	39	509	757	53
Qafë Qelë	Pukë	344	126	39	509	757	53
Pukë	Hadroj	872	320	99	1291	1920	134
Hadroj	Fushë Arrëz	872	320	99	1291	1920	134
Qafë Benë	Gjegjan	<338	<124	<38	<500	<743	<52
Gjegjan	Ura Kalivare	<338	<124	<38	<500	<743	<52
Ura Kalivare	Shkozë	<338	<124	<38	<500	<743	<52
Shkozë	Hadroj	<338	<124	<38	<500	<743	<52

Bardhët - Tuç	Qafë Bar	<338	<124	<38	<500	<743	<52
Qafë Laç (Khtesa Qafë Qelë)	Koman	<338	<124	<38	<500	<743	<52
Rruge Nacionale	Qelëz	98	2	0	100	103	7

Tabela 7.1.1: Fluksi i lëvizjes së automjeteve në rrjetin kryesor të transportit në Pukë (QAP / orë)

Trafiku mesatar ditor nëpërmjet SH-30, SH-25 dhe SH-43 është më pak se 500 automjete / ditë, shumica e të cilave janë automjete të lehta (autovetura/taksi/kamioncina/furgona/mikrobuze). Trafiku në qendër të Pukës, në kryqëzimin e saj qendror, është më pak se 200 automjete gjatë mëngjesit dhe gjatë orës së pikut të pasdites (respektivisht 190 dhe 55). Siç vërehet gjatë vizitave të Konsulentit në terren, trafiku përgjatë pjesës tjetër të rrjetit rrugor konsiderohet i papërfillshëm (duke iu referuar trafikut ndërqytetas, jo brenda qytetit të Rrëshenit), pra më pak se 100 automjete / orë dhe shumë herë - përgjatë rrjetit rural - më pak se 100 automjete / ditë.

Siç u përmend, trafiku i kamionëve është i kufizuar, pasi nuk është i favorizuar nga rrjeti rrugor i ofruar, sidomos përgjatë rrugës Hadroj-Gjegjan-Rreps (SH-30).

Si alternativë për transportin privat, përdoret motoçikleta dhe biçikleta, por ato janë kryesisht për udhëtime në distancë të shkurtër. Për transportin e udhëtarëve nga dhe në Pukë, për t'u shërbyer vendbanimeve të Bashkisë, përdoren furgonat. Por për shkak të gjendjes së rrjetit rrugor dhe numrit të ulët të banorëve, jo të gjithë vendbanimet janë shërbyer në këtë mënyrë. Shërbimet e autobusëve ofrohen për qytetet kryesore. Itineraret janë përmbledhur në tabelën më poshtë:

Nisja	Destinacioni	Stacioni	Itinerarari
Durrës	Pukë	Durrës	6:45
Lezhë	Pukë	Pranë Urës Lezhë	7:00
Tiranë	Pukë	Rr. Dritan Hoxha	5:00; 6:00; 7:00; 10:00

Tabela 7.1.2: Linjat e autobusëve që lidhin Bashkinë me qytete të tjera të Shqipërisë⁴⁹

Megjithatë, informacioni nga vizitat në terren është se në Tiranë ka 10 itinerare të ofruara çdo ditë (nga ora 5:00 deri në ora 14:30). Faqja e internetit të Bashkisë përmend 8 itinerare nga dhe në Tiranë (4 në çdo drejtim), katër itinerare në ditë nga dhe në Shkodër (2 në çdo drejtim), dy nga Kuksi, gjashtë nga Qeleza dhe 3 nga Gjegjani (2 nga Puka dhe 1 nga Qelëza). Vetëm dy itineraret e fundit janë verifikuar përmes pyetësorit, ku janë përmendur itineraret nga / në Durrës.

Përsa i përket sigurisë në rrugë, ekziston një vend përgjatë rrjetit rrugor që përqendron aksidentet rrugore dhe që është karakterizuar si "pika të zeza" bazuar në statistikat e periudhës 2008-2014. Ky vend ndodhet përgjatë SH-30, në Gjegjan. E gjithë SH-30 në Hardoj është treguar nga autoritetet si aks ku ndodhin aksidentet fatale dhe për këtë arsye është duke u zbatuar një projekt përmirësimi (përfshirë rehabilitimin e trotuareve, përmirësimin e sigurisë rrugore). Për periudhën 2015 – 2016 nuk na janë ofruar statistika.

Veç kësaj, vlen të përmendet se, struktura e përbashkët e të dhënave për të gjitha bashkitë shqiptare, si edhe dosjet e metadata që shoqërojnë shapefiles (bazuar në VKM Nr. 459, datë 16.06.2010) lehtësojnë shkëmbimin e informacionit midis njësive të ndryshme administrative, por edhe grumbullimin, në çdo moment, të informacionit nga administrata qendrore.

B) Identifikim dhe përditësim i informacionit të bazës së të dhënave

Për plotësimin e shp file me informacion, në përgjithësi u ndoq procedura e mëposhtme:

1. Identifikim dhe vlerësim i i gjithë të dhënave të disponueshme gjeohapësinore

Të dhënat hapësinore dhe përshkruese kanë ardhur nga (a) arkivi i Bashkisë, (b) shërbimet online kartografike dhe faqet e internetit të shërbimit si AKZM, INSTAT, (c) kërkesat e Shërbimit Teknik të Bashkisë drejtuar Shërbimeve Qendrore dhe Rajonale, dhe (d) të dhënat e mbledhura nga puna në terren.

Menjëherë pas marrjes së tyre, u bë një vlerësim për cilësinë, llojin (formatin digjital-analog) dhe plotësinë e informacionit.

Në rastet kur informacioni ishte analog u digjitalizuan (a) të dhënat që u konsideruan të nevojshme nga harta analoge ose të arkiva të tjera; b) të dhënat e mbledhura gjatë vizitës së punës në terren me qëllim identifikimin dhe përditësimin e përdorimit të tokës dhe të dhënave të tjera, si edhe të dhënat nga shërbimet online kartografike (WMS), bazuar në:

- Geoportalin ASIG (<https://geoportal.asig.gov.al/sq/sherbimet>)
- IMK (<http://imk.gov.al/Pages/Default.aspx>)
- AKBN (<http://185.30.147.99/AKBNPortal/Default.aspx>) dhe
- AKZM (http://akzm.gov.al/apps/akzm_cd/Index.htm).

Aty ku u konstatua se sistemi i projektimit i të dhënave primare digjitale ndryshonte nga sistemi i ri kombëtar i projeksionit (WGS 84 UTM 34N), u bënë transformime të sistemit të projektimit. Gjithashtu, janë konvertuar skedarë CAD në skedarë të përputhshëm me GIS (shapefiles).

2. Pastrim të versioneve të ndryshme të të njëjtit informacion duke mbajtur versionin më të përditësuar.
3. Kontroll i saktësisë së informacionit dhe përditësimi i tij përmes (a) vizitave në terren, (b) diskutimeve me autoritetet bashkiake dhe zyrtarët administrativë të njësisë, dhe (c) kontaktim me autoritetet kompetente.
4. Kategorizim i informacionit në 14 shapefiles që kanë lidhje me analizën dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese.
5. Plotësim i fushave të çdo shapefiles individuale me të gjitha të dhënat e disponueshme.

C) Arsyetim për mangësitë në bazën e të dhënave

Gjatë procesit të identifikimit të informacionit të disponueshëm dhe të përditësimit të tyre, u konstatua se ka disa mangësi në fusha të bazës së të dhënave. Më poshtë është një tabelë e shkurtër me pjesët që mungojnë nga shapefiles përkatëse.

SHAPEFILE_EMRI	FUSHA	KOMENTE
Infrastruktura Ujësjiellës Kanalizimeve (Arkiv poligonik)	Kategoria, Gjendja, Kapaciteti, Kuota	Në këtë shape file janë përfshirë të dhëna në lidhje me rrjetin e kanalizimit të qytetit të Pukës dhe infrastrukturën e ujitjes për disa zona të Bashkisë. Fusha "kapaciteti" nuk është plotësuar sepse nuk na janë dhënë informacione nga shërbimi i Drejtorisë Ujësjiellës Kanalizime, tek e cila Bashkia ka dërguar kërkesë (me shkresën e saj me Nr. Prot. 1539/6/8-8-2017). Gjithashtu, mangësi që janë vërejtur në këtë shapefile kanë lidhje me: <ul style="list-style-type: none"> • Në infrastrukturën e kanalizimit për vendbanimet e

		<p>tjera (përveç qytetit të Pukës). U dërgua kërkesë nga Bashkia drejtuar Drejtorisë së Ujësjetllës Kanalizimeve (me shkresën me Nr.Prot. 1539/6/8-8-2017) por nuk janë dhënë të dhëna.</p> <ul style="list-style-type: none"> Në infrastrukturën e ujësjetllës për gjithë vendbanimet e Bashkisë. U dërgua kërkesë nga Bashkia drejtuar Drejtorisë së Ujësjetllës Kanalizimeve (shkresa me Nr.prot. 1539/6/8-8-2017) por nuk janë dhënë të dhëna.
<p>Infrastruktura Ujësjetllës Kanalizime dhe Menaxhimi i Mbetjeve (arkiv shënues)</p>	<p>Kategoria, Lloji, Kapaciteti, Buffer</p>	<p>Në këtë shapfile janë regjistruar disa rezervuarë uji të pijshëm, të cilat janë identifikuar nga vizita në terren dhe të gjitha deponitë.</p> <p>Fusha "kapaciteti" nuk është plotësuar sepse nuk kemi marrë ndonjë informacion nga shërbimi i Drejtorisë Ujësjetllës Kanalizime në të cilin Bashkia ka dërguar kërkesën përkatëse për informacion (shkresa me nr. prot. 3464 / 28-7-2017).</p> <p>Fusha "Buffer" nuk u plotësua sepse nuk parashikohet nga legjislacioni ndonjë zonë mbrojtjeje përreth rrjeteve pikë të infrastrukturës.</p> <p>Gjithashtu, mungesa të tjera që janë vënë re në këtë shapfile kanë lidhje me infrastrukturën e ujërave të zeza, rezervuarët e ujit të pijshëm, stacionet e pompimit, ujësjetllësit, burimet, pusët e ujit. Për këto të dhëna, Bashkia ka dërguar kërkesë për informacion në Drejtorinë Ujësjetllës Kanalizimeve (shkresa me nr.prot. 3464 / 28-7-2017), por nuk ka marrë informacion.</p>
<p>Transporti Publik Pikë</p>	<p>Kategoria, Lloji, Niveli, Kapaciteti</p>	<p>Fusha "Kapaciteti" nuk është plotësuar, për shkak se nuk kemi pasur sqarime nga AKPT, pas pyetjeje që u dërguan me email më 25-8-2017 në lidhje me përshkrimin etributeve në shapfile.</p>
<p>Ndërtesa</p>	<p>Nr kate, Lartësia, Kate nën 0, Kate mbi 0, Gjendja fizike, Periudha e ndërtimit, Materiali, Funkzioni Primar, Funkzioni Sekondar, Statusi Ligjor, Përdorimi, Monument</p>	<p>Fusha "Kate nën 0" nuk është plotësuar, e cila ka të bëjë dhe i referohet kateve nën tokë. Për këtë fushë, nuk ka të dhëna nga Bashkia, deh as nuk është e mundur për tu identifikuar nga hulumtimi në terren. Si pasojë, nuk u plotësua fusha "Nr kate" që rezulton nga shuma e fushave "Kate nën 0" dhe "Kate mbi 0".</p>
<p>Përdorimi i Tokës</p>	<p>Bashkia, Sistemi, Kategori, Nënkategori, Përdorim specifik 1, Përdorim specifik 2, Përdorim specifik 3, I, Ksht, Kshp, Tipologjia Hapësinore</p>	<p>Fushat "I", "Ksht" dhe "Kshp" nuk janë plotësuar sepse nuk ekzistojnë për zonën e studimit ngaqë nuk ka studim të miratuar të planifikimit hapësinor.</p>
<p>Zona Rreziku Natyror</p>	<p>Lloji, Buffer, Përshkrimi</p>	<p>Fusha "Buffer" nuk është plotësuar sepse nuk parashikohet nga legjislacioni ndonjë zonë mbrojtjeje përreth zonave të rreziqeve natyrore.</p>

D) Plani i veprimit për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave në bazë të propozimeve të legjislacionit të planifikimit urban

Në mënyrë që bashkia të disponojë një bazë të plotë dhe të përditësuar të dhënash me të gjitha të dhënat me interes urban që lidhen me zonën e kompetencës, duhet të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

Ngritje fillestare e Bazës

- Së pari duhet të përcaktohet një seksion përgjegjës për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave i cili do të duhet të drejtohet nga personel i trajnuar dhe i pajisur me infrastrukturën e duhur (PC, software, etj). Shënohet se ky seksion do të kryesohet nga zyrtari përgjegjës, i cili do të ketë privilegje të veçanta të përdoruesit për bazën e të dhënave gjeohapësinore dhe do të jetë ai që do të jap miratimin përfundimtar për regjistrimin e organizuar të informacionit në bazën e të dhënave. Gjithashtu, në rastin kur ka të dhëna personale të ndjeshme do të jetë ai i cili mund të japë një leje shikimi, nëse kjo gjë konsiderohet e ligjshme dhe e përshtatshme.
- Më pas, duhet të hartohet një listë me të gjitha departamentet që mbajnë të dhënat që kanë lidhje me zonën e tij të përgjegjësisë (Ministri, Shërbime Teknike, Instituti Kombëtar i Statistikave, etj) dhe të krijohet një kanal komunikimi përmes korrespondencës për mbledhjen dhe përditësimin e të dhënave të Bashkisë. Para çdo kontakti me një palë të tretë, Bashkia duhet të sqarohet për secilin lloj të veçantë të informacionit, cila kërkohet të regjistrohet përmes fushave ekzistuese të Attribute Table secili shapefile, por edhe në bazë të përvojës së tij të përditshme dhe kërkesave.
- Më pas, Bashkia do të duhet të vlerësojë sistematikisht dhe të përditësojë të dhënat që vet ajo disponon të shpërndara në departamente dhe seksione të ndryshme të saj. Kjo fazë përfshin si punë zyre, e cila ka lidhje me njohjen dhe regjistrimin e versioneve të fundit të planeve dhe të gjithë informacionit relevant, ashtu edhe punë në terren, ku grupe të informuara për projektin do të dalin për të regjistruar të dhëna të cilat do të kalojnë më pas në bazën e të dhënave.
- Të dhënat e mbledhura nga Bashkia do të duhet të regjistrohen në shapefiles që përfshihen në Regjistrin e Integruar Territorial dhe në qoftë se kjo gjë nuk është e mundur do të duhet të regjistrohen shapefiles ndihmëse, të cilat do të duhet të respektojnë udhëzimet e regjistrimit shtetëror të informacionit gjeohapësinor p.sh. në lidhje me sistemin e referimit, fushat dhe llojin e informatave të regjistruara në to etj.
- Të dhënat e grumbulluara duhet të shoqërohen edhe nga metadata file (ku psh regjistrohet burimi nga i cili ato kanë ardhur, data e hartimit, saktësia hapësinore që kanë) me qëllim që të mund të kuptojë çdo përdorues sa të përditësuarat janë këto të dhëna të regjistruara dhe sa të vlefshme janë.

Mirëmbajtje e Bazës

- Për të ruajtur bazën e të dhënave të përditësuar, propozohet së Bashkia të ndjekë një proces të brendshëm të përditësimit dhe një të jashtëm. Procesi i brendshëm i përditësimit do të përfshijë të dhënat të ardhura të cilat depozitohen direkt në Bashki dhe në thelb nga qytetarët. Kështu psh miratimi i një lejeje të re ndërtimi çon në krijimin e një regjistrimi të ri të ndërtesës dhe ndoshta në një ndryshim në përdorimin e tokës të parcelës, pra çon në përditësim dokumentesh. Për mbarëvajtjen sa më të mirë të procesit të përditësimit të të dhënave mirë është të caktohet një periudhë kohore në të cilën do të bëhet përditësimi i tyre.

Në lidhje me procesin e përditësimit të jashtëm, duhet që Bashkia në periudha të caktuara kohore dhe periodikisht të paraqesë kërkesa të reja për institucionet e tjera, të cilat veprojnë në territorin e saj me qëllim për të mbledhur ndonjë të dhënë të re ose të përditësuar. Frekuenca e këtyre kërkesave në varësi të institucionit dhe të llojit të të dhënave mund të ndryshojë dhe të kryhet në periudha kohore në një gjashtëmuor apo në vit. Tabela e mëposhtme liston të dhënat dhe Institucionet e kërkimit të tyre.

Institucioni	Informacioni
AKM - Agjencia Kombëtare e Mjedisit	✓ Të dhëna mbi ndotjen në terren
ALUIZNI	✓ Zona informale dhe ndërtesa, planifikimi - projektet
ASIG	✓ Modelin e Dixhitalizimit të Terrenit të cilën dispononi në faqen zyrtare
Autoriteti i Mediave Audiovizive	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Antena radio dhe televizioni, nëse ka antena kërkojmë të dhënat e saj (lartësia e antenës, kapaciteti i transmetimit, etj) ✓ Kullat e antenës: kodi (nëse ka), tipi, administratori (operatori), kapaciteti i transmetimit, lartësia
Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH)	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Rrjeti rrugor (rrugë aktuale, mbulimi, kategorizimi, rrugë në projekt) ✓ Projekte në zhvillim/ të ardhshme në kuadër të promovimit të infrastrukturave rrugore dhe përfshirjes të tyre në zhvillim vendor
DAMT - Drejtoria e administrimit dhe mbrojtjes së tokës	✓ Të dhëna mbi fertilitetin e tokës (soil fertility)
Drejtoria e Arsimit	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Numri i objekteve arsimore për arsimin parauniversitar dhe numri i Profesoreve dhe Studenteve të institucioneve arsimore. ✓ Të dhëna për databazen GIS: Kopshti i fëmijëve: lloji, emri, kapaciteti/ Shkolla: lloji, emri, kapaciteti
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile	✓ Struktura e popullsisë (ndër vite , F , M ,Totali sipas viteve : 1988 , 1992, 1997 , 2001 , 2007, 2011 , 2015 ,2017
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Numri I bizneseve të ndara sipas N.Ad në vitet 2010-2017 ✓ Nr I të punësuarve /biznes në vitet 2010 - 2017 ndërtimit)
Drejtoria Ujësjetllës Kanalizime	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Të dhënat mbi furnizimin me ujë (nëse ka, cilat vendbanime shërbehen, distanca nga sipërfaqja e rrugës, diametri i tubacionit, gjatësia, materiali, viti i ndërtimit) ✓ Depozita (nëse ato ekzistojnë, cilat rajone shërbehen/përfitojnë, lartësia, niveli në lidhje me detin, thellësia, intensiteti gjatë vitit, materialet dhe lloji), ✓ Shpime ✓ Stacione të pompimit, rrjeti i kanalizimeve (tubacionet, diametri i tubacionit, gjatësia, materiali, pjerrësia, viti i ndërtimit) ✓ Pusetat e kanalizimeve (kushtet, madhësia, norma e rrjedhjes, niveli i tokës, materiali, forma, viti i ndërtimit)
EKB - Enti Kombëtar I Ndertesave	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Të dhënat për gjendjen dhe problemet e strehimit ✓ Të dhënat për projekte të ardhshme të strehimit social, numri i banesave, niveli i investimit, kohezgjatja, burimi i investimit.

IGJEUM - Instituti i Gjeoshkencave, Energjise, Ujit dhe Mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Të dhëna klimatike ✓ Të dhëna hidrologjike ✓ Të dhëna kimike në ujë etj. ✓ Gjeo-mjedisi ✓ Gjeo-burimet ✓ Ujëra të ndenjura ✓ Të dhëna të tokës ✓ Përmbytjet, zjarret, fatkeqësitë natyrore ✓ Përbërja e tokës (granit, rërë, baltë), të dhëna ujore (pozicioni, emri, funksioni)
IMK - Instituti i Monumenteve të Kulturës	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Informacion mbi monumentet - elementët kulturore (emri, kategoria, vendimi, pozicioni) ✓ Projekte në zhvillim/ të ardhshme në kuadër të promovimit të monumenteve kulturore dhe përfshirjes të tyre në zhvillim vendor.
INSTAT	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Të dhëna elektronike (p.sh. Popullsia për çdo vendbanim)
Instituti Gjeografik Ushtarak (IGJU)	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Ujërat sipërfaqësore
Instituti I Transportit (IT)	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Rrugët aktuale-kategorizimi, pika të rrezikshme ✓ Ruga: kategoria, kufijtë e shpejtësisë
MBZHRAU - Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Te dhena per Ullinj, vreshta, klasifikimi i tokës ✓ Te dhena per rreziqe të erozionit
MCV - Minister Shteti për Cështje Vendore	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Kufijtë administrativë
Ministria e Arsimit dhe e Sporteve	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Të dhënat mbi kapacitetet e shkollave dhe objektet arsimore. ✓ Projekte në zhvillim/ të ardhshme ne kuader se zhvillimit te kapaciteteve arsimore
Ministria e punëve të brendshme - drejtoria vendore e policies	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Rendi publik, siguria, niveli i kriminalitetit
Ministria e Energjisë dhe e Industrisë	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Industri farmaceutike (pozicioni i saktë, institucioni, vëllimi maksimal i lejuar në rajon, vëllimi e rezervuarëve) ✓ Industri të braktisura (kategoria, përshkrimi, adresa, sektori), magazina të substancave kimike (përshkrimi, kategoria emri, sektori) ✓ Karburante (adresa, aktiv apo joaktiv, institucioni, intensiteti maksimal dhe vëllimit i rezervuarit)
MSH - Ministria e Shëndetësisë	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Të dhëna mbi infrastrukturën shëndetësore (p.sh. lloji i infrastrukturës, mjaftueshmëria, problemet, numri i shtretërve). ✓ Te dhena per databazen GIS: Klinikat: emri, kapaciteti (shtretër)/ Spitali: emri, kapaciteti (shtretër)
MZHU - Ministria e Zhvillimit Urban	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Të dhënat mbi mbetjet e ngurta. ✓ Të dhënat deponitë. / Hapësira Urbane e Mbeturinave: emri, kategoria, përshkrimi, buffer. ✓ Të dhënat mbi pikat e nxehta.
Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të energjisë Elektrike (OSSHE)	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Rrjeti i energjisë elektrike. ✓ Gjatësia e linjave. ✓ Nëse është mbitokësor apo nëntokësor. ✓ Cili është tensioni i korrentit, kujt i shërben (punës, strehimit, industries). ✓ Nëse ka nënstacione në zonën e studimit dhe cilat rajonet shërbehen/përfitojnë.
Operatori mobil (Telecom, Vodafone Albania, Eagle Mobile)	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Telekomunikacioni (linjat e komunikimit në harta, kapaciteti, gjatësia, kodi, vendndodhja), ✓ Fibra optike, ✓ Cilat vendbanime shërbehen/përfitojnë nga lidhja e internetit wireless.

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Burime ✓ Puse ✓ Zona të përmytjeve dhe rrëshqitjes së dheut ✓ Zona sizmike ✓ Zona kodrinore me rrezik rrëshqitjeje: emri, kategoria, përshkrimi ✓ Zona me rrezik përmytjeje: emri, kategoria, përshkrimi ✓ Zona me rrezik sizmik: emri, kategoria, përshkrimi, buffer ✓ Te dhena me per databazen GIS: "Zona kodrinore me rrezik rrëshqitjeje: emri, kategoria, përshkrimi/ Zona me rrezik përmytjeje: emri, kategoria, përshkrimi/Zona me rrezik sizmik: emri, kategoria, përshkrimi, buffer.
Zyra Qendrore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme (ZQRPP)	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Zona kadastrale dhe katrorë (arkiva elektronike)
AKZM - Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Burime natyrore-zona të mbrojtura, gjëndja e burimeve ✓ Pemët të cilat janë shpallur monumente natyrore: diametri i trungut dhe kurorës, mosha, gjëndja e shëndetit ✓ Projekte në zhvillim/ të ardhshme në kuadër të promovimit të burimeve natyrore dhe përfshirjes të tyre në zhvillim vendor. ✓ Programe dhe projekte për shpalljen e malit të Munellës ose zonave të tjera si zona të mbrojtura (kufiri i zonës të mbrojtur, kategoria e zonës të mbrojtur, objekti i shpalljes të zones të mbrojtur, kohezgjatja e projektit). ✓ Projekte per zgjerimin e zonave te mbrojtura ekzistuese.
MM - Ministria e Mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Informacion mbi cilësinë e ajrit. ✓ Ndotjen akustike, për biodiversitetin. ✓ Të dhëna për hidrogeologjinë (p.sh. Përgjatë gjatësisë dhe gjerësisë së lumenjve). ✓ Pozicione dhe matje të stacioneve matëse (shpejtësia, furnizimi), përmytjet (kufijtë) ngjarje përmytjesh (data, rajoni i përmytur). ✓ Të dhëna mbi mbetjet, deponitë. ✓ Të dhëna mbi guroret, minierat.
MMSR - Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Të dhëna mbi mirëqenien sociale dhe varfërinë. ✓ Të dhëna mbi punësimin – papunësinë. ✓ Të dhëna mbi arsimin profesional (p.sh. Numri i studiuësve, specialiteteve). ✓ Të dhëna për personat me aftësi të kufizuar.

Theksohet se elementë të cilat kanë nevojë për përpunim dhe përfshirje në shapefiles mbahen edhe në Bashki, si të dhëna urbane, të dhëna mbi ndërtimin, licencimin, etj, dhe duhet që në periudha kohore të cilat gjykohen të nevojshme, të merren nga departamenti përkatës.

➤ Së fundi, duhet theksuar se të dhënat e bazës gjeohapësinore do të duhet të bëhen back-up javore në një network attached storage dhe në bazë mujore në një hard disk të jashtëm, i cili do të mbahet në një vend të sigurt jashtë ndërtesës ku mbahen dhe ruhen të dhënat.

Si përfundim, vlen të theksohet se baza e të dhënave e Regjistrimit të Integruar të Territorit përbën një pikënisje shumë të mirë për organizimin e informacioneve gjeohapësinore të Bashkisë në kategori me bazë standardet kombëtare. Megjithatë, struktura e ndarë e të dhënave në vetvete nuk zgjidh problemin ekzistues të ndarjes së informacionit në departamente të ndryshme dhe në arshiva të ndryshme, në thelb nuk kanë datë reference. Kështu duhet që, Bashkia duhet të studiojë me kujdes faktin se çfarë të dhënash duhet të regjistrojë dhe ti kërkojë ose në arkivën e vet ose në mënyrë të organizuar në terren përmes autopsive. Së fundi, përmes seminareve të familjarizimit me platformën GIS, nëpunësit e Bashkisë mund të përfshihen më drejtpërdrejt në procedurën e informimit dhe mirëmbajtjes së bazës dhe të largohen nga mentaliteti thjesht planifikues, që mbizotëron deri më sot në sektorin e planifikimit hapësinor.

Në kuadër të raportit të kapaciteteve të ndërtimit, që do të hartohet në një fazë të mëvonshme të studimit, do të hetohet dhe analizohet nëse ky model i regjistrimit, përpunimit dhe ruajtjes së informacionit, me organizimin e tij në files tematike të integruara në kategori më të mëdha, përmbush nevojat Bashkiake, ose kërkohet të konfigurohet në mënyrë të përshtatshme në nivel të të dhënave geodatabase.

12. VLERËSIMI TE DHËNAVE, PROBLEMEVE DHE PERSPEKTIVAVE

Bazuar në atë që është paraqitur në kapitujt e mëparshëm, në analizën dhe vlerësimin e të dhënave, paraqiten më poshtë konkluzionet kryesore për gjendjen aktuale të Bashkisë, avantazhet e veçanta të Bashkisë, dobësitë e identifikuara, potenciali i zhvillimit dhe perspektivat e Bashkisë, si dhe dhe vështirësitë që mund të hasen nga Bashkia.

Si **avantazhe** (Strengths) të rëndësishme përmenden fillimisht sa më poshtë vijon:

- Mjedis i pasur dhe i qetë natyror me vlerë të rëndësishme kulturore dhe ekologjike
- Peisazhe të paprekura dhe të bukura.
- Afërsia me qendrën urbane Shkodër e cila ofron shërbime me cilësi të lartë.
- Ekzistenca e njësive themelore të mikpritjes – ushqimit traditë të fortë dhe të gjatë kulturore.
- Burime të shumta të ujit të pijshëm të pastër, të përshtatshëm për amballazhim në shishe.
- Njohje e rajonit përmes produkteve të standartizuara bujqësore.

Më poshtë shënohen **pikat e dobëta** (Weaknesses) të Bashkisë dhe konkretisht:

- Mungesë nga territori i bashkisë i rrugëve kryesore kombëtare dhe ndërkombëtare - mungesë qasjeje e vendbanimeve jashtë rrjetit të rrugëve kryesore.
- Pamundësi për të tërhequr fonde të mjaftueshme për investime.
- Infrastruktura teknike urbane papërshtatshme dhe të pamjaftueshme (p.sh. furnizimi me ujë, kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave).
- Ulje e numrit të popullësisë dhe plakja e saj.
- Braktisja e vendbanimeve malore dhe fshatrat e largëta nga banorët e tyre.
- Numër i kufizuar dhe cilësi e ulët e infrastrukturës së turizmit dhe rekreacionit.
- Ndërtesa të shpërndara jashtë kufijve zyrtarë dhe ekzistenca e ndërtesave informale.

Potenciali më i rëndësishëm i zhvillimit - mundësi (Opportunities) të rajonit, në raport edhe me ambientin e jashtëm, përmbledhen në:

- Hapësira përmirësimi i rrjetit të brendshëm rrugor (lidhje e selisë me njësitë administrative) dhe lidhja rrugore me bashkitë fqinje (kryesisht Mirditë).
- Tendencat të rritura të zhvillimit të ekoturizmit në vend dhe jashtë vendit.
- Zbatimi / Programim ndërhyrjeve të rëndësishme (a) rigjenerimit urban që rrisin funksionin dhe imazhin e qytetit të Pukës, (b) Infrastrukturës sociale (Pallati i Sportit) që përmirësojnë jetën shoqërore dhe mundësitë rekreative, dhe (c) ndërtimin e banesave sociale për grupet në nevojë.
- Interesi i Bashkisë për projekte dhe investime për të krijuar vepra të reja dhe ndërhyrjeve në ekonomi, duke u fokusuar në format e buta dhe alternative të turizmit (p.sh. turizmi rural, turizmi dimëror).
- Kthimi i banorëve të cilët kishin emigruar brenda dhe/ose jashtë vendit me njohuri dhe mundësi financiare.
- Shfrytëzimi i trendeve ndërkombëtare të kërkesës për produkte cilësore lokale agro-ushqimore.
- Shfrytëzimi i instrumenteve financiare dhe fondeve nga BE dhe organizatat ndërkombëtare,
- Afërsia me destinacione kryesore dhe të njohura turistike.
- Bashkëpunim i mirë dhe i vazhdueshëm me bashkitë fqinje dhe institucione (p.sh. OJQ) për çështje që kërkojnë bashkëpunim ndër-bashkiak.

Së fundi, disa **rreziqe** (Threats) për zhvillimin e Bashkisë nga mjedisi i jashtëm:

- Pamundësi lidhjeje me autostradën (E851) Lezhë-Rrëshen-Kukës dhe konsolidim i pozitës marginale në lidhje me rrugët kryesore turistike.
- Politikë - strategji inekzistente kombëtare dhe rajonale për zonën malore (p.sh. mungesë të një kuadri zhvillimi dhe stimujve).
- Financim inekzistent i ndërhyrjeve të synuara–paaftësi për të përdorur burimet e disponueshme (p.sh. mungesë e planifikimit, mungesë e strukturave të duhura bashkiake).
- Pamundësi për të përshtatur standardet bashkëkohore në fermat bujqësore dhe blegtorale (p.sh. kostot e larta, mungesa e institucioneve dhe praktikave të duhura).
- Dëshira e banorëve të rinj për tu larguar nga bashkia për plotësimin e dëshirave të tyre personale apo për të gjetur punë.

13. REFERENCAT

- Aliaj S. et al., *Seismicity, seismotectonics and seismic hazard assessment in Albania*, Academy of Science of Albania, 2010
- Agoruka, *Vlerësimi i Shpejtë i Zhvillimit të Zinxhirit të Vlerës së Turizmit në Zonën e Pukës*, 2016
- Agropuka, *Gjendja e bimëve mjekësore – tanifere dhe frutave të pyllit në territorin e Bashkisë Pukë*
- Bashkia Pukë, *Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Pukë*, 2008
- Bashkia Pukë, *Plani Operacional i Zhvillimit Vendor*, 2016
- Bashkia Pukë, *Guida Turistike*, 2017
- Bicaj Z., *Raport shkencor me titull “Përpilimi i Hartës Gjeologjike dhe Pasurive Minerale të rrethit të Shkodrës në shkallë 1:50000 dhe teksti sqarues”* AQGJ, Tiranë, 2000
- Co-PLAN, *Towards Regional Operational Programming*
- Demek, J., *Manual of detailed geomorphological mapping*. Academia, Prague, 1972
- Dicau, R., *The application of a digital relief model to landform analysis*, Taylor and Francis, London, 1989
- Doda V. et al., *Albanian Geological Survey.ppt*
- Duraj A., *Relacion gjeologjik mbi punimet e kërkim-revizionimit në rojonin e Lekgjonajve*, AQGJ, Tiranë, 1985
- FZHSH, *Plani Rajonal Shkodër-Lezhë 2005-2020*, Eptisa, 2006
- Howard G. & Bartram J., *Sasia e ujit për përdorim familjar, Sherbimi, Niveli dhe Shëndeti*, WHO/SDE/WSH/03.02, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2003
- INSTAT, *Tipologjia e njësive vendore/ komunave*, 2014
- Kennedy C., Cuddihy J. and Engel-Yan J. (2007), *The changing metabolism of cities*, Journal of Industrial Ecology, vol. 11 (2),
- Këshilli i Qarkut Shkodër, *Skenarët e Zhvillimit Nënrajonal në Qarkun Shkodër*, 2015
- Këshilli i Qarkut Shkodër, GTZ, *Koncepti Strategjik i Zhvillimit Rajonal*, 2010
- Konomi N., *Harta gjeologo-inxhinierike e Shqipërisë në shkallë 1:200.000*, 1998
- Ledio Allkja, *Changing Planning Cultures - The Case of Albania*, July 2012
- Muço B. et al., *Seismic zonation in Albania using a deterministic approach*, 2000
- Peter A. Christopher, *Technical summary report, Mirdita Project, Albania*, Tirez Resources LTD, 2007
- Rabe Paul, Toto Rudina, Dhima Sibora, *Analyzing the Likely Impact of European Union Policies on Territorial Planning in Albania - Policy Brief*, Mars 2013
- SHGJSH, *Gjeologjia - Gjeoresurset – Gjeorreziqet dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë*, 2016
- Sfera Studio Arkitekture, *Hartimi i projekt-preventiv të zbatimit për rikualifikimin urban të qendrës dhe liqenit të vogël të qytetit të Pukës - Raporti teknik i arkitekturës*, Dhjetor 2016
- UNDP, *Integrated Support for Decentralization Project “Working for Regional Development”*, Regional Disparities in Albania, 2010

Universiteti Polis, Arizona State University, Metropolis sh.p.k, Bashkia Shkodër, *Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Shkodër*, 2016

USAID, *Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit në Shqipëri- Manual Teknik*

Velaj T, *New ideas on the tectonic of the Kurveleshi anticlinal belt in Albania, and the perspective for exploration in its subthrust*, Review article, Ke Ai journal, Petroleum 1, 2015

Zdruli P., Lushaj S., *“Overview of soil information and soil protection in Albania” (ppt)*

Xhomo A., *Gjeologjia e Shqipërisë. Stratigrafa, Magmatizmi, Metamorfzmi, Tektonika, Neotektonika dhe Evolucioni Paleogeografik dhe Gjeodinamik*, 2002

PLANET DHE STRATEGJITË

Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin, 2015-2030

Plani i Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës, 2015-2030

Plani i Përgjithshëm Kombëtar, 2015-2030

Plan Kombëtar të Veprimit për Burimet e Energjitë e Rinovueshme 2015-2020

Programi strategjik afatshkurtër dhe afatmesëm 2015-2020 nga AKZM

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin 2014-2020

Strategjia Ndërsektorale për Zhvillimin Rajonal

Strategjia Ndërsektorale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014 – 2020

Strategjia Kombëtare për Turizmin 2014-2020

Strategjia Ndërsektorale e Mjedisit 2007-2013

Strategjia Kombëtare e Biodiversitetit

Strategjia kombëtare sektorale e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017

Strategjia Kombëtare e Energjisë

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve

Strategjia e Sektorit të Transportit

FAQET E INTERNETIT

<http://imk.gov.al/Pages/Default.aspx>

<http://akzm.gov.al>

<http://akbn.gov.al>

<http://albania.usaid.gov/>

<http://www.instat.gov.al/en/Home.aspx>

<http://www.planifikimi.gov.al/?q=content/planet>

<http://mbetjet.zhvillimiurban.gov.al>

<http://aea-al.org/wp-content/uploads/2014/07/Geological-Overview-Albania.pdf>

<http://lukasmartinelli.ch/gis/2016/04/03/openstreetmap-noise-pollution-map.html>

https://www.numbeo.com/pollution/country_result.jsp?country=Albania

<https://www.britannica.com>

<http://diss.rm.ingv.it>

<http://www.moh.gov.al/>

<https://www.google.gr/publicdata>

<http://data.worldbank.org/indicator/EG.USE.PCAP.KG.OE/countries/AL?display=graph>

http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/67884/1/WHO_SDE_WSH_03.02.pdf

<http://www.dpuk.gov.al/rub.php?idr=345&lang=1>

http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Monitorim_Mjedisor/Mbetjet.pdf : «Tabela e sasisë së mbetjeve për vitin 2013»

<http://data.worldbank.org/indicator/EG.USE.PCAP.KG.OE/countries/AL?display=graph>

ANEKS

1. KONSULTIMI ME PUBLIKUN

U organizuan takime me një numër të Institucioneve rajonale, me qëllim për t'u njohur me përmbajtjen dhe objektivat e studimit PPV, të ofrojnë të dhëna në fushën e tyre të interesit dhe të shprehin pikëpamjet e tyre mbi çështjet që i prekin ato.

Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Shkodër

U zhvillua takim në datën 07.09.2017 me Drejtoreshen e DRKK Majlinda Lacaj dhe arkitektin Josel Radovani, nëpunës i DRKK, në të cilin u diskutuan çështje që lidhen me mjedisin kulturor të bashkisë Pukë. U zhvillua bisedë në lidhje me gjendjen e monumenteve të shpallura dhe zonat e mbrojtura, të monumenteve kulturore, si edhe për çdo problem që mund të ekzistojë. Ndërkohë, gjatë këtij takimi nuk është përmendur ndonjë problem i veçantë, me përjashtim të faktit se në disa monumente gjenden në zona të pronës private dhe kështu veprimi i shërbimit ndeshet me disa pengesa shtesë. Aktualisht, nuk ka monumente të reja apo zona të reja për tu shpallur të mbrojtura, me propozim të këtij Shërbimi.

Bashkëpunimi me këtë shërbim ishte shumë i mirë dhe na dhanë materiale informative (vendime, harta, fotografi, etj) për monumentet e shpallura kulturore.



Drejtoria Rajonale e Mjedisit Shkodër

U krye një takim në datën 30.08.2017 me drejtorin e shërbimit, z. Klodian Kovaçi (Drejtor në DRM Shkodër), ku u diskutuan shumë çështje që prekin mjedisin natyror dhe ujërat. U sqarua se DRM këshillon në lidhje me procesin e licencimit për përshtatshmërinë mjedisore apo papërshtatshmërinë mjedisore dhe barrën e mundshme të shkaktuar nga aktivitetet e investimeve të planifikuara të biznesit.

- Mbeturinat

Janë, sipas vlerësimi të shërbimit, një nga problemet më të rëndësishme, kur bëhet fjalë për rastet e disponimit të pakontrolluar. Ky problem nuk është i dukshëm në Bashki për shkak të popullsisë relativisht të vogël dhe ekzistencës së 2 deponive brenda rajonit të saj

- **Mjedisi natyror**

U diskutua gjendja e përgjithshme e mjedisit natyror në bashki dhe mundësia e ekzistencës së problemeve dhe i burimeve të ndotjes, por nuk u shfaqën probleme të rëndësishme dhe probleme mjedisore. Nuk disponojnë informacion mbi investimet e programueshme, apo projekte me ndikim të madh në mjedis.

Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së tokave (DAMT) Shkodër

Në takim në datën 31.08.2017 morën pjesë zyrtarët z. Ruzhdi Handraj dhe z. Skender Laçi, nga të cilët, i pari është nëpunës i zyrës së Shërbimit në Shkodër dhe i dyti është nëpunës i shërbimit në Pukë. Na paraqitën tabela analitike dhe të përqëndruar për çdo fshat të Bashkisë në lidhje me kategoritë e fertilitetit të tokës bujqësore. U theksua se në kategoritë e tokës 1 deri 4 nuk lejohet ndërtimi.



Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Shkodër

Në takimin në datën 30.08.2017, në të cilin morën pjesë drejtori z. Tonin Marku dhe znj. Sabrina Kuçi, arkitekt, u diskutuan çështje me interes për këtë Shërbim. Në mënyrë të veçantë, u theksua çështja për ndërtimet informale në qytetin Pukë dhe na informuan se nuk ka zona nën presion urban për shkak të ndërtimit të paligjshëm, përtej shtesave të zakonshme në ndërtesat ekzistuese dhe rasteve individuale të ndërtimit të paligjshëm në fshatra. Meqë rezultuan zona joformale, të cilat sot nuk janë të dukshme për momentin, atëherë do të duhet të kryhen studime të planifikuara urbanistike për këto zona. U theksua se një nga problemet kryesore të Shërbimit ka të bëjë me informacionin që ZVRPP duhet të ofrojë dhe të cilat shpesh herë nuk ofrohen ose kur ofrohen janë të pasakta. Së fundmi, na dhanë të dhëna në format dixhital.

AKZM / Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura (AdZM) Shkodër

Gjatë takimit në datën 30.08.2017 me punonjësën e AdZM, z. Tonin Maçaj, u diskutuan çështje më të gjera mjedisore, dhe në veçanti çështje të tilla si mundësia e deklarimit të zonës së mbrojtur të mjedisit natyror në rajonin Munella, i cili është në një fazë shumë të hershme.

Në bashkinë e Pukës nuk ka zona të deklaruara të mbrojtura të mjedisit natyror dhe për momentin nuk planifikohen projekte mbrojtjeje apo promovimi.



Agjensia e Basenit Ujor DRIN-BUNË

Gjatë diskutimit në datën 30.08.2017 me z. Martin Pllumbi, Drejtor, dhe znj. Rajmonda Guri, nëpunëse, u shpjegua hierarkia e shërbimeve të administrimit:

- Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU)
- Sekretariati i KKU
- Këshilli i Basenit Ujor
- Agjensia e Basenit Ujor (ABU) Drin-Bunë.

Kjo e fundit është shërbimi teknik që vlerëson projektet e propozuara hidroenergjetike dhe jep leje përkatëse të përdorimit të ujit si pjesë e procesit të autorizimit, nëse ato janë të një kapaciteti më të vogël se 2 MW kapaciteti të instaluar. Ka lëshuar licenca të përkohshme për aplikime për ndërtimin e projekteve hidroelektrike në bashkinë Pukë përkatësisht HEC Porav dhe Bujon, për HEC Kabash në lumin Vameçesh, si edhe 2 aplikime për lumin Gominë dhe 2 për lumin Lumi i Dardhës.

Është miratuar Rregullorja për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm (VKM nr.379, datë 25.05.2016), por nuk është autoriteti kompetent për këtë qëllim. Në nivel lokal, përgjegjësinë e ka Drejtoria e Shëndetësisë së çdo Bashkie dhe në nivel kombëtar Drejtoria e Ministrisë së Mjedisit. Përveç kësaj, Shërbimi Gjeologjik Kombëtar është përgjegjës për licencat e shfrytëzimit të ujërave nëntokësore dhe nëntokësore.

ABU Drin-Bunë nuk planifikon dhe aktualisht nuk ka ndonjë projekt për pellgun e lumit.



2. KONSULTIMI ME GRUPET E INTERESIT DHE AKTORË TË NDRYSHËM

Prezantimi i rezultateve të fazës A' për administratën dhe nëpunësit e Bashkisë, si edhe për faktorët e shërbimeve të ndryshme, u zhvillua në Bashki më 07.09.2017. Gjatë diskutimit u trajtuan çështjet e mëposhtme:

- 1- UNDP ka një program për dixhitalizimin e Bashkisë, dhe do të ishte mirë të kërkohej nëpërmjet planeve të veprimit edhe dixhitalizimi - inventarizimi i zonave të tjera të Bashkisë Pukë.
- 2- Në krahinën Delmace janë disa godina shtetërore, publike në pronësi të Ministrisë së Pushtetit Vendor, dhe për të pasqyruar këto ndërtesa - godina duhet të vihet në dispozicion nga Bashkia, Harta ku ndodhen këto prona - të cilat i kërkon Bashkia Pukë.
- 3- Ndarja administrative e re e Bashkisë nuk është konform të gjitha rregullave për ndarjet kufitare, ku në të gjitha rastet aplikohet ndarja sipas vijës ujore, pra dhe Bashkia Pukë duhet të kishte territorin e saj pikërisht poshtë lumit Drin, ndërkohë që aty shtrihet Bashkia Velipojë
- 4- Në Pukë ndodhen 50 shpella.
- 5- Qelëza është një vend ku po drejtohen investimet në Pukë, sepse ka afërsi me Komanin-Fierzën dhe gjithashtu donator të huaj si Gjermania, kanë investuar duke realizuar rrugë rurale dhe rrjetin ujësjellës rural.
- 6- Në Liqenin e Fierzës dhe në luginën që sot është, sipas reformës administrative, nën juridiksionin e Bashkisë Vau i Dejës, një firmë Turke e cila ka vendosur disa mjete peshkimi, dhe duke marrë shkas nga çfarë spjeguar më lart- në pikën 3, kompania turke nuk mund të punojë aty pa dijeninë tonë kur ne pretendojmë që ajo është pjesë territoriale e Pukës. Duhet të rishikohet kufiri administrativ. Mbase ka qenë gabim i grupit të punës që ka përcaktuar kufijtë administrativë, një gabim në shkallë që ka sjellë këtë ndryshim të kufijve, por që duhet të rishikohet jo vetëm për Bashkinë e Vau të Dejës, por edhe për zonën e Gjeganit. Sipas arshivës dhe kërkesave të Bashkisë Pukë, për të rikthyer të gjithë zonën e

- Gjegjanit në territorin e tyre, Bashkia i është drejtuar zyrtarisht Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe ata janë në process shqyrtimi të kërkesës së Bashkisë në lidhje me legjitimitetin.
- 7- Në territorin e Bashkisë Pukë ndodhen dy kompani të cilat kryejnë investime në nxjerrjen e ujit të një cilësie të mirë, sikurse është Lejthiza.
 - 8- Janë disa sipërfaqe ujore, rezervuare, liqene drejt të cilave nuk ka rrugë, për të bërë të mundur aktivitetin e peshkimit, pasi vihet re një interes i madh për peshkim dhe njerëzit duan të vizitojnë këto zona.
 - 9- Do të dëshironim që Puka të kishte qendrën - selinë në Qelëz.
 - 10- Ndërtim i teleferikut nga Krraba në Pukë për shërbim në bujtina, sepse në zonën e Krrabës është një sipërfaqe e sheshtë e cila është e mjaftueshme për të vendosur stacionin e teleferikut.
 - 11- Kujdes me faunën në Munellë, kafsha e famshme e gjendur në këtë zonë është Rrëqebulli. Rrëqebulli ballkanik (latinisht: Lynx lynx martinoi ose Lynx lynx balcanicus) është një nënloj i llojit të rrëqebullit evropian në gjininë e rrëqebullit. Haset më së shpeshti në lindje dhe në veri të Shqipërisë dhe në perëndim të FYROM, dhe ka një pakicë shumë të vogël edhe në Kosovë dhe Mal të Zi.
 - 12- Është shumë e rëndësishme të merret parasysh dhe të studiohet mënyra e zhvillimit urban të qytetit të Pukës.
 - 13- Një projekt i rëndësishëm për Bashkinë Pukë është lidhja e Shkodrës me liqenin e Komanit dhe me Kukësin. Kjo zonë ka vlera të larta turistike si dhe resurse natyrore të rëndësishme në mënyrë që të zhvillojnë këtë zonë të re, një rivierë e cila mundet të krahasohet me rivierën e jugut. Ky projekt është qëllim personal i kryetarit të Bashkisë, i cili dëshiron ta arrijë gjatë periudhës së qeverisjes së tij.
 - 14- Për landfillet, Bashkia shpreh interes më shumë jo në ndërtimin e një landfilli për përpunim, por në ndërtim pike transportimi të mbetjeve.



3. KËSHILLIMI PUBLIK E PARË

Takimi filloj ne ora 11 dhe perfundoj në 12.40. Moren pjese nga AKPT, Bashkia, Institucionet vendore dhe banore të zonave perreth. Sygjjerme dhe komente nga pjesmarësit janë si më poshtë:

	Çështja e ngritur	Mënyra e zgjidhjes/integrimit nga studimi
1	Drejtori i Drejtorisë Arsimore Pukë theksoj a) ndërtimin e shkollës në Qendër se mungon, b) parashikimin e projekteve për ngrohjen e shkollave në të gjithë bashkinë, c) digitalizimi i sistemit të shkolles për nxënës që janë në distanca të largeta apo njohja me të rejtat e shkences nga përdorimi i internetit në shkolla.	Problemet në infrastrukturën e trajnimit u identifikuan nga studimi. Propozime për zgjidhjen e tyre do të përfshihen në fazën tjetër, duke marrë parasysh gjetjet e këtij konsultimi.
2	Ndërtimi i nje spitali rajonal për shkak se klima është mjaft e mirë për kurimin e disa sëmundjeve të mushkrive etj. Mungojnë specialistet e mirefilltë pothuajse në të gjitha fushat.	Propozimi për një spital të ri do të merret parasysh në fazën e ardhshme. Mungesat në personale janë identifikuar nga studimi dhe do të adresohen përmes propozimeve përkatëse në fazat e ardhshme.
3	Pavaresisht se fshtrat nuk kane shumë banorë, ato duhet të lidhen me rrugë sepse njerëzit që jetojnë aty meritojnë respekt, për perpjekjet e tyre dhe me zhvillimin e zonave të mundohen te kthejnë banorë të tjerë në keto vendbanime.	Gjendja e rrjetit rrugor dhe rëndësia e lidhjeve të kënaqshme dhe të sigurta rrugore për zhvillimin e Bashkisë theksohen në fazën A dhe propozimet përkatëse do të bëhen në fazat e ardhshme.
4	Në fshatin Kabash ndodhet jo vetem Kisha, por edhe Xhamia e Vjeter e cila nuk është përmendur në materil, gjithashtu ndodhet dhe Hidrocentrali nje financim privat. Mungon lidhja e këtyre tre aseteve më rrugën për në Bashki.	Të gjitha të dhënat e raportuara janë identifikuar gjatë fazës së parë. Fizibiliteti i tyre dhe mënyra e lidhjes së tyre do të merret në konsideratë në fazën e ardhshme.
5	Të ndryshoj vendodhja e landfillit, pasi është nje impakt negativ për të gjithë vizitorët që në hyrje të Pukës prezantohen me mbeturinat dhe djegien e tyre.	Vendi dhe lloji i landfillit dhe mënyra e funksionimit të tij janë regjistruar në këtë fazë. Propozime për përmirësim, rehabilitim ose transferim do të merren parasysh në fazën tjetër.
6	Në fshatarat e Pukës mungon uji i pishem mëgjithese uje mbitokesor dhe nëntokesor ka plot Duhet të planifikohet ujsejelles në çdo fshat.	Kjo çështje është regjistruar nga faza e parë e projektit. Propozime relevante do të përfshihen në fazat e ardhshme.
7	Listimi i dy lumenjeve Kumina dhe Rrapaj si pjese e sipefaqeve ujore në materialet që shkruhen.	Rrjeti hidrografik u analizua në total në raportin teknik dhe në harta, dhe u morën në konsideratë studimet përkatëse të disponueshme.
8	Për objektet e kultit duhet parë mundësia e zhvillimit të tyre dhe pergjegjesi për këtë ka Ministria e Kulturës.	Kjo çështje do të shqyrtohet në fazat e ardhshme.
9	Izolimi për nje kohe të gjate ka sjelle dhe një gjë pozitive së Puka është ruajtur dhe tashme plani është në periudhen me të mire për të marre në konsideratë planifikimin e zhvillimit strategjik.	Çështja e izolimit është analizuar në shumë mënyra dhe do të trajtohet në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm të Bashkisë në fazën e ardhshme.

